



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**

Disertacion

Paraqitur nga:

Ma. Merita ISARAJ

Për gradën shkencore:

DOKTOR I SHKENCAVE

Specialiteti: Gjuhësi (Sintaksë)

**TEMA: “FJALITË NXITËSE E DËSHIRORE NË GJUHËN
ANGLEZE VËSHTRUAR NË PËRQASJE ME ATO NË
GJUHËN SHQIPE”**

Udhëheqës shkencor: *Prof. asoc. Shpresa SHAMBLLI*

Tiranë, 2015



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**

Disertacion

Paraqitur nga:

Ma. Merita ISARAJ

Për gradën shkencore:

DOKTOR I SHKENCAVE

Specialiteti: Gjuhësi (Sintaksë)

**TEMA: “FJALITË NXITËSE E DËSHIRORE NË GJUHËN
ANGLEZE VËSHTRUAR NË PËRQASJE ME ATO
NË GJUHËN SHQIPE”**

Udhëheqës shkencor: *Prof. asoc. Shpresa SHAMBLLI*

Mbrohet më datë _____ para jurisë:

1. Prof. dr. Nonda Varfi _ _ _ _ _ Kryetar (Oponent)
2. Prof. dr. Ilo Stefanllari _ _ _ _ _ Anëtar (Oponent)
3. Prof. dr. Shpresa Delija _ _ _ _ _ Anëtar
4. Prof. asoc. Elida Tabaku _ _ _ _ _ Anëtar
5. Prof. asoc. Esmeralda Kromidha _ _ Anëtar

Tiranë, 2015

P Ë R M B A J T J A

FALËNDERIME	iv
HYRJE	v
§0.1. Përligjja e punimit	v
§0.2. Objekti dhe hipotezat e punimit	vii
§0.3. Metodologjia dhe struktura e punimit	ix

KAPITULLI I

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM TEORIK I FJALIVE NXITËSE NË GJUHËN ANGLEZE DHE NË GJUHËN SHQIPE

	1
§1.1. Përkufizimi i fjalisë. Klasifikimi i saj në gjuhën angleze	1
§1.1.1. Klasifikimi i fjalive në gjuhën angleze sipas strukturës dhe qëllimit të kumtimit .	2
§1.1.2. Tipologjia e studimeve të fjalive nxitëse në gjuhën angleze	6
§1.1.3. Përkufizime dhe tipizime të fjalive nxitëse në gjuhën angleze nga pikëpamja formale-gramatikore	8
§1.1.4. Klasifikimi i fjalive në gjuhën shqipe sipas strukturës dhe qëllimit të kumtimit ...	13
§1.2. Fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe fjalitë nxitëse-dëshirore në gjuhën shqipe	17
§1.3. Fjalitë nxitëse në këndvështrimin gjenerativist dhe gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe ...	22
§1.3.1. Lëvizjet sintaksore në strukturën e thellë dhe sipërfaqësore të fjalive nxitëse dhe diagramet e përfutuara nga transformimet e ndodhura	26
§1.3.2. Bashkëpërkime të fjalive nxitëse në gjuhën angleze me fjalitë performative në strukturën e thellë	30
§1.4. Sjellja sintaksore e kryefjalës në fjalitë nxitëse në vështrimin gjenerativist	33
§1.4.1. Pozicioni i kundrinorit në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe gjegjësit në gjuhën shqipe	35
§1.4.1.2. Klitikët, pozicioni dhe sjellja e tyre në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe dhe gjegjëset e tyre në gjuhën angleze	36
§1.5. Projektimi i fjalive nxitëse krahasuar me fjalitë dëftore dhe pyetëse	42
§1.6. Përfundime të kreut.....	44

KAPITULLI II

VEÇORI TË PËRGJITHSHME GRAMATIKORE TË FJALIVE NXITËSE NË GJUHËN ANGLEZE DHE NXITËSE-DËSHIRORE NË GJUHËN SHQIPE

	47
§2.1. Veçoritë morfologjike të fjalive nxitëse në gjuhën angleze krahasuar me gjegjëset në gjuhën shqipe	47
§2.1.1. Kategoritë gramatikore tipike të foljeve në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe	48
§2.1.2. Shprehja morfologjike e fjalive nxitëse-mohore	56
§2.2. Valenca e foljes-kallëzues në fjalitë nxitëse	58
§2.3. Veçoritë sintaksore të fjalive nxitëse në gjuhën angleze krahasuar me gjegjëset në gjuhën shqipe	59
§2.3.1. Tiparet dalluese të kryefjalës në fjalitë nxitëse	62
§2.3.2. Veçori dalluese të fjalive nxitëse në gjuhën angleze me foljen <i>let</i> dhe gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe	64

§2.3.3. Veçoritë dalluese të thirrorit në strukturën e fjalive nxitëse	66
§2.4. Folja ndihmëse <i>do</i> me funksionin përforcues të kumtimit të fjalive nxitëse (<i>do-emphatic</i>)	68
§2.5. Përfundime të kreut.....	71

KAPITULLI III

VEÇORITË SEMANTIKE TË FJALIVE NXITËSE NË GJUHËN ANGLEZE DHE NË GJUHËN SHQIPE 73

§3.1. Vështrime të ndryshme rreth anës kuptimore të fjalive nxitëse në gjuhën angleze	73
§3.2. Veçoritë semantike të fjalive nxitëse në gjuhën angleze	78
§3.2.1. Vlera e kontekstit social në përdorimin e fjalive nxitëse	85
§3.3. Vlera kuptimore kushtore të fjalitë nxitëse në gjuhën angleze vështruar në përjasje me gjegjëset në gjuhën shqipe	90
§3.4. Tipare të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në fjalitë nxitëse	97
§3.4.1. Vlera kuptimore e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme	100
§3.4.2. Fjali nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme që shprehin urdhra, kërkesa, këshilla, oferta, ftesa	104
§3.4.3. Vlera gjuhësore e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe	107
§3.5. Bashkëpërkime në përbërës semantikë midis fjalive nxitëse me fjalitë dëftore dhe pyetëse në gjuhën angleze	109
§3.6. Përfundime të kreut.....	111

KAPITULLI IV

VEÇORITË SINTAKSORE DHE SEMANTIKE TË FJALIVE NXITËSE NË GJUHËN ANGLEZE NË PËRQASJE ME GJEGJËSET NË GJUHËN SHQIPE NË LIGJËRIMIN E SHKRUAR DHE NË LIGJËRIMIN E FOLUR 113

§4.1. Përdorimi i fjalive nxitëse në ligjërim	113
§4.2. Veçori sintaksore dhe semantike të fjalive nxitëse në gjuhën angleze në ligjërimin e shkruar	115
§4.2.1. Analiza sintaksore dhe semantike e fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar	116
§4.2.2. Fjali dëftore a pyetëse me funksionin kumtues të fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar	127
§4.2.3. Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme në strukturën e fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar	135
§4.2.4. Analiza kontrastive e fjalive nxitëse si pjesë të fjalive të përbëra në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe	136
§4.2.5. Denduria e përdorimit të foljeve më tipike në funksionin e kallëzuesit të fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar	138
§4.2.6. Tipare sintaksore dhe semantike të fjalive nxitëse të manualet udhëzuese, recetat e gatimit, reklamat	141
§4.2.6.1. Përdorimi i fjalive nxitëse në reklama	141
§4.2.6.2. Fjalitë nxitëse në recetat e gatimit dhe në udhëzuesit e përdorimit	145
§4.3. Veçori sintaksore dhe semantike të fjalive nxitëse në ligjërimin e folur	149
§4.3.1. Analiza kontrastive e fjalive nxitëse në dialogët e disa filmave	149
§4.3.2. Analiza kontrastive e fjalive nxitëse si pjesë e fjalive të përbëra në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe në ligjërimin e folur	157
§4.3.3. Fjali dëftore a pyetëse me funksionin kumtues të fjalive nxitëse në ligjërimin e folur	158

§4.3.4. Përdorimi i disa foljeve tipike në fjalitë nxitëse në filmat e shfrytëzuar	161
§4.3.5. Përdorimi i disa fjalëve leksikore, pjesëzave e thirrurëve në fjalitë nxitëse në dialogët e hulumtuar të filmave	163
§ 4.4. Fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe në ligjërimin e prozës popullore	164
§ 4.5. Fjalitë nxitëse në ligjërimin poetik të Nolit	166
§ 4.6. Përfundime të kreut.....	170
PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME	173
BIBLIOGRAFIA	185

Falënderime

Do të doja të shprehja falënderimet e mia më të sinqerta për personat që më kanë përkrahur gjatë punës sime hulumtuese.

Mirënjohja më e madhe i drejtohet udhëheqëses sime shkencore, prof. as. Shpresa Shamblli, e cila më ka motivuar, këshilluar dhe ndihmuar në çdo hap që kam ndërmarrë. I detyrohem shumë për përkushtimin, durimin dhe këshillat e vjera. Jam shumë e kënaqur që pata fatin ta njoh dhe të mësoj prej saj. (*Gratitude is one of the least articulate of the emotions, especially when it is deep.*)

Do të doja të bëja një falënderim për kolegët e mi të Departamentit të Gjuhës Angleze, që nuk kanë nguruar asnjëherë të më ndihmojnë dhe të më këshillojnë në këtë ndërmarrje të vështirë, si dhe Departamentin e Gjuhës Shqipe, Universiteti i Gjirokastrës, në mënyrë të veçantë prof. dr. A. Lamajn, prof. dr. Th. Dhimën dhe miken time, dr. M. Zekën, të cilët me shumë dashamirësi kanë ndjekur ecurinë e punimit dhe më kanë lehtësuar punën hulumtuese.

Një falënderim i veçantë i shkon prof. Roland Zisit për përkushtimin dhe gatishmërinë për të më ndihmuar. Kompetenca profesionale, njohuritë dhe idetë e tij shkencore më kanë dhënë një ndihmesë të vyer gjatë realizimit të këtij punimi.

Do të doja t'i shprehja mirënjohje të thellë znj. Yllka Avxhi për ndihmesën, inkurajimin dhe profesionalizmin në redaktimin e punimit. E admiroj shumë durimin, pasionin dhe përkushtimin e saj.

Falënderimet e përzemërta janë për familjen time, e cila ka qenë gjithmonë inkurajuese në këtë rrugë të vështirë dhe e ka mirëkuptuar mungesën time.

Së fundi, i falënderoj pafundësisht prindërit e mi që gjithmonë kanë qenë burim frymëzimi për mua. Përkrahja dhe inkurajimi i tyre më kanë dhënë më shumë forcë e energji për të realizuar këtë punim.

Këtë punim ua dedikoj prindërve të mi të dashur!

HYRJE

§0.1. Përligjja e punimit

Në ligjërimin e përditshëm folësit e çdo gjuhe pohojnë, informojnë, pyesin, urdhërojnë, japin udhëzime apo urojnë e mallkojnë. Në këtë larmi kumtimesh fjalitë nxitëse përbëjnë thelbin e ligjërimin bisedor. Në situatat fillestare të ligjërimin, ku realizohen dhe aktet e komunikimit me foshnjën (*i saponjohur me elementet thelbësore të gjuhës dhe ligjërimin, përballja me dikotominë gjuhë-ligjërim*), fjalitë nxitëse zënë një hapësirë të madhe dhe spikasin ndaj tipave të tjerë të fjalive. Kjo është arsyeja kryesore që ka ndikuar të merren në vështrim fjalitë nxitëse e të bëhen përpjekje të nxirren në pah veçoritë gramatikore, semantike, vlera e disa njësive leksikore, individualiteti i tyre, i cili, me të drejtë, del ndër më të pasurit në të gjitha llojet e fjalive. Madje, dinamika dhe denduria e përdorimit të këtyre fjalive është e lidhur ngushtë me vetë semantikën dhe llojin e kumtimit që ato mbartin.

Ideja për të ndërmarrë një studim të thelluar dhe përqsas në lëmin e nënsistemit të sintaksës së gjuhës angleze, në përqsasje me gjuhën shqipe, e ka zanafillën në punën tonë si mësimdhënës të gjuhës angleze. Gjatë përpjekjeve tona për të bërë një ndërthurje të suksesshme të anës teorike (çështjeve gramatikore) të gjuhës angleze me përdorimin praktik (përdorimi i gjuhës së huaj) në komunikim, kemi vërejtur këtë larmi të madhe kuptimesh që ato mbartin. Në anën tjetër, synimi kryesor në mësimin e gjuhës së huaj ngërthen zhvillimin e aftësive komunikuese në përvetësimin e drejtë të gramatikës së gjuhës. Duke përqsafuar idenë se rrafshi gramatikor është ai që i jep fytyrën një gjuhe, përcakton individualitetin e saj dhe përbën anën më të qëndrueshme të gjuhës, e shohim të udhës që si mësues të gjuhës angleze të thellojmë studimin tonë në fushën e sintaksës, duke u përqendruar te njësia e fjalisë, si një nga njësitet themelore sintaksore, me anën e së cilës formohet dhe shprehet gjuhësisht mendimi. Për ta bërë punimin sa më të gjerë e sa më shterues, fjalitë nxitëse të gjuhës angleze i kemi studiuar në përqsasje me fjalitë nxitëse-dëshirore të gjuhës shqipe.

Fjalitë nxitëse zënë pjesën më të madhe në bisedat e përditshme dhe përdorimi i tyre në kontekstet e duhura tregon përkapjen e drejtë të anës kuptimore dhe përvetësimin e plotë të gramatikës së gjuhës, duke e orientuar një nxënës drejt një shkalle të lartë të shprehësisë së gjuhës. Shpeshësia e shprehjes së kumtimeve që fjalitë nxitëse përçojnë në situata të caktuara ligjërimore, e bëri të domosdoshme krijimin e një baze teorike gramatikore në gjuhën e huaj. Kjo kërkon që nxënësi të përvetësojë dhe të përdorë drejt në praktikë fjalitë nxitëse, duke dalluar veçoritë tipike të tyre gjatë akteve të ndryshme të ligjërimin. Një nxënës që mëson gjuhën angleze në shkollë, duhet të përvetësojë jo vetëm anën e shprehjes formale gramatikore të fjalive nxitëse, por duhet të dallojë vlerat e larmishme kuptimore që këto fjali marrin në kontekste të ndryshme.

Për të përvetësuar kuptimin që një fjali apo një paragraf shpreh në një tekst të caktuar, duhet të jemi në dijeni të strukturave sintaksore që e përbëjnë dhe të tërësisë së veçorive gramatikore që e karakterizojnë. Për një nxënës që mëson një gjuhë të huaj, të arrish të kuptosh një fjali, do të thotë jo vetëm të përvetësosh vlerën kuptimore që ajo përçon, por të dallosh veçoritë gramatikore që e tipizojnë atë në dallim nga gjegjësjë në gjuhën amtare. Si pasojë e rolit thelbësor që luan gramatika në përvetësimin e një gjuhe, gjuhësia e aplikuar dhe një sërë studimesh bashkëkohore, veçanërisht hulumtuesit e përvetësimit të gjuhës së huaj, tradicionalisht janë përqendruar më shumë në gramatikën e gjuhës sesa në leksikun e saj.

Përmes analizës dhe shtjellimit të çështjeve dhe dukurive gramatikore që i veçojnë fjalitë nxitëse, ne jemi munduar të nxjerrim në pah vështirësitë që ndesh nxënësi, mësuesi dhe çdokush i interesuar në mësimin e gjuhës angleze, me qëllimin kryesor që një ligjërim i tillë të tingëllojë anglisht. Gjatë procesit të mësimdhënies, mësuesi i gjuhës angleze e gjen

shpeshherë shumë të vështirë të qartësojë kuptimin dhe veçoritë gjegjëse në gjuhën shqipe, për një sërë dukurish dhe strukturash sintaksore. Fjalitë nxitëse kumtojnë urdhra e kërkesa të drejtpërdrejta dhe për t'i përdorur këto fjali edhe në mjedise etno-linguistike, në të cilat kërkohet mirësjellje, etikë a ligjërim i tërthortë, mësuesi duhet të vërë në dukje përdorimin e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme (*tag questions*) në strukturën e periudhës me fjali nxitëse. Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme përbëjnë një veçori të gjuhës angleze dhe jo vetëm gjegjëset, por edhe studimet mbi përshtatjen e tyre në gjuhën shqipe mungojnë. Rrjedhimisht, ky punim është një ndërmarrje e vështirë, por edhe një kontribut modest në lëmin e fjalive nxitëse në veçanti dhe në fushën e sintaksës në përgjithësi.

Analiza dhe hulumtimi i fjalive nxitëse në hullinë e ndërveprimit të veçorive gjuhësore morfologjike, sintaksore, semantike dhe pragmatike në gjuhën angleze, të krahasuara me veçoritë gjegjëse në gjuhën shqipe, na japin më të plotë strukturën ndërtimore e kuptimore, si dhe karakteristikat që e dallojnë grupin e fjalive nxitëse. Analiza e situatave ligjërimore ku fjalitë nxitëse gjen përdorim, tregon se pavarësisht strukturës së saj të thjeshtë, kjo fjali shfaq shumë dukuri dhe tipare gramatikore të veçanta dhe interesante për t'u bërë objekt studimi. Fjalitë nxitëse "nxit" interesin e studiuesve për të njohur veçantitë e anës strukturore jo vetëm në strukturën sipërfaqësore, por edhe në strukturën e thellë, ndërveprimin e aktorëve pjesëmarrës në aktin komunikues, lidhjen sintaksore-semantike, shprehjen e thjeshtë morfologjike, "ngjitjen" e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme (*tag questions*) në pozicionin fundor të fjalive nxitëse, përcjelljen e një zinxhiri të larmishëm kuptimesh dhe një sërë komponentësh të tjerë që e plotësojnë një studim të tillë.

Tiparet dalluese të fjalive nxitëse në gjuhën angleze janë kthyer në objekt për shumë studime bashkëkohore të para nga këndvështrime të ndryshme, por në gjuhën shqipe studimet vetëm mbi fjalitë nxitëse janë të pakta dhe deri sot nuk kemi një studim të mirëfilltë që të përfshijë tërësinë e veçorive të këtyre fjalive në rrafshet kryesore gjuhësore. Edhe kjo ka qenë një ndër shtysat e kësaj ndërmarrjeje sa interesante, aq edhe të vështirë. E themi këtë, sepse gjuha shqipe, si një degëzim i veçantë i familjes indoevropiane të gjuhëve, në klasifikimin tipologjik bën pjesë në grupin e gjuhëve me eptim. Rendi jo i ngulitur i gjymtyrëve dhe eptimi kushtëzojnë përkapjen e funksioneve sintaksore jashtë strukturës së fjalisë dhe njëkohësisht mungesa e gjymtyrëve kryesore ose të dyta nuk e prish brendinë kuptimore të fjalisë në gjuhën shqipe. Këto veçori dalluese të gjuhës shqipe janë disa nga faktorët që ndikojnë në përvetësimin dhe përdorimin praktik të gjuhës angleze nga nxënësit shqiptarë. Si një punim që ngërthen analizën e ngjashmërive, dallimeve dhe veçoritë e fjalive nxitëse në gjuhën angleze me gjegjëset në gjuhën shqipe, ne synojmë të ndihmojmë sadopak në studimet përfaqëse-krahasuese rreth këtyre fjalive.

Gjatë paraqitjes, trajtimit, analizave dhe krahasimeve në punimin tonë jemi munduar të nxjerrim në pah dallimet dhe bashkëpërkimet mes këtyre gjuhëve, si gjuhë të një familjeje. Shumë diskutime e përfundime në këtë drejtim, natyrisht, gjenden në përmasat që lejojnë arritjet në këtë fushë studimesh. Mjaft çështje të pastudiuara sa duhet në gjuhësinë shqiptare më janë dukur problemore dhe të vështira për trajtim. Për këtë qëllim kemi shfrytëzuar burime të ndryshme të literaturës, të brendshme dhe të jashtme, si dhe është ndjekur rruga më e përshtatshme, duke u mbështetur në parime e metoda të njohura.

Që në fillim kemi qenë të vetëdijshëm për vështirësitë që shoqërojnë një punë të tillë. Kjo vetëdijshmëri u bë më e qartë e më reale sidomos gjatë analizës semantike që kërkonte një skemë të përgjithshme të përcaktuar. Megjithatë, dëshira për të trajtuar veçoritë e këtyre fjalive ka qenë një shtysë e fortë për të vazhduar. Jemi plotësisht të ndërgjegjshëm se ka mbetur edhe ndonjë çështje e pathelluar sa duhet, por kjo është e kuptueshme, sepse as që kam pretenduar të shtroj e të zgjidh gjithë çështjet që ngrenë fjalitë nxitëse.

Shpresojmë e mendojmë se ky punim do të jetë një ndihmesë modeste për të interesuarit dhe kërkuesit në fushën e studimeve gjuhësore mbi fjalitë nxitëse. Ky punim mund të jetë me

interes edhe për mësuesit e gjuhës angleze gjatë procesit të mësimdhënies, përvetësimit të fjalive nxitëse nga nxënësit shqiptarë, përdorimit praktik dhe dhënies së gjegjëseve në gjuhën shqipe, si dhe analiza dhe interpretimi i tyre në kontekste të ndryshme të përdorimit praktik.

§0.2. Objekti dhe hipotezat e punimit

Qëllimi kryesor i këtij punimi është vënia në dukje e veçorive formale-gramatikore, pra e veçorive sintaksore, morfologjike, semantike, vlera ligjërimore e fjalive nxitëse në gjuhën angleze në përjasje me gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe. Për të qenë një punim sa më i plotë e gjithëpërfshirës, këto fjali i kemi kundruar edhe në rrafshin diakronik, edhe në atë sinkronik.

Në këtë punim mëtojmë të nxjerrim në pah ngjashmëritë, përdallimet dhe vetjakësitë që i karakterizojnë fjalitë nxitëse në të dyja gjuhët. Në tërësinë e hulumtimit tonë jemi përqendruar në arritjet e rrymave të ndryshme gjuhësore, vështrimeve dhe përfundimeve të studiuesve që kanë spikatur si në gjuhësinë tradicionale, ashtu edhe në atë gjenerativiste. Teoritë mbi fjalitë nxitëse do të analizohen në aspektin e përjasjes, krahasimit dhe me synimin e qartë për të mbajtur një qëndrim ndaj teorive që rezultojnë bindëse dhe shkencore.

Ky punim është një panoramë e plotë dhe krahasuese e teorive dhe kërkimeve gjuhësore mbi fjalitë nxitëse, të sendërtuara edhe në aspektin pragmatik të përdorimit të tyre. Punimi është i shtrirë në kohë dhe i mbështetur në arritjet e shumë studimeve gjuhësore. Fillon që prej ndryshimit të objektit të studimeve gjuhësore, pra, nga analiza e gjuhës si një sistem strukturor, në studimin e anës praktike të saj, d.m.th. në shqyrtimin e gjuhës së përdorur në ligjërim.

Krahas parashtrimit të qasjeve teorike nga rryma të ndryshme studimi, kemi përfshirë edhe një analizë të fjalive nxitëse në përdorimin e tyre në ligjërimin e folur dhe të shkruar. Si një karakteristikë e ligjërimin bisedor, ne kemi bërë objekt studimi vlerën semantike, modelet strukturore, shpeshësinë e përdorimit dhe aktet e ndryshme të ligjërimin në të cilat shfaqen këto fjali. Materiali i vjelë përfshin edhe ligjërimin e shkruar, me synimin për të treguar shpeshësinë e madhe të përdorimit të tyre. Në të njëjtën kohë, del qartë se ballafaqimi i rezultateve të arritura do të tregojë edhe vlefshmërinë e teorive dhe studimeve më në zë në aspektin e pragmatikës së fjalive nxitëse.

Të nisur nga fakti i mungesës së punimeve të veçanta mbi fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe, në hulumtimin tonë jemi drejtuar nga studimet dhe analizat e fjalive nxitëse në gjuhën angleze, me qëllim që të arrijmë të japim gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe, t'i analizojmë dhe t'i interpretojmë ato. Edhe në gjuhën shqipe ne kemi bërë objekt studimi disa përdorime praktike tipike të fjalive nxitëse, si në prozën popullore apo në letërsinë shqiptare, me bindjen se kemi realizuar analiza të mirëfillta. Duke qenë se në gjuhën shqipe punime tërësore për këto lloje fjalish janë të pakta, na është shtuar edhe më tej shkalla e vështirësisë, sepse mungesa e studimeve të bollshme teorike nuk e plotëson apo nuk e ndriçon mjaftueshëm krijimin e një baze teorike tërësore. Krahas kësaj vështirësie, për të arritur objektivin kryesor të këtij punimi krahasues, është e nevojshme të përvetësohet baza gramatikore e të dyja gjuhëve. Një përvetësim i tillë i thelluar lehtëson analizën, vlerësimin, hulumtimin dhe finalizimin e një studimi të plotë dhe sa më shterues.

Ne mëtojmë të paraqesim mendimin tonë në kuadrin e një paraqitjeje të plotë të karakteristikave, çështjeve themelore, tipareve, veçorive dalluese dhe problematikës që paraqesin këto fjali jo vetëm gjatë përdorimit në ligjërimin të ndryshme, por të shtrira dhe në planin krahasues e përjasës me gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe. Gjatë hulumtimit tonë synojmë të vëmë në dukje vetjakësitë dhe përdallimet që i tipizojnë fjalitë nxitëse në të dyja gjuhët.

Të gjitha këto synime që përshkojnë gjithë punimin tonë, përbëjnë realizimin e një analize të thellë, tërësore dhe shteruese duke i dhënë përgjigje përsiatjeve dhe hipotezave që rrjedhin gjatë kundrimeve, përjasjeve dhe arritjes së përfundimeve, si:

1. Cila është hapësira që fjalitë nxitëse zënë në hullinë e studimeve gjuhësore, duke u nisur nga klasifikimi i fjalive sipas qëllimit të kumtimit?
2. Cilat janë llojet e fjalive nxitëse në gjuhën angleze nga pikëpamja formale-gramatikore dhe ku qëndron dallimi me gjegjëset në gjuhën shqipe?
3. Si janë analizuar fjalitë nxitëse në vështrimet e gjuhëtarëve tradicionalë, funksionalistë dhe gjenerativistë?
4. A është analiza gjenerative transformacionore e dobishme në realizimin e një përshkrimi të plotë të fjalive nxitëse?
5. A vërehen bashkëpërkime mes veçorive gramatikore të fjalive nxitëse në të dyja gjuhët?
6. Cila është vlera kuptimore që fjalitë nxitëse mund të marrin në kontekste të ndryshme dhe a paraqet ana formale e fjalive nxitëse një përmbajtje të veçantë kuptimore?
7. Cilat janë prirjet e përdorimit të fjalive nxitëse në ligjërime dhe në regjistra të ndryshëm?
8. Në ç'raport vendosen ligjërimi i folur dhe ai i shkruar?
9. A ndikojnë faktorët kontekstualë në larminë kuptimore që shprehin fjalitë nxitëse?
10. Cilat janë disa nga aktet e ligjërimin më tipike që kryejnë fjalitë nxitëse në kontekste të ndryshme ligjërimore?

Këto janë disa nga hipotezat bazë rreth të cilave orientohet i gjithë hulumtimi ynë dhe përgjigja e tyre jepet nëpërmjet përjasjes, inventarizimit të shembujve të vjelë, diagrameve dhe përfundimeve respektive.

Për të realizuar qëllimet e sipërpërmendura, në punimin tonë jemi mbështetur në një literaturë të pasur, kryesisht në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, në vepra dhe autorë që janë përfaqësues të rrymave gjuhësore më në zë, duke u përqendruar në teoritë dhe konceptet e tyre, të cilat na kanë ndihmuar jo vetëm në krijimin e një baze të plotë teorike, por edhe na kanë drejtuar në kërkimet tona në rrafshet e ndryshme gramatikore. Disa nga autorët dhe studimet shkencore që na kanë ndihmuar me lëndën gjuhësore dhe na kanë udhëhequr në hartimin e punimit janë: O. Jespersen, J. Lyons, N. Chomsky, S. Greenbaum, R. Quirk, G. Leech, J. Svartvik, R. Zanutti, P. Portner, J. R. Huddleston, G. K. Pullum, E. Davies, M. Kaufmann A.Y. Aikhenvald, R. Memushaj, M. Çeliku etj.

Disa nga gramatikat mbështetëse në këtë studim janë: M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe, përbërësit sintaksorë*, Tiranë; *Gramatika e gjuhës shqipe*, I dhe II, Akademia e Shkencave; S. Greenbaum, R. Quirk, G. Leech, J. Svartvik, *A comprehensive grammar of the English language*, Longman; R. Huddleston, G. K. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press; D. Biber, S. Conrad, G. Leech, *Student Grammar of spoken and written English*, Longman etj.

Për vjeljen e shembujve të përdorimit të fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar dhe të folur kemi shfrytëzuar burime të bollshme nga letërsia artistike, filmat, tekstet e stilit tekniko-shkencor (manualet udhëzuese), recetat e gatimit, reklamat, prozën popullore etj. Korpusi i fushës së studimit është i bollshëm dhe i mjaftueshëm për të arritur në përfundimet e duhura dhe për të realizuar objektivat kryesorë të këtij punimi.

§0.3. Metodologjia dhe struktura e punimit

Për realizimin e këtij punimi një rëndësi të veçantë i kemi kushtuar studimit, analizimit dhe mbledhjes së informacionit nga tekstet dhe kërkimet e ndryshme në fushën e sintaksës, që lidhen me fjalitë nxitëse në të dyja gjuhët. Për të bërë analiza të sakta e të plotë, jemi ndalur tek të gjitha studimet e bëra nga studiuesit e huaj dhe shqiptarë në periudha të ndryshme për çështjet që ne kemi përzgjedhur për të trajtuar. I kemi kushtuar vëmendje pasqyrimin të dukurive sintaksore, morfologjike e semantike të fjalive nxitëse në gjuhën angleze, në përjasje me dukuritë gjegjëse në gjuhën shqipe.

a. Fillimisht, për të realizuar pjesën *e parë* të punimit, me një vjelje të drejtpërdrejtë, kemi nxjerrë lëndë gjuhësore nga punime e autorë të tjerë pararendës a bashkëkohës, për gjithë ato çështje që i kemi konsideruar si të rëndësishme për studim. Për të nxjerrë përfundime sa më shkencore, kemi bërë edhe krahasime dhe përjasje të ndryshme. Me ndihmën e këtyre risjelljeve kemi përjasur më mirë gjuhën me mendimin, mjetet, regjistrat, veçoritë morfologjike e sintaksore të fjalive nxitëse në funksion të shprehjes së kuptimit të tekstit (ana semantike), duke pasur parasysh përdorimet e fjalive nxitëse jo vetëm si fjali të mëvetësishme (si të tilla kanë përdorimin më të dendur), por edhe në përdorimet në periudha dhe kontekste në të cilat këto fjali i ndeshim më rrallë.

b. Për trajtimin sa më shkencor të lëndës kemi përdorur metodën përjasëse-krahasuese, përshkruese dhe statistikore, të gërshetuar shpesh edhe me rrugën deduktive.

c. Nëpërmjet metodës përshkruese kemi bërë pasqyrimin e çështjeve teorike, përkufizimeve, trajtimeve dhe hipotezave duke u mbështetur në studimet e bëra nga gjuhëtarë të rrymave dhe këndvështrimeve të ndryshme, të shtrira në rrafshin diakronik dhe atë sinkronik.

d. Në lidhje me pjesën *e dytë* të disertacionit, e cila përqendrohet në përdorimin e fjalive nxitëse në të dy ligjërimet, të shkruar dhe të folur, kemi shfrytëzuar burime të korpusit, të larmishme dhe të bollshme për të bërë një analizë sa më të plotë dhe të hollësishme të përdorimeve më të shpeshta dhe tipike të fjalive nxitëse në gjuhën angleze, duke i shoqëruar edhe me gjegjëset në gjuhën shqipe. Burimet e korpusit përfshijnë letërsinë artistike, prozën popullore, ligjërimin bisedor, tekste që i përkasin stilit tekniko-shkencor etj. Në punën tonë të vjeljes së shembujve jemi drejtuar nga metoda përjasëse-krahasuese dhe ajo statistikore, të cilat na ndihmojnë të nxjerrim në pah dallimet dhe bashkëpërkimet që hasen në të dyja gjuhët. Krahasimi i veçorive të fjalive nëpërmjet shembujve konkretë na ka ndihmuar në evidentimin e bashkëpërkimeve dhe njëjtësimin e veçorive për secilën gjuhë.

e. Në pjesën e dytë një rol kryesor ka luajtur edhe metoda statistikore me anë të analizës së shpeshtësisë së përdorimit të fjalive nxitëse në regjistra të ndryshëm të gjuhës, modeleve strukturore, llojeve të akteve të ligjërimin, si dhe prirjet kryesore të përdorimit praktik të tyre në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe.

Për ta bërë analizën sa më shteruese, kemi shëstuar e realizuar një punim të ndarë në pjesë, në kapituj e sythe gjegjëse.

Në pjesën e parë, e përbërë nga tre kapituj, kemi bërë një analizë të plotë të tipologjisë së studimeve mbi fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe në lidhje me klasifikimin në këndvështrimet tradicionale dhe ato bashkëkohore.

Në kreun e parë kemi trajtuar një vështrim diakronik të studimeve mbi fjalinë, klasifikimin e saj nga pikëpamja strukturore dhe sipas qëllimit të kumtimit, duke dhënë një panoramë të plotë të klasifikimeve të fjalive në gramatika dhe punime që kanë spikatur dhe kanë ndikuar në prirjet e kërkimeve gjuhësore. Gjatë kundërimit të rrjedhës së studimeve gjuhësore mbi fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe klasifikimit të tyre, duke u bazuar në kriterin kumtues të thënies, vëmë re se në studimet e shumta mbi tipat e fjalive dhe fjalitë nxitëse në veçanti, gjuhëtarët kanë shprehur qasje të ndryshme apo shpeshherë kundërshti në

lidhje me çështje gjuhësore si: pranimin ose jo të fjalive nxitëse-dëshirore si grupi i tretë në klasifikimin e fjalive, kategorizimin e fjalive thirrmore (*exclamative sentences*) si grup i mëvetësishëm, trajtimin e fjalive dëshirore (*optative constructions*) si një prej tipave të fjalive apo konstrukteve brenda grupit të fjalive nxitëse, të emërtuara shpesh si *pseudo-nxitëse* (*pseudo-imperative*), *sifjali nxitëse* (*imperativelike sentences*) etj. Lidhur me përkufizimin dhe klasifikimin e fjalive nxitëse bazuar në funksionet kumtuese, kemi bërë një vlerësim të shkurtër të trajtimit të tyre në gramatikat e kahershme dhe në studimet e mëvonshme të gjuhës angleze dhe të gjuhës shqipe. Përfaqja e vështrimeve të ndryshme mbi klasifikimin dhe tipizimin e fjalive nxitëse në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe ka sjellë një paraqitje të plotë të studimeve gjuhësore në të dyja gjuhët.

Në kreun e dytë kemi parashtruar veçoritë e përgjithshme gramatikore që i dallojnë fjalitë nxitëse nga tipat e tjerë të fjalive sipas qëllimit të kumtimit. Duke e përqendruar kundrimin tonë në një trajtim të rrafshit morfologjik dhe sintaksor, jemi përpjekur të vëmë në dukje disa nga veçoritë më tipike morfologjike të klasës së foljeve. I kemi veçuar paradigmat foljore dhe karakteristikat e tyre, pasi folja përbën gjymtyrën kryesore të brendisë së një fjalie. Në rrafshin sintaksor jemi përqendruar në veçoritë dhe sjelljen sintaksore të kryefjalës të fjalitë nxitëse në gjuhën angleze, sepse, si dy gjuhë tipologjike të ndryshme, dallojnë në lidhje me shprehjen ose jo të kryefjalës në fjalitë nxitëse. Në gjuhën angleze kryefjala mund të mungojë, kurse në gjuhën shqipe mungesa e saj shënohet nëpërmjet mbaresave vetore të foljeve-kallëzues në mënyrën urdhërore ose lidhore. Edhe shpeshësia e përdorimit të thirrorit, i cili shënon personin a sendin që i drejtohet ligjërimi, është trajtuar si një prej veçorive sintaksore të fjalive nxitëse në të dyja gjuhët, duke bërë edhe dallimet e funksionit që kryen sintagma emërore në funksionin e kryefjalës apo të thirrorit në fjalitë nxitëse.

Në kreun e tretë jemi përqendruar te veçoritë semantike të fjalive nxitëse, vështrimet e ndryshme nga studiues bashkëkohorë të semantikës formale dhe vlerat e tjera kuptimore që fjalitë nxitëse mund të marrin në përdorime në kontekste të ndryshme. Përkufizimet e anës kuptimore të fjalive nxitëse tregojnë mjaft qartë tiparet e fushës konceptore të kategorisë së mënyrës urdhërore, e përbërë nga dy palë që shkëmbejnë urdhra, kërkesa dhe njëkohësisht kryejnë akte ligjërimi të caktuara. Njësitë minimale të komunikimit njerëzor janë akte ligjërimi të përkufizuara si akte *ilokutore*. Sa herë që një folës kumton një thënie në një kontekst të duhur me qëllime të caktuara komunikimi, atëherë themi se ai realizon një ose disa akte ilokutore. Një akt ilokutor i tillë është i ndërtuar nga dy komponentë: nga forca ilokutore dhe përmbajtja e kumtimit. Kuptimi thelbësor i fjalive nxitëse lidhet me teorinë e Portner-it, një teori e përqafuar nga shumë studiues të tjerë, listën e kërkesave (*to-do-list*), sipas së cilës nga ana konceptore dhe funksionale një fjali nxitëse nuk kumton gjë tjetër veçse i shton një kërkesë listës së kërkesave të bëra nga folësi. Një vend të veçantë në paraqitjen e veçorive semantike të fjalive nxitëse në gjuhën angleze zë edhe vlera kuptimore dhe tiparet e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme, të cilat përbëjnë një prej veçorive dalluese të fjalive nxitëse në gjuhën angleze.

Në pjesën e dytë kemi trajtuar veçoritë sintaksore dhe semantike të fjalive nxitëse në përdorimet në ligjërimin e folur dhe të shkruar. Në kreun *e katërt* jemi përqendruar në rëndësinë e ligjërimin në transmetimin e anës kumtuese të fjalive nxitëse, gjë që shpjegon qartë analizën e tyre brenda një situatë të caktuar komunikimi. Si rrjedhojë, pragmatika, si studimi i mënyrës së përdorimit të gjuhës, është mjaft e rëndësishme në realizimin e një studimi shterues të fjalive nxitëse. Fjalitë nxitëse për të kryer më së miri funksionet e tyre kumtuese, duhet të vlerësohen brenda ligjërimin ku ato realizojnë kumtimin që synojnë. Te fjalitë nxitëse gjuha përdoret me funksionin urdhërues ose konativ, që nënkupton nxitjen ndaj dëgjuesit për të kryer diçka. Analiza jonë e fjalive nxitëse në përdorimin praktik të tyre do të përqendrohet në ligjërimin e shkruar (letërsinë artistike, manuale e udhëzues përdorimi,

receta gatimi, reklama etj.), si dhe në ligjërimin e folur e në dialogët e disa filmave të ndryshëm.

Gjurmimi i fjalive nxitëse në këto korpusë ligjërimi do të paraqesë një panoramë të plotë dhe të qartë të veçorive sintaksore dhe semantike të fjalive nxitëse, të cilat ndeshen në burimet e marra në analizë. Analizën e strukturës së tyre e kemi nisur nga struktura më e thjeshtë, e cila është karakteristikë e sintaksës së fjalive nxitëse e deri në përdorimin e tyre si pjesë të fjalive të përbëra (një veçori që haset më rrallë në gjuhën angleze, në disa kontekste të veçanta të ligjërimin). Pavarësisht modeleve të thjeshta strukturore, fjalitë nxitëse shfaqen si fjali me struktura sintaksore të thjeshta, por të larmishme. Analiza e strukturave, akteve të ligjërimin që kryejnë, foljeve tipike që përdoren rëndom në romane, filma, manuale e receta gatimi është paraqitur në mënyrë statistikore në tabelat përkatëse, bazuar në shembujt e vjelë nga burimet e korpusit të mësipërm. Në këtë kapitull jemi munduar të japim edhe gjegjëset e shembujve në gjuhën shqipe dhe gjithashtu kemi bërë një përzgjedhje të përdorimeve më tipike të fjalive nxitëse në gjuhën shqipe për të treguar forcën shprehëse urdhëruese që i dallon këto fjali nga tipat e tjerë të fjalive. Modelet strukturore më tipike që kemi vjelë nga burimet e korpusit i kemi shoqëruar me gjegjëset në gjuhën shqipe, analizën kontrastive dhe tabelat përkatëse në lidhje me shpeshësinë e përdorimit të tyre në kontekste të ndryshme ligjërimore.

Në fund kemi nxjerrë konkluzionet përkatëse dhe bibliografinë mbështetëse e drejtuese në punën tonë hulumtuese.

KREU I

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM TEORIK I FJALIVE NXITËSE NË GJUHËN ANGLEZE DHE NË GJUHËN SHQIPE

§1.1. Përkufizimi i fjalisë. Klasifikimi i saj në gjuhën angleze

Fjalja është njësia themelore e gjuhës, që veçohet me lehtësi në rrjedhën e të folurit. Është njësi kumtuuese, njësia më e madhe e gjuhës, njësia themelore e sintaksës. Ajo është një kategori universale, ashtu si edhe fjala. Si njësi e nyjetimit të parë, fjalja përbëhet nga plani i shprehjes dhe plani i përmbajtjes, të lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me njëri-tjetrin. Megjithëse fjalja pranohet si njësia themelore e gjuhës, përkufizimi i saj paraqitet i vështirë.

Në sintaksën e ndërtuar mbi **skemat e logjikës**, fjalja është kuptuar si një gjykim i shprehur me gojë a me shkrim, pasi nëpërmjet saj pohohet ose mohohet një veprim a tipar që lidhet me subjektin¹. Nën ndikimin e logjikës, struktura dykryegjymtyrëshe subjekt + predikat e gjykimit është marrë si një tipar formal universal i fjalisë dhe, në ato raste kur kjo del me një gjymtyrë, është zbatuar parimi i të nënkuptuarit, duke nënkuptuar elipsë². Fjalja dhe gjykimi kanë një lidhje dialektike dhe shpeshherë strukturat e tyre shfaqin si bashkëpërkime, ashtu edhe dallime të ndryshme. Kumtimet e ndryshme që mund të shprehë një fjali e gjendur në kontekste dhe ligjërime të caktuara, tregojnë shtrirjen e gjerë semantike të saj dhe, për pasojë, shumë thënie që shprehin ndjenja, dëshirë a vullnet në një fjali nuk mund të gjejnë shprehjen e tyre te gjykimi si kategori e logjikës.

Kundër logjicizmit, që identifikonte gjuhën me mendimin, gjuhëtarët e drejtimit **psikologjist** në shekullin XIX janë shprehur se “fjalja lidhet me gjykimin aq sa nocioni i rrethit me ngjyrën e kuqe”, duke mohuar kështu fare lidhjen fjali-gjykim.

Gjuhësia e **sotme** e shikon fjalinë si një njësi gjuhësore, me lidhje të pazgjidhshme midis shprehjes dhe përmbajtjes së saj, duke pasur parasysh se me anë të fjalisë mendimi formësohet dhe shprehet gjuhësisht. Pra, fjalja është njësi kumtuuese, ndryshe nga njësitet sintaksore më të vogla, që janë njësi ndërtuese të fjalisë. Një ndër përkufizimet më të qëlluara të fjalisë është ai që ka dhënë gjuhëtari gjerman J. Reis, në veprën e vet “Ç’është fjalja?”. Sipas tij, “Fjalja është njësi minimale e ligjërit, e formësuar gramatikisht, që e shpreh përmbajtjen në perspektivën e lidhjes së saj me realitetin”³.

Gjuhësia **strukturore** parapëlqen t’i bazojë përkufizimet në kritere aksiomatike të formës dhe të distribucionit. Strukturalisti amerikan L. Blumfeld e përkufizon fjalinë si *një formë gjuhësore (tip gjuhësor) e cila nuk përmban elemente gramatikore që të hyjnë në ndonjë formë gjuhësore më të gjerë*. Pra, fjalja është forma gjuhësore më e gjerë, gramatikisht e pavarur. Ky përkufizim përfshin si fjali të thjeshta edhe fjali të përbëra⁴.

Fjalja është njësia sintaksore themelore e kumtimit ligjërimor, që shprehet me një a më shumë fjalë të lidhura gramatikisht, të shqiptuara me një intonacion mbarimi dhe që shpreh një gjykim, një pyetje, një dëshirë, një nxitje a një ndjenjë, si dhe qëndrimin e folësit ndaj realitetit të brendisë së kumtimit⁵. Fjalja është njësia më e vogël kumtuuese, me anën e së cilës

¹ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, 2004, f. 255-256.

² R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, 2002, f. 259.

³ *Po aty* f. 259.

⁴ Th. Dhima, *Gjuha shqipe, Sintaksa*, Tiranë, 2005, f. 38.

⁵ *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f.111-112.

mendimi formësohet dhe shprehet gjuhësisht. Kundrimi jo vetëm i anës kuptimore të fjalisë, në të cilën funksioni kumtues shërben për të përcjellë mesazhe të caktuara gjuhësore, por edhe asaj strukturore, na japin një tablo të larmishme të tipave të fjalive që gjejnë përdorim në ligjërime të ndryshme.

§1.1.1 Klasifikimi i fjalive në gjuhën angleze sipas strukturës dhe qëllimit të kumtimit

Nga *pikëpamja strukturore*, në gjuhën angleze dallojmë katër tipa të fjalive. Ky klasifikim përbën klasifikimin tradicional të fjalive, i cili jepet në disa gramatika të gjuhës angleze. Grupet kryesore janë: *simple* (e thjeshtë), *compound* (e përbërë me bashkërenditje), *complex* (e përbërë me nënrenditje) dhe *complex-compound* (e përbërë). Në gramatikën e Greenbaum-it dhe Quirk-ut fjalia në gjuhën angleze mund të jetë e thjeshtë ose e përbërë⁶. Nga ana strukturore, fjalia e thjeshtë mund të jetë *dykryegjymtyrëshe*, me kryefjalë dhe kallëzues të shprehur. Këto fjali përbëjnë dhe rastet më të shumta të fjalive të thjeshta, sepse fjalia në gjuhën angleze ka një rend të ngulitur të gjymtyrëve. Në kontekste të ndryshme, si në përshkrime apo ligjërime që përshkohen nga ndjenja, emocione, përjetime, ku semantika e tyre nxjerr në pah gjendjen ndjesore të folësit, fjalia mund të ketë të shprehur vetëm *një gjymtyrë* të fjalisë, e cila nuk është as kryefjala ose kallëzuesi, por gjymtyrë të tjera të dyta.

1. *Morning, cold and grey.*

(Mëngjes, i ftohtë dhe gri.)

2. *Miracle! Great!*

(Mrekulli! Bukur! Për bukuri!⁷)

Nga ana strukturore këto fjali shfaqen si të paplota apo eliptike, por nga ana kuptimore kanë një semantikë të plotë të vendosur në kontekstet ligjërimore të tyre. Megjithatë, fjalitë me një strukturë të tillë nuk janë të shumta në gjuhën angleze dhe nuk hasen shpesh në ligjërime të ndryshme, sepse rendi i ngulitur i gjymtyrëve e kushtëzon përdorimin e tyre në fjali.

Sipas *qëllimit të kumtimit*, në gjuhën angleze fjalitë ndahen në këto grupe kryesore: *dëftore*, *pyetëse*, *nxitëse* dhe *thirrmore*. Ky klasifikim shfaq ngjashmëri në shumë gramatika dhe në rryma gjuhësore që nga gjuhëtarët tradicionalistë dhe deri te studiuesit e kohëve të sotme.

Në gramatikën e Huddleston-it dhe Pullum-it fjalitë ndahen në pesë kategori të mëdha:

1. fjali *dëftore*;

2. fjali *pyetëse tërësore*;

3. fjali *pyetëse të pjesshme*;

4. fjali *nxitëse*;

5. fjali *thirrmore*⁸.

Në gramatikën e Greenbaum-it dhe Quirk-ut klasifikimi i fjalive sipas qëllimit të kumtimit përmban *katër tipa të mëdhenj sintaksorë të cilët dallojnë nga forma e tyre*. Përdorimi i tyre lidhet gjerësisht me funksionet e ndryshme që ato kryejnë në ligjërim:

1. *dëftore*,

2. *pyetëse*,

3. *nxitëse*,

⁶ S. Greenbaum, R. Quirk, G. Leech, J. Svartvik, *A comprehensive grammar of the English language*, Longman, 1985, f. 19.

⁷ Th. Sharra, *A comprehensive English Grammar*, Tiranë, 1981, f. 5-7.

⁸ R. Huddleston, G. K. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press, 2002, f. 853.

4. *thirrmore*⁹.

Ana semantike dhe sintaksore e fjalive nuk përputhet në të gjitha rastet, sepse një fjali dëftore mund të kumtojë edhe një pyetje ose kërkesë, pavarësisht se nga struktura sintaksore ajo mund të jetë fjali dëftore¹⁰.

Fjalitë që vijojnë përbëjnë tre tipat bazë të fjalive që hasen rëndom në të gjitha ligjërimet dhe janë plotësisht të përvetësuara e asimiluara nga folësit e një gjuhe të caktuar:

3. *You have joined the best sports club in our town.* *Fjali dëftore.*
(Ti je bashkuar me klubin më të mirë sportiv të qytetit tonë.)
4. *Have you joined the best sports club in our town?* *Fjali pyetëse.*
(A je/jeni pjesë e ndonjë klubi sportiv të qytetit tonë?)
5. *Join the best sports club in our town!* *Fjali nxitëse.*
(Bëhu/të bëhesh pjesë e klubit sportiv më të mirë të qytetit tonë.)

Sipas Biber, Conrad, Leech (2002), fjalitë kryejnë akte ligjërimore gjatë përdorimit të tyre. Në përgjithësi vërehet një përputhje midis katër funksioneve bazë të akteve të ligjërimet dhe katër tipave të fjalive. Tipat e fjalive dhe aktet e ligjërimet që kryejnë jepen në këtë tabelë:

<i>Akti i ligjërimet</i>	<i>Funksioni</i>	<i>Fjalja</i>	<i>Struktura</i>	<i>Shembuj</i>
informim	pohim	dëftore	kryefj +kall.	It's strong.
vjelje info.	pyetje	pyetëse	kall. + kryefj. Wh + kall. + kryefj.	Is it strong? Where is she?
urdhër	urdhër	nxitëse	kallëzues (pa kryefjalë)	Be strong!
shprehimësi	qëndrim ndjesor	thirrmore	wh + kryefj. + kall.	How good she is!

Struktura dhe funksioni i fjalive jo gjithmonë përputhen, por klasifikimi kryesor i fjalive sipas funksionit komunikativ përfshin katër lloje kryesore të fjalive¹¹.

Sadock dhe Zwicky (1985) i shpjegojnë tipat e fjalive si një bashkim (*pairing*) midis formës gramatikore dhe përdorimit në ligjërim (*conversation*). Tipat e fjalive në një gjuhë formojnë një sistem të mbyllur, që do të thotë se një tip fjalie nuk mund t'i përkasë edhe një tipi tjetër. Çdo tip ndërthen fjalitë që karakterizohen nga veçori të përbashkëta dhe dallojnë nga fjalitë e tjera për shkak të përkatësisë në tipat e tjerë¹².

Edhe në studimet e mëvonshme ndarja e fjalive sipas funksionit të kumtimit përfshin katër grupet kryesore të fjalive. E. P. Altenberg-u dhe R. M. Vago, në studimin e tyre "*English grammar, understanding the basics*", pranojnë klasifikimin e fjalive në katër grupe duke u bazuar në funksionin apo detyrën që ato kryejnë në një bisedë. Janë fjali *dëftore* fjalitë që pohojnë një thënie; *pyetëse* - fjalitë që realizojnë një pyetje, *nxitëse* - fjalitë që japin një

⁹ S. Greenbaum, R. Quirk, G. Leech, J. Svartvik, *A comprehensive grammar of the English language*, Longman, 1985, f. 803.

¹⁰ Ka debate dhe polemika të ndryshme nga gjuhëtarët në lidhje me klasifikimin e këtyre fjalive, në të cilat kemi një "përballje dialektike" mes funksionit dhe anës formale. Ne mendojmë se këto fjali, pavarësisht përfshirjes në njërin grup apo tjetrin, do të mbeten gjatë në "*udhëkryq*", sepse nuk ka një dallim në kriterin bazë klasifikues funksional apo formal. Megjithatë, për shkak se situata ligjërimore dhe ligjërimi në përgjithësi po fitojnë terren në studimet gjuhësore bashkëkohore, ne përkrahim qasjet që i klasifikojnë këto fjali në bazë të funksionit kumtues në një situatë të caktuar komunikimi.

¹¹ D. Biber, S. Conrad, G. Leech, *Student Grammar of spoken and written English*, Longman, 2002, f. 248-249.

¹² Cituar nga Zanutti dhe Portner në punimin *Exclamative Clauses: At the Syntax-Semantics Interface*, Language, 2003, vol. 79, Nr.1, f. 39.

urdhër dhe *thirrmore* - fjalitë ku kumtohen emocione të forta.¹³ Studiuesi Ch. F. Meyer, në qasjen e tij mbi fjalitë, analizon funksionin që ato kryejnë në komunikim. Meyer-i i analizon fjalitë të ndara në katër tipa kryesorë, duke i pranuar edhe fjalitë *thirrmore* si grup më vete¹⁴. Collins-i, në studimin e tij mbi gramatikën e gjuhës angleze, i klasifikon fjalitë në katër grupe kryesore¹⁵ dhe për të termi “*directive*” (*direktivë*) është një term i përgjithshëm që mbulon fushën semantike të kërkesave, rregullave e urdhrave të kumtuara nga fjalitë nxitëse etj. Ndërsa termin “*urdhër*”, të përdorur gjerësisht në gramatikat tradicionale, ai e përkufizon si mjaft specifik në përkapjen e gjithë përdorimeve që mund të kenë fjalitë nxitëse. Trajtimi i tij tregon larmishmërinë e kuptimeve që një fjali nxitëse mund të shprehë në kontekste të ndryshme. Mospërputhja mes kategorive sintaksore dhe semantike apo kategorive semantike dhe pragmatike e zgjeron më shumë fushën kuptimore të fjalive nxitëse, duke e shtrirë dhe në tipat e tjerë të fjalive, si në rastin e përdorimit të fjalive dëftore me funksione gjuhësore urdhëruese.

Në studimet e fundit për gjuhën angleze, ndarja e fjalive përftohet në pjesën më të madhe të klasifikimit të tyre sipas funksionit kumtues. G. Nelson (2001) i klasifikon ato në katër tipa kryesorë, duke përfshirë në klasifikimin e tij edhe fjalitë *thirrmore*. Sipas tij, *të gjithë tipat e fjalive dallojnë nga shprehja gramatikore e tyre dhe nuk ka një marrëdhënie të ndërsjellë mes formës gramatikore të fjalisë, rolit dhe funksionit që ajo luan në ligjërim*. Ai thekson se një fjali dëftore, e shprehur me një intonacion në ngritje, mund të kthehet në një fjali pyetëse¹⁶. Starr-i, në qasjen e tij mbi kuptimin që shprehin fjalitë nxitëse në përjasje me dëftoret dhe pyetëset, nënvizon: fjalitë dëftore paraqesin informacion që i përjashton realitetet, “*botët*”¹⁷, fjalitë pyetëse japin alternativa duke i grupuar këto realitete në kategori (grup realitetesh), ndërsa nxitëset paracaktojnë (diktojnë) alternativa.

Stalkner-i (1978) dhe Portner-i (2004) i analizojnë efektet e mësipërme si rezultate të argumentimit praktik (pragmatik). Sipas tyre, kuptimi konvencional gjuhësor i një fjalie shkrihet me përmbajtjen dhe nëpërmjet kësaj shkrirjeje ata mëtojnë të tregojnë se si mund të ndikojë shqiptimi i një fjalie në gjendjen (*state*) e bisedës¹⁸. Vështrimi i Starr-it është një qasje dinamike, sipas së cilës kuptimi konvencional gjuhësor i një fjalie është efekti karakterizues që vepron mbi qëndrimet e bashkëbiseduesve, të cilët përcaktojnë edhe gjendjen apo atmosferën e bashkëbisedimit. Pra, Starr-i i mëshon me këndvështrimin e tij kalimit nga një gjendje e bisedës në një tjetër, për shkak të veprimit të kuptimit gjuhësor që bart fjalia e kumtuar mbi qëndrimet dhe perceptimet e bashkëbiseduesve.

Të gjithë tipat e fjalive mund të kryejnë funksione të tjera gjuhësore që nuk përkojnë me strukturën tipike të llojit të fjalive ku bëjnë pjesë. Shumë studiues i trajtojnë disa fjali herë si fjali nxitëse e herë si fjali pyetëse apo si fjali dëftore nga ana strukturore. Në kontekste të caktuara ligjërimi ato mund të kryejnë funksionin e një fjalie pyetëse. Në kategorizimin e fjalive vërejmë mospërputhje të përmbajtjes kumtuese me anën formale-gramatikore, pra në formën e shprehjes së tyre. Një numër i madh i fjalive të tipave të ndryshëm karakterizohen në mënyrë të dallueshme nga veçori të më shumë se një lloji të fjalive dhe për këtë arsye

¹³ E. P. Altenberg, R. M. Vago, *English grammar, understanding the basics*, Cambridge University Press, 2010, f. 203.

¹⁴ Ch. F. Meyer, *Introducing English Linguistics*, Cambridge University Press, 2009, f. 139.

¹⁵ P. Collins, *The handbook of English Linguistics*, Blackwell Publishing Ltd, 2006, f. 194.

¹⁶ G. Nelson, *English, An essential grammar*, Routledge, 2001, f. 25.

¹⁷ Termi “*possible worlds*” është një koncept i përdorur në semantikë dhe shpreh pohime modale. Ky koncept nënkupton një sërë realitetesh të mundshme, që mund të ekzistojnë. Në termat e studiuesit David Lewis, si një nga të parët që e përdori, kemi të bëjmë me një *realizëm modal*. Pra, një përshkrim se si duhej të ishte realiteti. Fjalitë varen nga kriteri i vërtetësisë apo gabueshmërisë, që do të thotë se kumtimi i tyre mund të jetë i vërtetë në një “realitet” (botë), por i rremë në një realitet tjetër. Cituar nga D. Lewis, *General Semantics*, Reidel Publishing Company, 1970, f. 1-25.

¹⁸ Cituar nga W. B. Starr, *A preference semantics for imperatives*, Dissertation 2010, Kapitulli IV, f. 2.

gjenden në kufirin e klasifikimit të tyre në njërin grup apo në grupin tjetër. Është e vështirë për të bërë kategorizimin e këtyre fjalive, sepse tiparet klasifikuese që tipizojnë secilin lloj janë pak a shumë të barasvlershme në aspektin e analizës klasifikuese. Edhe pse kjo dukuri është e dallueshme dhe e qartë nga ana e kumtimit që ato mbartin, nga studiuesit nuk jepet një përcaktim në lidhje me kriterin klasifikues drejtues (*natyra e kumtimit apo forma e shprehjes*), për të bërë analizën e fjalive të ndryshme, si *nxitëse*, *pyetëse* apo *dëftore*.

Ana praktike e situatës komunikuese është shumë e rëndësishme, sepse ndihmon në klasifikimin e fjalive në ato raste ku kategorizimi i tyre nuk përlligjet nga ligjet gjuhësore. Studiuesit nuk kanë dalluar kriteret gjuhësore që përcaktojnë dhe “tiparin” që e klasifikon fjalinë brenda një lloji të caktuar. Në kontekste të tilla janë elemente të tjera, si ato intonacionore, që realizojnë një mbivendosje të fjalive në më shumë se një lloj. Ne mendojmë se tendencat gjuhësore që mëtojnë studimin e fjalive, klasifikimin dhe funksionet e tyre komunikuese, po e përqendrojnë objektin e tyre drejt ligjërit, elementeve të tij dhe rëndësisë që ai ka në thënie të caktuara.

Në analizën e Portner-it (Portner dhe Zanuttini 2000, 2006) të përqendruar te veçantitë dalluese të fjalive nxitëse, natyra e kumtimit drejtues dhe urdhërues që i dallon këto fjali nga dëftoret dhe pyetëset, shprehet qartë me praninë e tre tipave të fjalive sipas kumtimit: dëftore, pyetëse dhe nxitëse. Portner-i dhe Zanuttini shpjegojnë se nuk ka argumente mbështetëse në lidhje me idenë se një tip fjalie në një gjuhë natyrore mund të përcaktohet a karakterizohet nga një shenjues force i veçantë, i cili është i pranishëm në të gjitha fjalitë që klasifikohen brenda këtij lloji në një gjuhë të caktuar (pak a shumë tek të gjitha gjuhët). Portner-i paraqet një koncept të ndryshëm, sipas të cilit fjalitë bazë (*root clauses*) mbartin vlera semantike të përfuara dhe lidhja që ekziston mes tipit të fjalisë dhe forcës që përmban kjo fjali, kushtëzohet nga parimet bazë të teorisë pragmatike. Në mënyrë më specifike, në rastin e fjalive dëftore dhe nxitëse, ana semantike shpjegon lidhjen që kanë fjalitë me *forcën*. Portner-i dhe Zanuttini pranojnë se fjalitë dëftore shprehin pohime, ndërsa fjalitë nxitëse shprehin tipare që lidhen me kryefjalën¹⁹.

Mastop-i (2011) paraqet një propozim që përputhet me qasje të tjera, si vështirimi i Lewis-it, sipas të cilit semantika nuk mund të emërtohet si e tillë, nëse nuk merret me trajtimin e kushteve të vërtetësisë²⁰. Megjithatë Mastop-i, në dallim nga të tjerët, pohon se nuk mund të karakterizohen fjalitë nxitëse nga një analizë semantike, e cila bazohet në kushtin a kriterin e vërtetësisë (*truth conditions*). Fjalitë nxitëse më tepër shënojnë objekte, kryesisht “udhëzime”, sesa pohime të bazuara mbi kriterin e vërtetësisë²¹.

Një tjetër veçori dalluese e klasifikimeve në shumë gramatika të rrymave të ndryshme gjuhësore janë qasjet e ngjashme mbi *kategorizimin e fjalive thirrmore*, të cilat, në dallim nga klasifikimet e fjalive në gjuhën shqipe, janë grupuar në një lloj më vete. Përbërja e veçantë strukturore e fjalive thirrmore në gjuhën angleze, që nënkupton një mospërputhje mes strukturës sintaksore dhe funksionit kumtues, është një argument i qartë që shpjegon ekzistencën e këtyre dallimeve në klasifikimin e tyre sipas funksionit që ato kryejnë.

Përfundim: Pra, fjalitë mund të ndahen në katër grupe kryesore sipas strukturës së tyre. Për sa i takon klasifikimit të fjalive sipas qëllimit të kumtimit, gjuhëtarët kanë mendime të ndryshme. Një grup mendon që ato duhen ndarë në tre grupe kryesore: fjali *dëftore*, *pyetëse* dhe *nxitëse*, kurse grupi i dytë i klasifikon ato në katër grupe: fjali *dëftore*, *pyetëse*, *nxitëse* dhe *thirrmore*. Ne ndajmë mendimin e Portner-it, i cili thekson se lloji i fjalisë përcaktohet nga shkrirja e kumtimit gjuhësor të saj me përmbajtjen dhe përdorimin e saj në një situatë të caktuar.

¹⁹ Cituar nga P. Portner, *Imperatives, Handbook of Semantics*, Cambridge University Press, 2013, f. 21.

²⁰ D. Lewis, *General Semantics*, Synthese 22, Reidel Publishing Company, 1970, f. 18.

²¹ *Po aty*, f. 21-22.

§1.1.2. Tipologjia e studimeve të fjalive nxitëse në gjuhën angleze

Klasifikimi tipologjik i gjuhëve e vendos gjuhën angleze në grupin e gjuhëve analitike, ku rendi i gjymtyrëve të fjalisë është një rend i ngulitur dhe funksionet sintaksore të gjymtyrëve ndërtuese të fjalisë lidhen ngushtësisht me rendin e saj. Funksionet sintaksore të fjalëve në gjuhët analitike nuk mund të përkapen jashtë strukturës së fjalisë.

Në arealin e studimeve gjuhësore të fjalive nxitëse, të para si në rrafshin formal të shprehjes morfologjike me anë të mënyrës urdhërore, dhe në rrafshin kumtues në një ligjërimit të caktuar, studiuesit përcaktojnë kriteret e klasifikimit të tyre në tre grupe kryesore, ku fjalia *nxitëse* përbën një prej tipave të fjalive.

Gjatë kundërimit të rrjedhës së studimeve gjuhësore mbi fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe klasifikimit të tyre, duke u bazuar në kriterin kumtues të thënies, vëmë re se në studimet e shumta mbi tipat e fjalive dhe fjalitë nxitëse në veçanti, gjuhëtarët kanë shprehur qasje të ndryshme apo shpeshherë kundërshti në lidhje me çështje gjuhësore si: *pranimin* ose *jo* të fjalive nxitëse-dëshirore si grupi i tretë në klasifikimin e fjalive, *kategorizimin* e fjalive thirrmore (*exclamative sentences*) si grup i mëvetësishëm, trajtimin e fjalive dëshirore (*optative constructions*) si një prej tipave të fjalive apo konstrukteve brenda grupit të fjalive nxitëse, të emërtuara shpesh si *pseudo-nxitëse* (*pseudo-imperative*), *sifjali nxitëse* (*imperativelike sentences*) etj. Lidhur me përkufizimin dhe klasifikimin e fjalive nxitëse bazuar në funksionet kumtuese, po bëjmë një vlerësim të shkurtër të trajtimit të tyre në gramatikat e kahershme dhe në studimet e mëvonshme të gjuhës angleze dhe të gjuhës shqipe.

Jespersen-i në analizën e fjalive nxitëse bazohet në lidhjen mes funksionit të fjalive dhe kategorisë së mënyrës së foljes-kallëzues. Analiza e fjalive nxitëse, duke u bazuar në mënyrën e foljes-kallëzues, tregon drejtimin e studimeve të kësaj periudhe, të orientuara kryesisht nga analiza gramatikore formale e fjalive. Në studimet e mëtejshme këto fjali do të shihen në aspektin e realizimit të ligjërimit. Fjalia nxitëse përfton funksionin e saj kumtues nga bashkëveprimi i dy aktorëve të situatës ligjërore: folës-dëgjues. Sipas tij, *çdo fjali urdhërore e ka foljen-kallëzues virtualisht në vetën e dytë, edhe pse në dukje mund t'i adresohet një personi të vetës së tretë*²².

Për Davies-in (1986), në studimin e tij mbi sintaksën, semantikën dhe pragmatikën e fjalive nxitëse, *fjalitë nxitëse përbëjnë një tip më vete të fjalive, që dallojnë nga ana sintaksore me tipat e tjerë të fjalive: pyetëse dhe dëftore*. Sipas tij, fjalitë nxitëse janë një klasë sintaksore homogjene dhe të gjitha pretendimet dhe konkluzionet e disa studiuesve për të njohur disa nënklasa të tjera brenda grupit të fjalive nxitëse, përbëjnë arsyeime jo të përshtatshme në analizën tërësore të fjalive nxitëse. *Përbërja strukturore e tyre shfaq larmi njësish gjuhësore, por ato duhet të vlerësohen jo vetëm sipas vlerës dhe funksionit sintaksor të tyre, por edhe në varësi të faktorëve pragmatikë*²³. Pra, në studimin e tij i kushtohet vëmendje e veçantë edhe aspektit të pragmatikës²⁴, që nënkupton rëndësinë e pjesëmarrësve në ligjërimitin ku fjalitë nxitëse gjejnë përdorim. Situata ligjërore dhe aktorët që marrin pjesë në të, janë shpeshherë faktorë të rëndësishëm në përcaktimin dhe interpretimin e fjalive nxitëse.

²² O. Jespersen, *Essentials of English Grammar*, Routledge, London, 1933, f.110.

²³ E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 18-30.

²⁴ *Ndarja e prerë semantikë-pragmatikë nuk qëndron në të gjitha rastet dhe se shumë herë studimi semantik varet nga ai pragmatik*, cituar nga Th. Dhima, *Histori e Gjuhësisë*, INFOTUES, Tiranë, 2014, f. 321-323.

Sh. Zhang-u pohon se *fjalitë nxitëse mund të trajtohen si një lloj i veçantë i ndërtimeve të infinitivit, por jo detyrimisht një tip i veçantë në klasifikimin e fjalive në gramatikë*. Zhang-u i konsideron fjalitë nxitëse si konstrukte të varura dhe të mëvetësishme, duke argumentuar se *ato mund të jenë pjesë e një fjalie dëftore duke e plotësuar kumtimin e saj*. Si rrjedhojë, fjalitë nxitëse nuk janë gjë tjetër veçse ndërtime kuptimore plotësuese të tipit të fjalive dëftore.

6. *Go to the party!*

(Shko në festë!)

Sipas Zhang-ut, fjalia 6 kumton:

John told bill to go to the party.

(Xhoni i tha Billit të shkonte në festë.)

Ajo propozon se konkluzioni i Schmerling-ut (1975, 1982) mbi trajtimin e *fjalive nxitëse si grup më vete*, duhet të rishikohet dhe të trajtohet nga studiuesit²⁵.

M. Kaufmann-i pohon se fjalitë nxitëse klasifikohen si tipi i tretë i fjalive dhe *se kundrimi semantik i “urdhërores” si një kategori ndërgjuhësore nuk mund të pasqyrohet vetëm në aspektin formal*. “*Të drejtuar nga intuita, fjalitë dëftore dhe pyetëse përshkruajnë si është bota, ndërsa fjalitë nxitëse duken të jenë më të interesuara se si duhet të jetë ajo*”²⁶.

Kaufmann-i dhe Portner-i kanë bërë një studim të thukët dhe përsiatjet e tyre për të paraqitur një analizë formale të semantikës së fjalive nxitëse, kanë sjellë një përparim në përvetësimin dhe interpretimet që mund të marrë urdhërorja në kontekste të ndryshme. Portner (2004), duke analizuar komponentët semantikë të një fjalie nxitëse në ligjërim, thekson se “dallimet mes gjithë nëntipave të fjalive nxitëse nuk duhen parë në aspektin e forcës që nënkupton bashkëbisedimi. Kjo do të thotë se këta nëntipa të fjalive nxitëse kanë të përbashkët forcën e të *kërkuarit* dhe secili prej tyre i shton një karakteristikë listës së dëgjuesit (bashkëbiseduesit)²⁷”. Kaufmann (2012) i shpjegon fjalitë nxitëse (*imperatives*) si tipa fjalish në të cilat gjejmë një përdorim prototipik, siç është urdhri. Si Kaufmann, edhe Portner e pranojnë se *fjalitë nxitëse* duhet të trajtohen dhe të analizohen si kategori sintaksore.

Medeiros-i, në studimin e tij mbi sintaksën dhe semantikën e urdhërores, kundërshton qasjen e Portner-it (2004, 2007), Kaufmann-it (2012) dhe të tjerëve për trajtimin e fjalive nxitëse si lloji i tretë i fjalive sipas qëllimit kumtues²⁸. Në studimet e tjera që kanë si objekt kryesor funksionet gjuhësore të kategorive sintaksore, si fjali nxitëse duhet të përkufizohen edhe ato fjali, qoftë pyetëse apo dëftore, nga ana formale-gramatikore, të cilat përmbajnë një forcë urdhëruese në semantikën e tyre apo ato që kanë si funksion komunikativ dhënien e një urdhri a direktive.

Aikvenhald-i propozon një qasje funksionaliste të fjalive nxitëse, të cilat kryejnë funksionin e dhënies së urdhrave në ligjërim dhe, si rrjedhim, përkojnë me urdhrat, të cilët janë kategori jogjuhësore. Fjalitë nxitëse janë urdhra në thelb, edhe pse shpeshherë kuptimi që ato shprehin mund të shkojë përtej shtrirjes kuptimore të urdhrave. Medeiros-i analizon qasjet e studiuesve të sipërpërmendur, të cilët përkojnë në sendërtimin e kuptimeve tipike (nuanca kuptimore të *urdhrit, komandës, kërkesës* etj.) me kuptimet e rëndomta atipike, si sugjerimet, dëshirat, urimet etj.²⁹

²⁵ Sh. Zhang, *Sentence types: A look at imperative constructions*, Proceedings of the Western Conference on linguistics: WECOL 89, vol. 2, f. 370-380.

²⁶ M. Kaufmann, *Interpreting imperatives*, Springer, 2012, f. 2.

²⁷ P. Portner, *The semantics of imperatives within a theory of clause types*, R. Young, SALT XIV, f. 237-238.

²⁸ Shih D. J. Medeiros, *Formal approaches to the syntax and semantics of imperatives*, Dissertation, University of Michigan, 2013, f. 56-68.

²⁹ *Po aty*, f. 13-15.

Belnap-i (1990) propozon që të gjithë tipat e fjalive duhet të kenë të njëjtën peshë dhe rëndësi në analizën e tyre. Sipas tij, përmbajtja kuptimore e fjalive të një gjuhe natyrore nuk është unike. Fjalitë pyetëse dhe nxitëse nuk karakterizohen vetëm nga dallime në anën formale, krahasuar me fjalitë dëftore, por bartin struktura kuptimore krejtësisht të ndryshme³⁰.

Në klasifikimet e bëra në shumë gramatika të gjuhës angleze të rrymave të ndryshme gjuhësore, vëmë re qasjet mbi *kategorizimin e fjalive thirrmore*, si grupin e katërt të tipave të fjalive. Në gjuhën shqipe fjalitë thirrmore nuk klasifikohen si grup më vete, por janë përfshirë në secilin lloj të fjalive. Kjo ndodh sepse secili tip i fjalive mund të dalë me të njëjtën përbërje si fjalitë jothirrmore përkatëse, herë-herë edhe me të njëjtën strukturë, e të dallohen vetëm nga intonacioni i tyre; porse mund të karakterizohen edhe nga fjalë thirrmore a me vlerë thirrmore (*përemra a ndajfolje ose pasthirrma*)³¹. Ndërsa në gjuhën angleze, vetë përbërja e veçantë strukturore e fjalive thirrmore është një argument i qartë që i shpjegon këto dallime në klasifikimin e fjalive në bazë të funksionit që ato kryejnë.

Përfundim: Nga paraqitja e një analize të shkurtër të vështrimeve të ndryshme mbi kategorizimin e tipave të fjalive, ne vërejmë disa veçori dalluese në këto dukuri gjuhësore:

A. Kriteret bazë *klasifikuese* të tyre.

B. Kalimin nga tiparet e *shprehjes funksionale dhe formale* të marra si bazë për klasifikimin e fjalive nxitëse, në trajtimin e situatës *ligjërimore* dhe pjesëmarrësve në këtë situatë komunikimi. Në studimet e mëparshme kumtimi i fjalisë nxitëse ishte i lidhur ngushtë me shprehjen formale të kallëzuesit në mënyrën urdhërore.

C. Dallimet në zgjedhjen e terminologjisë emërtuese të fjalive nxitëse, nga fjali *urdhërore* në *nxitëse* apo në nxitëse-dëshirore në studimet e mëvonshme. Mungesa e një marrëveshjeje të përgjithshme mes gjuhëtarëve ka sjellë një dallim në terminologjinë e përdorur për nocione të ndryshme gjuhësore.

D. *Zhvendosja* e objektit të studimeve gjuhësore mbi fjalitë nxitëse nga struktura dhe ndërtimi gramatikor i tyre drejt një analize më të thellë e komplekse, përbën prirjen e teorive gjuhësore të dekadave të fundit.

§1.1.3 Përkufizime dhe tipizime të fjalive nxitëse në gjuhën angleze nga pikëpamja formale-gramatikore.

Në ligjërimin e përditshëm folësit e çdo gjuhe pohojnë, informojnë, pyesin, urdhërojnë, japin udhëzime apo urojnë e mallkojnë. Fjalitë ku shprehen **këto kumtime klasifikohen** në grupin e fjalive nxitëse. Fjalitë nxitëse janë pjesë e një ligjërimi ku veprojnë dy aktorë: *folësi* dhe *dëgjuesi* (i adresuari, marrësi a përfituesi i kumtimit përkatës). Për shumë gjuhëtarë dhe nxënës që mësojnë një gjuhë të caktuar apo kushdo që shfaq interes në një gjuhë, termi “*urdhërore*” (*imperative*) kumton një urdhër drejtuar një personi të dhënë, që shprehet nga ana gramatikore me anë të përemrit vetor të vetës së dytë *ti (you)*. Ky adresim i urdhrit ndaj një personi të vetës së dytë dallohet qartë në fjalitë në gjuhën angleze, si:

7. *Leave! Run away! (You!)*
(Largohu! Vrapo!) (Ti/ju!)

Edhe pse përemri *you (ti ose ju)* në funksionin e kryefjalës së fjalisë nuk shprehet, është e qartë se urdhri i jepet një personi tjetër, pra dëgjuesit (të adresuarit), i cili i korrespondon

³⁰ Cituar nga R. J. Mastop *Imperative mood in semantic theory*, ILLC dissertations, Netherlands, 2005, f. 1.

³¹ *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 118.

përemrit të vetës së dytë njëjës ose shumës. Dallimet bazë mes tipave të fjalive, si dëftore, pyetëse dhe nxitëse-dëshirore janë të njohura si për një nxënës që mëson një gjuhë të huaj, ashtu edhe për personat e tjerë që tregojnë interes për gjuhën.

Studimet mbi fjalitë nxitëse në gjuhën angleze kanë dëshmuar se urdhërorja, si një koncept gjuhësor më i gjerë, është trajtuar herë si një paradigmë foljore nga gramatikanët tradicionalë dhe herë si lloj gramatikor i veçantë i fjalive, e kumtuar për të realizuar një funksion të caktuar në aktin e komunikimit. Analiza e urdhërores si një kategori morfologjike apo sintaksore është pasuruar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë shfaqur dallime e kundërthënie nga qasjet formale apo funksionaliste të studiuesve në rrjedhën e viteve. Këto kundërshti janë nxitur nga fakti se gramatikanët, duke synuar që të përcaktojnë termin urdhëror si një kategori sintaksore, kanë marrë si të vërtetë përcaktimin e kësaj kategorie nëpërmjet kuptimit që fjalitë nxitëse shprehin në përdorim (duke e përdorur këtë term me disa kuptime).

Për shembull, Green-i (1975) i përkufizon fjalitë nxitëse si fjali të cilat bartin një forcë të ashtuquajtur urdhëruese, por kanë shprehje formale gramatikore normale, pavarësisht mungesës së fleksionit kohor, kryefjalës etj³². Pra, thelbi i kundërshtive i përket analizës së urdhërores si një kategori morfologjike, sintaksore apo si një tip fjali me karakteristika të veçanta edhe nga ana kuptimore, krahasuar me fjalitë dëftore dhe pyetëse.

Analiza dhe hulumtimi i fjalive nxitëse në hullinë e ndërveprimit të veçorive gjuhësore morfologjike, sintaksore, semantike dhe pragmatike në gjuhën angleze, të krahasuara me veçoritë gjegjëse në gjuhën shqipe, na japin më të plotë strukturën ndërtimore e kuptimore, si dhe karakteristikat që e dallojnë grupin e fjalive nxitëse. E parë në lidhje me të gjithë këta komponentë, fjalia nxitëse paraqitet si një fjali strukturalisht e thjeshtë, por e larmishme dhe komplekse në kuptimet që ajo mbart. Analiza e situatave ligjërimore, ku fjalia nxitëse gjen përdorim, tregon se pavarësisht strukturës së saj të thjeshtë, kjo fjali shfaq shumë dukuri dhe tipare gramatikore të veçanta dhe interesante për t'u bërë objekt studimi. Fjalia nxitëse "nxit" interesin e studiuesve për të njohur veçantitë e anës strukturore jo vetëm në strukturën sipërfaqësore, por edhe në strukturën e thellë, ndërveprimin e aktorëve pjesëmarrës në aktin komunikues, lidhjen sintaksore-semantike, në shprehjen e thjeshtë morfologjike, "ngjitjen" e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme (*tag questions*) në pozicionin fundor të fjalive nxitëse, përcjelljen e një zinxhiri të larmishëm kuptimesh dhe një sërë komponentësh të tjerë që e plotësojnë një studim të tillë sa të gjerë, aq edhe shterues.

Studimet mbi trajtimin e fjalive nxitëse në përgjithësi si në shumë gjuhë, edhe në gjuhën angleze, kanë qenë të shumta dhe u përkasin periudhave të mëvonshme të studimeve gjuhësore. Fillimisht, fjalitë nxitëse janë studiuar brenda koncepteve gjuhësore të aspektit morfologjik, si *mënyra e foljes* dhe *shprehja morfologjike* e tyre. Si fjali nxitëse janë përkufizuar ato fjali që kanë *foljen-kallëzues* në mënyrën *urdhërore*, pra janë analizuar vetëm në pikëpamjen e anës së shprehjes formale të tyre. Shprehja morfologjike ka qenë kriteri bazë për përcaktimin e fjalive si nxitëse dhe konteksti në të cilin fjalitë nxitëse kumtohen, nuk ka marrë rëndësinë e duhur. Me zhvendosjen e fokusit të studimeve në situatën ligjërimore, këto fjali janë kthyer në objekt studimi për kërkimet gjuhësore sintaksore mbi fjalitë nxitëse.

Ka mendime të ndryshme në lidhje me përcaktimin e saktë të fjalive nxitëse dhe këto përcaktime varen nga përshkrimi i tyre, duke marrë parasysh kuptimin ose strukturën sintaksore që kanë këto fjali. Duke ndjekur edhe kronologjikisht rrjedhën e studimeve mbi urdhëroren dhe fjalitë nxitëse në përgjithësi, përmendim Poutsma-n (1928), që i quan si "*fjali me anë të të cilave ne shprehim një urdhër (kërkesë) ose një nxitje*"³³. Ai nënkupton se ka një

³² Cituar nga E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 1.

³³ Cituar nga E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 2.

lidhje absolute mes strukturës sintaksore, e etiketuar si “urdhërore” (*imperative*), dhe kuptimit të fjalisë që mbart një nuancë kuptimore urdhërore a drejtuese. Të njëjtin propozim bën edhe Jespersen-i (1954) kur përmend se “shprehja e veçantë sintaksore për një kërkesë është urdhërorja, kuptimi thelbësor i së cilës është një kërkesë (*brutale ose e butë*) e drejtuar ndaj dëgjuesit ose dëgjuesve për të kryer diçka”. Në shumë gjuhë një grup i veçantë formash të urdhërores e ngushtojnë përdorimin e tyre vetëm në fjalitë që shprehin një urdhër të drejtuar ndaj vetës së dytë *you* (ti)³⁴.

Kjo shprehet qartë në vështrimin tradicional të Lyons-it, i cili thotë: “Është tepër e qartë se në thelb të një urdhri ose kërkesë qëndron drejtimi i saj ndaj një personi, i cili pritet që ta realizojë ose ta zbatojë një kërkesë a një urdhër të tillë”³⁵. Birjulin-i (1985) mendon se “për të formuluar një përkufizim të fjalive nxitëse, duhet fillimisht të përcaktojmë strukturën e saj semantike, e cila shfaqet si një model trishtresor që bashkon elemente të tri planeve të ndryshme”³⁶. Larmia e mendimeve dhe përkufizimeve na çon në përfundimin se fjalitë nxitëse kanë strukturë të thjeshtë, një semantikë të qartë dhe një ndërveprim të këtyre faktorëve me aktorët pjesëmarrës në një situatë të dhënë ligjërimiti.

Në gramatikat bashkëkohore të gjuhës angleze dhe të gjuhës shqipe fjalitë nxitëse-dëshirore përkufizohen si “fjalitë me tipare të veçanta gramatikore dhe që kumtojnë një komandë, një urdhër, një kërkesë ndaj një personi tjetër...”³⁷ apo “fjalitë që shprehin vullnetin e folësit në formë dëshire ose kërkesë, për realizimin a mosrealizimin e një veprimi, të një gjendjeje etj.”³⁸. Nga ana tjetër, përkufizimet e këtyre fjalive nga gjuhëtarë të ndryshëm të studimeve të fundit e përshkruajnë fjalinë nxitëse si një fjali, kuptimi i së cilës lidhet me faktin se do të ndryshojë realitetin ekzistues ose do ta ruajë atë³⁹.

Kjo tregon interesin e gjuhëtarëve ndaj kontekstit në të cilin kryhet një akt komunikimi që kumton një kërkesë, urdhër etj. Pavarësisht mendimeve të ndryshme që rrjedhin si pasojë e kriterit bazë që duhet të merret parasysh për të dhënë një përkufizim sa më të plotë të fjalive nxitëse, përsëri këto fjali shfaqen si formalisht të thjeshta dhe semantikisht shprehin diçka të kërkuar, të urdhëruar a të dëshiruar nga folësi. Ne mendojmë se semantika e këtyre fjalive, pra nuancat semantike që ato shprehin në kontekste të ndryshme, jo gjithmonë emërton këtë tip fjalish si fjali nxitëse, sepse ka shumë fjali që mund të jenë nga ana sintaksore të dallueshme si nxitëse, por nga ana e kuptimit përçojnë jo vetëm modalitetin e folësit, por edhe kuptime të ndryshme.

Kjo shpjegon mendimet kontradiktore dhe kundërshtitë që shfaqen nga disa studiues në lidhje me një nëntip të fjalive nxitëse (*pseudo-imperative*), të cilat jo gjithmonë mund të klasifikohen në grupin e fjalive nxitëse. Përmendim këtu fjalinë e kudogjendur:

8. *God bless you!*

(*Zoti të (ju) bekoftë!*), e cila mund të trajtohet si një fjali nxitëse a dëshirore e shprehur formalisht nga një folje-kallëzues në mënyrën lidhore. Por, e njëjta fjali mund të kategorizohet edhe si fjali nxitëse me një folje-kallëzues në mënyrën urdhërore, në të cilën folësi mëton të shprehë një lutje apo një kërkesë.

Kjo nënklasë do të shtjellohet më tej në pjesën që i referohet veçorive semantike të fjalive nxitëse. Konteksti në të cilin përdoren këto fjali duhet të luajë rolin kryesor në analizën e klasifikimit të fjalive të tilla. Konteksti socio-linguistik, ku këto thënie artikulohe, merr rëndësi në këtë pikë.

³⁴ A. Y. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 17.

³⁵ J. Lyons, *Semantics*, vol. 2, 1977, Cambridge University Press, f. 747.

³⁶ Cituar nga Victor S. Xrakovskij, *Typology of imperative constructions*, Lincom Europa, 2001, f. 5.

³⁷ R. Huddleston, G. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English language*, Cambridge University Press, 2002, f. 853-854.

³⁸ *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 129.

³⁹ *Po aty*, f. 5.

Studiuesit ndajnë një mendim të përbashkët në lidhje me thelbin e kumtimit që mbartin fjalitë (kërkesë, urdhër, porosi, këshillë), por ka një hendek që i ndan gjuhëtarët, sepse ata nuk përcaktojnë kufirin deri ku duhet të shtrihen fjalitë nxitëse në lidhje me semantikën e gjerë që ato shprehin⁴⁰. Pavarësisht përkufizimeve të shumta që shprehin anë të ndryshme të brendisë së fjalive nxitëse, analiza e tyre përforcon më tej vështrimet e gjuhëtarëve se këto fjali kanë një strukturë sintaksore të veçantë, që i dallon nga fjalitë e tjera dhe kanë këto karakteristika të përgjithshme:

A. Veçori themelore e fjalive nxitëse (tipari që e dallon nga tipat e tjerë të fjalive) është *mungesa e kryefjalës*. Në fjalitë nxitëse kemi një kryefjalë të pashprehur, por të nënkuptuar “you” (ti, ju).

9. *Come with me.*
(Eja, ejani me mua.)

Në fjalinë 9, kryefjala e nënkuptuar i referohet vetës së dytë njëjës ose shumës *you* (ti, ju). Shpeshherë kryefjala *you* përdoret në fjali për të përforcuar një urdhër, për të plotësuar kuptimin e fjalisë etj. Mospërdorimi i kryefjalës në fjalitë nxitëse është një tipar jo i përhershëm i këtyre fjalive apo i diktuar nga rregullat gramatikore që e specifikojnë këtë tip fjalie. Davies-i e përkufizon mungesën e kryefjalës në fjalitë nxitëse si *një tipar fakultativ që e karakterizon atë, që është i lidhur më tepër me dëshirën e kumtuesit sesa me kumtimin thelbësor që mbart urdhërorja në përgjithësi në fjalitë nxitëse*.⁴¹

Si rrjedhim, fjalitë nxitëse në gjuhën angleze mund të kenë një kryefjalë të shprehur, por vërehen kufizime në lidhje me shprehjen e sintagmës emërore në funksionin e kryefjalës së fjalisë nxitëse. Përemrat vetorë të vetës së parë njëjës, vetës së tretë njëjës dhe shumës nuk mund të luajnë funksionin e kryefjalës, ndërsa përemrat respektivë të vetës së dytë dhe përemrat e pacaktuar janë të zakonshëm në funksionin e kryefjalës në fjalitë nxitëse më poshtë:

10. *You* phone the police.
[Ti, ju telefonoji, telefononi / t’i telefonosh / të telefononi (policisë / policinë.)]
11. *Somebody* phone the police.
(Dikush t’i telefonojë policisë.)
12. *Everybody* leave the classroom.
(Të gjithë të largohen / largohuni nga klasa.)
13. * *I* please close the door.
(*Unë të lutem mbylle derën.) përkthimi literal
14. * *He* please turn the light on.
(*Ai të lutem ndize dritën.)
(Të lutem, ai të ndezë dritën.) gjegjësjë në gjuhën shqipe
15. * *They* please help me.
(*Ata të lutem më ndihmoni mua.)
(Të lutem, ata të më ndihmojnë mua.)

⁴⁰ E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 1-3.

⁴¹ E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 6.

Te fjalitë 13, 14 dhe 15 kemi dhënë përkthimin literal, nga i cili në gjuhën shqipe përftojmë fjali jo të sakta gramatikore dhe gjithashtu kemi përshtatur edhe gjegjëset në gjuhën shqipe. Te fjalitë 14 dhe 15 gjegjëset në gjuhën shqipe janë të sakta si nga ana gramatikore, ashtu edhe kuptimore. Folja-kallëzues në këto fjali shprehet formalisht me një folje të mënyrës lidhore (*Ai*, të lutem, të mbyllë derën dhe *Ata* të lutem të më ndihmojnë mua).

Në gjuhën shqipe, siç e kemi përmendur, kryefjala shenjohe me anë të mbaresave vetore, nëse kryefjala nuk shprehet. Duhet të theksojmë se në gjuhën shqipe folja-kallëzues e fjalive nxitëse mund të jetë edhe në mënyrën lidhore. Kuptimi urdhërues në këto fjali është më i zbutur dhe më pak i drejtpërdrejtë krahasuar me fjalitë nxitëse me foljen-kallëzues në mënyrën urdhërore. Bazuar në gjegjëset në shqip 14 dhe 15 arrijmë në përfundimin se edhe fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe mund të kenë kryefjalë të shprehur nga përemra të pacaktuar, kur folësi u drejtohet dëgjuesve të papërcaktuar. Por, në dallim nga gjuha angleze, në gjuhën shqipe përemri i vetës së tretë mund të kryejë funksionin e kryefjalës në fjalitë nxitëse me një folje-kallëzues në mënyrën lidhore (si te fjalia 14), *Të lutem, ai të ndezë dritën*, si një urdhër jo aq kategorik dhe i drejtpërdrejtë, krahasuar me forcën urdhëruese që shpreh gjegjësjë me folje-kallëzues në mënyrën urdhërore (*Ndize dritën!*).

Vetëm në përdorimet me *let*, përemri i vetës së parë dhe të tretë mund të përdoren në funksionin e kryefjalës, ku përemri *you* në një përdorim të tillë na jep një fjali jogramatikore:

16. Let [*me, him, her, us, you*] talk about science.

[Le / lërmë / më lër mua, atë, neve, ju] të flasim për shkencën.

B. Fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dallohet gjithashtu dhe nga tiparet e sintagmës foljore së cilës i *mungon kategoria e kohës* [-Tense]. Ka disa studiuues që ndajnë këtë qasje të kategorisë gramatikore të kohës. Lyons (1977) pohon: *Ne nuk mund të kërkojmë ose të urdhërojmë dikë të kryejë një veprim në të shkuarën; të vetmet dallime të kategorisë gramatikore të kohës që mund të gjejmë në fjalitë nxitëse, janë ato që lidhen me një të ardhme të menjëhershme dhe një të ardhme të largët*⁴². Fjalitë nxitëse nxitin dëgjuesin të bëjë ose jo diçka dhe duke pasur parasysh këtë funksion të kufizuar, këto fjali nuk e kanë të nevojshme kategorinë e kohës, aspektit ose modalitetit të shprehur formalisht në sintagmën foljore në funksionin e kallëzuesit të fjalisë⁴³.

P. sh.:

17a. *Be attentive!*

(*Ji i vëmendshëm!*)

b. *Somebody close the window.*

(*Dikush të mbyllë dritaren.*)

Në kumtimin e fjalive 17a dhe 17b shprehet një kërkesë dhe një urdhër që i përket një të ardhmeje pas çastit të ligjërimit. Edhe në rastet kur në fjali mund të përdoret një ndajfolje e kohës, si *now (tani)*, *right now*, si te fjalia 18, gjithmonë kuptimi kohor i kumtimit të fjalisë lidhet me të ardhmen. Telefonata kërkohet të kryhet në të ardhmen, pas çastit të ligjërimit. Kjo karakteristikë e mungesës së mbaresave kohore e afron kallëzuesin me infinitivin.

18a. *Call your brother, now!*

b. (*Telefonoji vëllait tani! / Tani t'i telefonosh vëllait!*)

⁴² A.Y. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 129.

⁴³ Biber, Conrad, Leech, *Student Grammar of spoken and written English*, Longman, 2002, f. 252.

C. Një tipar tjetër i rëndësishëm i sintagmës foljore të fjalisë nxitëse është përdorimi i foljes ndihmëse *do* në një fjali nxitëse *pohore* dhe *mohore*. Në fjalinë nxitëse *pohore* folja ndihmëse *do* përforcon kuptimin e foljes-kallëzues ose kuptimin e gjithë fjalisë. Përdorimi i *do* dallohet edhe në fjalitë nxitëse *mohore*, për të shprehur një veprim ndalues a parandalues, pra *mohor*. Në gjuhën shqipe gjegjësjë e *do not* në fjalitë nxitëse *mohore* është pjesëza *mohuese mos*.

- 19a. *Do* phone her!
(Telefonoje atë!)
b. *Do* believe her!
(Besoji asaj!)
c. *Don't* phone her!
(Mos i telefono asaj!)
d. *Don't* believe her!
(Mos i beso asaj!)

Në fjalinë nxitëse në gjuhën angleze, folja ndihmëse *do* përdoret me funksionet e përforcimit dhe shprehjes së kuptimit *mohor* me foljen *to be* (me qenë), si te fjalia 19a dhe, gjithashtu, me foljen ndihmëse *have* (*kam*) në të kryerën. Ky është një përdorim i veçantë i *do* në fjalitë nxitëse, sepse *do* dhe *have* në një përdorim të tillë në tipat e tjerë të fjalive e bëjnë fjalinë jogramatikore.

- 20a. *Do be* very attentive.
(Të jesh shumë i vëmendshëm!)
b. *Don't be* unattentive!
(Mos ji i pavëmendshëm!)
c. *Don't have* called your brother, before I send the flowers to his house.
(Mos e telefonotë mos e kesh telefonuar vëllanë tënd, para se t'i dërgoj lulet në shtëpi!)
21a. **He does* be ready.
(Ai ... të jetë gati.)
b. **Don't* we have finished the essay.
(Mos të kemi mbaruar esenë.) (përkthimi literal)

Karakteristikat e sipërpërmendura janë një vështrim i përgjithshëm i veçorive të fjalive nxitëse. Karakteristika e parë për mungesën e kryefjalës lidhet me strukturën sintaksore të fjalive nxitëse në përgjithësi, kurse dy të tjerat, [-Tense] dhe [+Aux.], i referohen tipareve të sintagmës foljore. Ndërveprimi i këtyre karakteristikave e tipizon dhe e veçon foljen-kallëzues të fjalive nxitëse si unike, krahasuar me kallëzuesit në tipat e tjerë të fjalive, të cilët nuk e kanë të kufizuar kategorinë e kohës. Modaliteti që karakterizon mënyrën urdhërore e kufizon kategorinë e kohës të foljeve-kallëzues në fjalitë nxitëse.

§1.1.4. Klasifikimi i fjalive në gjuhën shqipe sipas strukturës dhe qëllimit të kumtimit

Gjuha shqipe dhe gjuha angleze bëjnë pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane pra, në një familje gjuhësh me burim të përbashkët. Gjatë evolucionit, gjuhët indoevropiane kanë pësuar ndryshime të mëdha, në të cilat të gjitha nënsistemet e tyre janë larguar shumë njëra nga tjetra. Gjuha shqipe ka mbijetuar si një degëzim i veçantë i familjes indoevropiane të gjuhëve dhe në klasifikimin tipologjik të gjuhëve bën pjesë në grupin e gjuhëve me eptim. Si rrjedhim, në gjuhën shqipe klasifikimi i fjalive sipas strukturës së tyre dallon nga larmia e nënklasave që fjalia mund të shfaqë, krahasuar me klasifikimin strukturor të fjalisë në gjuhën

angleze. Rendi jo i ngulitur i gjymtyrëve dhe eptimi kushtëzojnë përkapjen e funksioneve sintaksore jashtë strukturës së fjalisë dhe njëkohësisht mungesa e gjymtyrëve kryesore ose të dyta nuk e prish brendinë kuptimore të fjalisë në gjuhën shqipe.

Sipas pjesëve përbërëse, pra strukturës së tyre, fjalitë mund të jenë: fjali të thjeshta, të përbëra, dykryegjymtyrëshe, njëkryegjymtyrëshe, vetore, pavetore, të plota a të paplota (mungesore) apo fjali të pagjymtyrëzueshme, të cilat nuk mund të zbërthehen. Fjalitë dhe periudha përbëjnë dy njësitë kryesore sintaksore, të cilat kanë vlerë kumtuese dhe sintaksa i studion ato të ndara në sintaksën e fjalisë dhe në sintaksën e periudhës.

Edhe në gjuhën shqipe periudha mund të jenë me bashkërenditje dhe me nënrenditje. Te periudhat me bashkërenditje kemi dy njësi kallëzuesore të një fare dhe te periudhat me nënrenditje, sipas raporteve të pjesëve përbërëse, këto njësi ndahen në fjali kryesore dhe fjali të nënrenditura ose të varura⁴⁴. Fjalitë mund të klasifikohen edhe si fjali pohore ose mohore. Ky klasifikim lidhet me raportet që ndërton thënia me realitetin dhe anën formale të shprehjes së këtij raporti.

Në gjuhën shqipe, ashtu si në gjuhën angleze dhe në shumë gjuhë të ndryshme, fjalitë klasifikohen edhe në bazë të funksionit kumtues që ato kryejnë në ligjërim. Në gramatikat e gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe në përgjithësi, mënyra e klasifikimit të fjalive sipas llojit të kumtimit shfaq ngjashmëri. Në gramatikat e gjuhëve të ndryshme, sipas llojit të kumtimit, natyrës së përmbajtjes, rolit dhe funksionit që përmbushin në ligjëratë, dallohen tre tipa fjalish:

1. fjalitë dëftore
2. fjalitë nxitëse e dëshirore
3. fjalitë pyetëse.

Klasifikimi i fjalive sipas funksionit kumtues në gjuhën shqipe nuk përkon tërësisht me klasifikimin gjegjës në gjuhën angleze. M. Çeliku e kundërshton qasjen e *Gramatikës* së Akademisë mbi klasifikimin e fjalive dhe i grupon fjalitë thirrmore në tipin e katërt të fjalive, sepse, në dallim nga tipat e tjerë të fjalive, kanë karakteristika të veçanta të natyrës së kumtimit, mjeteve leksikore dhe rolit që kryen intonacioni.

Rreth kësaj çështjeje gjuhëtarët shqiptarë në rrjedhë të viteve kanë shprehur qëndrimet e tyre. Sipas K. Cipo, farët e fjalive të pavarura janë: leçitëse (dëftore), urdhëronjëse, pyetëse, eksklamative, hipotetike, kundërshtore. Te Cipoja *fjalitë urdhëronjëse*, siç e emërton ai, klasifikohet në grupin e fjalive të pavarura dhe shpreh një urdhër, një dëshirë të atij që flet, që duhet të çohet në vend patjetër.

22. *Shko, nxito, bëmë një kafe.*

Fjalitë e pavarura mund të rrijë edhe me dëshiroret kur shpreh urim a mallkim⁴⁵.

23. *Paç fat!*

Pra, grupi i fjalive dëshirore përfshihet në grupin e fjalive *urdhëronjëse*, klasifikim që do të jepet më vonë në *Gramatikën* e Akademisë, ku shpjegohet se vullneti i folësit, i shprehur në forma të ndryshme, përbën edhe tiparin e përbashkët të të dy tipave dhe klasifikimin brenda një grupi.

I. D. Sheperi i ndan fjalitë sipas mënyrës me të cilën e shfaqin kuptimin e tyre në:

- a) pohore ose afirmative, kur shfaqin pohim: 24. *Shkruaj.*
- b) mohore ose negative, kur shfaqin mohim: 25. *Nuk shkruaj.*
- c) pyetëse, kur nuk shfaqin as pohim, as mohim⁴⁶: 26. *Shkruaj? Nuk shkruaj?*

⁴⁴ *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 110-116.

⁴⁵ K. Cipo, *Sintaksa*, Tiranë, 1952, f. 6.

⁴⁶ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001, f. 163.

Ky klasifikim nuk i përfshin fjalitë nxitëse si grup më vete në ndarjen e fjalive. Megjithatë, Sheperi analizën e fjalive *urdhërore* e kufizon me shprehjen foljore të foljes me anë të mënyrës urdhërore të përdorur vetëm në fjalitë kryesore. Ai përmend edhe mënyrën lidhore, e cila në një fjali kryesore mund të shprehë urdhër si shtytje ose ndalim.

27. *Të shkruani!*

28. *Të mos ikin!*

Sipas S. Priftit, *nuancat e ndryshme që merr fjalia për të shprehur brendinë e saj, rrjedhin nga fakti se sa e njohim këtë brendi, sa jemi në gjendje ta disponojmë si të duam, si edhe nga qëllimi që i shtrojmë vetes lidhur me të*. Për këtë arsye, mënyra e formulimit të fjalisë varet nga qëndrimi ynë subjektiv kundrejt brendisë së saj dhe kjo përbën modalitetin në fjali. Në këtë bazë ne kemi: fjali gjykimi, pyetëse, dëshirore, habitore dhe thirrore. Në grupin e tretë fjalia dëshirore përmban këta tipa: a. fjalia thjesht *dëshirore*; b. fjalia *dëshirore urdhërore*; c. fjalia *dëshirore nxitëse*; d. fjalia *dëshirore e lejimit dhe e lutjes*⁴⁷. Nga përshkrimi i tipave të fjalive të Prifti, vërejmë se ndarja e tyre bazohet më shumë në modalitetin e shprehjes së fjalive sesa në shprehjen e foljes-kallëzues me anë të mënyrës foljore urdhërore a dëshirore. Qasja e tij ndaj fjalive, ku folësi dhe situata ku ai kryen një akt komunikimi luajnë një rol të rëndësishëm, tregon kalimin e vështrimeve gjuhësore nga një aspekt më i ngushtë i shprehjes së foljes-kallëzues në fjalinë nxitëse në atë të ligjërit. Ai pohon se: *dëshira mund të marrë forma të ndryshme në të shprehurit e saj, sipas konditavet objektive, në të cilat ndodhet folësi*. Pra, jo vetëm ndërtimi sintaksor, por edhe situata e ligjërit, ku folësi vepron, shënojnë tipin e fjalive dhe kumtimin e tyre.

Sipas M. Çelikut (2012), fjalitë e thjeshta të klasifikuara sipas qëllimit të thënies janë: *dëftore, pyetëse, urdhërore, dëshirore e thirrmore*. Secili tip përbën një konstrukt të veçantë më vete e dallohet jo vetëm nga përmbajtja kumtuuese e funksioni, por edhe nga ndërtimi leksiko-gramatikor, si dhe nga intonacioni i veçantë⁴⁸. Kriteret e klasifikimit të fjalive sipas qëllimit të thënies dhe emërtimi i këtyre fjalive përbën një çështje të debatueshme mes studiuesve të gjuhës që u përkasin tendencave të ndryshme gjuhësore. Në emërtimin e fjalive nxitëse, Çeliku përdor termin fjali *urdhërore* në vend të fjali *nxitëse*, sepse, sipas tij, “urdhërore” është një term i traditës sonë gjuhësore dhe i njohur në studimet perëndimore. Në dallim nga disa gjuhëtarë të cilët nuk i shohin fjalitë thirrmore si lloj i veçantë i fjalive të thjeshta sipas qëllimit të thënies, në klasifikimin e tij Çeliku i veçon fjalitë thirrmore si grup më vete. Ai shpjegon se *këto fjali kanë intonacion të ndryshëm në varësi të emocioneve që ato shprehin, prandaj intonacioni i veçantë besoj se u jep atyre statusin e fjalive të veçanta*. Edhe përbërja strukturore me pasthirra, përemra a ndajfolje pyetëse për të shprehur emocione e ndjenja të ndryshme të folësit, e dallon këtë grup fjalish nga tipat e tjerë.

Th. Dhima, në klasifikimin e llojeve të fjalive sipas kumtimit, përmbajtjes dhe funksionit që kryejnë në ligjërim, fjalitë nxitëse dhe dëshirore i përfshin në një grup. Ai thekson se dëshira dhe nxitja për të bërë diçka janë dy forma të shprehjes së vullnetit, që në shumë raste janë aq pranë njëra-tjetrës sa është vështirë t’i dallosh dhe t’i ndash. *Të gjitha tipat e fjalive mund të jenë edhe thirrmore, në qoftë se ato shoqërohen me intonacion thirrës, me anën e të cilit folësi shpreh ndjenjat e veta*⁴⁹. Ky klasifikim përkon me qasjen e Gramatikës së

⁴⁷ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1971.

⁴⁸ M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2012, f. 279.

⁴⁹ Th. Dhima, *Sintaksa*, ShBLU, Tiranë, 2005, f. 48-60.

Akademisë⁵⁰, ku fjalitë *thirrmore* apo *eksklamative* të emërtuara nga disa gjuhëtarë, nuk grupohen më vete.

Përkrahja e kritereve klasifikuese semantike apo strukturore ka sjellë një luhatje të dukshme të shumë studiues në lidhje me klasifikimin e fjalive të ndryshme, si pyetëse, nxitëse apo dëftore. Kjo shpjegon faktin pse hasen vështirësi në përcaktimin e fjalive të tilla si:

29. *Why don't you do that?*
(*Pse nuk vepron kështu?*)

Te fjalia 29 kemi të bëjmë me një fjali pyetëse që shërben për të marrë informacion, një fjali ku folësi urdhëron dëgjuesin të veprojë apo me një fjali ku vërehet një fakt në mënyrë të tërthortë? Studimi jo i hershëm i fjalive nxitëse ka bërë që alternativat emërtuese dhe klasifikuese mbi këto fjali të jenë të larmishme.

Sipas Graffit, tradicionalisht, fjalitë ndahen para së gjithash në bazë të funksionit të tyre, në dëftore (apo *shprehëse*), pyetëse, urdhërore dhe habitore (të quajtura edhe *pasthirrmore* apo *afektive*). Në këtë klasifikim është e lehtë të vihet re se termi “funksion” nuk është termi i përshtatshëm. Një fjali dëftore, në vend që të pohojë një fakt, mund të kryejë në shumë raste funksionin për të shprehur një urdhër apo dëshirë. Duket, pra, më e përshtatshme të themi që ky dallim nuk ka të bëjë shumë me *funksionin*, sa me *modalitetin* e fjalive.⁵¹

Në “Gramatikën e gjuhës shqipe” II, fjalitë nxitëse e dëshirore klasifikohen brenda të njëjtit tip. *Ato kanë të përbashkët vullnetin e folësit, i cili shprehet në formën e një kërkesë ose dëshire, për realizimin a mosrealizimin e një veprimi apo të një gjendjeje*⁵².

Sipas klasifikimit të bërë në “Gramatikën e gjuhës shqipe” II, *Sintaksa*, të gjitha grupet e fjalive të klasifikuara sipas funksionit të kumtimit mund të jenë edhe **fjali thirrmore**, pra, dëftore-thirrmore, pyetëse-thirrmore, nxitëse-thirrmore dhe dëshirore-thirrmore. Në gjuhën shqipe fjalitë thirrmore nuk përbëjnë një grup të veçantë në klasifikimin e fjalive sipas funksionit kumtues dhe për rrjedhojë nuk shfaqin ndërtim strukturor të ndryshëm nga tipat e tjerë të fjalive. Një fjali pyetëse mund të kumtojë një pyetje të mirëfilltë mbi diçka të panjohur ose një pyetje të shoqëruar edhe me ndjenjat e folësit në çastin e ligjërimit. Në rastin e parë fjalia pyetëse shqiptohet me një intonacion të veçantë pyetës dhe në rastin e fjalisë së dytë, e cila emërtohet si pyetëse-thirrmore, intonacioni është thirrmore. Pra, karakterin e kumtimit të fjalisë e përcakton vetëm intonacioni i veçantë në të dyja fjalitë.

30a. *E more patentën?*
b. *E more patentën?!*

Fjalia 30a është fjali pyetëse, ndërsa 30b është fjali thirrmore, në të cilën intonacioni thirrmore shpreh edhe emocionet e folësit si: habi, gëzim, zili etj.

Ndryshe paraqitet kjo sjellje fjalish në gjuhën angleze. Në gjuhën shqipe çdo fjali mund të shprehë elementet afektive me anë të mjeteve prozodike, si intonacioni dhe pikësimi. Shprehja e gjendjes emocionale dhe ndjesive të veçanta në situata të ndryshme nuk pasqyrohen në fjali me një strukturë sintaksore a shprehje morfologjike të veçantë, që ta dallojë nga tipat e fjalive dëftore, pyetëse dhe nxitëse, siç ndodh me fjalitë thirrmore në gjuhën angleze. Pra, në gjuhën shqipe fjalitë ndahen në tre grupe.

⁵⁰ Secili tip i fjalive mund të dalë edhe në formën e një fjalie të shqiptuar me intonacion të ndjeshëm ngashërimor, thirrmore e atëherë është fjali thirrmore, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 118.

⁵¹ G. Graffi, *Sintaksa*, Dituria, 2008, f. 130.

⁵² *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 117.

Në shumë klasifikime të tipave të fjalive në gjuhën angleze sipas qëllimit të kumtimit, tre tipave të fjalive të sipërpërmendura u shtohet edhe grupi i fjalive thirrmore (*exclamative sentences*), të cilat klasifikohen si grup më vete⁵³. Fjalitë thirrmore në gjuhën angleze kanë strukturë sintaksore të veçantë të ndërtuar me fjalët pyetëse specifike: *what* (çfarë) dhe *how* (si), të vendosura në pozicionin nistor të fjalisë thirrmore. Rendi i fjalëve në fjalitë thirrmore është pothuajse i njëjtë me fjalitë dëftore: kryefjalë-kallëzues, të paraprirë nga *what* dhe *how*.

- 31a. *What* a weekend we had in Spain! Fjali thirrmore
 b. (Çfarë fundjave që kaluam në Spanjë!)
 32a. *How* magnificent she looks! Fjali thirrmore
 b. (Sa e mrekullueshme duket!)

What në strukturën e fjalive thirrmore (*eksklamative*) në gjuhën angleze ndiqet nga një sintagmë emërore dhe *how* nga një mbiemër a ndajfolje me vlerën kuptimore të shkallës së emocionit, ndjenjës etj. Ka edhe raste ku në fjalinë thirrmore nuk ka folje-kallëzues, por strukturalisht ndërtohen nga fjalët pyetëse *how* ose *what* të ndjekura nga një sintagmë emërore ose mbiemërore. *Fjalitë thirrmore shpeshherë dalin pa një folje të shprehur, por vetëm me elementin-wh, si fjali eliptike*⁵⁴.

33. (*How nice that dress is!*)
 (Sa i bukur që është ai fustan!)
 34. *How nice!*
 (Sa bukur!)

Duhet të theksojmë se ngjyrimet kuptimore dhe përdorimet e fjalive thirrmore janë më të pakta krahasuar me tre tipat kryesorë të fjalive. Ana semantike e tyre është shumë e larmishme dhe përmbajtja kuptimore mund të kapërcejë kuptimin thelbësor të tipit ku bën pjesë, sepse nuk ka një paralelizëm të plotë mes natyrës së kumtimit dhe shprehjes së saj formale.

Përfundim: Mund të themi që gjuhëtarët shqiptarë ndajnë mendime të ndryshme në lidhje me klasifikimin e fjalive sipas qëllimit të kumtimit. Bazuar në këtë kriter, disa gjuhëtarë të përmendur më sipër i ndajnë në tre grupe: dëftore, pyetëse dhe nxitëse-dëshirore. Të tjerët i klasifikojnë fjalitë në katër grupe: dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore. Mendojmë se klasifikimi i fjalive sipas qëllimit të kumtimit të dhënë nga Gramatika e Akademisë, është kategorizimi më i përshtatshëm i tyre dhe ne ndajmë të njëjtin mendim me këtë klasifikim.

§1.2. Fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe fjalitë nxitëse-dëshirore në gjuhën shqipe

Fjalitë nxitëse dhe dëshirore në gjuhën shqipe klasifikohen në të njëjtin grup bazuar në parimin sipas qëllimit të kumtimit që ato shprehin. Fjalitë nxitëse dhe dëshirore kanë të përbashkët vullnetin e folësit të shprehur në formë të ndryshme dhe ky modalitet i përbashkët sjell bashkëpërkime të kumtimit të të dy tipave të klasifikuar brenda një grupi. Te fjalitë dëshirore shprehet dëshira e folësit, ndërsa te fjalitë nxitëse folësi shpreh një urdher, kërkesë a udhëzim duke ndikuar te dëgjuesi, në mënyrë që të përmbushë kërkesat e tij. Si te fjalitë nxitëse, ashtu edhe tek ato dëshirore në gjuhën shqipe, vërehet përdorimi i dendur i mënyrës lidhore. Të dyja fjalitë dallojnë në *shkallën e në natyrën e elementit vullnetshprehës, që*

⁵³ S. Greenbaum, R. Quirk, *A student's grammar of the English language*, London: Longman, 1990, f. 231.

⁵⁴ S. Greenbaum, R. Quirk, G. Leech, J. Svartvik, *A comprehensive grammar of the English language*, Longman, 1985, f. 834.

përcakton përmbajtjen e kumtimit të dhënë prej tyre: te dëshiroret ai është i mekët, mosveprues; te nxitëset i ndjeshëm, veprues, merr formën e një thirrjeje për veprim⁵⁵.

Në gjuhën shqipe një fjali dëshirore karakterizohet nga tipare formale dalluese nga fjalia nxitëse, sepse folja-kallëzues është në mënyrën dëshirore dhe është lehtësisht e dallueshme nga mbaresat vetore respektive. Nga ana formale, këto fjali dallojnë nga fjalia nxitëse, ku folja-kallëzues ka vetëm dy veta të mënyrës urdhërore. Profili sintetik i gjuhës shqipe shpjegon shprehjen e foljes-kallëzues të fjalive dëshirore me një mënyrë të veçantë të foljes, *mënyrën dëshirore*. Fjalitë dëshirore gjegjëse në gjuhën angleze klasifikohen brenda fjalive nxitëse dhe shpeshherë cilësohen si grupi i fjalive ku shprehet një nuancë urimi, dëshire dhe mallkimi, e cila qëndron në kahun e kundërt me kuptimin kryesor urdhëror që mbart fjalia nxitëse. Shumë gjuhëtarë e konsiderojnë kuptimin e fjalive dëshirore si një nuancë kuptimore të zbutur brenda kuptimit thelbësor të fjalive nxitëse. Quirk-u i emërton si një lloj i fjalive të çrregullta që kanë mbijetuar si shprehje standarde, të cilat përdoren për të shprehur një dëshirë të folësit drejtuar një personi tjetër⁵⁶. Siç dihet, në shprehje të tilla përdorimi i kryefjalës është i kufizuar në disa shembuj të veçantë.

35. *Long live the King!*

(Rroftë mbreti!)

Në gjuhën angleze fjalitë dëshirore nga ana formale shprehen me të njëjtën strukturë si fjalitë nxitëse, por gjejnë realizimin e kumtimit të tyre me anë të intonacionit. Në bazë të ndërtimit strukturor, fjalitë dëshirore (*optative constructions*) në gjuhën angleze, të klasifikuara si një grup i veçantë brenda fjalive nxitëse, *mund t'i grupojmë në këto lloje*:

A. Fjali dëshirore *me strukturë të njëjtë me fjalitë nxitëse*. Në fjalinë 36 kemi një *strukturë të njëjtë* me një fjali nxitëse me foljen-kallëzues *to have (kam)*, ku folësi shpreh një urdhër a udhëzim, si te fjalia që vijon:

36. *Have a rest.*

Fjali nxitëse ku folësi shpreh një urdhër a sugjerim.

(Bëni një pushim.)

Intonacioni në këtë çift fjalish (36 dhe 37) bën dallimin mes një fjalie nxitëse në të cilën kumtohet një urdhër dhe fjalisë dëshirore ku shprehet një urim që vjen nga ana e folësit.

37. *Have a good time.*

Fjali dëshirore ku folësi shpreh një urim.

(Kalofsh mirë.)

B. Fjali dëshirore si *formula* dhe *shprehje* idiomatike arkaike. Këto shprehje dallojnë për nga rendi i gjymtyrëve, sepse kanë inversionin kryefjalë-kallëzues dhe në pozicionin nistor një ndajfolje. Vërejmë shembujt:

38. *Long live the queen!*

(Rroftë mbretëresha!)

Në disa raste të tjera nuk ka inversion dhe kryefjala gjendet para foljes në fjali. Mund të hasim edhe fjali në të cilat të dy rendet e gjymtyrëve janë të pranueshme:

39. *God save us all!*

(Zoti të na ruajë të gjithëve!)

40. *God help you!*

(Zoti të ruajtë!)

41. *So help me God!*

(Zoti më ndihmoftë!)

⁵⁵ Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 129.

⁵⁶ S. Greenbaum, R. Quirk, G. Leech, J. Svartvik, *A comprehensive grammar of the English language*, Longman, 1985, f. 839.

C. Fjali dëshirore që shprehin **urime** dhe **mallkime** të ndryshme, të cilat kanë në krye të strukturës së tyre foljen modale *may*. Këto fjali nuk hasen rëndom në ligjërim, janë më pak arkaike se strukturat e përmendura më lart dhe shprehin dëshirën e folësit për një ose më shumë persona. Larmia dhe përdorimi i këtyre shprehjeve dhe formulave të gatshme në ligjërimin e folur ose të shkruar janë shumë të kufizuara dhe nuk mund të emërtohen si urdhra të mirëfilltë që i drejtohen vetës së tretë. Këto fjali janë kategorizuar si një vlerë apo alternativë shtesë e gjithë gamës së kuptimeve të fjalive nxitëse (u drejtohen edhe personave që nuk janë të pranishëm në çastin e ligjërimit).

42. *May you be successful!*

(Paç sukses!)

43. *May you be happy!*

(Qofsh i lumtur!)

44. *May you have a speedy recovery!*

(U shërofsh sa më shpejt! / Shërim të shpejtë!)

45. *May it not happen!*

(Kurrë mos ndodhtë!)

Në shumë gjuhë, fjalitë nxitëse mund të kumtojnë edhe një urim, mallkim, përsëndetje a një dëshirë të folësit, duke e zgjeruar fushën kuptimore të tyre në një shkallë të tillë që i largon nga kuptimi thelbësor i tyre, i kumtimin të një urdhri. Studiues të ndryshëm japin emërtime të ndryshme për përdorimet e fjalive nxitëse me vlerën kuptimore tipike për fjalitë dëshirore. Me termat e Lakoff (1966), duke u bazuar në vlerën kuptimore që kanë fjalitë nxitëse në përdorim, ato ndahen në fjali *nxitëse të mirëfillta* (të vërteta sipas përkthimit literal - *true imperative*) dhe fjali *pseudo-nxitëse*. Fjalitë nxitëse të mirëfillta shprehin urdhra dhe kërkesa, kurse pseudo-nxitëset shprehin “këshilla të mirëpritura”⁵⁷.

46. *Be careful.*

(Të jesh i kujdesshëm.)

47. *Be happy.*

(Të jesh i lumtur.)

Jespersen-i⁵⁸ i ka emërtuar si përdorime *jokomanduese* të fjalive nxitëse, *pseudo-urdhërore* apo *fjali nxitëse imagjinare*, ndërsa Aikhenvald-i i përkufizon si fjali nxitëse, por që nuk urdhërojnë. Sipas saj, këto forma të urdhërores janë modele të etikës së ligjërimit - një mbështetje sociale (*social glue*) - që i ndihmon bashkëbiseduesit të vlerësojnë praninë e të tjerëve⁵⁹.

Greenbaum-i dhe Quirk-u, në klasifikimin e tipave të fjalive bazuar në funksionin që ato kryejnë në ligjërim, i grupojnë në një grup të veçantë, ku përfshijnë edhe fjalitë dëshirore që kumtojnë dëshira dhe urime nga ana e folësit. Ata e fusin këtë grup të fjalive, ku hyjnë dhe fjalitë dëshirore, në llojin e *fjalive të çrregullta*. Sipas Greenbaum-it dhe Quirk-ut, fjalitë e çrregullta janë ato fjali të cilat nuk përkojnë me modelet e strukturave të fjalive apo me variacionet e këtyre strukturave në klasat e mëdha sintaksore. Përveç fjalive dëshirore, në këtë grup ata përfshijnë edhe disa fjali pyetëse që kanë në strukturën e tyre fjalët pyetëse me *wh-*, fjali të nënrenditura me *that / if only / to-infinitive* etj.⁶⁰

Përdorimet e fjalive dëshirore përkojnë me shprehje standarde dhe idiomatike të ligjërimit të përditshëm, me shprehjet e mirësjelljes, përsëndetjeve dhe lamtumirës. Në një situatë ligjërimi ku urohet, përsëndetet apo mallkohet, kumtimi i këtyre fjalive as nuk jep, as nuk

⁵⁷ Cituar nga E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 18-19.

⁵⁸ A. Y. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 253.

⁵⁹ *Po aty*, f. 211.

⁶⁰ S. Greenbaum, R. Quirk, *A student's grammar of the English language*, London: Longman, 1990, f. 244-245.

shton një informacion, pra ligjërimi nuk përbën një komunikim kuptimplotë. Folësi në një ligjërim të tillë shpreh qartë dëshirën e tij për diçka, përfundon një bashkëbisedim në mënyrë të kulturuar apo shpreh interesin për t'u përfshirë në një situatë të dëshiruar, duke kryer në këtë mënyrë një funksion gjuhësor emotiv. Vërejmë shembujt e mëposhtëm dhe japim fjalitë gjegjëse në gjuhën shqipe:

48. *Take care.*

Folje + emër

(Trego kujdes.)

49. *Be healthy.*

Folja jam + mbiemër

(Qofsh me shëndet!)

50. *God be with you!*

Emër + folja jam + kundrinor

(Zoti qoftë me ty!)

Shumë prej fjalive që kumtojnë një dëshirë të folësit janë kthyer në mënyra të thëni e në formula të gatshme, nuk shprehin urdhra të folësit, edhe pse nga ana formale përmbajnë një folje në urdhërore. Megjithatë, të gjendur në një kontekst ku folësi urdhëron, ato mund të përcjellin edhe nuanca kuptimore urdhëruese, si te fjalia 51.

51. *Take care, it is an order!*

(*Kujdesu, ky është urdhër!*)

52. Ja kështu ju *paça*, o miq, gjithmonë në një sofër⁶¹.

Kuptimi i fjalisë 52 tregon një dëshirë të folësit a diçka që ai dëshiron t'u ngjasë të tjerëve dhe nga përdorimi i dendur këto forma janë kthyer në mënyra të thëni e në formula të gatshme. Si të tilla, këto fjali dëshirore dalin si jothirrmore.

Kur përshëndesim në gjuhën angleze me *goodbye*, ne thjesht në mënyrë të kulturuar ndahemi, largohemi dhe e përdorim si një formulë ndarëse në ligjërim. Asnjë folës nuk është në dijeni në çastin e ligjërimin, se një përshëndetje e tillë nënkupton një fjali në të cilën kuptimi kryesor është nuancë urdhri: *God be with you!* Etimologjia e fjalës *goodbye* tregon se zëvendësimi i fjalës leksikore *god* (zoti) me *good* (i mirë) u bë nga folësit e gjuhës angleze në analogji me fjalën *good day*. Një kuptim urdhërues në një fjali të tillë mund të interpretohet vetëm nga një studiues i historisë së gjuhës⁶².

Shembujt e mësipërm përforcojnë dakordësimin tonë mbi klasifikimin e fjalive dëshirore në një grup me fjalitë nxitëse. Ndërthurja kuptimore e urdhrit dhe dëshirës është e qartë dhe e dallueshme në këtë lloj të fjalive dhe ky kriter e përlligj kategorizimin e fjalive nxitëse në të njëjtin grup me fjalitë dëshirore. Ne mendojmë se përfshirja e grupit të fjalive dëshirore brenda grupit të fjalive nxitëse në gjuhën angleze dhe brenda të njëjtit tip të fjalive në gjuhën shqipe, është realizuar nga veprimi i disa faktorëve gjuhësorë:

1. Shprehja *identike* formale e fjalisë dëshirore me *fjalinë nxitëse* në gjuhën angleze, ku folja-kallëzues në të dyja fjalitë është një folje në formën bazë të saj, pra, *infinitivi* pa pjesëzën *to*. Në gjuhën shqipe fjalitë dëshirore gjejnë shprehje nga ana formale nëpërmjet kategorisë gramatikore të *mënyrës dëshirore* dhe në disa kontekste edhe në *mënyrën lidhore*. Përfshirja brenda të njëjtit grup përlligjet nga vlera e modalitetit që shprehin fjalitë nxitëse dhe dëshirore në gjuhën shqipe, ndërsa në gjuhën angleze fjalitë dëshirore përfshihen brenda tipit të fjalive nxitëse, si një prej gamës së larmishme të kuptimeve të fjalive nxitëse.

⁶¹ *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 130.

⁶² A. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 244.

2. Realizimi i kumtimit të një fjalie dëshirore dhe nxitëse në një situatë ligjërimi në të cilën veprojnë *dy palë pjesëmarrëse*. Fjalja dëshirore shpreh një fakt të dëshiruar prej folësit, ku në shumë raste e përfshin edhe atë vetë.

Folësi: urdhëron ose uron.

Dëgjuesi: përmbush urdhrin ose asimilon urimin e marrë.

3. Ana semantike e fjalive dëshirore të përdorura në kontekste të ndryshme ligjërimi me një *përmbajtje kuptimore* urdhri a nxitjeje (universalisht kuptimi kryesor i fjalive nxitëse). Siç e kemi përmendur edhe më lart, disa fjali nxitëse në gjuhën angleze, që shprehin një fakt të dëshiruar nga folësi për dëgjuesin (vlerë kuptimore e fjalive dëshirore në gjuhën shqipe⁶³), shpeshherë mund të shprehin nxitje dhe porosi për dëgjuesin, si te fjalia 52, edhe pse në situata të ndryshme ligjërimore shprehin fakte të dëshiruara dhe janë kthyer në shprehje a thënie të veçanta urimi, përshëndetjeje etj.

4. *Modaliteti* që përshkon përmbajtjen e kumtimit që transmetojnë të dyja fjalitë. Në gjuhën shqipe folja-kallëzues ka mbaresa të veçanta vetore që shënojnë mënyrën dëshirore dhe nuk mund të përdoret me kuptimin e një urdhri për folësin, por si një dëshirë e folësit për dëgjuesin, në mënyrë që të kryejë diçka. Te fjalia 52, folësi shpreh një dëshirë të tij drejtuar bashkëbiseduesve, e shenjuar formalisht nga mbaresat vetore foljore të mënyrës dëshirore dhe fjalia shfaq dukshëm edhe ndjesitë e folësit, edhe karakterin afektiv. Në shumicën e rasteve fjalitë dëshirore në gjuhën shqipe dalin si fjali thirrmore. Vullneti i folësit është e përbashkëta e anës kuptimore të fjalive nxitëse dhe dëshirore. Një modalitet i tillë i ka afruar këta dy tipa fjalish si pjesë e të njëjtit lloj në gjuhën shqipe, dhe si ngjyime kuptimore që u përkasin fjalive nxitëse në gjuhën angleze.

Analiza e fjalive dëshirore brenda grupit të fjalive nxitëse në gjuhën angleze nuk përmban gjithë ngjyrimet kuptimore të fjalive gjegjëse në gjuhën shqipe. Edhe në gjuhën angleze nuanca kuptimore e një fakti të dëshirueshëm prej folësit mund të realizohet edhe me struktura të tjera të fjalisë, përveç ndërtimit strukturor me një folje në formën bazë të saj. Përmendim këtu fjalitë që kanë në pozicionin nistor të strukturës së tyre *if only* (sikur).

53. *If only I had known Sam earlier*

(Sikur ta kisha \ paskështa njohur Semin më parë!)

54. *If only he hadn't learnt the truth!*

(Sikur të mos e kishte marrë vesh të vërtetën!)

Semantika e disa fjalive dëshirore në gjuhën angleze do të trajtohet më tej në varësi të gamës së gjerë të kuptimeve që mbartin dhe, në qasjen tonë, mëtojmë të theksojmë strukturën e njëjtë të fjalive dëshirore dhe fjalive nxitëse në gjuhën angleze. Gjegjësjë në gjuhën shqipe shprehet nga ana morfologjike me anë të një foljeje në mënyrën dëshirore dhe shpeshherë në mënyrën lidhore.

Përfundim: Meqenëse fjalitë nxitëse përbëjnë numrin më të madh të fjalive në grupin e fjalive nxitëse-dëshirore, të cilat kanë një strukturë të njëjtë me fjalinë nxitëse të mirëfilltë në gjuhën angleze, ne do të përqendrohemi më tepër në veçantitë semantike, sintaksore dhe pragmatike të fjalive nxitëse, duke kundruar më thellë fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe.

⁶³ “Fjalitë dëshirore shprehin një fakt të dëshiruar prej folësit, diçka që folësi do që t’i ngjasë (a të mos i ngjasë) një tjetri a disa të tjerëve, bashkëbiseduesit a bashkëbiseduesve ose një personi të tretë a disa personave të tretë - ndonjëherë vetes ose disa vetave, duke përfshirë edhe folësin.” Cituar nga *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 130.

§1.3. Fjalitë nxitëse në këndvështrimin gjenerativist dhe gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe

Studimi i gjuhëve dhe gjuhësia si shkenca mbi gjuhën përjetuan një revolucion të vërtetë në konceptin dhe mendimin gjuhësor të shekullit XX. Gjysma e dytë e shekullit XX shënoi një kthesë të madhe në drejtimet gjuhësore, duke u orientuar në teorinë dhe konceptet gjenerativiste. Një nga përfaqësuesit më të mëdhenj të gjenerativizmit si rrymë gjuhësore është Noam Chomsky, i cilësuar si babai i gjuhësisë moderne me botimin tij “*Strukturat sintaksore*” (*Syntactic Structures*) në vitin 1957. Gjenerimi i fjalive, përligjja e rregullave që e bëjnë fjalinë të kuptueshme, rregullat transformuese dhe gramatika universale janë disa nga konceptet bazë të gramatikës gjenerative-transformuese.

Veçoritë sintaksore të fjalive nxitëse në gjuhën angleze u studiuuan dhe u analizuan në mënyrë shteruese në fazat e para të zhvillimit të rrymës gjenerativiste (Thorne 1966, Downing 1969, Chomsky 1975 etj.). Pas një periudhe të gjatë “qetësie” në lidhje me studimin e fjalive nxitëse, Beukema dhe Coopmans (1989) propozuan analizën e parë të plotë brenda traditës së teorisë së drejtimit dhe të lidhjes (*Government - Binding theory*). Ky studim e përfshiu edhe fjalinë nxitëse në objektin e studimeve sintaksore dhe zgjoi interesin e studiuesve të tjerë për fjalitë nxitëse⁶⁴.

Teoria gjenerative u ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe fjalive nxitëse, për shkak të larmisë së madhe të modalitetit që ato shprehin. Gramatika tradicionale (te përkufizimet dhe qasjet e studiuesve të përmendura më lart) ka hasur vështirësi në paraqitjen skematike të tyre, sepse këta tipa fjalish konsideroheshin si fjali që nuk kanë tipare të veçanta për t’u analizuar, për shkak të strukturës së thjeshtë të ndërtimit të tyre. Të emërtuara më herët në gjuhën shqipe si fjali *urdhërore*, fjalitë nxitëse janë analizuar dhe shpjeguar nëpërmjet kategorive gramatikore, mënyrës urdhërore apo dy vetave të foljes, gjë që ka sjellë një trajtim jo të plotë dhe të thelluar të tipologjisë së fjalive nxitëse në përgjithësi në të gjitha gjuhët e familjes indoevropiane.

Duke u mbështetur në studimet e deritanishme, mund të arrijmë në përfundimin se gramatika tradicionale ka bërë një analizë të fjalive nxitëse *me prirjen drejt karakteristikave të anës formale dhe gramatikore*. Ky trajtim i fjalive nxitëse nga studimet dhe vështrimet tradicionale që paraprinë pikëpamjet gjenerativiste, ishte një shtysë për të thelluar më tej analizën e fjalive nxitëse në të gjithë komponentët karakterizues të strukturës së thellë dhe transformimeve që rrjedhin prej tyre.

Nga pikëpamja gjenerativiste, fjalitë nxitëse nuk shfaqen si fjali me një strukturë të thjeshtë, pasi rregullat transformuese që i gjenerojnë ato, janë po aq komplekse dhe të ngjashme me rregullat e transformimit të tipave të tjerë të fjalive, të cilat janë trajtuar më herët dhe më gjatë nga studiuesit. Disa nga tiparet sintaksore dalluese që mund të kundrohen gjatë analizës së fjalive në gjuhën angleze dhe që i kanë udhëhequr gjuhëtarët gjenerativistë në studimet e tyre janë:

1. **Së pari**, kryefjala *boshe* ose *zero* në strukturën e fjalive nxitëse.

55. (K)_____ *Join* *the English club!*
 (Kryefjala zero) bashkohu-urdhër, v. II nj.-sh. *klubi i anglishtes!*
 (Merr/-ni pjesë *në klubin e anglishtes!*)

Studimet mbi statusin sintaksor të kryefjalës në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze kanë qenë të shumta. Veçanti dalluese te fjalitë nxitëse në gjuhën angleze është *mungesa* e

⁶⁴ E. Potsdam, *Analysing word order in the English imperative*, in Wim van der Wurff, *Imperative clauses in generative grammar*, Amsterdam: John Benjamins, f. 251.

kryefjalës. Kryefjala e pashprehur nga ana formale, sipas semantikës së fjalisë, është gjithmonë një kryefjalë e nënkuptuar *you* (ti). Pra, kumtimi i fjalisë i drejtohet një personi të vetës së dytë. Në punimet tradicionale është theksuar se urdhërorja gjithmonë ka një kryefjalë të vetës së dytë, për faktin se: “Përderisa urdhërorja përdoret për t’iu adresuar dikujt, atëherë kryefjala e një fjalisë nxitëse duhet të jetë gjithmonë në vetën e dytë” (Sweet, 1960)⁶⁵. Portner, në studimin e fundit (2013)⁶⁶ dhe në studimet e hershme të tij (2004, 2007) mbi kryefjalën në fjalitë nxitëse, thekson se ajo ka dy tipare tipologjike të rëndësishme: *kryefjala i referohet një të adresuari dhe ajo mund të mos shprehet*. Këto përcaktime theksojnë praninë e një kryefjale te fjalitë nxitëse që herë është e shprehur e herë jo.

Në vështrimin e saj mbi interpretimin e kryefjalës në fjalitë nxitëse, Jensen-i propozon një përfaqje të karakteristikave të kryefjalës në fjalitë nxitëse me gjegjësen në fjalitë dëftore. Sipas saj, fjalitë nxitëse dhe fjalitë dëftore dallojnë nga mënyra e interpretimit të kryefjalës. Nëse do ta analizojmë kryefjalën në aspektin semantik, do të dallojmë dy anë: *e para* lidhet me rolin tematik që mbart kryefjala e secilës fjali. Ndryshe nga kryefjala e fjalisë dëftore, e cila mund të ketë disa role tematike, te fjalitë nxitëse kryefjala ka vetëm rolin e vepruesit (*agentive theta-role*). Te fjalitë nxitëse kryefjala luan rolin e vepruesit dhe vepruesit të nënkuptuar (*intended agent*). Dallimi mes kryefjalës së fjalive dëftore dhe fjalive nxitëse vërehet në anën e dytë të vlerës semantike: te dëftoret është kryefjala e kallëzuesit dhe te nxitëset është dëgjuesi⁶⁷.

Sipas vështrimit gjenerativist, në strukturën e thellë te fjalitë nxitëse gjendet një kryefjalë e shprehur *you* (ti, ju), e cila fshihet në strukturën sipërfaqësore dhe lë pas gjurmën përkatëse t̲. Në strukturën e thellë, rendi i përbërësve të fjalisë përmban jo vetëm një kryefjalë *you*, por edhe foljen modale ndihmëse *will*, të cilat ndryshohen ose lëvizin në nivelin e strukturës sipërfaqësore. Zhvendosja ose fshirja e kryefjalës *you* në strukturën sipërfaqësore, lë një gjurmë t̲⁶⁸. Tradicionalisht, *kryefjala është përkufizuar si një gjymtyrë “e nënkuptuar” ose “e munguar”*. Për ta përligjur një dukuri të tillë shërbejnë një sërë “testesh” për kryefjalën *you* në fjalitë nxitëse. Një prej tyre është edhe përdorimi i përemrave vetvetorë, të cilët janë të ndërtuar formalisht me *-self* ose *-selves të vendosur pas një përemri vetor dhe që kanë të njëjtin referent me kryefjalën e fjalisë, d.m.th. ata përshtaten në vetë, në numër dhe në gjini me kryefjalën*⁶⁹.

Kryefjala në fjalitë nxitëse shprehet formalisht me përemrin vetor *you* (ti) dhe për të kuptuar praninë e një gjymtyrë të tillë në funksionin e kryefjalës analizojmë përemrat vetvetorë në gjuhën angleze. Dimë që përemrat vetvetorë në gjuhën angleze janë të tipit: *myself, yourself*⁷⁰ (*vetja*) dhe i drejtohen të njëjtit referent me kryefjalën e fjalisë. Pra, këta përemra përshtaten në numër, në vetë apo dhe në gjini (për vetën e tretë). Nuk e vërejmë këtë përshtatje në fjalitë nxitëse, në të cilat prania e përemrit vetvetor të vetës së dytë njëjës dhe shumës (*yourselves, yourselves*) na jep një fjali të saktë nga ana gramatikore. *Përderisa kryefjala e nënkuptuar e një fjalisë nxitëse të mirëfilltë është you (ti), atëherë do të përftojme një fjali gramatikisht jo të saktë, kur në përbërjen e saj ka përemra vetvetorë të vetave të tjera*

⁶⁵ Cituar nga B. Jensen, *Syntax and semantics of imperative subjects*, Proceedings of 19-th Scandinavian Conference of Linguistics, vol. 31.1, 2003, f. 150.

⁶⁶ P. Portner, *Imperatives, Handbook of Semantics*, Cambridge University Press, 2013.

⁶⁷ B. Jensen, *Syntax and semantics of imperative subjects*, Proceedings of 19-th Scandinavian Conference of Linguistics, vol. 31.1, 2003, f. 150-164.

⁶⁸ “Kategoria e zbrazët, që unë e quaj “gjurmë” [...], është një element real i rishkrimit mendor, edhe pse nuk ka kurrfarë përmbajtje fonetike”, Chomsky, *Lectures on Government and Binding*, Foris publications, 1988, f. 34.

⁶⁹ L. J. Brinton, *The structure of modern English*, John Benjamins publishings, 2000, f. 208.

⁷⁰ Përemrat vetvetorë përdoren në fjali kur kundrinori i fjalisë është bashkëreferent me kryefjalën e fjalisë. *Po aty*, f. 410.

dhe jo të vetës së dytë në funksionin e kundrinorit të fjalisë⁷¹. E dallojmë këtë ndryshim në fjalitë e mëposhtme:

- | | |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| 56. They enjoyed <i>themselves</i> in the birthday party [*himself, myself]
(Ata u kënaqën në festën e ditëlindjes.) | <i>Fjali dëftore</i> |
| 57. Did she enjoy <i>herself</i> in the birthday party? [*ourselves, yourself]
(U kënaq ajo në festën e ditëlindjes?) (e kënaqi veten e saj \ vetveten) | <i>Fjali pyetëse</i> |
| 58. Cover <i>yourself</i> with a blanket!
(Mbulohu (<i>mbuloje veten</i>) me një batanije!) | <i>Fjali nxitëse</i> |
| 59. (You) Enjoy <i>yourself</i> !
(Ti) Kënaq <i>vetveten</i> !
*You \ enjoy <i>himself</i> !
(Kënaqe <i>veten e tij</i> ! ⁷²) | <i>Fjali nxitëse</i> |

Në fjalitë 56 dhe 57 (fjali dëftore dhe pyetëse), vetëm përemri vetvetor është i pranueshëm dhe, nëse do të vendosnim përemrin vetor të vetës së dytë *you* në vend të tij, do të kishim një fjalë jogramatikore. Përemri vetor i vetës së dytë *you* në fjalë gjendet vetëm në pozicionin e kryefjalës, prandaj dhe në gjuhën angleze janë emërtuar si përemra kryefjalorë si: *Enjoy you (*kënaqu ti* \ Cover you (*mbulohu ti*) etj. Gjegjëset në shqip janë të sakta si nga ana kuptimore, edhe nga ana gramatikore, sepse rendi i lirë i gjymtyrëve në gjuhën shqipe lejon që përemri vetor *ti*, edhe pse i vendosur pas foljes-kallëzues, kryen funksionin e kryefjalës së fjalisë.

Të gjithë këta shembuj vërtetojnë hipotezat e ndryshme mbi pozicionin e kryefjalës *you* në strukturën e thellë të fjalive nxitëse. Për sa i takon fjalive gjegjëse të shqipes, përemrat vetvetorë janë vetëm dy dhe nuk kanë formë të tjera për të dalluar vetën e kryefjalës të cilës i referohen përemrat vetvetorë. Përemri vetvetor përdoret me kuptimin e përemrave vetorë të çdo vete e të çdo numri. Si përemra vetvetorë në gjuhën shqipe shërbejnë fjalët *vetja* dhe *vetvetja*. Përemri vetvetor ka vlerë kuptimore përemërore dhe strukturë emërore⁷³. Përemrat vetvetorë në gjuhën angleze kanë formë të veçanta për numrin njëjës e shumës, vetën dhe gjininë: *myself-ourselves*; *himself-herself* etj. Në dallim nga përemrat në gjuhën angleze, përemrat vetvetorë në gjuhën shqipe nuk kanë formë të veçanta për numrin shumës dhe në paradigmat e lakimit marrin trajtat e një emri të gjinisë femërore të trajtës së shquar në numrin njëjës.

Në gjuhën shqipe kryefjala në fjalitë nxitëse mund të mungojë, por është lehtësisht e dallueshme veta të cilës i referohemi, pra, nëse kemi të bëjmë me një dëgjues (të adresuar) të vetës së dytë njëjës apo të vetës së dytë shumës. Mbaresat foljore shënojnë përkatësisht vetën e dytë njëjës dhe shumës. Në vetën e dytë shumës të gjitha foljet dalin me të njëjtën formë si në vetën e dytë shumës së kohës së tashme të mënyrës dëftore ose lidhore (Punoni - *Punoni*!), kurse, për sa i takon numrit njëjës të urdhërores, vetëm një pjesë e vogël foljesh dalin me të njëjtën formë si në vetën e dytë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore (hap-hap). Foljet e tjera dalin me formë të ndryshme nga format gjegjëse të kohës së tashme të mënyrës dëftore (Ti, punon-puno, luan-luaj etj.)⁷⁴. Foljet e mënyrës lidhore që luajnë funksionin e kallëzuesit në fjalitë nxitëse dalin me të njëjtat mbaresa vetore (Të punosh-Të punosh / punoni!).

⁷¹ S. Greenbaum, R. Quirk, G. Leech, J. Svartvik, *A comprehensive grammar of the English language*, Longman, f. 357.

⁷² Në gjuhën shqipe përemrat vetvetorë lakohen si emrat e gjinisë femërore në trajtën e shquar, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 2002, f. 228-229.

⁷³ *Po aty*, f. 228-229.

⁷⁴ *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 2002, f. 297-298.

2. *Së dyti*, rendi i *përmbysur* i kryefjalës në rastin e fjalive nxitëse-mohore (nxitëse-ndaluese):

60. *Don't you (S) touch that!*
 (Mos ti (kryefj.) prek atë!)
 (Mos e prek atë! Ti mos e prek atë!)

Struktura e fjalisë 60 tregon se nuk kemi të njëjtën dukuri të rendit të përmbysur të kryefjalës në fjalinë gjegjëse në gjuhën shqipe. Kryefjala nuk vendoset midis pjesëzës mohuese *mos* dhe foljes *prek*, si në rastin e gjuhës angleze. Kryefjala zë pozicionin nistor në strukturën e fjalisë mohuese dhe nga ana e vlerës semantike merr nuanca më të forta të urdhrit, krahasuar me rastin kur kryefjala nuk shprehet në të njëjtën fjali nxitëse-mohore. Pra, kur kryefjala *ti* gjendet në fillim të fjalisë, folësi shpreh një urdhër më të prerë e kategorik. Në këtë rast folësi e veçon apo e diferencon kryefjalën *ti* që nënkupton:

61. *Ti* nuk duhet ta prekësh dhe jo *dikush tjetër*.

3. *Së treti*, përdorimi i foljes *ndihmëse do* në fjalitë nxitëse-mohore dhe fjalitë *emfatike*⁷⁵ edhe me foljen *be (jam)* apo me foljen *ndihmëse have (kam)*, si një karakteristikë dalluese e tipit të fjalive nxitëse. Në fjalitë dëftore dhe pyetëse në gjuhën angleze foljen *ndihmëse do* nuk e gjejmë të përdorur me foljet *to have (me pas)* dhe *to be (me qenë)*⁷⁶:

62. * They don't are tourists.

*Don't they are tourists?

63. *Do be sincere.*

Fjali nxitëse

Fol. ndihm. + jam i sinqertë

(Ji / të jesh i sinqertë.)

64. *Do have some tea.*

Fjali nxitëse

Fol. ndihm. + pi pak çaj.

Pi pak çaj.

Nga shembujt më lart dallojmë se strukturat gjegjëse në shqip nuk ndërtohen me foljen *jam* ose *kam*, por në përkthimet e përshtatura ato shprehen me foljen leksikore në mënyrën urdhërore ose lidhore. Funkcioni përforcues i kumtimit të fjalisë në gjuhën shqipe nuk mund të përmbushet me anë të foljeve *ndihmëse* si të fjalitë nxitëse në gjuhën angleze. Rendi i fjalëve, pjesëzat modale, mjetet prozodike si: *intonacioni*, *theksi* etj., shërbejnë në gjuhën shqipe për të theksuar kumtimin e fjalisë. Ndryshimi i rendit të fjalëve mund të sjellë ndryshime të karakterit stilistik, duke tërhequr vëmendjen mbi këtë apo atë fjali, po nuk ndikon në marrëdhëniet sintaksore⁷⁷.

4. *Së katërti*, kundrinor *zero* në një pjesë të madhe të fjalive nxitëse në gjuhën angleze, edhe pse ai mund të ketë një referent të përcaktuar dhe të nënkuptuar prej dyshes *folës - dëgjues* në situatën në të cilën zhvillohet ligjërimi:

65. *Leave!* (the meeting etj.)

(Lëre!) (takimin)

Strukturën e fjalive pa një kundrinor të shprehur nuk e hasim në të gjitha fjalitë nxitëse në gjuhën angleze, por mungesa e kundrinorit është një veçori dalluese e tyre. Pra, fjalitë nxitëse mund të kenë një strukturë të thjeshtë vetëm me një folje-kallëzues të shprehur dhe funksioni kumtues i tyre është i përmbushur. Fjalitë gjegjëse në gjuhën shqipe në disa raste mund të ndërtohen nga folja-kallëzues që shpeshherë merr kundrinor të shprehur (ose me formën e tij

⁷⁵ Fjalitë emfatike janë ato fjali ku folja *ndihmëse do* paraprin foljen-kallëzues në fjalinë nxitëse duke e theksuar dhe përforcuar kumtimin përkatës të fjalisë: *Do believe me!* - Më beso!

⁷⁶ Cituar nga W. Van der Wurff, *Imperative clauses in generative grammar*, Benjamins publishings, 2007.

⁷⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 72.

të plotë me emër a përemër apo me trajtat e shkurtra). Edhe kur kundrinori mungon në fjali, trajtat e shkurtra kryejnë funksionin sintaksor të kundrinorit të drejtë ose të zhdrejtë, të vendosura para, pas apo të ndërfutura në trupin e foljes si te fjalia nxitëse 65 (gjegjësja në gjuhën shqipe).

Ngjitja e trajtave të shkurtra te kallëzuesi i fjalive nxitëse në gjuhën shqipe me një funksion të tillë sintaksor është një tipar i gjuhëve aglutinative. Gjithashtu, në gjuhën shqipe dhe në gjuhët romane kundrinori i drejtë mund të rimerret në fjali. Këtë rast do ta shtjellojmë më tej gjatë analizës së pozicionit që trajtat e shkurtra në funksionin sintaksor të kundrinorit marrin në strukturën e thellë dhe atë sipërfaqësore. Këto tipare, përveçse përbëjnë veçoritë sintaksore dalluese të fjalive nxitëse në gjuhën angleze, janë shndërruar për një kohë të gjatë në objektin e studimit të gjuhëtarëve gjenerativistë. Këto veçori të fjalive nxitëse janë lehtësisht të dallueshme për çdo studiues që bën një analizë të thjeshtë të tyre.

Trajtimi sipërfaqësor i fjalive nxitëse për një kohë të gjatë shpjegohet edhe me kategoritë e kufizuara që ka folja-kallëzues në këto fjali. Kategoritë e kufizuara mund të gjenden në gjuhët analitike, si gjuha angleze, por edhe te gjuhët me një eptim të pasur, në të cilat folja-kallëzues humbet edhe disa kategori gramatikore, si aspekti, veta, koha apo mënyra. Në gjuhët e poshtëshënuara, si gjuhë me një eptim të pasur dhe tipologjikisht të emërtuara si gjuhë sintetike, folja shfaq kufizime të kategorisë gramatikore të vetës (*e cila shpreh lidhjen mes folësit dhe kryefjalës, së shprehur ose të nënkuptueshme të fjalisë*⁷⁸) dhe në mënyrën urdhërore ajo ka vetëm dy veta:

Latinisht: veta e dytë njëjës - *lauda = lëvdo!* dhe veta e dytë shumës: *laudata = lëvdoni!*

Frëngjisht: parler - je *parle / j'ai parle / parlerai*, por në urdhërore kemi: *parle / parlez;*

Italisht: parlare: *parlo, ho parlato, parlerai, avra parlato*, por kemi: *parla / parlate;*

Shqip: me folë: *flas, fola, kam folur, do të flas* dhe në urdhërore kemi dy veta: *fol / flisni.*

Edhe në gjuhën shqipe folja ka vetëm dy veta në mënyrën urdhërore, por në disa kontekste folja-kallëzues mund të shprehet edhe me një folje në kohën e ardhme apo në kohën e tashme të mënyrës dëftore.

Si përfundim mund të themi që fjalitë nxitëse sipas analizës gjenerativiste kanë një strukturë sipërfaqësore të thjeshtë dhe formohen nga të njëjtat rregulla komplekse transformuese si fjalitë dëftore e pyetëse. Ato kanë katër tipare dalluese sintaksore:

1. Kryefjalë zero.
2. Rend të përmbysur të kryefjalës te fjalitë nxitëse-mohore.
3. Folja ndihmëse *do* në fjalitë nxitëse-mohore dhe fjalitë emfatike.
4. Kundrinor zero në një pjesë të madhe të fjalive nxitëse.

§1.3.1. Lëvizjet sintaksore në strukturën e thellë dhe sipërfaqësore të fjalive nxitëse dhe diagramet e përfutuara nga transformimet e ndodhura

Në spektrin e teorive gjenerative transformuese përsiatjet e studiuesve gjenerativistë u drejtuan drejt paraqitjes së rregullave transformuese që e shndërruan fjalinë nxitëse nga një strukturë e thellë në atë sipërfaqësore, duke theksuar faktin se fjalia nxitëse "*fshihte*" disa dukuri sintaksore që drejtoheshin nga këto rregulla. Mendimet dhe hipotezat e studiuesve të ndryshëm tregojnë për një strukturë të thellë të fjalive nxitëse të ndërtuar me përbërësit *you* dhe *will*, të cilët mund të asimilohen në strukturën e fjalisë pyetëse të pagjymtyrëzueshme (*tag question*)⁷⁹ me *will* në fjalinë dëftore (si te fjalia 67), e cila me një strukturë të tillë merr një vlerë kuptimore drejtuese apo urdhëruese.

⁷⁸ Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 267.

⁷⁹ Përdorimi i *tag questions* është karakteristikë e fjalive dëftore në gjuhën angleze. Ato gjenden edhe në strukturën e fjalive nxitëse dhe kryejnë funksionin përforcues e plotësues të kumtimit përkatës. Ne i kemi


Në studimet e mëtejshme Chomsky dhe të tjerë gjenerativistë shpjeguan se ishin rregullat e transformimit që e vendosnin *will* në strukturën e fjalive dëftore dhe gjithashtu në strukturën e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme (*tag questions*), të cilat ndjekin fjalitë nxitëse dhe vendosen në fund të tyre. Struktura e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme e ndërtuar me *you* dhe *will* vërteton hipotezat e gjuhëtarëve për praninë e kryefjalës *you* në strukturën e thellë, e cila në strukturën sipërfaqësore del në një pozicion që paraprin foljen ndihmëse *will*.

66. Throw the box, *will you?* Fj. nxitëse + fj. pyetëse e pagjymtyrëzueshme
(Hidhe kutinë, apo jo/si thua?) (A e hedh pak kutinë?)⁸⁰

67. You will not throw the box, *will you?* Fj. dëftore + fj. pyetëse e pagjymtyrëzueshme
(Ti nuk do ta flakësh kutinë, apo jo?)

Vërejmë shndërrimet në fjalitë dëftore si:


68. *You will accept my proposal you have promised to.* Fjali dëftore
(Ti do ta pranosh propozimin tim që më ke premtuar.)



Throw the box, *will you?*

përshtatur në gjuhën shqipe me termin *fjali pyetëse të pagjymtyrëzueshme* dhe do t'i trajtojmë si një çështje më vete në kërret pasardhës.

⁸⁰ Përkthimi gjegjës në gjuhën shqipe i *tag questions* në fjalitë nxitëse nuk është gjithmonë *apo jo*, por në kontekste të ndryshme mund të përkojë me *pjesëza modale* që shprehin dyshim, konfirmim etj. Kjo ndodh sepse nuk kemi një strukturë identike gjegjëse të tyre në gjuhën shqipe.



Nga këta shembuj vërejmë këto shndërrime:

1. Kryefjala *you*, koha e tashme dhe folja ndihmëse *will*, që paraqiten në strukturën e thellë, nuk shfaqen në strukturën sipërfaqësore.⁸¹

2. Struktura sipërfaqësore nuk pranon një folje modale ose ndihmëse *be* dhe *have*, sepse fjalia do të ishte jo e saktë nga ana gramatikore. Për shembull, fjalitë 69 dhe 70 janë të pasakta.

69. **Have* drop the bag,

70. **May* close the door etj.

Foljet modale nuk shfaqen në strukturën e thellë të fjalisë nxitëse, sepse pozicioni i tyre është zënë nga folja ndihmëse *will*. Dimë se folja në mënyrën urdhërore nuk e ka kategorinë gramatikore të kohës dhe foljet ndihmëse modale nuk përdoren në strukturën e foljeskallëzues të fjalive dëftore⁸². Sipas Rupp, nuk ka dallime morfologjike kohore të fjalitë nxitëse dhe ato shfaqin ngjashmëri me infinitivin e foljes, por dallojnë nga fjalitë dëftore në këtë aspekt⁸³. Pra, mungesa e kategorisë së kohës {-Tense} shpjegon mungesën e foljeve ndihmëse *to have* (kam) dhe *to be* (jam), të cilat tregojnë një veprim në kohën e shkuar ose me aspekt të vazhduar, ndërsa fjalia nxitëse shpreh një veprim që i përket një çasti kohor të së ardhmes, pas çastit të ligjërit.

Një tjetër dukuri gjuhësore që do të shpjegonte më qartë rregullat e transformimit në fjalitë nxitëse lidhet me ndryshimet që mund të sjellin këto transformime në kuptimin e fjalisë, pra, veprimin e *ndërfaqësit semantik*. Një transformim i tillë, në lidhje me parimet gjenerativiste, nënkupton se shndërrimi në strukturat e thella nuk e prek semantikën e fjalisë dhe si rrjedhojë nuk sjell ndryshime në kuptimin e saj. Botimi i veprës së Chomsky-it (“*Syntactic Structures*”) tregoi më qartë ndikimin e rregullave transformuese në kuptimin e fjalive. Sipas Chomsky-it, “në mënyrë që një fjali të kuptohet, është e nevojshme të njihet fjalia bazë nga e cila ajo ka origjinën, struktura e frazës për secilin nga këta komponentë

⁸¹ Në strukturën e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme të fjalitë nxitëse në gjuhën angleze kemi *will* dhe *you*: Help me, will you?

⁸² S. Greenbaum, R. Quirk, G. Leech, J. Svartvik, *A comprehensive grammar of the English language*, Longman, 1985, f. 827.



⁸³ L. Rupp, *The syntax of imperatives in English and Germanic*, Palgrave Macmillan, 2003, f. 12-13.

fillearë, ashtu si edhe historia e transformimit të fjalisë së dhënë krahasuar me fjalinë bazë⁸⁴. Kjo lidhet me lëvizjet që kryejnë përemri you dhe folja ndihmëse will në strukturën e thellë. Lind pyetja: A ka një strukturë të thellë të njëjtë të fjalisë nxitëse dhe asaj dëftore? Vërejmë shembujt:

71. *Help your sister!*



(Ndhimjoje motrën tënde!)

Fjali nxitëse



72. *You will help your sister.* (Ti do të ndihmosh motrën tënde.)

Fjali dëftore



Duke krahasuar transformimet e ndodhura te fjalitë 71 dhe 72 vërejmë këto dallime:

1. Te fjalia 71, kryefjala *you* në strukturën e thellë nuk shfaqet në strukturën sipërfaqësore gjegjëse, sepse në këtë rast vepron rregulli i transformimit, i emërtuar si *fshirja e kryefjalës së fjalive nxitëse (Imperative Subject Deletion⁸⁵)*. Ndërsa në fjalinë 72, kryefjala *you* shfaqet në strukturën sipërfaqësore.
2. Te fjalia 71, folja ndihmëse (Aux) *will* nuk shfaqet në strukturën sipërfaqësore, por kjo gjë nuk ndodh në strukturën sipërfaqësore të fjalisë dëftore 72.

⁸⁴ N. Chomsky, *Syntactic structures*, Mouton de Gruyter, 2002, f. 92.

⁸⁵ Sipas gramatikës gjenerativiste, në fjalitë nxitëse ndodh fshirja e kryefjalës në strukturën sipërfaqësore të shprehur me *you*, nëpërmjet një rregulli që fshin përemrin. A. Zwicky, *On the subject of bare imperatives in English*, Duncan-Rose & Vennemann, Festschrift for Robert P. Stockwell, 1988, f. 437.

Këto dallime tregojnë se transformimet kanë ndodhur në strukturën e thellë të fjalitë nxitëse, por jo tek ato dëftore. Siç duket qartë, këta përbërës të strukturës së thellë (kryefjala *you* dhe folja ndihmëse *will*) janë të pranishëm në strukturën sipërfaqësore të fjalës dëftore. Mendimet e studiuesve kanë qenë të ndryshme në lidhje me natyrën e strukturës së thellë të fjalitë nxitëse, të cilat përmbajnë në përbërësit e tyre semantikë tipare semantike të klasës së foljeve të emërtuara si folje performative (*performative verbs*): *insist* (insistoj), *demand*, *request* (kërkoj) etj. Prania e foljeve të tilla në interpretimin e semantikës së fjalive nxitëse në strukturën e thellë, prej nga përftojmë edhe strukturën sipërfaqësore të fjalive nxitëse me një semantikë të ngjashme me foljet performative, shpjegon mjaft qartë edhe lidhjen kuptimore mes dy fjalive më lart (71 dhe 72). Pra, interpretimet e kuptimeve semantike të fjalive nxitëse mund të realizohen edhe në strukturën e tyre të thellë, ashtu siç ndodh edhe me fjalitë pyetëse, në të cilat jepet kuptimi i bërjes së një pyetjeje: *I ask you* (Unë të pyes ty) apo te dëftoret: *I tell you* (Unë të tregoj ty). Çifti i fjalive që vijojnë janë një ilustrim i përshtatshëm për të treguar marrëdhënien mes fjalive me folje performative dhe fjalive nxitëse apo dhe tipave të tjerë:

73a. *Demand* more opportunities. —→ b. *I request* you to demand more opportunities.
(*Kërko/ni* më shumë mundësi.) —→ (Unë të *kërkoj* ty të kërkojsh më shumë mundësi.)

Megjithatë, thelbi kuptimor ruhet edhe në strukturën sipërfaqësore të fjalive nxitëse dhe shndërrimi që ndodh në strukturën e thellë nuk e prek semantikën e fjalisë, duke shënuar në këtë rast lidhjen kuptimore të fjalive nxitëse me fjalitë dëftore dhe performative.

Përfundim: Analiza e shndërrimit të fjalisë nxitëse nga struktura e thellë në atë sipërfaqësore tregon se kryefjala *you* dhe folja ndihmëse *will* fshihen dhe nuk shprehen në strukturën sipërfaqësore. Ky është dallimi midis fjalive nxitëse dhe dëftore, pasi në fjalitë dëftore kryefjala dhe folja ndihmëse *will* dalin edhe në strukturën sipërfaqësore.

§1.3.2 Bashkëpërkime të fjalive nxitëse në gjuhën angleze me fjalitë performative në strukturën e thellë

Termi *fjali performative* (*performatives*) është përdorur fillimisht nga filozofi i njohur anglez J. L. Austin në veprën e tij *How to do things with words*, në të cilën ai formuloi tezën e tij mbi *aktet ligjërimore*. Sipas tij, thëniesi që shqipton një thënie të caktuar, kryen në të njëjtën kohë dhe një akt të caktuar si: akti i të premtuarit, paralajmërimit a ndalimit etj. Foljet që shprehin këto akte janë folje që shprehin veprime të kryera qartë. Thëniet kanë këto karakteristika:

a. Ato nuk “përshkruajnë”, “raportojnë” ose “konstatojnë” asgjë, nuk janë të vërteta apo të pavërteta.

b. Shqiptimi i një thënieje është një pjesë e kryerjes së një veprimi, i cili nuk do të përshkruhet si të thënit e diçkaje⁸⁶.

Vlera kuptimore e fjalive të tilla kushtëzohet nga veprimet që kryhen me shqiptimin e një thënieje. Thëniet performuese përbëjnë, sipas Austin-it, akte të të folurit, sepse kuptimi i këtyre thënieve nuk varet thjesht nga ajo ç’kuptohet me këto fraza, por edhe nga synimi i folësit, prej asaj që ai kërkon të realizojë duke thënë këto fjali⁸⁷. Thëniet performative kanë vlerën e tyre kuptimore vetëm nëse ato thuhet nga dikush që zotëron të drejtën për ta thënë dhe në kushte që gjithashtu pranohen si të përshtatshme në një akt ligjërimi me vlerë kumtuese performuese⁸⁸.

⁸⁶ J. L. Austin, *How to do things with words*, William James Lectures, Oxford University Press, 1962, f. 5.

⁸⁷ Sh. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës, prej antikitetit në kohën e sotme*, Arbëria, 2010, f. 206.

⁸⁸ Ch. W. Kreidler, *Introduction to English Semantics*, Routledge 2002, f. 185-186.

Në analizat tradicionale të fjalive është theksuar shpesh se brendia kuptimore e tyre lidhet me kuptime që mund të jenë të vërteta ose jo. Pra, vlera kuptimore e fjalive kishte bazë të vërtetën dhe është parë përtej kontekstit në të cilin këto fjali shqiptohen. Megjithatë, jo të gjithë tipat e fjalive mund të analizohen sipas kriterit të vërtetësisë apo pavërtetësisë së kumtimit të tyre. Kjo qasje nuk bënte një analizë të plotë të të gjitha llojeve të fjalive që mund të hasen në ligjërimi të ndryshme dhe kështu ishte një analizë përshkruese. Mungesa e analizës së gjithë llojeve të fjalive, të cilat jo gjithmonë mund të shprehin diçka të vërtetë ose jo, u pasua nga teoria e *akteve të ligjërimit*, që do të përbënte një teori bazë në studimet e ndryshme mbi pragmatikën. Austin kishte dalluar te një thënie tri anë, që së bashku lejojnë të bëjmë diçka, duke thënë diçka:

1. Aspekti *lokucionar* (është një akt që kryhet duke thënë).
2. Aspekti *ilokucionar* (akti i pohimit, premtimit, urdhrit, akti që kryhet nga fakti që thuhet). Fjalitë nxitëse karakterizohen nga vlera ilokutive ose forca shprehëse e thënies.
3. Aspekti *perlokucionar* (akti i shkaktimit të pasojave, efektit mbi ndjenjat, mendimet, veprimet e dëgjuesit etj.)⁸⁹.

Fjalitë performative (*ekzekutuese*) mund të kategorizohen më tej si thënie që *e përshkruajnë qartë*⁹⁰ llojin e aktit kumtuesor apo si thënie ku kuptimi i tyre *nuk është i përmbushur qartë*. Në këtë mënyrë, analiza e strukturës së thellë të fjalitë nxitëse është bërë duke e qasur transformimin e tyre me fjalitë *performative* të cilat kanë këto vlera kuptimore:

74. *I demand you.* —→ (Unë të kërkoj ty.)
75. *I command you.* —→ (Unë të urdhëroj ty.)
76. *I request you.* —→ (Unë të kërkoj ty.)
77. *I nominate him.* —→ (Unë e emëroj atë.)
78. *I pronounce them man and wife.* —→ (Unë i shpall ata burrë dhe grua.)

Kuptimi i një fjalie nxitëse nuk është *konstatimi* i një veprimi që është kryer (*performed action*), por të *urdhërojë* kryerjen e veprimit (*to order the performance*)⁹¹. Kemi një lëvizje të tillë të përbërësve të fjalisë performative në strukturën e thellë:

79. *I order you [you to help my sister].*
Unë të urdhëroj ty [ti të ndihmosh motrën time].

Fshirja e kryefjalës *you* në strukturën sipërfaqësore të fjalisë 79 shkaktohet nga adresimi i kumtimit të fjalisë, pra, drejtimi i urdhrit ndaj së njëjtës SE (sintagmë emërore). Referenti në fjali është i njëjti person (*i adresuari*). Kjo analizë e krahasimit dhe e hulumtimit të ndërtimit strukturor të *fjalive nxitëse* në strukturën e thellë dhe sipërfaqësore, me ndërtimin strukturor gjegjësisht të *fjalitë performative*, u zhvillua më tej nga Sadock (1970)⁹², qasjet e të cilit shënuan një hap përpara në studimet gjenerativiste mbi tipat e fjalive, veçanërisht ravijëzimit të veçorive të analizave gjenerativiste të fjalive nxitëse dhe sjelljet e tyre sintaksore gjatë zbatimit të rregullave transformuese.

Përjasja dhe shpjegimi i strukturës së fjalive nxitëse me anë të fjalive performative dëshmon ngjashmërinë që shfaqin tipat e tjerë të fjalive (*dëftore a pyetëse*) në përmbushjen e një funksioni tjetër ligjërimit, krahas funksionit gjuhësor që i karakterizon këto fjali. Funksionet e tyre përkojnë me funksionet gjuhësore të fjalive nxitëse. Pra, e parë në

⁸⁹ Xh. Lloshi, *Stilistika dhe Pragmatika*, Toena, 1999, f. 311-314.

⁹⁰ Sipas termave të Austin, këto thënie emërtohen si *explicit performatives* që përfshijnë: *I prevent you. / I warn you. / Unë të ndaloj ty. / Unë të paralajmëroj ty.*

⁹¹ R. J. Mastop *Imperative mood in semantic theory*, ILLC dissertations, Netherlands, 2005, f. 34.

⁹² Cituar nga W. Van der Wurff, *Imperative clauses in generative grammar*, Benjamins publishing, 2007, f. 5-6.

konteksin pragmatik, një fjali pyetëse mund të kryejë të njëjtin funksion gjuhësor me një fjali nxitëse:

80. *Will you help me?*
(Do të më ndihmosh?)

Këta tipa fjalish janë emërtuar nga Sadock si *whimperative*⁹³. Për të bërë një analizë më të thellë të semantikës dhe ndikimit që transformimet sjellin në vlerën kuptimore të fjalive nxitëse, Sadock-u është përpjekur të gjejë një përputhje të plotë midis strukturës së thellë të fjalive nxitëse dhe funksionit pragmatik që ato kryejnë në ligjërime të ndryshme. Kjo tregon se fjalitë nxitëse mund të kumtojnë një larmishmëri nuancash kuptimore, të cilat nuk përkojnë me kuptimet nxitëse dhe urdhëruese që shpreh një fjali nxitëse e mirëfilltë. Si rrjedhim, fjalitë nxitëse mund të shprehin dëshira, urime, mallkime, vlera kuptimore kushtore, lejore etj., që vendosen larg nuancave bazë kuptimore të fjalive nxitëse si: urdhër, këshillë, grishje, nxitje, kërkesë etj.

81. *Enjoy the meal!*
(Ju bëftë mirë!) (Folja-kallëzues gjegjëse në gjuhën shqipe është në mënyrën dëshirore dhe shpreh një urim nga ana e folësit.)
82. *Study the lectures and you will pass the exam.*
(Mësoji leksionet dhe do ta kalosh provimin.)

Në të dyja fjalitë e përbëra 82, në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, folja-kallëzues *study* dhe gjegjësj *mësoji* janë në mënyrën urdhërore dhe e gjithë perioda ka vlerë kuptimore kushtore, veçoritë e të cilave do të trajtohen më me hollësi në kreun e veçorive semantike të fjalive nxitëse.

Si rrjedhojë, analiza gjenerative transformacionore dëshmoi se *ajo ishte mjaft e dobishme dhe frytdhënëse për një përshkrim më të plotë të fjalive nxitëse, kumtimi i të cilave mund të shprehet edhe nga llojet e tjera të fjalive*.⁹⁴ Megjithatë, nuk mund të jepet një shpjegim i plotë në lidhje me marrëdhënien e fjalive nxitëse në strukturën e thellë dhe fjalive performative. Studimet e tjera për strukturën e thellë të fjalive nxitëse treguan shfaqjen e *will* jo vetëm në fjalitë dëftore, por edhe në strukturën e *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme (tag-questions)* në fjalitë nxitëse. Sjellja sintaksore e foljes modale *will*, shfaqja e saj në strukturën e *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme* *will you, would you*, bie në kundërshtim me mendimet se kemi gjithmonë një fshirje të foljes ndihmëse (*will-deletion*) në strukturën e thellë. Sipas Culicover-it⁹⁵, fjalia nxitëse dhe fjalia dëftore dallojnë mes tyre nga rregulla që veprojnë në vendosjen e *do* në të dy tipat e fjalive në strukturën sipërfaqësore të tyre. Ato nuk përftohen nga i njëjti rregull transformues dhe këtë e dëshmon përdorimi i foljes ndihmëse *do* me foljet *have* dhe *be*, si një specifikë dalluese e fjalive nxitëse në gjuhën angleze.

Përfundim: Fjalitë nxitëse mund të kumtojnë një larmishmëri nuancash kuptimore, të cilat nuk përkojnë me ngjyrimet kuptimore që mund të shprehin fjalitë nxitëse të mirëfillta në kontekste të ndryshme ligjërimit. Përjasja dhe analiza e tipareve strukturore të fjalive nxitëse me anë të tipareve të fjalive *performative* tregon bashkëpërkimet dhe dallimet që shfaqin fjalitë dëftore dhe pyetëse në kryerjen e funksioneve ligjërimore, të cilat janë tipike për fjalitë nxitëse.

⁹³ Janë fjali *pyetëse* nga ndërtimi strukturor, por nga ana e vlerës kuptimore shprehin një *urdhër* ose *porosi*.

⁹⁴ W. Van der Wurff, *Imperative clauses in generative grammar*, Benjamins publishings, 2007, f. 1-85.

⁹⁵ *Po aty*, f. 10.

§1.4. Sjellja sintaksore e kryefjalës në fjalitë nxitëse në vështrimin gjenerativist

Në studimet gjenerative mbi fjalitë nxitëse sjellja e kryefjalës është një dukuri interesante që ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve. Një nga veçoritë dalluese të fjalive nxitëse në shumë gjuhë indoevropiane është mungesa e kryefjalës. Kryefjala e pashprehur nga ana formale është gjithmonë një kryefjalë e nënkuptuar [*you* (ti)]. Në punimet tradicionale kryefjala e fjalive nxitëse është parë si një gjymtyrë që gjithmonë mungon te këto fjali. Në studimet e mëvonshme, ky konkluzion është kundërshtuar, duke vërejtur se një mori kryefjalësh janë të mundshme në fjalitë nxitëse-dëshirore. Vërejmë shembujt:

83. *You do that for me!*
(Ti bëje këtë për mua!)
84. *Someone call the police!*
(Dikush t'i telefonojë policisë!)
85. *The tallest of you sit at the back!*
(Më i gjati të ulet në fund!)

Karakteristikë e kryefjalës në fjalitë nxitëse është roli tematik i saj, që dallohet dhe në fjalitë dëftore. Ky rol tematik është veprues (*agentive*), i interpretuar si *intended agent* (*vepruesi i parashikuar*). Në thelb fjalitë nxitëse kanë rol tematik të vepruesit. Kjo do të thotë që situata e shprehur nga fjalia nxitëse presupozon një veprues, i cili ka përgjegjësinë për të kryer një veprim (përveç rasteve kur fjalia nxitëse përdoret për të shprehur një dëshirë)⁹⁶. Edhe pse ajo mungon, kryefjala nënkupton një veprues që përmbush një kumtim të caktuar, p.sh. të mbajë shënim një adresë.

86. *Write down the home address.*
(Mbaj shënim adresën.)

Për të analizuar sjelljen sintaksore të kryefjalës në këndvështrimin gjenerativist dhe pozicionin e saj në projeksionin e fjalisë, po bëjmë një analogji të shkurtër të strukturës së fjalisë nxitëse, pozicionit të kryefjalës dhe ndryshimeve që ajo ka pësuar në periudhat e kahershme të gjuhës angleze e deri në periudhat bashkëkohore.

Në anglishten *e vjetër*, folja në fjalinë nxitëse paraprin kryefjalën dhe është e pozicionuar në K° (C°).

87. Be *you* in haste.
(Folja jam ti - kryef. - me nxitim)

Edhe në anglishten *e kohës së mesjetës* folja zë të njëjtin pozicion në fjalitë nxitëse pohore, kurse në fjalitë nxitëse mohore kryefjala vendoset midis foljes në pozicionin nistor dhe pjesëzës mohuese *not*.

88. Help *you* me.
Folje + kryef. + *you* - kund. mua
89. Depart *you* not from me.
Folje + kryef. + pjes. moh. + kund.

Në anglishten *e kohëve moderne*, në fazat e para kemi pothuajse strukturë të njëjtë të fjalisë me anglishten e mesjetës, por në këto fjali shfaqen edhe strukturat me ndihmësen *do*. Si folja ndihmëse, ashtu edhe folja bazë e paraprijnë kryefjalën në fjali dhe zënë pozicionin K° (Komplementuesi).

90. Do *you* have mercy on us.

⁹⁶ Ch. Han, *The structure and interpretation of imperatives*, Garland publishings, Inc, 2000, f. 180-181.

Ndihm + kryef. + folje + kund.
(*Kini mëshirë për ne. / Na mëshironi.*)

Në anglishten bashkëkohore, ndihmësja *do* me funksionin përforcues dhe *don't* me funksionin mohor të kumtimit të fjalisë nxitëse, gjenden në fillim të strukturës së fjalisë dhe folja leksikore paraprihet nga kryefjala. Në fjalitë nxitëse me kryefjalë të shprehur, kryefjala duhet të paraprijë foljen-kallëzues. Vërejmë shembujt e mëposhtëm:

91. *Do somebody read this handwriting.*

Folja ndihm. + kryef. + folje...
(*Dikush* të lexojë këtë shkrim.)

92. *Don't you bother.*

Folja ndihm. + nuk + kryef. + folje.
(Mos u mërzit.)

93. *You write on the board!*⁹⁷

(*Ti shkruaj në dërrasë!*)

Te fjalitë 91, 92, 93 vërejmë se folja ndihmëse *do* zë pozicionin fillestar, pra vendoset në pozicionin K°(C°), kurse folja leksikore kalon në një pozicion më të ulët në pemën strukturore në fjali. Krahasuar me të dyja periudhat (anglishtja *e vjetër* dhe e periudhës *së mesjetës*), në anglishten moderne folja në fjalitë nxitëse me foljen ndihmëse *do* vendoset në pozicionin më të ulët të pemës strukturore të kësaj fjalie.

Përcaktimi i pozicionit dhe natyrës së kryefjalës të fjalisë nxitëse, si një kategori boshë, është çështje që i ka drejtuar gjuhëtarët në qasje të ndryshme. Me termat e gramatikës gjenerative, kategoria boshë në pozicionin e kryefjalës së fjalisë është emërtuar si *pro* ose *PRO* nga studiues të ndryshëm, edhe pse kanë një dallim mes tyre. Në projeksionin e një fjalie në një gjuhë T (Koha), koka e ST ka një tipar të veçantë: të gjitha fjalitë duhet të kenë kryefjalë. Por ky kusht nuk përputhet me strukturën sintaksore të disa gjuhëve, si frëngjishtja, italishtja dhe shqipja, gjithashtu, ku vepron parametri i kryefjalës zero. Në këto gjuhë kryefjala nuk mund të përshkruhet si plotësisht kategori zero. Asaj i mungojnë vetëm tipare të interpretueshme në ndërfaqësin fonetik, ndërkohë që ajo përmban tipare të interpretueshme në ndërfaqësin semantik. Kjo do të thotë që nuk kemi prishje të semantikës së fjalisë, kuptimi i saj është i plotë. Në mënyrë konvencionale, kategoria boshë e pozicionit të kryefjalës është shënuar si *pro* gjatë fazës historike të gramatikës gjenerative. Kushtëzimi i pranisë së *pro* ose *jo* në fjali janë tiparet e kohës T, të eptimit foljor. Jo gjithmonë kemi një përputhshmëri të këtij kushti të domosdoshëm me realitetin gjuhësor të gjuhëve⁹⁸. *PRO* tregon “kryefjalën e nënkuptuar”, veçori e gjuhëve pa eptim, del në fjalitë e pashtjelluara dhe merr një rasë zero. Ndërsa kategoria *pro* është kryefjala e pashtprehur e fjalive që kanë folje të shtjelluara⁹⁹. Pra, kategoria *pro* është veçori e gjuhëve me eptim.

A është kryefjala në fjalitë nxitëse një gjurmë e *wh-movement* (lëvizja - *wh*), *pro* ose *PRO* apo thjesht një kategori tjetër boshë që krijohet si rezultat i veprimt të një rregulle të veçantë fshirjeje? Beukema dhe Coopmans-i¹⁰⁰ kanë hedhur idenë se kryefjala e pashtprehur në fjalitë nxitëse është gjurma *wh* e një operatori boshë të vendosur në pozicionin nistor të kësaj fjalie. Duhet të theksojmë se *pro-drop* është parametri *çomskian* që i ndan gjuhët në gjuhë *pro-drop*

⁹⁷ Ch. Han, *The structure and interpretation of imperatives*, Garland publishings, Inc, 2000, f. 142-145.

⁹⁸ Ka gjuhë me eptim të pasur që nuk pranojnë kryefjalë zero, p.sh. gjermanishtja apo gjuhë me eptim të varfër, si gjuha kineze (gjuhë izoluese), ku kryefjala zero është e pranueshme në fjali.

⁹⁹ J. Mita, *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, 2005, f. 78-79.

¹⁰⁰ Ch. Han, *The structure and interpretation of imperatives*, Garland publishings, Inc, 2000, f. 140.

(gjuhët ku kryefjala në fjali mund të bjerë, si shqipja) dhe gjuhë *non-pro-drop* (gjuhët ku zakonisht në fjali nuk mund të hiqet kryefjala, si anglishtja).

Platzack-u dhe Rosengren-i (1997)¹⁰¹ mendojnë se fjalia nxitëse nuk ka një kryefjalë sintaksore të vërtetë, por një argument veprues bosh në [Spec,VP]. Ch. Han (2000) i trajton këto hipoteza si të papërshtatshme për fjalinë nxitëse, sepse konkluzione të tilla e veçojnë rastin e kategorisë bosh vetëm në fjalitë nxitëse. Sipas saj, statusi sintaksor i kryefjalës bosh është PRO dhe referimi i saj mund të kundrohet nga tiparet interpretuese të operatorit urdhërues¹⁰². Chan-i propozon ekzistencën e një *operatori* urdhërues në sintaksën e gjuhëve, i cili përfshin një grup tiparësh morfo-sintaksore.

Operatori urdhërues karakterizohet nga tipari [*directive*], i cili i jep një forcë *ilokutore* shprehëse drejtuese dhe tipari [*irrealis*]¹⁰³, i cili shënon modalitet. Ky modalitet ndihmon në përfundimin e kuptimit se një gjendje e caktuar nuk është realizuar. Pra, forca ilokutore shprehëse na jep një urdhër a një udhëzim dhe dëshirën që folësi kërkon të plotësohet nga dëgjuesi apo personi, e cila merr kumtimin e caktuar. Forma logjike e urdhërueses e përfshin këtë *operator urdhërues*. Gjithashtu, forca ilokutore drejtuese është si një udhëzim për dëgjuesin për të ndryshuar a pasuruar një modul të caktuar. Chan-i e emërton këtë modul si *plani i kërkesave \ detyrave (Plan set)* dhe Postdam-i si *lista e kërkesave (To-do-list)*. Ky modul i dëgjuesit (the listener) përmban një sërë qëllimesh, gjendjesh, çështjesh, të cilat ai dëshiron t'i kryejë dhe t'i plotësojë.

Potsdam-i përqafon përfundimet e Chan-it dhe thekson se struktura e frazës së fjalive nxitëse në anglisht ka ngjashmëri me strukturën e frazës së fjalive pyetëse. Chan-i *nuk e pranon veprimin e forcës shprehëse në fjalitë nxitëse duke u bazuar në aspektin pragmatik, pra në kontekstin pragmatik a ligjërimor të fjalisë nxitëse*¹⁰⁴. Këto hipoteza bien ndesh me disa studiuës të rrymës së semantikës gjenerative, të cilët e vënë theksin te forca shprehëse e koduar nga forma logjike e saj.

Përfundim: Mënyra e shprehjes së kryefjalës dhe natyra e saj në fjalinë nxitëse përbëjnë një çështje mjaft të mprehtë teorike ende të shtruar për zgjidhje në gjuhësinë gjenerative. Ne dakordësohemi me teorinë e zbatimit të parametrin pro-drop (të kryefjalës zero në gjuhën shqipe) dhe atij non-pro-drop (të kryefjalës së shprehur në gjuhën angleze) jo vetëm në fjalitë nxitëse, por edhe në ato dëftore. Kryefjala në fjalinë nxitëse nuk është një gjurmë e *lëvizjes wh* (wh-movement) dhe mund të ketë një operator urdhërues që vepron te fjalitë nxitëse, por konteksti është thelbësor në interpretimin e kryefjalës në këto fjali.

§1.4.1. Pozicioni i kundrinorit në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe gjegjësit në gjuhën shqipe

Rizzi (1997) i përcakton strukturat e fjalive nxitëse dhe dëftore përkatësisht si struktura me foljen në fillim (“verb first”) dhe (“verb second”), ku folja vjen e dyta, gjë që vë në dukje dallimet strukturore të dukshme mes periferisë së majtë të dy tipave të fjalive. Njëkohësisht theksohet dhe pozicioni bosh i kryefjalës te fjalitë nxitëse. Për sa i përket periferisë së djathtë të fjalive nxitëse, prania ose jo e kundrinorit është dukuria që i ka drejtuar studiuesit drejt qasjeve të ndryshme. Koopman, në analizën krahasuese të topikës së fjalive nxitëse dhe dëftore në gjuhën holandeze, arrin në përfundimin se fjalia nxitëse nuk mund të ketë një topikë të dukshme a të shprehur, nuk mund të ketë një përemër dëftor të shprehur dhe lejon fshirjen e temës (*topic drop*). Vërejmë shembullin:

¹⁰¹ Cituar nga Ch. Han, *The structure and interpretation of imperatives*, Garland publishings, Inc, 2000, f. 140.

¹⁰² *Po aty*, f. 115-156.

¹⁰³ Termi *irrealis* karakterizon modalitetin e dëshirës, jo reales, asaj që dëshirohet të ndodhë (term që lidhet me mënyrat gramatikore të lidhore, kushtores, dëshirores, të cilat shprehin veprime që nuk kanë ndodhur).

¹⁰⁴ Chan nuk pranon gjithashtu shkrirjen e semantikës dhe sintaksës së fjalive nxitëse me fjalitë performative.

94. *dat leg even neer dat boekje
That put adv down that book
95. leg even neer dat boekje
Put adv *down* that book
(Vendose poshtë atë libër.)

Nga shembulli vërejmë se duhet të kemi fshirjen e temës të fjalitë nxitëse.

Për sa i përket periferisë së djathtë, pozicion që zihet nga kundrinori, propozimi i Den Dikken-it parashikon një kundrinor të mundshëm në krahun e djathtë të fjalitë nxitëse. Sipas Koopman-it, nëse një gjuhë lejon si zhvendosjen në të djathtë dhe rënien e temës apo klitikut (*topic* ose *clitic drop*), atëherë kundrinori i pozicionuar në krahun e djathtë është i mundshëm.

96. Place *it on the table, that book.
(Vendose atë mbi tavolinë, atë libër.)

Në shembullin 96, te gjegjësi në shqip kundrinori është rimarrë si enklitik dhe nuk mund të ketë edhe formën e përemrit vektor në rasën kallëzore, edhe SE *atë librin*.

Pozicioni i kundrinorit dhe lëvizja e tij në fjali i kanë nxitur disa studiues të theksojnë se fjalitë nxitëse janë njësoj si fjalitë dëftore në lidhje me tiparet e brendshme të SF (VP). *Zhvendosja e kundrinorit* në fjalitë nxitëse përbën një prej këtyre tipareve të përbashkëta. Një tipar tjetër që e dallon kundrinorin në fjalitë nxitëse, nga ai në fjalitë dëftore, është shfaqja e tij në një formë jo të dallueshme (i fshehur). Haegeman-i për pozicionin e kundrinorit ngre pyetjen: *Çfarë kategorie bosh është kundrinori?* Sipas saj, *null objects* në fjalitë nxitëse janë ndryshore që lidhen nga një temë boshe. Pra, elementet kundrinore bosh mund të analizohen si gjurmë të elementeve të pashprehura të topikalizuara.

Një veçori e kundrinorit në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe është dhe *rimarrja e kundrinorit*, pra shprehja e tij si me formën e plotë emërore ose përemërore, ashtu edhe me një trajtë të shkurtër. Sh. Demiraj rimarrjen e kundrinës e sheh si *një dukuri të përgjithësuar, e shprehur me anë të formave të theksuara të përemrave vektorë të dy vetave të para, pavarësisht nga topika e tyre para apo pas foljes kallëzues*¹⁰⁵. Dyfishimi i kundrinës shfaqet në gjuhët romane perëndimore dhe si dukuri sintaksore. Kjo është trajtuar si një ballkanizëm. E gjejmë në greqisht, shqip, spanjisht. *Gjuha shqipe dhe gjuha greke janë dy gjuhë me rend të lirë dhe fleksion të pasur; ato kanë klitikë përemërorë si për rasën kallëzore, ashtu edhe për rasën dhanore. Në fjalitë nxitëse në greqisht klitikët në funksionin e kundrinorit ndjekin kryefjalën; në shqip mund të vendosen para, në mes dhe pas foljes kallëzues*¹⁰⁶.

Përfundim: Pozicioni i kundrinorit dhe lëvizja e tij në fjali vërtetojnë se sintagma foljore ka të njëjtat tipare të brendshme si në fjalitë dëftore, ashtu edhe në ato nxitëse. Por kundrinori i fjalive nxitëse mund të shfaqet i fshehur, ndryshe nga ai i fjalive dëftore. Ne përkrahim idenë e Haegeman-it se kundrina zero është ndryshore që ndodh për shkak të topikës boshe. Ndërsa rimarrja e kundrinorit është veçori tipike e gjuhës shqipe.

§1.4.1.2. Klitikët, pozicioni dhe sjellja e tyre në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe dhe gjegjëset e tyre në gjuhën angleze


Në këtë pjesë kemi menduar të analizojmë klitikët, pozicionin dhe sjelljen e tyre në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe, për arsye se ata kanë një sjellje sintaksore mjaft të veçantë në të. Pozicionet e ndryshme që marrin klitikët (*trajtat e shkurtra në funksionin e kundrinorit*) janë interesante për t'u trajtuar dhe gjithashtu lidhen më tepër me fjalitë nxitëse të gjuhës me eptim

¹⁰⁵ Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Logos, Shkup, 1994, f. 127-146.

¹⁰⁶ D. Kallulli, *Direct object clitic doubling in Albanian and Greek*, Oxford Studies in Comparative Syntax, 2001.

të pasur. Megjithëse e njëjta dukuri nuk haset në gjuhën angleze, është me rëndësi të pasqyrojmë strukturat gjegjëse në këtë gjuhë, duke u thelluar më tej në pozicionet që zë kundrinori në fjalitë nxitëse në të. Termi “klitik” vjen nga greqishtja dhe ka kuptimin “mbështetje”¹⁰⁷. Në morfologji a sintaksë klitikët janë morfema me veçoritë sintaksore të një fjale, të lidhura fonologjikisht me një fjalë që e paraprin apo ndodhet pas saj¹⁰⁸. Klitikët, nga ana formale e shprehjes, ngjajnë me afikset, por përdoren në fjali si fjalë funksionale duke luajtur rolin sintaksor në nivelin e sintagmës. Zakonisht janë përemra ose përcaktorë, por mund t’u përkasin edhe kategorive të tjera gramatikore. Në varësi të pozicionit që zënë në lidhje me fjalën që hyjnë në marrëdhënie, ato ndahen në *proklitike* (të paravendosur); *enklitike* (të pasvendosur); *mesoklitike* (të vendosur midis temës së fjalës dhe afiksit) dhe *endoklitike* (që ndërfiten në rrënjën e fjalës). Në anglisht ka dy lloj *enklitikë*: *auxiliary (foljet ndihmëse)* të cilat vendosen para kryefjalës dhe pjesëzat mohore -n’t të cilat ngjiten te folja ndihmëse paraprirëse. Disa gjuhë kanë proklitikë, fillimisht fjalë të mëvetësishme të cilat duhet të ngjiten me fjalën që pason; nyjet në frëngjisht janë proklitike; *l’auto*, gjithashtu forma arkaike e anglishtes: ’twas - it was ose ’tis- it is përmbajnë *proklisis*¹⁰⁹.

Pozicioni i klitikëve në gjuhën shqipe dhe gjegjëset në gjuhën angleze. Teoria e parimeve dhe e parametrave është ndër modelet më të mira për t’i kuptuar veçoritë e sintaksës së gjuhëve natyrore, të cilat fëmijët, çuditërisht, fillojnë t’i flasin rreth dy vjeç pa ua mësuar askush në mënyrë të programuar. *Natyrisht, gjuhët ndryshojnë nga njëra-tjetra, sepse gramatika universale është një sistem i hapur që ka edhe veçori që nuk janë të lindura. Këto veçori fitohen nga përvoja e çdo individi që lind dhe jeton në një shoqëri të caktuar dhe quhen parametra*¹¹⁰. Në gjuhën shqipe struktura bazë e foljes-kallëzues në fjalinë nxitëse projektohet në pozicionin K (C). Vërejmë shembujt: 97. Mëso. \ Mësoni.



Këto projektme nuk janë gjë tjetër veçse struktura *e thellë* e fjalive nxitëse përkatëse:


98. *Learn! (Mëso! \ Mësoni!)*

¹⁰⁷ *Fjalor i gjuhës së re greke*, Athinë : Qendra e leksikologjisë, [C. Bambiniotis], 1998, f. 910 .

¹⁰⁸ P. H. Mathews, *The Concise Oxford Dictionary of Linguistics*, Oxford University Press, 2007, f. 56.

¹⁰⁹ Laurel J. Brinton, *The structure of modern English, A linguistic introduction*, John Benjamins, 2000, f. 78.

¹¹⁰ J. Mita, *Hyrje në sintaksën gjenerative*, “Shpresa”, Prishtinë, 2005, f. 133.




Nga ky projektim i fjalive nxitëse vërejmë se folja vendoset në një degëzim më vete dhe qëndron jashtë SF (VP). Fakti që folja në urdhërore lëviz jashtë sintagmës foljore, duket nga pozicioni i ndajfoljeve në fjalitë e mëposhtme:

99. *Bëje mirë punën!*
 * *Mirë bëje punën.*

Rasti i parë ku është zhvendosur folja, është i pranueshëm, i dyti, ku nuk është bërë kjo lëvizje, është i papranueshëm. Lëvizja e foljes në pozicionin K në gjuhën shqipe shpjegon dhe vendosjen e trajtave të shkurtra para, në mes ose pas foljes. Sheperi në gramatikën e tij shkruan se *urdhërorja afirmative i merr pleonormat e kundrinave dhe si prapashtime: më shkruaj ose shkruam¹¹¹.*

Shembuj të klitikëve tregojnë se folja gjendet brenda K (C) dhe klitikët brenda EPT (I).

100. *Telefonomë.*
 Call-me.
 Call me!



Nga projeksioni vërejmë kalimin e foljes nga sintagma foljore (SF) në K (Komplementues) dhe klitikët mbeten brenda sintagmës eptimore (SEPT). Në frëngjisht, në italisht, në greqisht dhe në spanjisht një klitik në funksionin e kundrinorit të drejtë duhet të ndjekë foljen në fjalinë nxitëse, kur ajo është në mënyrën dëftore e lidhore.

¹¹¹ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001, f. 146.

Frëngjisht: 101. Faites le!
Do - v. 2 nj. urdh. it!
Do it!
*Le faites!
(It do!)

Italisht: 102. Auita le!
Help her!
*Le aiuta!

Greqisht: 103. Diavase to!
Read - v. 2 nj. urdh. it
(Read it!)
*To diavase!
(It read.)

Rivero (1994¹¹²) e trajton rendin *folje + klitik* në fjalitë nxitëse për të dëftuar se folja-kallëzues e fjalisë lëviz drejt K° (C°).

104. *Dëgjo-j- e!*
Listen + her
Listen to her.
*e dëgjo!
*Her listen!
105. *Tregoj-u të vërtetën!*
Tell them the truth!
Tell it!
*U trego të vërtetën!

Në gjuhën shqipe *enklisa* tregon se pozicioni i foljes në fjalinë nxitëse është në C (K-komplementuesi). Kemi edhe një karakteristikë të veçantë në fjalitë nxitëse me enklisë, te klitikët e vetës së tretë (*u, e*), të cilët duhet të ndjekin foljen-kallëzues. Kjo dukuri e pasvendosjes ndodh vetëm te këta klitikë, ndërsa klitikët e kundrinorëve që i përkasin vetës së parë dhe të dytë, mund të vendosen para dhe pas foljes-kallëzues të fjalisë nxitëse. Këta klitikë në funksionin e kundrinorit (*trajtat e shkurtra të përemrit vetor, veta e tretë*) shkrihen në sintagmën foljore SF. Në tipat e tjerë të fjalive klitikët e vetës së tretë paraprijnë foljen-kallëzues.

106. *E dëgjova atë.*
(her listen).
107. *U tregova të vërtetën.*
(them told the truth).

Kur folja-kallëzues është në vetën e dytë shumë, klitikët mund të jenë *proklitike* dhe *endoklitike*.

108. *Dëgjomë-ni.*
dëgjo-më-fleks.
(Listen to me!)

Te fjalia 108 endoklititi vendoset midis foljes bazë dhe fleksionit përkatës të urdhërores -ni-.


¹¹² Cituar nga G. Turano, *On clitics and negation in Albanian*, Rivista di grammatica generativa, vol. 25, f. 81-117.

Në fjalinë 109 vërejmë klitikun *më* si proklitik:

109. **Më** dëgjoni!
Me listen - v. 2 sh.
 (Listen to *me!*)

Nëse do t'i paraqesim me skemën e projektimit *proklitikët*, në pozicionin para foljes, e cila, siç e kemi thënë, qëndron në pozicioni e komplementuesit K, vërejmë se klitikët vendosen në një pozicion më lart, mbi pozicionin e foljes në K. *Enklitikët* pozicionohen brenda shkallës I (*eptimi*) dhe folja lëviz në K. Proklitikët i paraqesim me këtë skemë projektimi:

- 110a. **Më** telefono. b. Telefon**më**ni.




Në rastin e parë (110a) kemi këto lëvizje: folja nga SF kalon në K; trajta klitike *më* nga SEPT lëviz në një pozicion më lart foljes në SK, duke lënë pas gjurmët në EPT dhe F. Në rastin e fjalisë 110b, ku trajta e shkurtër ndërfitet midis temës së foljes dhe mbaresës vetore, trajta e shkurtër qëndron brenda SEPT dhe folja zë pozicionin K.

Në fjalitë nxitëse mohore pjesëza mohuese *mos* kalon në pozicionin K dhe folja nuk mund të kalojë më në atë pozicion, kështu që folja qëndron brenda SEPT. I shikojmë lëvizjet e foljes dhe pjesëzës mohuese në këto fjali:

111. *Mos* fol!
 (Don't speak!)

Prania e elementit negativ në pozicionin K arrin të kontrollojë tiparet e foljes dhe kjo bën që ajo të mos pozicionohet në K, por lëvizja e saj në K bllokohet.



Në këto fjali trajtat e shkurtra nuk mund të vendosen as prapa, as të ndërfuten në trupin e foljes, por në të gjitha rastet ato e paraprijnë atë. Pra, kemi vetëm proklisis të fjalitë mohore dhe jo endoklisis apo enklisis.

112. *Mos e telefono!* * *Mos telefonoje!*

Moh. **her** phone!
(Don't phone **her**!)

113. *Mos na telefono!* * *Mos telefonona!*¹¹³

Moh. us phone
(Don't phone us!)

Trajtat e shkurtra me foljet me mohim në mënyrën urdhërore vendosen gjithnjë përpara foljes. Sipas J. Mitës, qoftë prapavendosja, qoftë ndërvendosja e trajtave të shkurtra, vijnë nga lëvizja e foljes në pozicionin K. Kur folja në mënyrën urdhërore është me mohim, pozicioni K tashmë është i zënë nga pjesëza mohuese *mos*, kështu që folja nuk mund të lëvizë më në atë pozicion; si pasojë, trajtat e shkurtra nuk mund të vendosen as prapa, as në mes të foljes, por gjithmonë përpara saj¹¹⁴.

Turano, në analizën e vendit që zë pjesa mohuese *mos*, ndikimin që ka pozicioni i saj në K në pozicionimin e foljes në fjalitë nxitëse mohore, e shpjegon me faktin që *mos* zë pozicionin K dhe folja detyrimisht qëndron brenda SEPT. Sipas Turano-s, në projektimin e fjalive nxitëse me pjesëzën mohuese *mos*, mund të pranojmë dhe një pozicionim të pjesës mohuese *mos* mbi degëzimin K, por përsëri folja mbetet brenda SEPT. Pjesëza mohuese, e pozicionuar në K ose një shkallë më lart, *arrin të kontrollojë tiparet dhe lëvizjen e foljes e për rrjedhojë kjo e pengon apo e bllokon lëvizjen e saj drejt K*¹¹⁵. Duhet të theksojmë se dallimet në shpërndarjen e klitikëve në funksionin e kundrinorit për vetën e parë, të dytë dhe të tretë në gjuhën shqipe shkaktohen nga lëvizja që pëson folja në fjalitë nxitëse nga V-C, pra nga SF drejt SK, gjë që nuk ndodh në tipat e tjerë të fjalive.

Sintaksa e urdhërores në disa gjuhë përfshin një *imperative operator* (operatori urdhërues), si një mbartës i tipareve morfo-sintaksore të gjuhës. Ndërveprimi midis një universaleje formale të *imperative operator* dhe sintaksës së një gjuhe parashikon variacionet ndër-gjuhësore të urdhërores mohore në përgjithësi. Në projektionet e këtyre fjalive, K⁰ del si pozicioni i këtij (*imperative operator*) operatori urdhërues. Dhe K është *focus* i operatorit

¹¹³ Edhe pse fjalia është jogramatikore, e gjejmë të përdorur në disa dialekte dhe variacione gjuhësore, p.sh. në dialektin e jugut, në zona të Labërisë.

¹¹⁴ J. Mita, *Hyrje në sintaksën gjenerative*, "Shpresa", Prishtinë, 2005, f. 184-185.

¹¹⁵ G. Turano, *On clitics and negation in Albanian*, Rivista di grammatica generativa, vol. 25, f. 81-117.


urdhërues, i cili e tërheq foljen në këtë pozicion. Në fjalitë nxitëse mohore klitikët vendosen mes pjesëzës mohuese *mos* dhe foljes. Në këto fjali kemi vetëm proklisis. Pozicionimi i pjesëzës mohuese në K kontrollon tiparet e K dhe kjo gjë nuk e lejon lëvizjen e F(V) në K(C). Kjo lëvizje ndodh në të gjitha pozicionet që marrin klitikët.

Përfundim: Llojet e ndryshme të klitikëve dhe pozicionet e tyre në gjuhën shqipe janë një tjetër tregues i mjeteve të shumta gjuhësore që përdor gjuha shqipe për të shprehur të njëjtin funksion sintaksor krahasuar me gjuhën angleze. Llojet e ndryshme të klitikëve në gjuhën shqipe mbeten brenda eptimit. Dallimet në shpërndarjen e tyre për të tri vetat janë rrjedhojë e lëvizjes së foljes nga SF në SK (C). Klitikët janë shumë problematikë për të huajt që mësojnë gjuhën shqipe.


§1.5. Projektimi i fjalive nxitëse krahasuar me fjalitë dëftore dhe pyetëse

Nëse do të krahasojmë strukturat e fjalive në të dyja gjuhët, vërejmë se në gjuhën angleze është folja ndihmëse që lëviz nga koka EPT në K (Komplementuesi); në gjuhën shqipe, siç e pamë në skemat më lart, folja e mënyrës urdhërore zakonisht lëviz në pozicionin K. Më poshtë po paraqesim projektimin në *fjalinë dëftore*:

114. *John consulted the dictionary.*
(Xhoni u konsultua me fjalorin.)




-ed në këtë rast është eptimi dhe pozicionohet në SF.



Projektimi në fjalinë pyetëse.

115. Çfarë kërkoi Xhoni?



Në projektimin e fjalisë 115 vërejmë ngjitjen e foljes në pozicionin K, pas lëvizjes në degëzimin EPT.

Në gjuhën angleze fjalia pyetëse ka një projektim të ndryshëm nga gjegjësjë në shqip. Folja-kallëzues nuk mund të lëvizë drejt njëjës K, sepse do të përfitohej një fjali jogramatikore si:

116. **What drinks John?*

Në fjalinë 116 kemi lëvizjen e foljes ndihmëse *will* ose *do* në pozicionin K dhe fjalia pyetëse është gramatikore:

117. *What does John drink?*

(Çfarë pi Xhoni?)


118. *Will John drink a beer?*

(Do të pijë Xhoni birrë?)

Skema e projektimit tregon se te pozicioni K nuk mund të gjejmë foljen leksikore *drink* (*pi*), por ndihmësen *will* ose *does*. Pozicioni K zihet nga folja ndihmëse *will*, e cila lë gjurmën në degëzimin përkatës, në atë të EPT.

Le ta ilustrojmë lëvizjen e foljes-kallëzues në këtë fjali me skemën përkatëse të projektimit:

What will John drink? dhe *Will John drink a beer?*



Projektimet në fjalitë dëftore dhe pyetëse, krahasuar me projektimet e fjalive nxitëse, në të dyja gjuhët tregojnë një strukturë të thellë komplekse të këtyre fjalive po aq sa edhe tek tipat e tjerë, gjë që hedh poshtë mendimet e shumë gjuhëtarëve (veçanërisht atyre tradicionalë), se fjalitë nxitëse janë të thjeshta nga ana strukturore dhe nuk shfaqin dukuri gjuhësore të veçanta për t'u analizuar. Ndërtimi i thjeshtë në strukturën e tyre sipërfaqësore nuk nënkupton të njëjtën gjë edhe për strukturën e thellë, ku, siç e kemi përmendur, ndodhin lëvizje të elementeve si në tipat e tjerë.

Përfundim: Kundrimi i fjalive nxitëse në vështrimin gjenerativist tregon se ato mund të analizohen dhe të paraqiten nga ana skematike ashtu si edhe tipat e tjerë të fjalive në gjuhë. Veçoritë sintaksore të fjalive nxitëse shpërfaqen po aq komplekse dhe interesante për t'u kundruar e përqsuar me gjegjëset në gjuhën shqipe. Hipoteza e përkrahur nga shumë gjuhëtarë e radhit anglishten si një gjuhë që shfaq një sjellje sintaksore të fjalive nxitëse jo të veçantë nga tipat e tjerë të fjalive dhe në këtë mënyrë mund të përfshihet brenda analizës së strukturës së frazës, duke u mbështetur në shumësinë e koncepteve bazë të analizës transformacionore të gjenerativizmit.

§1.6. Përfundime të kreut

❖ Fjalitë mund të ndahen në katër grupe kryesore sipas strukturës së tyre. Për sa i takon klasifikimit të fjalive sipas qëllimit të kumtimit, gjuhëtarët kanë mendime të ndryshme. Një grup mendon që ato duhen ndarë në tre grupe kryesore: fjali *dëftore*, *pyetëse* dhe *nxitëse*, kurse grupi i dytë i klasifikon ato në katër grupe: fjali *dëftore*, *pyetëse*, *nxitëse*

dhe *thirrmore*. Ne ndajmë mendimin e Portner-it, i cili thekson se lloji i fjalisë përcaktohet nga shkrirja e kuptimit gjuhësor të saj me përmbajtjen dhe përdorimin e saj në një situatë të caktuar.

❖ Nga paraqitja e një analize të shkurtër të vështrimeve të ndryshme mbi kategorizimin e tipave të fjalive, ne vërejmë disa veçori dalluese në këto dukuri gjuhësore: A. Kriteret bazë *klasifikuese* të tyre.

B. Kalimin nga tiparet e *shprehjes* funksionale dhe *formale* të marra si bazë për klasifikimin e fjalive nxitëse, në trajtimin e situatës *ligjërimore* dhe pjesëmarrësve në këtë situatë komunikimi. Në studimet e mëparshme kumtimi i fjalisë nxitëse ishte i lidhur ngushtë me shprehjen formale të kallëzuesit në mënyrën urdhërore.

C. Dallimet në zgjedhjen e terminologjisë emërtuese të fjalive nxitëse, nga fjali *urdhërore* në *nxitëse* apo në nxitëse-dëshirore në studimet e mëvonshme. Mungesa e një marrëveshjeje të përgjithshme mes gjuhëtarëve ka sjellë një dallim në terminologjinë e përdorur për nocione të ndryshme gjuhësore.

D. *Zhvendosja* e objektit të studimeve gjuhësore mbi fjalitë nxitëse nga struktura dhe ndërtimi gramatikor i tyre drejt një analize më të thellë e komplekse, përbën prirjen e teorive gjuhësore të dekadave të fundit.

❖ Gjuhëtarët shqiptarë ndajnë mendime të ndryshme në lidhje me klasifikimin e fjalive sipas qëllimit të kumtimit. Bazuar në këtë kriter, disa gjuhëtarë të përmendur më sipër i ndajnë në tre grupe: dëftore, pyetëse dhe nxitëse-dëshirore. Të tjerët i klasifikojnë fjalitë në katër grupe: dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore. Mendojmë se klasifikimi i fjalive sipas qëllimit të kumtimit të dhënë nga Gramatika e Akademisë, është kategorizimi më i përshtatshëm i tyre dhe ne ndajmë të njëjtin mendim me këtë klasifikim.

❖ Meqenëse fjalitë nxitëse përbëjnë numrin më të madh të fjalive në grupin e fjalive nxitëse-dëshirore, të cilat kanë një strukturë të njëjtë me fjalinë nxitëse të mirëfilltë në gjuhën angleze, ne do të përqendrohemi më tepër në veçantitë semantike, sintaksore dhe pragmatike të fjalive nxitëse, duke kundruar më thellë fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe.

❖ Fjalitë nxitëse sipas analizës gjenerativiste kanë një strukturë sipërfaqësore të thjeshtë dhe formohen nga të njëjtat rregulla komplekse transformuese si fjalitë dëftore e pyetëse. Ato kanë katër tipare dalluese sintaksore:

A. Kryefjalë zero.

B. Rend të përmbysur të kryefjalës të fjalitë nxitëse-mohore.

C. Folja ndihmëse *do* në fjalitë nxitëse-mohore dhe fjalitë emfatike.

D. Kundrinor zero në një pjesë të madhe të fjalive nxitëse.

❖ Analiza e shndërrimit të fjalisë nxitëse nga struktura e thellë në atë sipërfaqësore tregon se kryefjala *you* dhe folja ndihmëse *will* fshihen dhe nuk shprehen në strukturën sipërfaqësore. Ky është dallimi midis fjalive nxitëse dhe dëftore, pasi në fjalitë dëftore *kryefjala* dhe folja ndihmëse *will* dalin edhe në strukturën sipërfaqësore.

❖ Fjalitë nxitëse mund të kumtojnë një larmishmëri nuancash kuptimore, të cilat nuk përkojnë me ngjyrimet kuptimore që mund të shprehin fjalitë nxitëse të mirëfillta në kontekste të ndryshme ligjërimi. Përfaqja dhe analiza e tipareve strukturore të fjalive nxitëse me anë të tipareve të fjalive *performative* tregon bashkëpërkimet dhe dallimet që shfaqin fjalitë *dëftore* dhe *pyetëse* në kryerjen e funksioneve ligjërimore, të cilat janë tipike për fjalitë nxitëse.

❖ Mënyra e shprehjes së kryefjalës dhe natyra e saj në fjalinë nxitëse përbëjnë një çështje mjaft të mprehtë teorike ende të shtruar për zgjidhje në gjuhësinë gjenerative. Ne dakordësohemi me teorinë e zbatimit të parametrut pro-drop (të kryefjalës zero në gjuhën shqipe) dhe atij non-pro-drop (të kryefjalës së shprehur në gjuhën angleze) jo vetëm në fjalitë nxitëse, por edhe në ato dëftore. Kryefjala në fjalinë nxitëse nuk është një gjurmë e *lëvizjes*

wh (wh-movement) dhe mund të ketë një operator urdhërues që vepron te fjalitë nxitëse, por konteksti është thelbësor në interpretimin e kryefjalës në këto fjali.

❖ Pozicioni i kundrinorit dhe lëvizja e tij në fjali vërtetojnë se sintagma foljore ka të njëjtat tipare të brendshme si në fjalitë dëftore, ashtu edhe në ato nxitëse. Por kundrinori i fjalive nxitëse mund të shfaqet i fshehur, ndryshe nga ai i fjalive dëftore. Ne përkrahim idenë e Hageaman-it se kundrina zero është ndryshore që ndodh për shkak të topikës boshe. Ndërsa rimarrja e kundrinorit është veçori tipike e gjuhës shqipe.

❖ Llojet e ndryshme të klitikëve dhe pozicionet e tyre në gjuhën shqipe janë një tjetër tregues i mjeteve të shumta gjuhësore që përdor gjuha shqipe për të shprehur të njëjtin funksion sintaksor krahasuar me gjuhën angleze. Llojet e ndryshme të klitikëve në gjuhën shqipe mbeten brenda eptimit. Dallimet në shpërndarjen e tyre për të tri vetat janë rrjedhojë e lëvizjes së foljes nga SF në SK (C). Klitikët janë shumë problematikë për të huajt që mësojnë gjuhën shqipe.

❖ Kundrimi i fjalive nxitëse në vështrimin gjenerativist tregon se ato mund të analizohen dhe të paraqiten nga ana skematike ashtu si edhe tipat e tjerë të fjalive në gjuhë. Veçoritë sintaksore të fjalive nxitëse shpërfaqen po aq komplekse dhe interesante për t'u kundruar e përqsuar me gjegjëset në gjuhën shqipe. Hipoteza e përkrahur nga shumë gjuhëtarë e radhit anglishten si një gjuhë që shfaq një sjellje sintaksore të fjalive nxitëse jo të veçantë nga tipat e tjerë të fjalive dhe në këtë mënyrë mund të përfshihet brenda analizës së strukturës së frazës, duke u mbështetur në shumësinë e koncepteve bazë të analizës transformacionore të gjenerativizmit.

KREU II

VEÇORI TË PËRGJITHSHME GRAMATIKORE TË FJALIVE NXITËSE NË GJUHËN ANGLEZE DHE NXITËSE-DËSHIRORE NË GJUHËN SHQIPE

§2.1. Veçoritë morfologjike të fjalive nxitëse në gjuhën angleze krahasuar me gjejëset në gjuhën shqipe

Studimet e fundit kanë treguar se fjalitë nxitëse shfaqin tipare të ngjashme në rrafshet e dukuri gramatikore në disa gjuhë të ndryshme të familjes indoevropiane. Këto bashkëpërkime morfo-sintaksore të urdhërores, si dhe ndërveprimi me sistemin morfo-sintaksor të një gjuhe të caktuar, realizojnë krijimin e një modeli universal për interpretimin dhe analizën e fjalive nxitëse dhe dëshirore, vështruar në lidhje dhe me zhvillimet e tendencat e fundit gjuhësore.

Gjuha angleze dhe gjuha shqipe, edhe pse janë dy gjuhë indoevropiane, paraqesin mjaft dallime në disa aspekte gjuhësore, si gjuhë pa eptim (-INFL gjuha angleze) dhe me eptim (+INFL gjuha shqipe). Këto dy gjuhë shfaqin ngjashmëri dhe afri në shumë dukuri gjuhësore në lidhje me fjalitë nxitëse dhe dëshirore, veçanërisht në anën semantike, sintaksore apo modalitetin që ato shprehin. Kjo tregon se natyra sintetike e gjuhës shqipe, veçoritë gramatikore dhe përdorimi i saj në ligjërime luajnë një rol të rëndësishëm në përvetësimin e veçorive gjejëse në gjuhën angleze. I ndikuar nga rendi i lirë i gjymtyrëve të fjalisë në gjuhën shqipe, një nxënës që mëson gjuhën angleze në shkollë e shfaq këtë ndikim gjatë përdorimit të fjalive nxitëse në kontekste të ndryshme ligjërimore.

Në gjuhën angleze, si gjuhë jo eptimore, nuk shënohet kryefjala nëpërmjet fleksionit foljor dhe përdorimi i saj mund të ndryshojë vlerën kumtuese të fjalisë apo kumtuesit (folësit). Gjithashtu, përqasja e rendit të ngulitur të gjuhës angleze dhe rendit të lirë në gjuhën shqipe mund të sjellë fjali të pakuptimta dhe gramatikisht jo të sakta (p.sh. një ndajfolje që paraprin foljen në një fjali nxitëse në gjuhën angleze). Raste të tjera të ndikimit të gjuhës amtare janë edhe përdorimet e gabuara të fjalive nxitëse në gjuhën angleze në situata të ndryshme konteksture, situata formale apo joformale. Të gjitha këto ndikime gjuhësore përkojnë me dukuritë përbërëse të rrafshit sintaksor, i cili do të shpërfaqej i paplotësuar pa një analizë të veçorive dhe mjeteve morfologjike që shprehin këto funksione.

Duke e përqendruar kundrimin tonë në një trajtim të rrafshit morfologjik, jemi përpjekur të vëmë në dukje disa nga veçoritë më tipike morfologjike të klasës së foljeve. I kemi veçuar paradigmat foljore dhe karakteristikat e tyre, pasi folja përbën gjymtyrën kryesore të brendisë së një fjalie. Brendia reale e fjalisë gjen shprehjen e saj në kategorinë gramatikore të kallëzuesisë, e cila është uniteti i pandashëm i kategorisë së modalitetit sintaksor, të kohës sintaksore dhe vetës sintaksore¹¹⁶. Nuk mund të japim një pasqyrë të plotë e të hollësishme të fjalive nxitëse pa analizuar foljen-kallëzues, jo vetëm funksionet sintaksore që ajo kryen, por edhe veçoritë, kuptimet dhe format gramatikore të saj. Lidhja e ndërsjellë mes formës dhe përmbajtjes, si dhe rëndësia funksionale që folja merr në fjalitë nxitëse (ku përbën bërthamën e fjalisë), shpeshherë e kushtëzojnë kuptimin e saj në këto fjali. Në kontekste të caktuara, struktura e fjalisë nxitëse mund të ndërtohet nga një folje-kallëzues dhe një kryefjalë e nënkuptuar, por jo e shprehur. Në fjalinë 1, urdhri a kërkesa ndaj dëgjuesit mund t'i drejtohet një ose disa dëgjuesve të caktuar, të cilët janë të pranishëm në çastin e ligjërimin.

¹¹⁶ *Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa)*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 110.

1. [Call the doctor. (You)]

[Telefonoji doktorit (ti ose ju)], kushtëzojnë kumtimin e foljes-kallëzues në fjalitë nxitëse.

§2.1.1. Kategoritë gramatikore tipike të foljeve në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe

Fjalitë nxitëse në gjuhë të ndryshme dallohen formalisht nga tipat e tjerë të fjalive, sepse kanë një morfologji të ndryshme të foljes-kallëzues. Mënyra urdhërore përdoret gjerësisht për të shprehur një nuancë kuptimore në formën e një urdhri apo kërkesë. Shpeshherë, nga shumë studiues është hedhur ideja se kuptimi urdhërues dhe drejtues i fjalive nxitëse bën që çdo fjali me këtë kuptim të klasifikohet si fjali me kuptim nxitës, pavarësisht nga forma gramatikore e foljes në këto fjali. Kjo nënkupton se *fjalitë mund të dallohen si nxitëse dhe dëshirore në varësi të funksionit urdhërues që shprehin apo kumtojnë*.¹¹⁷ Megjithatë, termi *imperative* (urdhërore) përdoret për t'iu referuar formës së fjalisë dhe nuk përdoret për t'iu referuar funksionit të një fjalie të caktuar. Karakteristikë e fjalive nxitëse është mungesa e fleksionit ose një fleksion i varfër në pjesën më të madhe të gjuhëve, madje dhe në ato gjuhë që shfaqin një morfologji të pasur të foljes për kohën, përshtatjen dhe mënyrën.

Disa nga kategoritë gramatikore që i kemi bërë objekt studimi dhe përjasjeje përfshijnë kategorinë e mënyrës, aspektit, diatezës dhe kohës. Njëherazi, këto kategori përbëjnë edhe veçantitë dalluese të foljes-kallëzues të fjalive nxitëse në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Struktura e thjeshtë e ndërtuar përgjithësisht nga një folje-kallëzues (edhe nga gjymtyrë të tjera: kundrinor, rrethanor etj.) përlligj analizën e detajuar të foljes-kallëzues si në shprehjen formale, ashtu edhe në funksionin sintaksor dhe komunikativ që ajo luan te fjalitë nxitëse. Qasja e fjalive nxitëse dhe dëshirore në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe lidhet ngushtë me veçoritë që karakterizojnë dy gjuhët eptimore dhe analitike. Këto veçori kushtëzojnë edhe funksionet sintaksore në fjali. Duke u mbështetur në natyrën e dy gjuhëve, duhet të theksojmë se këto kategori gramatikore e përforcojnë këtë natyrë. Kategoritë gramatikore të fjalitë nxitëse dhe dëshirore janë më të kufizuara krahasuar me fjalitë dëftore dhe pyetëse dhe njëherazi dallojnë edhe me gjegjëset në gjuhën shqipe, ku kategoritë gramatikore shprehen me anë të fleksionit. Kategoritë gramatikore që gjejnë shprehje në fjalitë nxitëse dhe dëshirore në gjuhën shqipe dallohen më shkoqur dhe nuk janë të kufizuara si te gjegjëset e tyre në gjuhën angleze. Disa nga kategoritë gramatikore tipike që vihen re te fjalitë nxitëse janë: kategoria e *mënyrës, aspektit, diatezës, vetës, kohës* etj.

Po japim më poshtë një parashtrim të tipareve të kategorive gramatikore të foljes-kallëzues te fjalitë nxitëse në gjuhën angleze.

Kategoria gramatikore e mënyrës. Në gjuhën angleze dallohen tri mënyra të foljes: *dëftore* (indicative), *lidhore* (subjunctive) dhe *urdhërore* (imperative). Nëpërmjet kategorisë gramatikore të mënyrës shprehet lidhja midis veprimt të emërtuar nga folja dhe realitetit objektiv. Kategoria gramatikore e mënyrës është mjeti kryesor për të shprehur modalitetin¹¹⁸. Në gjuhën angleze karakteristikë për foljen-kallëzues te fjalitë nxitëse është *mënyra urdhërore* e foljeve. Mënyra urdhërore kategoritë gramatikore i shfaq më të kufizuara në krahasim me mënyrat e tjera, për shkak të modalitetit që ka. Përmendim kategorinë e kohës në mënyrën dëftore, e cila është më e pasur në forma kohore, ndërsa mënyrat e tjera, përfshi edhe mënyrën urdhërore, kanë një numër të kufizuar formash kohore duke u kushtëzuar nga kuptimet modale që ato shprehin. Si në gjuhën shqipe, edhe në gjuhën angleze mënyra

¹¹⁷ Ch. Han, *The structure and interpretation of imperatives*, Garland Publishing, 2000, f. 4.

¹¹⁸ *Gramatika e gjuhës shqipe I, (Morfologjia)*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 272.

urdhërore ka vetëm dy veta (*njëjës* dhe *shumës*) të kohës së tashme. Mënyra urdhërore ka vetëm këto kategori gramatikore; ajo nuk ka kohët që kanë mënyrat e tjera në gjuhën shqipe. Urdhërorja është një prej mënyrave të trashëguara nga një fazë e lashtë indoevropiane.

Gjuha angleze klasifikohet në grupin e gjuhëve që kanë një paradigmë të urdhërores, e cila përfshin një formë foljore të shoqëruar në raste jo të shpeshta dhe nga një folje ndihmëse *do*.

2. “*Bring the human creature food and drink.*” she said.
(Silli krijesës humane ushqim dhe pije, - tha ajo.)
3. “*Take it away.*” said Edmund sulkily.
(Merre atë me vete.)
4. “*Wait for me there in hiding.*”
(Më prit mua te vendi i fshehtë.)
5. “*Do stop it,* said Susan.”
(Ndaloje atë, - tha Suzana.)
(C. S. Lewis, *The lion, the witch and the wardrobe*, f. 102, 103, 45.)

Kategoria gramatikore e vetës. Paradigma e foljes-kallëzues të fjalive nxitëse në gjuhën angleze përfshin forma të foljes në vetën e dytë, njëjës e shumë, si dhe trajta të kombinuara të vetës së parë e të tretë, njëjës dhe shumë. Trajtat foljore të vetës së parë, të dytë e të tretë, njëjës a shumë, janë emërtuar në gjuhën angleze si forma të kombinuara (dual forms). Këto forma të kombinuara të vetave gjenden në fjalitë nxitëse me foljen *let* (*let + me / him / her / us / them*) dhe u nënshtrohen disa kufizimeve në lidhje me semantikën e fjalive, të cilat, në këtë rast, nuk mund të shprehin udhëzim, komandë etj., por mund të shprehin vetëm një kërkesë ose sugjerim¹¹⁹.

6. *Let us read* (you “ti, ju” and I “unë”).
(Le të lexojmë.) (ti / ju dhe unë: format e kombinuara të vetave)

Në këto fjali vërejmë përdorimin e foljes *let*, të ndjekur nga një përemër në funksionin e kryefjalës (*us*). Edhe kur i referohemi vetës së tretë, kemi të njëjtin ndërtim të fjalisë.

7. *Let’s go and find Lucy.*
(Le të shkojmë të gjejmë Lusin).
8. *Let him approach,* said Aslan.
(Lëre atë të afrohet, - tha Aslani.)
(C. S. Lewis, *The lion, the witch and the wardrobe*, f. 45, 126.)

Këto përdorime janë më pak të hasura dhe pothuajse arkaike në ligjërim, duke veçuar tipin *let me type*, që i referohet vetës së parë. Më e përdorur është forma e shkurtuar e vetës së parë shumë: *let us = let’s*. Duhet të theksojmë se folja *let*, e ndjekur nga një përemër vector (veta e parë ose e tretë njëjës dhe shumë) në rasën kallëzore, nuk mund të përdoret me përemrin vector të vetës së dytë *you*. Fjalitë nxitëse me *let you* dalin si fjali jogramatikore. Përemrat që ndjekin *let* shënojnë vepruesin, pra personin që pritet të përmbushë urdhrin, kërkesën a porosinë.

9. **Let you have a look.*¹²⁰
(Le t’i hedhësh një sy ti. Hidhi një sy ti. T’i hedhësh një sy.)

Te fjalitë gjegjëse në gjuhën shqipe vërejmë përdorimin e pjesëzës *le* para foljes-kallëzues në mënyrën lidhore, folje në mënyrën lidhore apo folje në mënyrën urdhërore. Fjalja 9 është e

¹¹⁹ V. S. Xrakovskij, *Typology of imperative constructions*, Lincom Europa, 2001, f. 361.

¹²⁰ R. Quirk, S. Greenbaum, G. Leech, J. Svartvik, *A comprehensive Grammar of the English Language*, Longman, 1985, f. 829-830.

saktë si nga ana gramatikore, ashtu edhe nga ajo kuptimore. Gjegjësjja në gjuhën shqipe dallon nga ajo në gjuhën angleze, e cila është një fjali jogramatikore.

Në gjuhën angleze, për shkak të mungesës së *fleksionit*, folja ka të njëjtën shprehje morfologjike. Gjuha angleze nuk ka shenjues të vetës apo numrit dhe forma e foljes është e njëjtë për të dyja vetat:

10. *You go* (ti - veta e dytë, njëjës) dhe *You go* (ju - veta e dytë, shumës).

(Ti shko.)

(Ju shkoni.)

Siç e vërejmë edhe nga shembulli i sipërpërmendur, karakteristikë e gjuhës angleze është përdorimi i një forme foljore pa pjesëzën *to* të infinitivit (*bare infinitive*): *to go - go!* (shko / shkoni); *to leave - leave!* (largohu / largohuni); *to learn - learn!* (mëso / mësoni). Fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe në shumë gjuhë të tjera dallohen për një formë foljore të thjeshtë dhe për mungesën e kryefjalës së fjalisë në të shumtën e rasteve. Megjithatë, në kontekste të caktuara, fjalitë nxitëse në gjuhën angleze e kanë të detyrueshëm përdorimin e kryefjalës për të shprehur një kuptim sa më të qartë dhe të plotë të urdhrit, kërkesës apo porosisë¹²¹ (në varësi të semantikës a kuptimit të fjalisë nxitëse).

Kategoria gramatikore e diatezës. Kjo kategori shenjon lidhjen midis veprimit të shprehur nga folja dhe kryefjalës së fjalisë. Këtë kategori e gëzojnë ato folje që mund të përdoren në kundërvëniet formale veprare dhe jo veprare. Fjalitë nxitëse në gjuhën angleze shfaqin karakteristika të të dyja diatezave, por në diatezën pësore përdorimet janë më të rralla, veçanërisht në pësore me formë foljore në të kryerën [*perfect passive*], si dhe forma e pësore me foljen *to be* [*be passives* të përdorura si *negative passives*]

11. *Have it finished before you leave.*

(Të kesh mbaruar, para se të largohesh.)

12. *Be led by your desires.*

(Të udhëhiqesh / drejtohesh nga dëshirat e tua.)

13. *Don't be seated.*

(Të mos jesh i ulur / ulesh.)

Semantika e fjalive me folje-kallëzues në pësore shpreh ngjyrimet kuptimore parandaluese dhe fjalitë janë fjali nxitëse-mohore. Një rast i pësore është edhe ndërtimi me foljen *get + pjesoren* e foljes leksikore. Vlera kuptimore e fjalive me këtë strukturë përkon me dëshirën e folësit për të shprehur një propozim a kërkesë ndaj të tjerëve për të realizuar diçka të nevojshme për ta.

14. *Get vaccinated as soon as you can.*

(Të vaksinoheni sa më shpejt të mundeni.)

Kategoria e kohës. Folja-kallëzues është gjymtyra kryesore në strukturën e fjalive nxitëse, sepse në pjesën më të madhe të konteksteve kryefjala nuk shprehet. Folja-kallëzues mund të shprehet nga një folje në formën bazë, infinitivit ose një folje ndihmëse e ndjekur nga folja kryesore. Mënyra urdhërore nuk ka tregues gramatikorë për kategorinë e kohës në krahasim me mënyrat e tjera. Kjo ndodh pasi modaliteti i mënyrës urdhërore kufizon kategorinë e kohës. Folja-kallëzues e fjalive nxitëse ka të kufizuar kategorinë e kohës, e cila në këto fjali i përket së ardhmes dhe jo veprimeve të së shkuarës. Edhe në rastet kur kemi përdorime të tilla, si në gjuhën angleze me ndajfoljen *now* (tani), kuptimi i urdhrit apo porosisë lidhet me një të ardhme të afërt, pas çastit të ligjërimit.

¹²¹ You, boys at the back join the others! (Ju, djemtë aty në fund, bashkohuni me të tjerët!)

15. "Give me that concertina at once (*now*), William Brown," she said.
[Ma jep mua atë fizarmonikë menjëherë (tani), William Brown, - tha ajo.]
16. *Now*, listen, said William earnestly.
(Tani, dëgjo, - tha Williama me seriozitet.)
(R. Crompton, *William the tramp*, f. 89, 19).

Modaliteti i kësaj mënyre shpjegon mungesën e një kundërvënieje kohore, nëpërmjet së cilës shprehet dëshira e folësit në formë urdhri, kërkesë etj., për veprime që zakonisht priten të kryhen pas çastit të ligjërimit. Edhe pse kemi kufizime të kategorisë së kohës te folja-kallëzues e fjalive nxitëse, në disa kontekste specifike kupimi i fjalisë i referohet një çasti kohor të së shkuarës. Këtë përdorim e gjejmë kur kumtimi i fjalisë i referohet një informacioni të panjohur për folësin a shumë të tjerë. Në këtë rast kemi një përdorim shumë sporadik të fjalive nxitëse me kuptimin e një urimi a lutjeje për veprime që kanë ndodhur në të shkuarën (kryesisht në formën e lutjeve¹²²). Në fjalinë 17 vërejmë përdorimin e formës pësore të kryer që i referohet një çasti kohor para ligjërimit.

17. *Please don't have participated in that fatal scene.* (Një lutje)
(Të lutem, të mos kishe marrë pjesë në atë situatë fatale.) përkthimi literal
(Të lutem, sikur të mos kesh marrë pjesë në atë situatë fatale.)
(Do të doja të mos kesh marrë pjesë në atë situatë fatale.)

Fjalja gjegjëse në gjuhën shqipe e ka foljen-kallëzues në të kryerën e mënyrës lidhore.

Kategoria e aspektit. Termi aspekt i referohet kategorisë gramatikore e cila reflekton mënyrën se si zhvillohet veprimi i shprehur nga folja, në lidhje me kohën¹²³.

18. *He is working.*
[Ai po punon (ose është duke punuar)].

Teorikisht dallohen tre lloje të kategorisë së aspektit: *main=progressive=perfect*; (veprim i çastit, në rritje progresive, i kryer etj.). Gjuhët që kanë një kundërvënie kohore, kanë një sistem aspekti të zhvilluar dhe anasjelltas¹²⁴. Praktikisht, vetëm forma bazë në gjuhën angleze, si *be finishing* - gjen përdorim, nëse veprimi është në vazhdim në çastin e ligjërimit.../ *I have it performed* forma e kryer e pësore (tregon një veprim të paraprirë). Sipas Huddleston-it, forma e aspektit e një veprimi në proces është një përdorim i rrallë dhe akoma më pak i përdorshëm është aspekti i kryer¹²⁵. Në terma të thjeshtë, urdhërorja shprehet me një folje në kohën e tashme, por nga ana kuptimore tregon një urdhër ose ftesë e cila mund të kryhet a të zbatohet në një çast kohor të së ardhmes që pason momentin e ligjërimit.

Mungesa e dallimeve të kategorisë së kohës sjell një përdorim më të rrallë të foljeve ndihmëse në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze:

19. *Be doing your job.*
(Të jesh duke bërë punën tënde.)

Rastet e sipërpërmendura (*be finishing / I have it performed*) gjejnë një përdorim shumë të rrallë në të dyja ligjërimet. Në mënyrë që të përdoret, forma e pësore e fjalive nxitëse në gjuhën angleze, duhet të *kontekstualizohet*¹²⁶. Përdorimi i aspektit të vazhduar është kaq i

¹²² R. Quirk, S. Greenbaum, G. Leech, J. Svartvik, *A comprehensive Grammar of the English Language*, Longman, 1985, f. 828.

¹²³ *Po aty*, f. 188.

¹²⁴ *Po aty*, f. 240.

¹²⁵ R. Huddleston, G. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English language*, Cambridge University Press, 2002, f. 828.

¹²⁶ A.Y. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 148.

rrallë, saqë shumë gjuhëtarë nuk i kanë kushtuar vëmendje foljeve me aspekt të vazhduar të hasura në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze. Përmendim këtu gjuhë, si frëngjishtja e italishtja, ku është e pamundur të haset një formë e tillë¹²⁷.

Megjithatë, edhe ato raste të fjalive nxitëse dhe dëshirore jo të shpeshta, ku folja përdoret në kohët me aspekt të vazhduar, janë situata ligjërimore specifike. Në këto situata ligjërimore foljet në kohët me aspekt të vazhduar në fjalitë nxitëse përdoren së bashku me fjalitë e nënrenditura kohore të lidhura me lidhëzat (*while - ndërsa*), (*when - kur*), me plotës kohe ose në bashkërenditje me një fjali tjetër. Vërejmë shembujt e mëposhtëm:

20. *Be doing* your homework, when your mum gets home.

(Të jesh duke bërë detyrat, kur mamaja të arrijë në shtëpi.)

21. Let's *be waiting* at the busstop at seven.

(Le të jemi duke pritur te stacioni i autobusit në orën shtatë.) (përkthimi literal)

Le të presim në stacionin e autobusit në orën shtatë.

22. Let's *be calling*, it's too late.

(Le të jemi duke folur në telefon, është shumë vonë.) (përkthimi literal)

(Le të flasim në telefon (të telefonojmë), është shumë vonë.)

Fjalitë e varur kohore dhe konteksti përcaktojnë edhe semantikën e përdorimit të formës foljore *be doing* në këtë fjali, ku veprime të shprehura me folje në kohët e vazhduara ndodhin njëkohësisht me situata të tjera ose ndodhin në një moment të caktuar të së ardhmes. Te shembulli 21, situata ligjërimore i përket një çasti tjetër të së ardhmes, i shkëputur plotësisht nga çasti i ligjërimit, d.m.th. e tashmja. Në rastin e fjalitë 22, forma foljore me aspekt të vazhduar nuk i përket një çasti në të ardhmen, por çastit të ligjërimit, të tashmes, ku në rastin konkret nevojitet një veprim i menjëhershëm (të telefonuarit). Në fjalitë nxitëse forma foljore në kohët e vazhduara përdoret në kontekste të caktuara ligjërimit dhe duke u bazuar në referencën kohore të rasteve të sipërpërmenduar, format e urdhërores mund të merren “*si forma me një natyrë hibride mes të tashmes dhe të ardhmes*¹²⁸”, për sa i përket lokucioneve kohore apo nuancës kohore. Në gjuhën angleze, forma e pësorës së fjalive nxitëse përdoret rëndom në gjuhën e teksteve të reklamave:

23. *Be surprized* by the size!

(reklamë e bërë nga një agjent i shitjes së pasurive të patundshme)¹²⁹.

Gjuha shqipe nuk e ka aspektin si kategori të veçantë. Disa vlera të aspektit shprehen me mjete leksikore, si me pjesëzën *po*¹³⁰. Lidhur me kategorinë e aspektit të vazhduar, në gjuhën shqipe nuk kemi forma foljore gjegjëse, por folja-kallëzues shprehet me forma foljore në mënyrën urdhërore ose lidhore (të bësh, të presim, të telefonojmë). Kategoria e aspektit në sistemin foljor të shqipes nuk është e zhvilluar dhe lidhja e ngushtë mes kategorisë së aspektit dhe kategorisë së kohës ka bërë që kuptimet e shumta kohore të kufizojnë vlerat e aspektit në këtë gjuhë. Në mënyrë që të jetë më i plotë kuptimi i fjalitë dhe të plotësohen disa vlera të aspektit të munguara në gjuhën shqipe, është e nevojshme që me anë të mjeteve leksikore të theksojmë se veprimi lidhet me të tashmen, çastin e ligjërimit apo pas këtij ligjërimit.

Nëse te fjalitë gjegjëse në shqip do të shtojmë ndajfoljet e kohës apo sintagmat emërore si: *tani, në këtë moment, sapo, urgjent*, kjo do të plotësonte elementet e aspektit të vazhduar të shprehura me *progressive tenses* në gjuhën angleze. Pra, në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe është për t'u theksuar prania e fjalëve leksikore me vlerë kuptimore kohore, në mënyrë që të shprehen sa më qartë disa vlera të aspektit që nuk shprehen nga ana gramatikore.

¹²⁷ Ch. Williams, *The use of progressive tenses in imperative*, Nottingham Linguistic Circular 16, 2001.

¹²⁸ *Po aty*.

¹²⁹ A. Y. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 150.

¹³⁰ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 240.

Mungesa e kategorisë së kohës në fjalitë nxitëse dhe dëshirore lidhet me modalitetin dhe hyrjen në marrëdhënie me disa ndajfolje kohore si: *now, the next day, tomorrow* etj. Meqenëse folja-kallëzues në mënyrën urdhërore i referohet një situatë apo veprimi që do të ndodhë në një të ardhme të menjëhershme, të afërt ose më të largët, fjalitë nxitëse nuk mund të pranojnë në strukturën e tyre ndajfolje kohore me një referencë të kohës së shkuar ose veprime të zakonshme që përsëriten herë pas here:

24. **Usually* take the bus.
25. **Zakonisht* merr autobusin.
26. **Phone yesterday*.
27. **Telefononi dje*.

Në frëngjisht folja-kallëzues në fjalinë nxitëse mund t'i drejtohet një çasti kohor të së ardhmes, por në kontekste të ndryshme mund të ketë nuanca kohore që i referohen kohës së shkuar: 28. Soyez parti!

Duhet të theksojmë se rendi i ndajfoljeve në fjalitë nxitëse shfaqet më i ngulitur krahasuar me përdorimin e tyre të fjalitë dëftore a pyetëse. Rendi i ndajfoljeve të kohës të fjalitë nxitëse është në shumicën e rasteve në fund të fjalisë, ndërsa të fjalitë dëftore dhe pyetëse ndajfoljet kanë një rend më të lirë: në fillim apo në fund të fjalisë. Disa prej tyre dalin midis foljes kryesore dhe foljes ndihmëse.

29. Tomorrow he is flying to London.
Nesër ai do të fluturojë për në Londër.
 He is flying to London tomorrow.
 Ai do të fluturojë për në Londër nesër.
 Is he flying to London tomorrow?
 A do të fluturojë ai për në Londër nesër?
30. Go to the dentist tomorrow!
 Shko te dentisti nesër!
 **Tomorrow* go to the dentist!¹³¹
Nesër, shko te dentisti!

Fjalitë në gjuhën shqipe janë të sakta. Ndajfolja *now* (tani) mund të jetë si në pozicionin nistor, ashtu edhe në fund të fjalive nxitëse, sepse ana kuptimore e saj përmban një forcë shprehëse që përkon me forcën drejtuese të mënyrës urdhërore dhe fjalive nxitëse në përgjithësi. Synimi i folësit për të drejtuar dëgjuesin të përmbushë një kërkesë të tij pas çastit të ligjërimin del më i qartë dhe më i përforcuar nga përdorimi i ndajfoljes *now* në fjalitë nxitëse.

Në gjuhën angleze jo të gjitha foljet mund të përdoren në fjalitë nxitëse. *Kufizimet* e foljeve në fjalitë nxitëse lidhen me semantikën që ato shprehin. Semantika e foljeve që përdoren si folje-kallëzues në fjalitë nxitëse kushtëzohet nga shprehja ose jo e veprimeve të kontrollueshme. Ky është i vetmi kufizim i foljeve, të cilat duhet të shprehin veprime të kontrollueshme që mund të kryhen në një situatë të caktuar. Pra, foljet që emërtojnë gjendje, perceptime, foljet modale *know* (*di, njoh*), *own* (*zotëroj*), *belong* (*përket*), *see* (*shikoj*), *hear* (*dëgjoj*), *can* (mund), *want* (dua), nuk mund të përdoren në fjalitë nxitëse, sepse kuptimi thelbësor i urdhërores nënkupton një folës që jep një direktivë dhe një dëgjues që duhet ta përmbushë atë.

31. **Want* the address!

¹³¹ Në një kontekst ku ndajfolja *tomorrow* shqiptohet me një pauzë nga pjesa tjetër e fjalisë dhe ndahet në të shkruar me presje, fjalia nxitëse është e rregullt nga ana gramatikore dhe kuptimore. *Tomorrow*, go to the dentist! Pra, pozicioni i *tomorrow* në fillim të fjalive nxitëse është i rregullt.

32. **Know* the answer!

Pra, në këtë akt ligjërimi folësi zotëron kontroll mbi realizimin e veprimit nga ana e të adresuarit. Megjithatë, foljet që emërtojnë gjendje mund të gjejnë përdorim si folje-kallëzues të një fjalie nxitëse, kur kjo është pjesë e një fjalie të përbërë me nuancë kuptimore kushtore. Vetëm në kontekste të caktuara, ku kuptimi i foljeve të gjendjes kushtëzohet nga një situatë a veprimtari tjetër, këto folje mund të shprehin veprime a gjendje në të cilat folësi mund të ketë kontroll.

33. *Believe* in your efforts and you will overcome this frustration.
(*Beso* në forcat e tua dhe do ta kapërcesh këtë pezmatim.)

Urdhërorja e shqipes, siç dihet, ka vetëm dy forma, njëren për vetën e dytë njëjës dhe tjetrën për vetën e dytë shumës. Për vetat e tjera (me përjashtim të vetës së parë njëjës) me vlerën e urdhërores *përdoren format përgjegjëse të kohës së tashme të mënyrës lidhore, ashtu siç ndodh në përgjithësi edhe në shumë gjuhë të tjera indoevropiane*¹³².

Në **gjuhën shqipe** format gramatikore të foljes i përkasin vetë vetës së dytë, njëjës dhe shumës. Format foljore të vetës së dytë shumës të mënyrës dëftore përkojnë me vetën e dytë shumës të mënyrës urdhërore.

34. *-Ikni, - u thashë prapë unë. – Puna ime s’ dihet, ju dilni lart dhe më pritni atje!*
(veta II shumës)

(V. Koreshi, *Tregime të zgjedhura*, f. 23.)

Këto forma homonime dallohen vetëm nga intonacioni i fjalisë, i cili në fjalitë nxitëse është i veçantë, urdhërues:

35. (Ju) *lexoni - Lexoni!*

Në vetën e dytë shumës të gjitha foljet në mënyrën urdhërore dalin me të njëjtën formë si në vetën e dytë shumës të kohës së tashme të mënyrës dëftore. Për sa i takon numrit njëjës të urdhërores, vetëm një pjesë e foljeve dalin me të njëjtën formë si në vetën e dytë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore¹³³.

36. (Ti) *hap - hap* (mbaresë foljore *zero*).

Pjesa tjetër e foljeve dalin me një formë të ndryshme nga veta e dytë e mënyrës dëftores, koha e tashme dhe marrin mbaresa vetore (-j), ndërrojnë zanoret e temës (-e ose -je në -i), ose dalin pa ndonjë mbaresë si:

37. (Ti) *laj, hiq, mëso, etj.*

38. – *Pi!* – i tha. *-Këndo!* – i tha Fitja. – *Këndo* tjera! – tha Fitja me sy të turbulluar nga pija (veta II njëjës¹³⁴). (V. Koreshi, *Tregime të zgjedhura*, f. 17.)

39. *Shtrydhe* pak atë trurin tënd rudimentar prej fetusi gjenetikiisht të modifikuar, siç mëton të jesh tani.....

(F. Kongoli, *Te porta e shën Pjetrit*, f. 95.)

Kategoria gramatikore e mënyrës. Në varësi të kuptimeve modale dhe formave gramatikore respektive, në *gjuhën shqipe* dallohen gjashtë *mënyra* foljore, të gjitha me kategorinë e kohës, vetës, numrit, gjë që lidhet me eptimin e pasur foljor që ka gjuha shqipe.

Përveç formave foljore të urdhërores, përdorimi i formave foljore të vetës së tretë, njëjës e shumës, të kohës së tashme të **mënyrës lidhore**, për të shprehur modalitetin e urdhrit, është

¹³² Sh. Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1976, f. 116.

¹³³ *Gramatika e gjuhës shqipe I, (Morfologjia)*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 297.

¹³⁴ Në varësi të përkatësisë në një nga tre zgjedhimet e foljes, format e foljeve në vetën e dytë njëjës të mënyrës urdhërore ndryshojnë, marrin mbaresa të ndryshme vetore nga vetat e mënyrës dëftore, mund të dalin me temë -o-, -e-, marrin mbaresë -j-, nuk marrin ndonjë mbaresë etj.

karakteristikë për gjuhën shqipe, e papaprirë ose jo nga pjesëza *le*. Pra, përdorimi i mënyrës lidhore për foljen-kallëzues të fjalive nxitëse-dëshirore është një karakteristikë e fjalive nxitëse-dëshirore në gjuhën shqipe, e cila mund të shprehë modalitetin e dëshirueshmërisë në formë urimi ose mallkimi, në formë urdhri a kërkesë¹³⁵.

40. - *Le ta thotë ai.* (V. Koreshi, *Tregime të zgjedhura*, f. 130.)

Edhe *veta e parë shumës* e së tashmes së lidhore merr vlerën e urdhërores, në rastin kur folësi përfshihet edhe vetë në një veprim të urdhëruar apo nxitur prej tij.

41. – *Ndreçi! Bëjmë ç'të bëjmë e të marrim* ndonjë gjë për darkë, - i tha Fatriu kur erdhi. (V. Koreshi, *Tregime të zgjedhura*, f. 177.)

“*Konouiktivi (mënyra lidhore) është mënyra e mundësive, e shprehjet të pacaktuara, e dyshimit, e pasigurisë. Konouiktivin e gjejmë..... të plotësojë vetat që i mungojnë imperativit*¹³⁶. E tashmja e lidhore mund të marrë edhe kuptime modale të tjera si: modaliteti i dëshirueshmërisë në formë urimi, kërkesë, mallkimi etj.

42. *Të marrtë zoti mendtë! Ju preftë një flamë, moj të mallkuara!* (V. Koreshi, *Tregime të zgjedhura*, f. 87.)

Në gjuhën shqipe, te fjalitë nxitëse dhe dëshirore përdorimi i kryefjalës është i panevojshëm në pjesën më të shumtë të rasteve, sepse mbaresat vetore shënojnë kategorinë e vetës dhe të numrit të personit që i drejtohem. Në këta tipa fjalish kryefjala pothuajse nuk përdoret fare. Por, nuanca kuptimore e foljes-kallëzues në fjalitë nxitëse-dëshirore nuk shprehet vetëm me një folje në mënyrën urdhërore, pasi folja-kallëzues mund të jetë dhe në një mënyrë tjetër (*dëftore* ose *lidhore*).

43. *Provoni!* (Mënyra urdhërore)
 (Ju) *Provoni.* (Mënyra dëftore)
Të provoni. (Mënyra lidhore)
 (Të provojmë llotarinë amerikane në shtator. Ja, shtatori zëre se erdhi.)
 (Le të merren të tjerët me këtë, qoftë edhe çakejtë.)
 (F. Kongoli, *Te porta e shën Pjetrit*, f. 203, 164.)

Në gjuhën shqipe vërejmë një përdorim të përsëritur të vetës *së dytë* të foljes-kallëzues në fjali dëftore me vlerën e fjalive nxitëse-dëshirore, për të tri vetat njëjës apo shumës, të cilat i përkasin një veprimi të përsëritur të ndodhur më parë. Në këto fjali përsëritet urdhërorja e së njëjtës folje ose forma të urdhërores së dy a më shumë foljeve, të shoqëruara me kryefjalën përkatëse dhe të lidhura midis tyre me lidhëza. Në këtë rast veprimet e përshkruara kanë një fuqi shprehëse më të madhe dhe lidhen me të shkuarën:

44. *Dhe qaj e ik dhe qaj e rend, dhe qaj e klith....*¹³⁷ (*Then cry and run and ...*)

Për të shprehur nuancën kuptimore të porosisë a këshillës, gjuha shqipe karakterizohet jo vetëm nga përdorimi i foljes në mënyrën lidhore me vlerën e urdhërores, por vërehet edhe përdorimi i foljes-kallëzues *në kohën e ardhme të mënyrës dëftore* për të shprehur propozim apo pranim.

45. *Do ta provosh dhe një herë. Do të shkoj gjer këtu afër e do të kthehem prapë.* (V. Koreshi, *Tregime të zgjedhura*, f. 168, 169.)

¹³⁵ Sh. Demiraj, *Rreth kategorisë gramatikore të kohës dhe të mënyrës në gjuhën shqipe*, Studime filologjike 3, 1977, f. 105.

¹³⁶ K. Cipo, *Gramatika shqipe*, 1949, f. 115-116.

¹³⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 331.

Sipas gramatikës së gjuhës shqipe, duhet pasur parasysh se, me përjashtim të formave kohore të mënyrës dëftore, te format kohore të mënyrave të tjera kuptimi gramatikor i kohës është i gërshetuar me atë të modalitetit, i cili në përgjithësi del në plan të parë¹³⁸. Në gjuhën shqipe, sa më shumë modalitet të shprehë folja-kallëzues në fjali, në atë më pak kohë gramatikore do të përdoret kjo folje-kallëzues, ashtu si në fjalitë nxitëse. Edhe mënyra dëshirore në gjuhën shqipe ka në përdorim kohën e tashme, megjithëse kjo mënyrë ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën. Koha e kryer ka përdorim të kufizuar, sepse dëshira e folësit në formën e një urimi a mallkimi në një moment të veçantë mund t'i referohet aktiviteteve ose veprimeve të së shkuarës.

46. Ju pastë lënë uratën!

Në gjuhën shqipe hasim edhe përdorimin e foljes pësore në fjalitë me kuptimin e disa urdhrave të zakonshëm. Veprorja, në krahasim me pësoren, gjen përdorim më të shpeshtë. Edhe pse urdhërorja në gjuhën angleze i ka të dyja format, veprorë dhe pësore, forma e dytë përdoret atë rrallë, sa që normalisht nuk është e përfshirë në paradigmen e urdhërores. Në gjuhën shqipe foljet janë në formën veprorë, sepse vetë urdhërorja është një mënyrë e shprehur me një folje veprorë. Gjuhët indoevropiane përdorin më shumë urdhëroren veprorë.

Përfundim: Nga krahasimi i kategorive gramatikore të diatezës, të kohës dhe të mënyrës në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze vëmë re se:

1. Gjuha shqipe përdor tri mënyra të foljeve në fjalitë nxitëse: urdhërore, lidhore dhe dëftore, kurse në gjuhën angleze përdoret vetëm forma e infinitivit, i cili merr vlerat e urdhërores.

2. Kategoria e kohës është e kufizuar si në gjuhën angleze, ashtu edhe në gjuhën shqipe, pasi ajo lidhet me shprehjen e modalitetit në fjalitë nxitëse.

3. Format e diatezës pësore përdoren rrallë në të dyja gjuhët.

4. Gjuhës shqipe i mungojnë format gramatikore të aspektit të vazhduar. Kjo mungesë plotësohet duke përdorur plotësa kohe ose fjali kohore.

§2.1.2. Shprehja morfologjike e fjalive nxitëse-mohore

Te fjalitë mohore mohohet përmbajtja e gjithë fjalisë ose një element i saj, qenia e një fakti, shprehet dëshira a kërkesa për të mos u bërë diçka, për t'u parandaluar një veprim, gjendje, si dhe pyetet për vërtetësinë e mosqenies së diçkaje. Këto fjali janë të shenjzuara, karakterizohen zakonisht nga prania e pjesëzave mohuese, të cilave mund t'u shtohen për saktësim të mëtejshëm a përforcim ndajfolje, përemra, mbiemra përemërorë a ndonjë fjalë tjetër mohore¹³⁹. Folësi në një fjali nxitëse mund të kërkojë shpeshherë dhe të ndalojë apo të parandalojë realizimin e një veprimi të caktuar. Bazuar në kuptimin që shprehin thënie të ndryshme, fjalitë nxitëse kanë një forcë shprehëse dhe urdhëruese që i karakterizon dhe i veçon nga tipat e tjerë.

Kjo forcë urdhëruese jepet me një strukturë sintaksore të një fjalie pohore. Kjo mëton të drejtojë të adresuarin të kryejë një veprim të urdhëruar nga folësi. Si rrjedhim, mohimi i një urdhri të dhënë është i papërshtatshëm në një kontekst ku pritet të zbatohet një direktivë. Studiues të ndryshëm e gjejnë si të papërshtatshëm mohimin te fjalitë nxitëse, sepse ai bie në kundërshtim me thelbin kuptimor të tyre, i cili nënkupton kryerjen a realizimin e një urdhri ose kërkesë dhe jo mosrealizimin e tij. Davies shpjegon se mohimi te fjalitë nxitëse në gjuhën angleze duhet të shihet në dritën e ndërveprimit të tij me kuptimin e urdhërores në përgjithësi dhe jo të dallohet mohimi nga tipat e tjerë të fjalive. Ajo çka e dallon mohimin te fjalitë

¹³⁸ Gramatika e gjuhës shqipe II, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 275.

¹³⁹ Gramatika e gjuhës shqipe II, Tiranë, 2002.

nxitëse është mënyra e ndërveprimit me semantikën që mbart urdhërorja, e cila bën që të gjallojnë interpretime të ndryshme krahasuar me një fjali gjegjëse pohore¹⁴⁰.

Të analizojmë fjalitë e mëposhtme:

47. *Don't do the room.*

(Mos e rregullo dhomën.)

48. *Undo the room, please.*

(Prishe dhomën, - të lutem.)

Po të bëjmë dallimin mes tyre në aspektin e semantikës, do të vërejmë se ai kushtëzohet nga qëndrimi apo synimi që ka folësi kur artikulon një thënie të tillë. Pra, thënie të tilla nënkuptojnë interpretime të tilla si: mospranimin e një të vërtete, mohimin e një mundësie më tepër sesa pranimin e saj. *Unë nuk e pranoj rregullimin e dhomës dhe unë pranoj mosrregullimin e dhomës.* Si rrjedhim, fjalitë mohore shprehin direktiva për mosrealizimin e diçkaje.

Në gjuhën angleze mohimi të fjalitë nxitëse shprehet me anë të foljes ndihmëse (*auxiliary*) *do* dhe pjesëzës mohuese *not* (*don't*) që e paraprin foljen bazë. Huddleston-i vë në dukje se fjalitë nxitëse përftohen nga një strukturë mohimi foljor i cili dallon nga ai në llojet e tjera të fjalive¹⁴¹. Në fjalitë nxitëse me kryefjalë të shprehur *don't* paraprin kryefjalën dhe si rrjedhim kemi një rend të përmbysur të gjymtyrëve. Në gjuhën shqipe mohimi i përgjithshëm, tërësor (*negative imperative*), shprehet nëpërmjet pjesëzave mohuese *mos*, *nuk*, *s'* të ndjekura nga format foljore të mënyrave të ndryshme. Pjesëza mohuese *mos* përdoret me kallëzues a këpujë në urdhërore, dëshirore, lidhore, ndërsa pjesëzat *nuk* dhe *s'* vendosen para foljes-kallëzues në dëftore, kushtore, habitore dhe janë të ndërkëmbyeshme. Pjesëza *mos* paraprin kallëzuesin e fjalive nxitëse të shprehur nga një formë foljore në mënyrën urdhërore dhe vendoset midis pjesëzës formëformuese *të* dhe trajtës foljore themelore në mënyrën lidhore. Këto fjali emërtohen si *nxitëse-ndaluese* dhe kanë strukturë identike me fjalitë nxitëse pohore të paraprirë nga pjesëza mohuese *mos*. Në disa kontekste ku folësi mëton të ndalojë apo të nxisë mosrealizimin e një veprimi që pritet të kryhet nga disa të adresuar të vetës së dytë shumë, *mos* del me një mbaresë *-ni* që përkon me formën foljore: *mos-ni*.

49. *Don't pretend not to understand, said Robert.*

(Mos pretendo të mos kuptosh, - tha Roberti.)

50. *Don't go in there, Henry.*

(Mos hyr aty, Henri).

(R. Crompton, *William the tramp*, f. 101, 216.)

51. *Yy, mos u bëj çilimi! Mos u zemëro, o xha Sadik.*

(V. Koreshi, *Tregime të zgjedhura*, f. 33, 56.)

Në rastet kur folja e fjalive nxitëse është në mënyrën lidhore, pjesëza mohore vendoset midis pjesëzës *le* dhe foljes: *le të mos vijë*. Në gjuhën angleze mohimi shprehet me vendosjen e pjesëzës mohuese *not* në fjalitë nxitëse-dëshirore me foljen *let* ose duke përdorur operatorin mohor *don't*.

52. *Let's not continue with the same topic.*

(Le të mos vazhdojmë me të njëjtën temë.)

53. *Let's don't say what we all think about this matter.*

(Le të mos e themi mendimin tonë rreth kësaj çështjeje.)

¹⁴⁰ E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 67-75.

¹⁴¹ R. Huddleston, G. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English language*, Cambridge University Press, 2002, f. 802.

Shembulli 53 *let`s don`t...* haset në përdorimet joformale (*informal usage*).

Në strukturën e fjalive nxitëse-mohore në gjuhën angleze vërejmë një rend të përmbytur të gjymtyrëve, ku kryefjala është në pozicionin midis ndihmësës *don`t* dhe formës bazë të foljes, infinitivit në këtë rast:

54. *Don`t you write on the board.*
(Mos shkruani në dërrasë.)

Në gjuhën shqipe mohimi realizohet në këtë rast me pjesëzën mohuese *mos* që paraprin foljen-kallëzues. Nuk e hasim një rend të tillë të vendosjes së kryefjalës midis pjesëzës mohuese dhe foljes-kallëzues të fjalisë nxitëse në gjuhën shqipe.

Përfundim: Nga krahasimi i fjalive nxitëse mohore në gjuhën angleze dhe shqipe vërejmë:

1. Përdorimin e operatorit mohor *don`t* ose *not* (forma me *let* dhe rendin e përmbytur në fjali) në gjuhën angleze.
2. Përdorimin e pjesëzës mohore *mos* në gjuhën shqipe pa rend të përmbytur të gjymtyrëve të fjalisë.

§2.2.Valenca e foljes-kallëzues në fjalitë nxitëse

Si një kategori sintaksore gramatikore, koncepti i valencës shtjellohet si aftësia e një lekseme - atomet e sintaksës¹⁴² - për të lidhur një numër të caktuar elementesh në një konstrukt apo strukturë gramatikore. Teoria e valencës është trajtuar jo shumë në gjuhësinë angleze. Modeli i valencës së foljes kushtëzohet nga karakteristikat e foljes për gjuhën në fjalë dhe valenca, si teori, është më e përshtatshme te gjuhët flektive. Gramatikat tradicionale kanë pranuar shumë kohë më parë se forma e shtjelluar e foljes është pothuajse në mënyrë universale i vetmi element në një fjali dhe mund të konsiderohet si “*glue*”, pra që i mban të gjitha elementet së bashku. Teorinë e valencës do ta vërejmë te folja-kallëzues e fjalisë dëftore krahasuar me një fjali nxitëse: *John bought Sara a house.*

Foljet në gjuhën angleze janë më të ndjeshme për sa i përket valencës. Një folje kalimtare mund të kthehet në jokalimtare.

55. *He moves.*
(Ai lëviz.)
He moves the car.
(Ai lëviz makinën.)

Në shumë gjuhë të tjera, ndryshe nga anglishtja, ndryshime të tilla të valencës nuk janë të mundura. Folja duhet të marrë fleksionin e duhur për të ndryshuar valencën.

56. *You go!*
(Ti shko!)
57. *You go to your house!*
(Ti shko në shtëpinë tënde!)

Në gjuhën angleze kryefjala në fjalitë dëftore nuk mund të hiqet, ndryshe nga struktura e fjalive nxitëse në gjuhën shqipe apo angleze. Në rastin e fjalisë së përmendur më lart, folja kallëzues është trivalente, sepse rreth saj qëndrojnë përbërësit e fjalisë si: kryefjala - kundrinori i zhdrejtë - kundrinori i drejtë.

¹⁴² M. Haspelmath & Th. Muller-Bardey, *Valence Change, Morphology*, a handbook on inflection and word formation, vol. 2, Berlin: de Gruyter, 2001, f. 2-15.

58. I bought *him* a book.
(Unë i bleva atij një libër.)

Ndërsa në fjalitë nxitëse mungesa e kryefjalës në të shumtën e rasteve bën që e njëjta folje të ndryshojë valencën, kalon në një ose dy valente, sepse, përveç një kryefjale të munguar, edhe kundrinori në fjalitë nxitëse në mjaft raste mungon.

Përfundim: Në përmbledhje të analizës së veçorive morfologjike të fjalive nxitëse-dëshirore në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, na duhet të ritheksojmë se, pavarësisht profilit të dy gjuhëve, që tipologjikisht janë të ndryshme (anglishtja si gjuhë izoluese dhe shqipja si gjuhë flektive), vërejmë ngjashmëri në shumë dukuri morfologjike. Këtu përfshijmë kategorinë e kufizuar të kohës së foljes, vetës, aspektit, diatezës, modalitetin e mënyrës foljore, përdorimin kryesisht të mënyrës urdhërore të foljes-kallëzues etj. në fjalitë nxitëse-dëshirore. Dallimet mes të dyja gjuhëve janë të natyrshme, për vetë faktin se këto janë dy gjuhë të tipave të ndryshëm dhe përdorimi i mënyrave të tjera të foljes-kallëzues me vlerën e urdhërores (mënyra *lidhore* apo dhe *dëftore* në gjuhën shqipe), foljet modale *do + positive imperative në gjuhën angleze*, fleksioni foljor i vetave etj., shpreh qartë ekzistencën e dallimeve të dukshme dhe bashkëpërkimeve mes të dy gjuhëve.

§2.3. Veçoritë sintaksore të fjalive nxitëse në gjuhën angleze krahasuar me gjegjëset në gjuhën shqipe

Fjalitë nxitëse zënë një pjesë të rëndësishme në ligjërimin bisedor dhe përmbajnë një larmi ngjyrimesh kuptimore në semantikën e tyre. Fjalitë nxitëse, në të gjitha gjuhët, nga ana kuptimore shprehin një forcë *ilokutore* urdhëruese, e cila në pjesën më të madhe të rasteve shoqërohet me një ngjyrim kuptimor të urdhrit dhe kërkesës. Nga ana formale, ato janë të dallueshme nga tipat e tjerë të fjalive, pavarësisht gjuhës ku ato shfaqen. Këto fjali kanë karakteristika të dallueshme të foljes bazë, pra kallëzuesit, dhe disa veçori sintaksore që i individualizojnë më mirë.

Kundrimi i fjalive nxitëse në gjuhën angleze ngërthen qëndrime të ngjashme, qasje të ndryshme, si dhe kundërthënie. Kjo larmi e vështrimeve ka të bëjë me përcaktimin, kategorizimin dhe trajtimin e fjalive nxitëse si njësi sintaksore të mëvetësishme, të formësuara nga ana e kumtimit dhe e ndërtimit. Qasja e analizës së aspektit sintaksor të fjalive nxitëse do të përqendrohet në trajtimin e disa veçorive sintaksore si: *kryefjala; përdorimi i thirrorit dhe kryefjalës; nevoja e përdorimit të formës mohore me foljen ndihmëse **do** për efekt të theksimit (tipare të strukturës së fjalisë); rendi i përmbysur i kryefjalës dhe përdorimi i pjesëzës mohuese **don't** në fjalitë nxitëse mohore; intonacioni etj.*

Në të njëjtën kohë, do të mëshojmë në nxjerrjen në pah të dallimeve dhe bashkëpërkimeve të hasura në të dyja gjuhët. Duke u nisur nga fakti se fjalitë nxitëse në strukturën e tyre përmbajnë gjithmonë një kallëzues të shprehur, një kryefjalë përgjithësisht të munguar dhe kundrinor të shprehur ose jo, në analizën tonë do të ndalemi në trajtimin e *sintagmës foljore* si gjymtyra bërthamë e fjalive nxitëse. Gjuha angleze dhe gjuha shqipe, tipologjikisht të ndryshme, si gjuhë flektive dhe joflektive, dallojnë qartë në shprehjen foljore të foljes kallëzues. Në gjuhën angleze fjalitë nxitëse e kanë foljen-kallëzues të njëjtë me formën bazë të infinitivit (paskajorja), pa pjesëzën *to*. Disa nga format foljore më kryesore dhe modelet strukturore të fjalive nxitëse janë:

1. Forma bazë e foljes e njëjtë me infinitivin (*Infinitivin* pa pjesëzën *to*):

59. *Wait!* (Prit / prisni!)

2. Forma mohore me *don't* (*don't* + forma bazë):

60. *Don't wait!*

(Mos prit / prisni!)

3. Forma e theksuar (*do* + forma bazë - *do* + V):
 61. *Do wait* a moment!
(Prit / prisni një moment!)
4. Forma e adresimit të një personi të caktuar. Në strukturën e fjalisë përfshihet edhe kryefjala e shprehur me një përemër vetor (*përemër vetor* + forma bazë e foljes):
 62. *You wait* here!
(Ti / ju prit / prisni këtu!)
5. Forma bazë e urdhërores së foljes-kallëzues + *question tag*¹⁴³:
 63. *Wait* here, *will* you?
[Prit këtu (mundesh, apo jo)?]¹⁴⁴.
 64. *Come* in, *won't* you? (veçanërisht në British English)¹⁴⁵
(Hyr, hë pra; apo s'vjen brenda?)
6. Folje në urdhërore e lidhur me lidhëzën bashkërenditëse *dhe*:
 65. *Go and play* outside.
(Dil dhe luaj jashtë ose Dil të luash jashtë.)
(Është e përdorshme edhe fjalia pa pjesëzën *të* ose lidhëzën *dhe* si: *Dil luaj jashtë*).

Në dallim nga gjuha angleze, fjalia nxitëse me dy kallëzues homogjenë të lidhur me lidhëzën *dhe*, në gjuhën shqipe mund të jetë një fjali kuptimplotë edhe pa përdorimin e lidhëzës apo pjesëzës *të* të mënyrës lidhore. Në anglisht fjalitë gjegjëse do të jenë jo të sakta nga ana gramatikore.

66. **Go play* outside.
Go and play outside është fjalia e saktë.

Të gjitha fjalitë nxitëse në gjuhën angleze kanë një shprehje foljore të tillë, pra një folje në formën bazë të infinitivit, me përjashtim të fjalive nxitëse të vetës së parë shumës të tipit:

67. *Let's sing*. (Le të këndojmë.) Paradigma e foljes-kallëzues të fjalive nxitëse në gjuhën angleze përfshin forma të foljes në vetën e dytë, njëjës e shumës, si dhe trajta të kombinuara të vetës së parë e të tretë, njëjës dhe shumës.

68. *Let us read* (you and I).

[*Le të lexojmë*] (të emërtuara në anglisht si forma *të kombinuara*)¹⁴⁶. Në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze nuk mund të përdorim një folje modale për të kumtuar një urdhër, një këshillë, një kërkesë etj. **Must / can / should* go!

Siç e kemi përmendur në kreun paraardhës, në gjuhën shqipe fjalitë nxitëse e kanë foljen-kallëzues në pjesën më të madhe të rasteve në mënyrën urdhërore, por shpeshherë edhe në mënyrën lidhore. (Kategoria gramatikore e mënyrës është mjeti kryesor për të shprehur modalitetin¹⁴⁷. Në këtë rast shprehet modaliteti i dëshirës në formë urdhri, kërkesë, porosie, lutjeje, grishjeje, lejimi etj.¹⁴⁸.) Vërejmë shembujt:

¹⁴³ Një specifikë e veçantë e gjuhës angleze për të shprehur mirësjellje ose të kundërtën, është dhe përdorimi i fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme me një strukturë të njëjtë si në fjalitë dëftore, struktura e të cilave përmban një folje modale.

¹⁴⁴ Në gjuhën shqipe nuk kemi një përdorim të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme, por gjegjëset e tyre në shqip shprehin modalitet dhe në kontekste të ndryshme mund të përshtaten si: mundesh, si thua, apo jo... etj. Në semantikën e fjalisë i shtojnë një nuancë kuptimore pasigurie, mirësjelljeje, dyshimi etj.

¹⁴⁵ M. Swan, *Practical English usage*, Oxford University Press, 2005, f. 471.

¹⁴⁶ Format e kombinuara (dual forms) u nënshtrohen disa kufizimeve në lidhje me semantikën e fjalive, e cila në këtë rast nuk mund të shprehë udhëzim, komandë etj., por mund të shprehë vetëm kërkesë ose sugjerim. Victor S. Xrakovskij, *Typology of imperative constructions*, Lincom Europa, 2001, f. 361.

¹⁴⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1995, f. 272.

¹⁴⁸ *Po aty*, f. 330.

69. *Prano / pranoni* propozimin. *Të telefononi* më shpesh.

Pra, duke marrë parasysh strukturën sintaksore dhe formën e shprehjes gramatikore të foljes-kallëzues, të gjitha fjalitë nxitëse në gjuhën angleze mund të klasifikohen në dy grupe të mëdha:¹⁴⁹

1. Në grupin e *parë* hyjnë ato fjali që përmbajnë një shenjues gramatikor specifik, si:

70. *Paint well!*

(Pikturo mirë!)

71. *Let me go to*

(Le të shkoj unë...)

72. *John, to the director, right now!*

(Xhon, te drejtori, menjëherë!)

Në këtë grup hyjnë ato fjali që kanë si funksion të vetëm dhe përmbajtje semantike shprehjen e një urdhri. Në teorinë e akteve të ligjërimit këto fjali përkufizohen si akte ligjërimit të drejtpërdrejta (*Direct Directives*). Kjo nënkupton shprehjen apo lëshimin e një urdhri ndaj marrësit ose të adresuarit. Në këtë grup hyjnë ato fjali nxitëse kallëzuesit e të cilave shprehen me një formë foljore *sintetike* (*Go! Shko / shkoni!*) apo *analitike* (*Let him go! Le të shkojë ai!*).

2. Grupi *i dytë* përfshin ato fjali të cilat nuk i kanë shenjuesit gramatikorë të veçantë si te grupi i parë¹⁵⁰. Shenjuesit gramatikorë të këtij grupi fjalish janë shenjuesit gramatikorë të fjalive dëftore dhe nga ana semantike ato nuk shprehin një urdhër, sepse funksioni kryesor i tyre nuk është dhënia e një urdhri apo kërkesë.

73. *Tomorrow you are going to London!*

(Nesër ju do të shkoni në Londër.)

74. *You can go and apologize.*

(Ti / ju mund të shkosh / shkoni dhe të kërkos / kërkon falje.)

Interpretimi i këtij grupi fjalish si fjali nxitëse lidhet me tiparet e veçanta që rrjedhin nga situata komunikuese a situata konteksture të veçanta (përfshi *rolin* dhe *statusin* e pjesëmarrësve në aktin e komunikimit), në të cilat realizohet ligjërimiti.

Duke u nisur nga ana formale e shprehjes së kallëzuesit, fjalitë nxitëse mund të grupohen në:

a. Fjali me një *kallëzues të shprehur* nga një folje në mënyrën urdhërore:

75. *Look at her!*

(Shikoje atë!)

76. *Close the door!*

(Mbylle derën!)

b. Fjali nxitëse ku *kallëzuesi mungon* formalisht:

77. *Out! To your room!*

(Jashtë! Te dhoma jote!)

Në gjuhën shqipe, fjalitë gjegjëse të këtij tipi, vëmë re se me përdorimin e infinitivit, pjesëzave apo pasthirmave të ndryshme, të cilat mbartin kuptimin thelbësor të fjalisë nxitëse, dalin pa një kallëzues të shprehur. Nuk ka një klasifikim të tillë për gjuhën shqipe, por, duke u nisur nga ngjashmëria e shembujve, mund të përshtasim grupin e fjalive të shprehura nga

¹⁴⁹ Victor S. Xrakovskij, *Typology of imperative constructions*, Lincom Europa, 2001, f. 8.

¹⁵⁰ Përdorimin e një foljeje në formën bazë të saj dhe një kryefjalë të shprehur ose jo.

një folje në urdhërore ose lidhore, si dhe grupin e fjalive eliptike, pa kallëzues si: *Jashtë!* etj. Trajta e urdhërores mund të shoqërohet ndonjëherë me pjesëza ose me pasthirrma.¹⁵¹

§2. 3.1. Tiparet dalluese të kryefjalës në fjalitë nxitëse

Sjellja sintaksore e kryefjalës në fjalitë nxitëse në disa gjuhë është e parashikueshme, nëse dihen tiparet sintaksore të gjuhës në përgjithësi. Për shembull, frëngjishtja, gjermanishtja apo anglishtja nuk pranojnë në asnjë rast një pozicion bosh të kryefjalës (*empty*), përveçse në fjalitë nxitëse. Rendi i ngulitur i gjymtyrëve të fjalisë në gjuhën angleze e përjashton rastin e mospërdorimit të kryefjalës në një fjali të dhënë, kurse në fjalitë nxitëse kjo kryefjalë *mungon*. Edhe në gjuhën shqipe kryefjala mungon, por *mbaresat* specifike *vetore* të mënyrës urdhërore e plotësojnë pozicionin bosh të kryefjalës. Përgjithësisht struktura sintaksore e fjalive nxitëse përmban një kryefjalë të pashprehur: \emptyset (zero) (*Absence of an overt subject*).

P.sh.: 78. \emptyset *Read the letter!* \emptyset Lexoje letrën!
79. \emptyset *Drink your beer!* \emptyset Pije birrën!

Elementi i pashprehur, pra *kryefjala zero*, ka tri karakteristika të dukshme:

- Gjendet në pozicionin e kryefjalës.
- I referohet të adresuarit ose marrësit të urdhrit.
- Interpretohet si një agjent ose veprues.

Mungesa e kryefjalës është një karakteristikë e strukturës së fjalive në të dyja gjuhët. Por gjuha angleze, si një gjuhë me rend të ngulitur, shfaq një marrëdhënie të fortë mes tri karakteristikave të sipërpërmendura. Në gjuhën shqipe mungesa e kryefjalës plotësohet me *mbaresat* flektive, të cilat shënojnë vetën e dytë njëjës ose shumës. (*Dëgjo-mbaresa zero* v. II njëjës; *dëgjo-ni* v. II shumës).

Në gjuhën angleze, pavarësisht tipit analitik që nënkupton përdorimin e detyrueshëm të një kryefjale, në fjalitë nxitëse në pjesën më të madhe të rasteve kryefjala nuk shprehet. Ajo është gjithmonë një kryefjalë e nënkuptuar (*you*) *ti / ju*, v. II, njëjës ose shumës. Theksojmë se elementi bosh që përfaqëson kryefjalën, duhet t'i referohet edhe të adresuarit dhe të marrë rolin e agjentit. Jo të gjitha fjalitë nxitëse mund të kenë një kryefjalë të shprehur që i referohet të adresuarit dhe njëkohësisht merr edhe rolin veprues në fjali. Përmendim këtu rastin e kryefjalës që i referohet vetës së tretë.

80. *Everyone / Someone complete his / their application form.*

(*Kushdo / Dikush* të plotësojë formularin e aplikimit të tij / të tyre.)

Në këtë rast kryefjala nuk i drejtohet të adresuarit, sepse ajo është e papërcaktuar (*quantificational*). Nuk i drejtohet një personi të veçantë, por një grupi njerëzish. Në këto fjali në të cilat kryefjala shprehet me përemra të pacaktuar, përdorimi i saj është i detyrueshëm. Veçojmë rastet në të cilat kryefjala është e nevojshme në fjali, në të kundërt, do të formohen fjali nxitëse jogramatikore.

A. Përdorimet me *let* + përemër në rasën kallëzore ose të ndjekur nga emra në rasën emërore.

81. *Let us leave it there, all right? / Let him leave it there. / Let the student leave it there.*

Le ta vendosim ne aty, si thua? / Le ta vendosë ai aty. / Le ta vendosë studenti aty.

B. Rastet kur në fjali agjenti (*vepruesi*) është i papërcaktuar, pra nuk veçohet nga folësi.

82. *Somebody call the police.*

Dikush të telefonojë policinë.

¹⁵¹ *Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa)*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 132.

C. Kur ligjërimi kryhet në një situatë komunikimi që nënkupton kundërshti ose kontradiktë.

83. *Will you call him? You do it.*

Do ta telefonosh atë? Ti bëje / telefonoje.

Në situata të ndryshme komunikimi kryefjala mund të shprehet me një sintagmë emërore të përdorur në mënyrë kontrastive, d.m.th. vlera kuptimore e fjalisë përkon me veprime që shprehin kontrast, kundërshti a kontradiktë, të kryera nga kryefjalët përgjegjëse të fjalive nxitëse. Elementet intonacionore luajnë një rol të rëndësishëm, sepse i radhitin në një listë sintagmat emërore në funksionin e kryefjalës dhe i referohen vetës së tretë. Këto kryefjalë zgjedhin individë apo grup individësh nga një kategori më e madhe personash.

84. *John read out his essay, Barbara develop her favorite topic and Rebecca finish the rest of grammar exercise.*

(Xhoni lexon esenë e tij, Barbara zhvillon temën e saj të preferuar dhe Rebeka mbaron pjesën e ushtrimeve gramatikore të mbetura).

Përderisa kryefjalët *John, Barbara* dhe *Rebeka* nuk i referohen vetës së dytë, ato nuk janë thirrur. Por mund të bashkëndodhen edhe me një thirrur, kur themi:

85. *Students / kids, John read out his / your essay...*

(Studentë / Fëmijë lexoni esenë tuaj.)

(Xhoni lexo / të lexojë esenë tënde / e tij.)

Përdorimi i kryefjalës është i detyruar në shumë raste për të shprehur një kuptim më të qartë, duke shfaqur në këto kontekste dhe tiparin analitik të gjuhës angleze. Në gjuhën shqipe mbarsa vetore e foljes shënon njëkohësisht edhe personin të cilit i drejtohem (pra, vetën ose dëgjuesin). Ndërsa në gjuhën angleze përdorimi i kryefjalës e përmbush këtë mungesë të shenjuesit vetor për të shprehur një urdhër të kuptueshëm, të qartë dhe të drejtuar te personi i duhur.

86. *Write the address, the student who has got it.*

(Shkruani adresën, studenti që e ka atë.)

Në raste të tjera të shprehjes së nuancave kuptimore të fjalive nxitëse përdorimi i kryefjalës nuk është i detyrueshëm. Siç theksohet edhe në studime nga autorë të ndryshëm, vërehet në shumë situata tendenca për ta përdorur kryefjalën në fjali, pra me një strukturë të njëjtë si në fjalitë dëftore, për të shprehur një kërkesë me një kontekst më të gjerë kuptimor, si përçuese të një nuance kuptimore të kërcënimit, paralajmërimit etj. Kur përemri i vetës së dytë *you (ti / ju)* në funksionin e kryefjalës përdoret në këto fjali, atëherë folësi e vendos veten në një pozicion që qëndron mbi dëgjuesin ose *ilokutorin* (vepruesin tjetër). Kryefjala e shprehur i jep fjalisë vlerën kumtuesore të nxitjes, grishjes, paralajmërimit etj.

87. *Listen, you do, go.*

(Dëgjo, ti ta bësh, jepi.)

88. *Don / t you claim to.*

(Ti mos pretendo të...)

89. *Don` t you do the same things.*

(Ti mos bëj të njëjtat gjëra... etj.)

Përfundim: Funkcioni kryesor i kryefjalës është të shënojë personin që i drejtohem dhe një grup të tillë personash. Kryefjala e fjalive nxitëse përfaqësohet nga një përemër i vetës së dytë, njëjës dhe shumës, që në shumicën e rasteve nuk shprehet. Kjo tregon se funksioni bazë i kryefjalës për të shënuar dëgjuesin, si vepruesi i dëshiruar prej tij, është i realizuar në fjalitë nxitëse. Mungesa e kryefjalës tregon se informacioni që folësi synon të japë me anë të një

fjalie nxitëse në strukturën e së cilës kryefjala mungon, është i plotë. Kur kryefjala shprehet në fjali, funksioni i saj shkon përtej shënimit të të adresuarit apo të adresuarve, por ajo mund të shprehë edhe informacion më të plotë. Si rrjedhojë, kryefjala ka edhe funksion informues apo plotësues të kumtimit të fjalisë nxitëse.

§2.3. 2. Veçori dalluese të fjalive nxitëse në gjuhën angleze me foljen *let* dhe gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe

Një lloj i veçantë i fjalive nxitëse në gjuhën angleze janë edhe fjalitë nxitëse që kanë një propozim, i cili përfshin si folësin, edhe dëgjuesin¹⁵². Quirk-u dhe Greenbaum-i pohojnë se fjalitë nxitëse me foljen *let* në gjuhën angleze formohen nga paravendosja e *let* dhe kryefjalës në rasën kallëzore¹⁵³. Në gjuhën angleze nuk ka një urdhërore të vetës së parë (që të propozojë se “unë” dhe “ti” duhet të bëjmë diçka) apo të vetës së tretë (për persona të tjerë, jo dëgjuesi). Këto kuptime të fjalive nxitëse mund të shprehen me një strukturë të ndërtuar nga *let*¹⁵⁴. Dimë se kumtimi i fjalive nxitëse i drejtohet dëgjuesit ose dëgjuesve dhe si rrjedhim i drejtohet vetës së dytë, një dukuri që tipizon fjalitë nxitëse në shumë gjuhë. Megjithatë, ngjyrimet kuptimore nxitëse mund t’i drejtohen edhe vetës së parë njëjës a shumës ose vetës së tretë me anë të një nëntipi të veçantë të paradigmës së urdhërores të ndërtuar me foljen *let*. Karakteristika kryesore që e dallon nga një fjali nxitëse e mirëfilltë është mundësia e përdorimit të disa sintagmave emërore në strukturën e fjalive nxitëse me *let* në funksionin e kryefjalës, të cilat nuk mund të përdoren në fjalitë nxitëse të mirëfillta.

Megjithatë, në lidhje me statusin dhe natyrën e fjalive me *let* ka pasur qasje të ndryshme dhe kundërshti, sepse shpeshherë folja *let* ka të njëjtat tipare si foljet e tjera në fjalitë nxitëse të mirëfillta. Costa (1972), në vështrimin e tij, e përshkruan fjalinë nxitëse me *let* si një fjali nxitëse të mirëfilltë dhe foljen *let* të ngjashme apo të perifrazueshme me foljen *lejoj* (allow).

90. *They let (allow) the children go home early.*

(Ata i lejojnë fëmijët të kthehen herët në shtëpi.)

Sipas Costa-s, efekti i shembujve të tillë është nxitje e personave të vetës së dytë për të lejuar ngjarjen e dëshiruar të ndodhë. Edhe Ukaji mban një qëndrim të ngjashëm, duke propozuar se në këto raste *folësi i lutet dëgjuesit të lejojë një grup personash, mes të cilëve bëjnë pjesë të dy, për të kryer një veprim të caktuar*¹⁵⁵.

Qëndrime të tjera e përshkruajnë foljen *let* në fjalitë nxitëse herë si pjesëz, herë si një folje modale apo folje tjetër që dallon nga kumtimi *lejoj* (allow) dhe që përdoret me një kryefjalë të nënkuptuar *ti* ose *ne*. Sipas E. Davies, të gjitha vështrimet e mësipërme nuk janë të argumentuara shkencërisht, sepse janë lënë mënjanë përfaqja e ndërtimit me *let* dhe fjalive nxitëse në përgjithësi apo jepen propozime dhe paralele që nuk ekzistojnë mes të dyja fjalive (me *let* dhe fjalive nxitëse të mirëfillta). Davies-i propozon një kategorizim të fjalive me *let* si fjali nxitëse, duke i quajtur të një lloji të veçantë, të cilat shërbejnë si plotësuese të fjalive nxitëse të mirëfillta. Veçantia dalluese e tyre qëndron në përdorimin e një sërë kryefjalësh që nuk janë gramatikusht të sakta në fjalitë nxitëse të mirëfillta¹⁵⁶.

Për sa i përket anës kuptimore që shprehin fjalitë nxitëse me *let*, mund t’i grupojmë në:
A. Fjali që kumtojnë një urdhër, një udhëzim a një kërkesë:

91. *Let her print this form.*

(Le ta printojë ajo këtë formular.)

¹⁵² D. Biber, S. Conrad, G. Leech, *Student Grammar of spoken and written English*, Longman, 2002, f. 254.

¹⁵³ R. Quirk, S. Greenbaum, *A student’s grammar of the English language*, London: Longman, 1990, f. 242.

¹⁵⁴ M. Swan, *Practical English Usage*, Oxford University Press, 2005, f. 243.

¹⁵⁵ Cituar nga E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 229.

¹⁵⁶ *Po aty*, f. 239-250.

- B. Fjali që kumtojnë një propozim që i drejtohet çiftit folës-dëgjues. Në këto përdorime folja *let* ndiqet nga përemri vetor *us*.
92. *Let's have a drink.*
(Le të pimë diçka. / Pimë diçka?)
- C. Fjali që kumtojnë një ofertë nga ana e folësit për të bërë diçka. Në këto përdorime ndiqet nga përemri vetor *me* (*mua*).
93. *Let me drive you home.*
(Le t'ju çoj unë me makinë në shtëpi. Ju shoqëroj unë me makinë në shtëpi.)
- D. Në stilin formal të gjuhës angleze fjalia nxitëse me *let* shpreh një dëshirë apo urim¹⁵⁷.
94. *Let the best man or woman win.*
(Le të fitojë më i miri. / Të fitojë më i miri.)

Jo në të gjitha kontekstet folja *let* në fjalitë nxitëse shpreh një veprim që i përfshin të dyja palët, folës-dëgjues, sepse në kontekste të ndryshme folësi kërkon një angazhim a reagim nga ana e dëgjuesit, i cili përdor fjalinë nxitëse me *let* për t'iu drejtuar dëgjuesit në mënyrë të tërthortë, duke përfshirë edhe veten.

95. *Let's be more careful.*
(Të tregojmë më shumë kujdes).

Mesazhi te fjalia 95 i drejtohet më tepër dëgjuesit, sesa të dyve së bashku. Nënteksti i kësaj thënieje është:

96. *Be more careful!*
(Ji më i kujdesshëm!) ose
97. *You should be more careful!*
(Ti duhet të tregosh më shumë kujdes!)

Një karakteristikë e veçantë e fjalive nxitëse me *let* në gjuhën angleze është se dëgjuesi në një akt komunikimi në të cilin i propozohet apo i ofrohet diçka e shprehur nga një fjali nxitëse me *let*, jo detyrimisht duhet të reagojë me një përgjigje ndaj kumtimit të mëparshëm. Kjo do të thotë që folësi propozon të kryejnë diçka së bashku dhe e merr të mirëqenë ose të pranuar nga dëgjuesi. *Ok. Let's try this.* (Në rregull. Le ta provojmë.) Këto fjali gjenden në fund të bisedës dhe trajtohen si një thënie e kuptueshme dhe e pranueshme nga të dyja palët. Kjo karakteristikë vërehet në pjesën më të madhe të përdorimeve të fjalive nxitëse me *let*, por duhet të theksojmë se në disa kontekste dallohet edhe pritshmëria për një reagim nga ana e dëgjuesit, qoftë miratim apo refuzim i kumtimit të dhënë.

98. *Let's do this tomorrow. Ok. Good idea.*
(Ta bëjmë nesër. Në rregull. Ide e mirë.)

Shpeshtësia e përdorimit të fjalive nxitëse me *let* është më e madhe krahasuar me fjalitë nxitëse të mirëfillta. *Larmia* e kuptimeve të fjalive nxitëse me *let* del në përdorimet e gjurmara në ligjërime të ndryshme. Pra, fjalitë nxitëse me *let* janë trajtuar si një lloj i veçantë i grupit të fjalive nxitëse¹⁵⁸. Në ligjërimin e folur këto lloj fjalish kanë dëndurinë më të madhe të përdorimit dhe një analizë më e hollësishme e anës semantike të tyre, e sendërtuar në disa regjistra, është trajtuar në kreun e katërt.

Nga pikëpamja strukturore kemi këto modele:

- a. (Let + me / him / her / them +infinitiv.)
(Le + përemrat vetorë të vetës së tretë: mua, atë, ata + infinitivi - folje në lidhore.)

¹⁵⁷ P. Collins, *The handbook of English Linguistics*, Blackwell Publishing Ltd, 2006, f. 204.

¹⁵⁸ H. Takahashi, *A cognitive linguistic analysis of English imperative: with special reference to Japanese imperatives*, John Benjamins, 2012, f. 25.

b. (Let + us + infinitive.)

(Le + përemri vetor i vetës së parë ne / neve + infinitivi - folje në lidhore.)

Në gjuhën shqipe gjegjësjë e fjalive nxitëse me *let* është një fjali nxitëse me foljen-kallëzues në mënyrën lidhore, e paraprirë nga pjesëza *let*, e cila edhe mund të hiqet. Le t'u referohemi shembujve 91, 92, 93, 94 [(*Le ta printojë, të pimë, të të çoj unë, të fitojë*)]. Pjesëza *le* në gjuhën shqipe përdoret para foljeve në mënyrën lidhore për të shprehur një urdhër a një udhëzim në mënyrë të zbutur. Pjesëza foljore *le* (trajtë e gjymtë e urdhërtores së foljes *le* në vetën e dytë të njëjësit), kur përdoret për ta paraqitur në formë nxitjeje, lejimi a pëlqimi veprimin e shprehur nga folësi në kohën e tashme ose të shkuar të mënyrës lidhore, e ka dobësuar thuajse plotësisht kuptimin leksikor përkatës, ka humbur theksin, funksionin sintaksor dhe kategoritë gramatikore të foljes¹⁵⁹. Po të krahasojmë fjalitë 95 dhe 96, vërejmë se fjalitë 95 shpreh një urdhër a udhëzim më të zbutur sesa kumtimi i fjalitë 96, që i drejtohet folësit në mënyrë më të drejtpërdrejtë.

99. *Le ta printojë ajo.*

100. *Ta printojë ajo.*

Përfundim: Në gjuhën angleze, fjalitë nxitëse me *let* kanë një larmi kuptimesh dhe dallohen nga fjalitë nxitëse të mirëfillta, pasi kanë një kryefjalë të shprehur me përemrin vetor, rasa kallëzore. Fjalitë nxitëse me *let* janë më të shpeshta krahasuar me fjalitë nxitëse të mirëfillta. Në gjuhën shqipe ato shprehen me një folje-kallëzues në mënyrën lidhore e paraprirë nga pjesëza *let*, e cila edhe mund të hiqet.

§2.3.3. Veçoritë dalluese të thirrorit në strukturën e fjalive nxitëse

Në strukturën e fjalive nxitëse në të dyja gjuhët vërehet përdorimi i *thirrorit* (*vocative*) në një fjali me kryefjalën. Përdorimi i thirrorit në fjalitë nxitëse shpjegohet me faktin se ai shënon personin të cilit i drejtohet ligjërimi. Thirrorët janë karakteristikë e gjuhës së folur, funksioni i të cilëve përkon me tiparet karakterizuese të fjalive nxitëse. Shpeshherë **thirrori** dhe **kryefjala** e fjalitë nxitëse mund të gjenden në të njëjtën fjali, gjë që vështirëson dallimin e funksionit që kryen sintagma emërore si kryefjalë apo thirror. Jespersen-i në lidhje me dallimin mes tyre propozon: "*dallimi mes kryefjalës dhe thirrorit është sipërfaqësor; ajo çka e bën you (ti / ju) një kryefjalë të fjalitë nxitëse në dallim nga thirrori është thjesht shpejtësia me të cilën kumtohet e gjithë thënia*"¹⁶⁰.

101. *You take the chair.*

(Ti merr karrigen.)

102. *You, take the chair.*

(Ti, merr karrigen.)

Por shembuj të tjerë në kontekste të ndryshme ligjërimore vërtetojnë se kryefjala dhe thirrori dallojnë si nga ana **formale**, ashtu dhe nga ajo **funkcionale**. Ja disa nga tiparet që i dallojnë:

A. Pauza *intonacionore* që ndodh mes sintagmës emërore të përdorur si thirror dhe pjesës tjetër të fjalitë. Nga pikëpamja drejtshkrimore shënohet me presje. Thirrori përbën një grup të veçantë intonacionor dhe shënohet apo dallohet në fjali nga toni i pavarur në ligjërim,

¹⁵⁹ Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 415.

¹⁶⁰ O. Jespersen, *A modern English Grammar on historical principles*, London, f. 184.

ngjitës-zbritës (*fall-rise*). Ndërsa kryefjala nuk veçohet as me pikësim, as me një intonacion të veçantë.

103. *John, open the door.*

(Xhon, hape derën.)

Megjithatë, jo gjithmonë mjetet prozodike janë të mjaftueshme për të bërë dallimin mes tyre:

104. *All of you, whatever you are doing, should listen to me.*

(Të gjithë, çfarëdo që jeni duke bërë, duhet të më dëgjoni mua.)

Në këtë rast kryefjala shqiptohet me një intonacion të veçantë dhe ndahet nga pjesa tjetër e fjalisë kur ndërfitet një fjali ose një gjymtyrë e veçuar.

B. *Vendi* që zënë në fjalitë nxitëse thirrori dhe kryefjala janë një tipar i rëndësishëm për të bërë dallimin. Thirrori është një gjymtyrë emërore që mund të gjendet në fillim, në mes apo në fund të fjalisë dhe pozicioni i lirë që merr në fjali e kategorizon më tepër si një rrethanor sesa si ndonjë gjymtyrë tjetër fjali¹⁶¹. Vendosja pas kallëzuesit është karakteristikë për thirrurin. Topika luan rol të rëndësishëm në gjuhët që s'kanë sistem të zhvilluar eptimi. *Vendi* i një fjale përcakton rolin e saj sintaksor¹⁶².

105. *Read the newspaper, Dave.*

(Lexo gazetën, *Dave*.)

106. *Dave, read the newspaper.*

(*Dave*, lexo gazetën.)

C. *Adresimi*. Në fjalitë nxitëse me foljen-kallëzues në vetën e tretë (në rastin e vetave të kombinuara) thirrori i përket një personi të tretë, jashtë situatës së ligjëritimit. Pra, nuk kemi bashkëpërkim të të adresuarit të thirrorit dhe agjentit të një urdhri të dhënë.

107. *Sara, let him (your brother) read the letter.*

[Sara, lëre atë (vëllanë tënd) të lexojë letrën.]

Kjo fjali shpjegon qartë se përemri vetor ose pronor (*him / your*) nuk mund t'i drejtohen dëgjuesit të shprehur nga thirrori në këtë rast. Si rrjedhim, kryefjala del si një gjymtyrë e integruar brenda fjalisë, një funksion që thirrori nuk mund ta ketë. Kërkesa që thirrori i referohet vetëm personave të adresuar nga folësi duket një kërkesë absolute, e cila nuk funksionon si e tillë për kryefjalën. P. sh.:

108. *Ejani, o shqiptarë.* (referenti nuk është i pranishëm)

D. *Kufizime* në larminë e sintagmave emërore që përmbushin këto funksione.

a. Përemri i pacaktuar *someone* (*dikush*) duket i përshtatshëm si thirrur në fund të fjalisë, por jo në fillim, kurse si kryefjalë mund të qëndrojë në fillim të fjalisë.

109. *Someone, answer the phone.*

(*Dikush*, të përgjigjet në telefon.)

Someone, answer the phone.

(*Dikush*, t'i përgjigjet telefonit.)

Answer the phone, *someone*.

(Përgjigju në telefon, *dikush*.)

¹⁶¹R. Quirk, S. Greenbaum, G. Leech, J. Svartvik, *A comprehensive Grammar of the English Language*, Longman, 1985, f. 773.

¹⁶²*Gramatika e gjuhës shqipe II*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 71.

b. *Emrat e përveçëm* përdoren më shumë si thirrurë dhe në kontekste të veçanta i gjejmë edhe si kryefjalë:

110. *Mary, bring the glasses in, will you?*
(Meri, silli gotat brenda, pra!)

111. *Take a look at this, sweetheart / you fool / idiot.*
(Hidhi një sy kësaj, zemër / ti budalla/ torollak.)

Kufizimet hasen dhe në funksionin e thirrurit, por këto sintagma foljore në funksionin e kryefjalës nuk mund të përdoren.

112. * *Sweetheart take a look at this book.*

Në gjuhën shqipe kemi një strukturë të tillë: *Zemër, hidhi një sy librit.*

113. *Sara, you go there on foot.*
(Sara, ti shko atje në këmbë.)

Megjithatë, duke pasur parasysh rendin e ngulitur të gjymtyrëve në fjali në gjuhën angleze, gjithmonë kryefjala do të paraprijë foljen-kallëzues dhe njëkohësisht kjo veçori e dallon nga thirruri¹⁶³.

Thirruri mund të gjendet në fjalitë nxitëse pa kryefjalë. I adresuari në fjali mund të shenjohe nga ana sintaksore me anë të sintagmës emërore në funksionin e thirrurit. Biberi-i analizon edhe përdorimin e thirrurit në fjalitë nxitëse pa kryefjalë.

114. *Melissa, take those things away.*
(Melisa, merri me vete ato gjërat.)

Sipas tij, në shembullin e mësipërm thirruri shenjon të adresuarin¹⁶⁴. Thirruri mund të përdoret edhe në tipat e tjerë të fjalive dhe nuk duhet t'i përgjigjet detyrimisht një argumenti, ndërsa te fjalitë nxitëse thirruri duhet t'i korrespondojë kryefjalës, sepse thirruri i referohet një të adresuari¹⁶⁵. Dallimi mes thirrurit dhe kryefjalës kushtëzohet edhe nga funksionet e ndryshme komunikuese që përmbushin secili në fjali, ku thirruri mund të shënojë: personin e adresuar, rolin, statusin apo qëndrimin e folësit etj.

Përfundim: Dallimet kryesore midis thirrurit dhe kryefjalës së përdorur në strukturën sipërfaqësore të fjalive nxitëse janë:

1. Pauza intonacionore mes thirrurit dhe pjesës tjetër të fjalisë e shënuar me presje nga ana drejtshkrimore.
2. Pozicioni që kanë në fjalinë nxitëse, thirruri në dallim nga kryefjala, mund të vendoset në fillim, në mes apo në fund të fjalisë.
3. Adresimi i kumtimit të fjalisë mund të përkojë edhe me një person jashtë situatës ligjërimore, si te thirruri.
4. Kufizime në larminë e shprehjes së sintagmës emërore në funksionin e kryefjalës apo thirrurit të fjalive nxitëse.

§2.4. Folja ndihmëse **do** me funksionin përforcues të kumtimit të fjalive nxitëse (*do-emphatic*)

Një veçori tjetër e fjalive nxitëse është edhe përdorimi i foljes ndihmëse (auxiliary *do*) për efekte theksimi, përforcimi ose të tjera funksione. Kjo është një karakteristikë e veçantë e

¹⁶³ Veçojmë këtu rastin e shprehjeve dhe formulave standarde si: *Mind you!* (Kujdes! / Ki mendjen!)

¹⁶⁴ D. Biber, S. Conrad, G. Leech, *A student grammar of spoken and written English*, Longman, 2002, f. 254.

¹⁶⁵ P. Portner, *Vocatives, Topics and Imperatives*, IMS Workshop on information structure, 2004.

gjuhës angleze. Quirk-u e emërton foljen ndihmëse *do* në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze si një shenjuese të kategorisë urdhërore¹⁶⁶. Biber-i vëren një përdorim të veçantë të operatorit theksues *do* në fjalitë nxitëse¹⁶⁷.

115. *Do believe me.*

-- folja –përemri vetor

(Beso mua/më beso mua)

Kjo fjali nxitëse në strukturën e saj përmban në pozicionin fillestar foljen ndihmëse *do*, që duket të jetë e zhveshur nga kuptimi i saj leksikor, por kryen funksionin sintaksor të përforcimit të kumtimit të thënies. Po të vërejmë *semantikën* e fjalisë, *do* shpreh një dëshirë të folësit, një kërkesë, përforcim a theksim të kryerjes së një veprimi, udhëzimi etj. Një përdorim i tillë nuk është vetëm specifikë e fjalive nxitëse në gjuhën angleze, por vihet re edhe te fjalitë dëftore, ku kumtohet një pohim, një deklaram, një konstatim më i fortë, bindës dhe më i theksuar.

116. *I do trust him.*

(Unë i besoj atij.)

117. kundrejt - *I trust him.*

Tradicionalisht *do* përshkruhet si një pjesëz theksuese që paraprin foljen-kallëzues në kohën e tashme apo në të kryerën e thjeshtë të mënyrës dëftore, për të vënë në dukje realitetin e ngjarjeve të kumtuara në fjalitë dëftore.

118. *He does know the answer.*

(Ai e di përgjigjen.)

119. *He did perform very well.*

(Ai interpretoi shumë mirë.)

Një përdorim i veçantë dhe që dallon nga gjuha shqipe, është ai i foljes-kallëzues në fjalitë nxitëse-dëshirore me foljen ndihmëse (*auxiliary-do*) në formën pohore. Këto konstrukte janë quajtur neutrale emfatike (theksuese - përforcuese).

120. *Join your friends!*

Do join your friends.

(Bashkohu me miqtë e tu).

Funksioni i *do* në fjalitë nxitëse lidhet me vënien në dukje të dëshirës së folësit për të realizuar diçka. Dëgjuesi pritët të bindet duke plotësuar një kërkesë e cila paraqitet si një mundësi e favorshme për të. Duhet të theksojmë se *do* mund të vërë në dukje të gjitha kuptimet që mund të marrë një fjali nxitëse, përveç fjalive ku folësi lëshon një urdhër ndaj të adresuarit. Mospërdorimi i *do* në krye të fjalisë e bën autoritetin e folësit para të adresuarit më të dukshëm dhe më të fortë.

121. *Do call the secretary.*

Call the secretary.

(Telefona sekretaren.)

(Telefona sekretaren.)

Në fjalinë gjegjëse në shqip theksimi i kuptimit (të telefonuarit në këtë rast) të fjalisë mund të bëhet me mjetet intonacionore apo me theksin logjik. Nuk mund të vëmë në dukje kumtimin e fjalisë me anë të përdorimit të fjalëve leksikore, siç ndodh me foljen ndihmëse *do*

¹⁶⁶ R. Quirk, S. Greenbaum, *A student's grammar of the English language*, London: Longman, 1990, f. 243.

¹⁶⁷ D. Biber, S. Conrad, G. Leech, *A student grammar of spoken and written English*, Longman, 2002, f. 139.

në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze. Mund të themi se fjalia e dytë shpreh një urdhër të mirëfilltë, që në vështrimin e folësit do të zbatohet në mënyrë të padiskutueshme. Kurse te fjalia e parë përdorimi i *do* e zbut urdhrin dhe lë të kuptohet që nuk është zbatuar apo nuk duhet zbatuar. Edhe në kumtimet e tjera përdorimi i *do* është i rregullt dhe i mundshëm.

122. *Do take your friends to the party.*

(Merrini shokët tuaj në mbrëmje.)

Do give a hug to your daughter.

(Jepi një përqaftim motrës.)

Do be sincere.

(Të jesh i sinqertë.)

Një fjali nxitëse pohore mund të jetë më bindëse dhe më detyruese nëse i shtojmë foljes-kallëzues në mënyrën urdhërore *do* me një ton theksues përpara foljes. Kjo folje ndihmëse shërben si një përforcues i kuptimit pozitiv të urdhrin. Në ligjërimin e folur dhe në anglishten e përditshme ky përdorim me kuptim bindës ngjan të jetë më tipik te femrat sesa në ligjërimin mashkullor:

123. *Oh, please, please, please do hurry!* - said the three children.

(Ju lutem, nxitoni! - thanë tre fëmijët.)

124. **Do stop** it said Susan.

(Ndaloje këtë, - tha Suzana.)

125. **Do stop grumbling**, Ed, said Susan.

(Pusho së ankuari, Edi, -tha Suzana.)

(*The lion, the witch and the wardrobe*, f. 11, 95, 45.)

Nga gjuhëtarët ka mendime të ndryshme në lidhje me funksionin, semantikën apo interpretimin e *do* në fjalitë nxitëse, krahasuar me përdorimin e *do* në fjalitë dëftore. Por i vetmi dallim mes të dyjave është se në fjalitë nxitëse *do* mund të përdoret dhe me foljet ndihmëse *to be* (jam) dhe *have* (kam), që nuk ndodh në fjalitë dëftore. Përdorimi i *do* në mohimin a theksimin e thënies me foljet ndihmëse *to be* dhe *have* përbën një prej tipareve dalluese të fjalive nxitëse në gjuhën angleze¹⁶⁸.

126. *Somebody do tidy that kitchen up, please.* (dëshira që një veprim të realizohet)

(Dikush të rregullojë kuzhinën, ju lutem.)

127. *Do try next door / do give the mobile to me.* (kërkesën ose shqetësimin për të realizuar veprimin e dhënë)

(Provo derën në krah / Ma jep mua telefonin.)

Ka shembuj të tjerë të cilët e përkufizojnë *do* në këtë tip fjalish si: insistuese, bindëse, përforcuese, theksuese etj. Në këtë rast ky përdorim dallon strukturën e fjalive angleze nga ato të gjuhës shqipe, ku nuk haset një strukturë e tillë e shprehur me një gjymtyrë të veçantë. Megjithatë, për të shprehur një funksion gjuhësor të caktuar të fjalive në gjuhën shqipe përdoren edhe mjete të tjera si: struktura tematike¹⁶⁹, rendi, intonacioni etj.

128. *Më jep adresën / adresën më jep.*

Fjalitë nxitëse karakterizohen edhe nga veçori të tjera **sintaksore**, si për shembull: përdorimi i *tag-questions* (*fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme*). “Ngjitja” e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në fund të fjalive nxitëse është një veçori sintaksore dalluese e gjuhës

¹⁶⁸ E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 7.

¹⁶⁹ Struktura tematike e thënies: nga këndvështrimi i ngarkesës komunikative, çdo thënie përbëhet nga një *temë* ose gjëja e njohur e komunikimit dhe *rema* ose gjëja e re që folësi dëshiron t’ia kumtojë dëgjuesit.

angleze. Edhe te fjalitë dëftore në gjuhën angleze vihet re përdorimi i tyre me funksione sintaksore të larmishme për kumtimin e fjalisë. Në fjalitë nxitëse kumtimi merr ngjyra të tjera afektive me përdorimin e *tag-questions* në pozicionin fundor. Në gjuhën shqipe nuk kemi fjali apo struktura gjegjëse, por përshtatja në ligjërimi të caktuara përkon me disa fjalë a togje fjalësh që shprehin edhe qëndrimin afektiv e emocional të folësit ndaj kumtimit të fjalisë. Ndërtimi strukturor, semantika kuptimore dhe funksioni që ato kryejnë në fjali do të trajtohen te kreu pasardhës.

Si përfundim, lidhur me aspektin sintaksor të fjalive nxitëse, gjuha angleze dhe gjuha shqipe shfaqin **bashkëpërkime** në disa veçori si: ana e thjeshtë formale e këtyre fjalive, mungesa e kryefjalës në pjesën më të madhe të rasteve, denduria e përdorimit në ligjërimin e përditshëm, përdorimi i thirrorit që shënon se kujt i drejtohet kumtimi etj. **Dallimet** vërehen në shprehjen morfologjike të foljes-kallëzues, në përdorimin e foljes ndihmëse si mjet përforcues i kumtimit të fjalisë, në rendin e përmbysur të fjalisë në fjalitë nxitëse-mohore, në mungesën e fleksionit kohor etj.

Si dy gjuhë **tipologjikisht** të ndryshme vërejmë dallime në disa tipare sintaksore, por edhe disa bashkëpërkime të cilat nënvizojnë idenë e universalitetit të fjalive nxitëse në përgjithësi. Qoftë në gjuhën angleze, qoftë në gjuhën shqipe, si dhe në shumë gjuhë indoevropiane fjalia nxitëse shpreh vullnetin e folësit në formë dëshire ose kërkesën për realizimin a mosrealizimin e një veprimi ose të një gjendjeje.

§2.5 Përfundime të kreut

❖ Nga krahasimi i kategorive gramatikore të diatezës, të kohës dhe të mënyrës në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze vëmë re se:

1. Gjuha shqipe përdor tri mënyra të foljeve në fjalitë nxitëse: urdhërore, lidhore dhe dëftore, kurse në gjuhën angleze përdoret vetëm forma e infinitivit, i cili merr vlerat e urdhërores.

2. Kategoria e kohës është e kufizuar si në gjuhën angleze, ashtu edhe në gjuhën shqipe, pasi ajo lidhet me shprehjen e modalitetit në fjalitë nxitëse.

3. Format e diatezës pësore përdoren rrallë në të dyja gjuhët.

4. Gjuhës shqipe i mungojnë format gramatikore të aspektit të vazhduar. Kjo mungesë plotësohet duke përdorur plotësa kohe ose fjali kohore.

❖ Nga krahasimi i fjalive nxitëse mohore në gjuhën angleze dhe shqipe vërejmë:

3. Përdorimin e operatorit mohor *don't* ose *not* (forma me *let* dhe rendin e përmbysur në fjali) në gjuhën angleze.

4. Përdorimin e pjesëzës mohore *mos* në gjuhën shqipe pa rend të përmbysur të gjymtyrëve të fjalisë.

❖ Në përmbledhje të analizës së veçorive morfologjike të fjalive nxitëse-dëshirore në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, na duhet të ritheksojmë se, pavarësisht profilit të dy gjuhëve, që tipologjikisht janë të ndryshme (anglishtja si gjuhë izoluese dhe shqipja si gjuhë flektive), vërejmë ngjashmëri në shumë dukuri morfologjike. Këtu përfshijmë kategorinë e kufizuar të kohës së foljes, vetës, aspektit, diatezës, modalitetin e mënyrës foljore, përdorimin kryesisht të mënyrës urdhërore të foljes-kallëzues etj. në fjalitë nxitëse-dëshirore. Dallimet mes të dyja gjuhëve janë të natyrshme, për vetë faktin se këto janë dy gjuhë të tipave të ndryshëm dhe përdorimi i mënyrave të tjera të foljes-kallëzues me vlerën e urdhërores (mënyra *lidhore* apo dhe *dëftore* në gjuhën shqipe), foljet modale *do + positive imperative në gjuhën angleze*, fleksioni foljor i vetave etj., shpreh qartë ekzistencën e dallimeve të dukshme dhe bashkëpërkimeve mes të dy gjuhëve.

❖ Funkzioni kryesor i kryefjalës është të shënojë personin që i drejtohem dhe një grup të tillë personash. Kryefjala e fjalive nxitëse përfaqësohet nga një përemër i vetës së dytë, njëjës dhe shumës, që në shumicën e rasteve nuk shprehet. Kjo tregon se funksioni bazë i kryefjalës për të shënuar dëgjuesin, si vepruesi i dëshiruar prej tij, është i realizuar në fjalitë nxitëse. Mungesa e kryefjalës tregon se informacioni që folësi synon të japë me anë të një fjalisë nxitëse në strukturën e së cilës kryefjala mungon, është i plotë. Kur kryefjala shprehet në fjali, funksioni i saj shkon përtej shënimit të të adresuarit apo të adresuarve, por ajo mund të shprehë edhe informacion më të plotë. Si rrjedhojë, kryefjala ka edhe funksion informues apo plotësues të kumtimit të fjalisë nxitëse.

❖ Në gjuhën angleze, fjalitë nxitëse me *let* kanë një larmi kuptimesh dhe dallohen nga fjalitë nxitëse të mirëfillta, pasi kanë një kryefjalë të shprehur me përemrin vetor, rasa kallëzore. Fjalitë nxitëse me *let* janë më të shpeshta krahasuar me fjalitë nxitëse të mirëfillta. Në gjuhën shqipe ato shprehen me një folje-kallëzues në mënyrën lidhore e paraprirë nga pjesëza *let*, e cila edhe mund të hiqet.

Dallimet kryesore midis thirrorit dhe kryefjalës së përdorur në strukturën sipërfaqësore të fjalive nxitëse janë: 1. Pauza intonacionore mes thirrorit dhe pjesës tjetër të fjalisë e shënuar me presje nga ana drejtshkrimore.

2. Pozicioni që kanë në fjalinë nxitëse, thirrori në dallim nga kryefjala, mund të vendoset në fillim, në mes apo në fund të fjalisë.

3. Adresimi i kumtimit të fjalisë mund të përkojë edhe me një person jashtë situatës ligjërimore, si te thirrori.

4. Kufizime në larminë e shprehjes së sintagmës emërore në funksionin e kryefjalës apo thirrorit të fjalive nxitëse.

❖ Për sa i përket aspektit sintaksor të fjalive nxitëse, gjuha angleze dhe gjuha shqipe shfaqin *bashkëpërkime* në disa veçori si: ana e thjeshtë formale e këtyre fjalive, mungesa e kryefjalës në pjesën më të madhe të rasteve, denduria e përdorimit në ligjërimin e përditshëm, përdorimi i thirrorit që shënon se kujt i drejtohet kumtimi etj. *Dallimet* vërehen në shprehjen morfologjike të foljes-kallëzues, në përdorimin e foljes ndihmëse si mjet përforcues i kumtimit të fjalisë, në rendin e përmbysur të fjalisë në fjalitë nxitëse-mohore, në mungesën e fleksionit kohor etj.

❖ Si dy gjuhë *tipologjikisht* të ndryshme vërejmë dallime në disa tipare sintaksore, por edhe disa bashkëpërkime të cilat nënvizojnë idenë e universalitetit të fjalive nxitëse në përgjithësi. Qoftë në gjuhën angleze, qoftë në gjuhën shqipe, si dhe në shumë gjuhë indoevropiane fjalia nxitëse shpreh vullnetin e folësit në formë dëshire ose kërkesën për realizimin a mosrealizimin e një veprimi ose të një gjendjeje.

KREU III

VEÇORITË SEMANTIKE TË FJALIVE NXITËSE NË GJUHËN ANGLEZE DHE NË GJUHËN SHQIPE

§3.1. Vështrime të ndryshme rreth anës kuptimore të fjalive nxitëse në gjuhën angleze

Për të kuptuar më mirë semantikën e fjalive nxitëse dhe urdhëroren në përgjithësi, na duhet të vërejmë përkufizimet mbi thelbin kuptimor të tyre të shpjeguar në fjalorë të ndryshëm. Termi *imperative* (urdhërore) vjen nga frëngjishtja e vjetër *imperatif* dhe në mënyrë direkte rrjedh nga gjuha latine *imperativus* (komandoj) dhe *emperor* (perandor). Etimologjia e termit "*imperative*" shpjegon më qartë semantikën e plotë të urdhërores, e lidhur ngushtë me kuptimin e urdhrit, drejtimit e kërkesës¹⁷⁰. Në fjalorin e gjuhës angleze termi *imperative* përshkruhet si "*forma e foljes që shpreh një urdhër*"¹⁷¹. Në fjalorin e gjuhës shqipe ky term përshkruhet si: "*urdhëror-e, që shpreh ose që përmban një urdhër, një kërkesë a një lutje*"¹⁷². Nga përkufizimet e mësipërme ilustron mjaft qartë fusha konceptore e urdhërores, e përbërë nga dy palë që shkëmbejnë urdhra, kërkesa dhe njëkohësisht një akt komunikimi në të cilin fjalitë nxitëse gjejnë përdorim. Të gjithë tipat e fjalive kanë të përbashkët përmbajtjen kuptimore, forcën shprehëse dhe mënyrën foljore përkatëse, të cilat paraqesin fushën e semantikës. Larmia e përdorimit të urdhërores në kontekste të ndryshme komunikative është e lidhur në mënyrë të ndërsjellë me rregullat sociale të cilat drejtojnë ndërveprimet gjuhësore midis folësve të një gjuhe. Zgjedhjet gjuhësore të folësve në situata të ndryshme mbartin me vete kuptime sociale dhe identifikime që anëtarët e bashkësisë dinë t'i interpretojnë¹⁷³.

Njësitë minimale të komunikimit njerëzor janë akte ligjërimit të përkufizuara si akte *ilokutore*. Sa herë që një folës kumton një thënie në një kontekst të duhur me qëllime të caktuara komunikimi, atëherë themi se ai realizon një ose disa akte ilokutore. Një akt *ilokutor* i tillë është i ndërtuar nga dy komponentë: nga forca ilokutore dhe përmbajtja e kumtimit. Forca ilokutore, si një komponent i kumtimit të fjalisë, realizohet në strukturën sintaksore të gjuhëve të ndryshme me një varg mënyrash si: kategoria gramatikore e mënyrës, theksi, intonacioni, rendi i gjymtyrëve etj.

Gramatikanët e viteve 1930-1960 e kanë përshkruar dallimin mes tipave të ndryshëm të fjalive në lidhje me "mënyrën" ose me qëndrimin e folësit ndaj ngjarjes a situatës së dhënë. Për të dhënë një përkufizim të plotë të kumtimit që përmbajnë fjalitë nxitëse, ata janë përqendruar në dy drejtime: çfarë kumton dhe ç'funksion kryen thënia. Jespersen-i (1954) shprehet kështu mbi kuptimin e fjalive nxitëse: "*kuptimi i vërtetë i fjalisë nxitëse është një kërkesë (e vrazhdë ose modeste) ndaj dëgjuesit për të bërë diçka*". Curme (1931) pohon: "*Urdhërorja është mënyra e urdhrit, kërkesës, qortimit, lutjes, paralajmërimit, ndalimit*"¹⁷⁴. Nëse do të përdorim teorinë e Austin (1962) për të përkufizuar fjalitë nxitëse dhe mënyrën urdhërore, pra *teorinë e akteve të ligjërimit* (e cila është plotësisht e përshtatshme në shpjegimin e aspektit kuptimor të fjalive nxitëse), atëherë do të themi se folësi realizon akte

¹⁷⁰ *The Concise Oxford Dictionary of current English*, H. W. Fowler, F. G. Fowler, f. 407.

¹⁷¹ *Oxford Advanced Learner's Dictionary*, Oxford University Press, 2004, f. 649.

¹⁷² *Fjalori i Shqipes së Sotme Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 1409.

¹⁷³ R. Manzini, *Leksione të pabotuara*.

¹⁷⁴ Cituar nga E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 30-31.

ilokutore në kumtimin e një thënieje nxitëse. Ky akt ligjërimit që përfshin folësin dhe dëgjuesin (i adresuari), kryhet në tre aspekte komunikimi dhe ka një strukturë semantike treplanëshe të tillë: *Plani i kërkesës a urdhrit. / Plani i komunikimit. / Plani i situatës së urdhëruar*¹⁷⁵. Si rrjedhojë, analiza e një akti komunikimi duhet të përqendrohet në këta komponentë të rëndësishëm të saj.

Kjo strukturë semantike vepron në të gjitha kuptimet që mund të marrë fjalia nxitëse në situata të ndryshme ligjërimore. Në një akt komunikimi, ku kumtohet një thënie nxitëse, folësi dëshiron të realizojë diçka nëpërmjet dhënies a lëshimit të një urdhri ndaj një personi tjetër, dëgjuesit ose të adresuarit, i cili pritet të kryejë veprimin e urdhëruar dhe të dëshiruar, pra të pajtohet dhe të zbatojë direktivën e marrë. Pra, fjalitë nxitëse kumtojnë kërkesa ose urdhra për dëgjuesin. Megjithatë, vetëm termi *kërkesë* apo *urdhër* nuk mund të përmbushë gjithë strukturën semantike të urdhërores, sepse në situata të caktuara ligjërimore këto fjali e zgjerojnë kumtimin e tyre. Fjalitë nxitëse, me një semantikë të gjerë dhe të larmishme, përshkruhen më qartë me termin *direktivë* (*directive*), në të cilën përfshihen pothuajse ngjyrimet kryesore kuptimore që kjo fjali mund të kumtojë në kontekste të ndryshme.

Një teori tjetër mbi paraqitjen e plotë të *vlerës semantike* të fjalive nxitëse është analiza *përshkruese* e përqafuar nga *shkolla semantike gjenerativiste* në fillim të viteve 70^{-të}, ku shfaqet një dakordësi nga gjithë gjuhëtarët e kohës në lidhje me larminë e forcës ilokutore që mbartin semantikën e gjithë tipave të fjalive. Fjalitë nxitëse janë trajtuar si një rast i veçantë për sa i përket marrëdhënies midis *kuptimit* dhe *forcës* që ato përdorin. Ato gjithmonë paraqesin akte ligjërimit të drejtpërdrejta dhe përforcojnë idenë se ka një marrëdhënie shumë të ngushtë mes kuptimit dhe forcës ilokutore që mbart kjo fjali në ligjërimit.

Pra, sipas konceptimit nga ana e tyre, të gjithë tipat e fjalive të klasifikuara në bazë të kumtimin që përçojnë në ligjërimit, janë semantikisht të specifikuar, në mënyrë që të shprehin një forcë ilokutore të caktuar: për të kumtuar një pyetje, një premtim, një këshillë, një urdhër, një pohim etj. Por jo domosdoshmërisht në çdo kontekst gjuhësor një fjali do të gjejë përdorim vetëm për të shprehur një forcë ilokutore të caktuar, pra duke iu përmbajtur përshkrimit semantik të saj. Kjo nënkupton se fjalitë dëftore, pyetëse a nxitëse-dëshirore në shumë raste mund të përcjellin një forcë ilokutore shprehëse të ndryshme nga semantika specifike e tyre.

Qasjet e studiuesve mbi fjalitë nxitëse kanë qenë të ndryshme, por përgjithësisht përcaktimet e tyre përkujtojnë në kumtimin bazë që shprehin fjalitë nxitëse: *kuptim drejtues* e *urdhërues* (*directive meaning*). Kjo nënkupton që veçantia tipike e urdhërores qëndron te përdorimi i saj në një funksion drejtues dhe urdhërues, ku një person i dytë (i adresuari) “*urdhërohet*” të ndërmarrë një veprim të caktuar. Teoritë e akteve të ligjërimit e shpjegojnë kumtimin drejtues me anë të konceptit *forcë*, *forcën shprehëse* të urdhërores në realizimin e akteve të komunikimit. Tiparet dhe sjellja sintaksore e *shënuesit të forcës* shfaqen në strukturën sintaksore të fjalive nxitëse. Këto dukuri sintaksore shpjegojnë dhe disa nga veçoritë tipike sintaksore të fjalitë nxitëse. Vërejmë disa nga qasjet e studiuesve më në zë mbi semantikën e fjalive nxitëse dhe realizimin e një kumtimi të tillë nga ana formale gramatikore.

Sipas Paul Portner, dy përbërësit themelorë të kumtimin që duhet të jenë të pranishëm në një fjali nxitëse, lidhen me: drejtimin e kumtimin të thënies ndaj një personi tjetër (dëgjuesi) dhe praninë e një tipari që duhet t’i bashkëngjitet listës së dëgjuesit (*to-do-list*)¹⁷⁶. Kjo listë lidhet me teorinë e tij të *listës së kërkesave* (*to-do-list*), sipas së cilës nga ana konceptuale dhe funksionale një fjali nxitëse nuk kumton gjë tjetër, veçse i shton një kërkesë listës së kërkesave të bëra nga folësi.

¹⁷⁵ V. S. Xrakovskij, *Typology of imperative constructions*, Lincom Europa, 2001, f. 5.

¹⁷⁶ P. Portner, *Imperatives and Modals*, *Natural Language Semantics*, 15(4), 351-383.

Zanuttini në mënyrë metaforike i shpjegon komponentët e semantikës së fjalive nxitëse në përgjithësi si *një listë me një rend të caktuar detyrash*, veprimesh, aktivitetesh, që të gjithë individët e mbajnë me “vete” në jetën e përditshme:

1. *Promptly get up in the morning.*
(Çohu shpejt në mëngjes.)
2. *Make breakfast.*
(Përgatit mëngjesin.)
3. *Take the kids to school.*
(Shoqëroji fëmijët në shkollë.)
4. *Work.*
(Puno.)
5. *Exercise.*
(Bëj ushtrime.)

Në këtë mënyrë kjo listë vijon më tej për të gjithë individët¹⁷⁷. Mënyra urdhërore e foljes-kallëzues në fjalitë nxitëse pasuron ose shton të tjerë “artikuj” në këtë listë kërkesash të individit, e cila duhet të “përditësohet” në mënyrë të vazhdueshme.

Paul Portner-i është një nga studiuesit më në zë që ka bërë si objekt analize dhe sinteze semantikën e fjalive nxitëse nën këndvështrimin e semantikës formale gjenerativiste. Ai u rikthehet herë pas here tezave të paraqitura në punimet e para të tij, duke i pasuruar dhe analizuar më tej ato të mëparshmet. Ne pajtohemi me mendimet e tij në lidhje me koncepte si “*informacioni i përbashkët, lista e kërkesave, planet e përcaktuara*” etj. Konceptin e *listës së kërkesave* Portner e shpjegon me konceptin e *common ground*, pra “informacioni i përbashkët”. Me termin *common ground* Clark-u (1996) emërton informacionin e përbashkët që folësi dhe dëgjuesi duhet të kenë. Për të dalluar elementet në një thënie të caktuar, është e nevojshme që dyshja folës-dëgjues të kenë ose të ndajnë këtë *informacion të përbashkët*¹⁷⁸. Rolet që luajnë *to-do-list* dhe *common ground* i bëjnë këto dy koncepte të semantikës së fjalive nxitëse ngushtësisht të lidhura. *Informacioni i përbashkët* krijon një bazë të “mundësive të drejtpërdrejta”, pra realitete të mundshme dhe që mund të jenë të vërteta për sa i përket pjesëmarrësve në bashkëbisedimin ndërveprues. Në këtë mënyrë lista e kërkesave të një individi i rendit mundësitë në përputhje me *informacionin e përbashkët*, duke i kategorizuar disa si më të pëlqyeshme se të tjerat¹⁷⁹.

Ndërsa Portner-i (2007) i paraqet fjalitë nxitëse si fjali ku tiparet modale mungojnë. Krahasimin mes fjalive nxitëse dhe modaleve bazë ai e shtrin në burimin renditës (*ordering source*). Ky burim renditës i modaleve bazë i vendos pohimet dhe thëniet sipas një standardi: ligjet, rregullat (deontic); dëshirat, urimet (bouletic) dhe synimet (teleological). Radhitja e tyre në kumtimin e fjalive nxitëse bëhet duke u mbështetur në një kriter që Portner-i e quan si kriterin më të përshtatshëm në *listën e kërkesave (to-do list)*, një sërë veprimesh që i adresuari merr përsipër ose angazhohet të kryejë. Nuancat kuptimore që marrin fjalitë nxitëse mund të shpjegohen duke konsideruar se çdo pjesëmarrës në një akt ligjërimit zotëron një shumëfish të *listës së kërkesave*, të cilat mund të grupohen në kategori të tilla si: një pjesë përfshijne urdhra, një pjesë dëshira, qëllime e kështu me radhë shtrihen kuptimet e larmishme të fjalive nxitëse në kontekste të ndryshme. Ky konceptim tregon një ngjashmëri mes tipareve semantike të fjalive nxitëse dhe kuptimeve të foljeve modale (*priority modals*). Portner-i e

¹⁷⁷ R. Zanuttini, *Addressing the addressee in imperatives*, Georgetown University, 2005.

¹⁷⁸ Cituar nga Ch. W. Kreidler, *Introducing English semantics*, Routledge, 1998, f. 23.

¹⁷⁹ P. Portner, *The semantics of imperative within a theory of clause*, Proceedings of Semantics and Linguistic Theory, XIV, CLC publications, 2004, f. 241.

evidenton këtë bashkëpërkim kuptimor, por mendon se asnjëherë nuk duhet të shkrihen modalet brenda fjalive nxitëse. Sipas tij, urdhërorja nuk mund të përcaktohet si modale dhe e argumenton qëndrimin e tij në dy veçori që i largojnë këto dukuri gramatikore¹⁸⁰.

Daniela Isac, në analizën e semantikës së fjalive nxitëse në gjuhën angleze, thekson se fjalitë nxitëse shprehin ngjyrimet e modalitetit. Sa i përket modalitetit të fjalive nxitëse dhe kumtimit që këto fjali shprehin, Isac thekson se koncepti i burimit të urdhrit (*ordering source*) e përcakton marrëdhënien e ndërsjellë. Pra, burimi i urdhrit u jep vlerën modale kumtimeve të fjalive nxitëse. Në këtë kontekst, Portner-i (2004, 2007) propozon se kriteri i përshtatshëm në këtë rast është lista e kërkesave të dëgjuesit, si një sërë veprimesh që ai angazhohet të kryejë. Isac pajtohet me idetë e Portner-it mbi konceptin e *to-do-list*, duke theksuar se kumtimet e fjalive nxitëse që marrin vlerë modale do të caktohen në varësi të suksesit që një individ arrin në kryerjen e një veprimi që ka ndërmarrë. Ngjyrimet e larmishme kuptimore të fjalitë nxitëse mund të shpjegohen me faktin se secili pjesëmarrës në bisedë ka lista të shumta kërkesash ose duke supozuar se këto lista janë të ndara në grupe: një pjesë që përfshijnë urdhrat, një tjetër përmban dëshirat, tjetra synimet¹⁸¹ etj.

Daniela Isac ka një qasje të kundërt me Portner-in mbi marrëdhënien e fjalive nxitëse (urdhëroren) dhe modalitetit. Ajo shton dy veçori të tjera të foljeve modale:

a. *Qasje* e realitetit (*actuality entailment*), që tregon se ngjarja e shprehur nga fjalitë me folje modale përmban elemente të aktualitetit që lidhen me botën reale.

b. *Interpretimet* kohore (*temporal interpretations*), që nënkuptojnë elemente të kategorisë së kohës.

Fjalitë me folje modale mund të shprehin dhe veprime që i përkasin kohës së shkuar, pra para çastit të ligjëritimit. Te fjalitë nxitëse referenca kohore lidhet gjithmonë me çastin e ligjëritimit dhe pas tij. E parë në aspektin logjik, një fjali nxitëse kumton një direktivë ndaj të adresuarit, i cili duhet ta përmbushë në çastin e ligjëritimit ose pas këtij çasti dhe një direktivë që i përket çastit të së shkuarës. Sipas saj, veçoritë që i dallojnë fjalitë nxitëse nga foljet modale nuk nënkuptojnë mungesën e plotë të modalitetit, por në këtë rast kemi vetëm një lloj tjetër të modalitetit. Pra, Isac shfaq edhe ide të reja që bien ndesh me pikëpamjet e Portner-it për modalitetin.

Kaufman-i dhe Portner-i janë dy nga studiuesit më të spikatur të semantikës formale dhe hulumtimi i tyre mbi interpretimin e semantikës së fjalive nxitëse ka qenë një progres në spektrin e studimeve mbi këto fjali. Sipas Kaufman-it, kuptimi drejtues i fjalive nxitëse është një pohim modal, i cili i shtohet *informacionit të përbashkët* (common ground). Kjo tregon se një fjali nxitëse ku urdhërohet të kryehet diçka, mund të përmbajë një kuptim modal si:

6. *You clean the room.*

(Ti pastro dhomën.)

7. *You should clean the room.*

(Ti duhet të pastrosh dhomën).

Pra, fjalitë nxitëse mund të shihen më mirë në aspektin e modalitetit. Për Kaufman-in (2012),¹⁸² urdhërorja në gjuhë si anglishtja mund të shtjellohet me anë të dy komponentëve që përbëjnë semantikën e saj: komponenti *modal* dhe komponenti *performativ*. Fjalja 7, *You should clean the room*, përveç tiparit të drejtimit, ka edhe tiparin performues dhe jo atë

¹⁸⁰ Cituar nga Daniela Isac, *Imperatives are modal*, Bucharest Working Papers in Linguistics, Volume 14, Nr. 2, f. 41-56.

¹⁸¹ *Po aty*, f. 44-45.

¹⁸² D. Medeiros, *Formal approaches to the syntax and semantics of imperatives*, Dissertation, University of Michigan, 2013, f. 7.

përshkrues. Dallimet mes fjalive nxitëse dhe fjalive me folje modale mund të vërehen në këto drejtime:

A. Kuptimi bazë i urdhërores nuk mund të interpretohet si i vërtetë apo i pavërtetë, gjë që nuk ndodh me fjalitë me folje modale. Fjalitë nxitëse nuk mund t'i nënshtrohen testit të vërtetësisë, ashtu si llojet e tjera të fjalive.

B. Kryefjala në fjalitë nxitëse është e orientuar të shënojë tipare të vetës së dytë dhe kufizohet në veprimet e të adresuarit. Te fjalitë me folje modale, kryefjalët u përkasin vetave të ndryshme dhe u referohen veprimeve të gjithfarë kryefjalësh.

Sipas Mastop-it, në qasjen e tij mbi semantikën e fjalive nxitëse, ai thekson se koncepti i semantikës së këtyre fjalive është lënë në “qetësi” në vitet e fundit, por pas viteve 1990 kjo çështje është trajtuar në literaturën gjuhësore. Disa nga këto studime të analizës sintaksore të fjalive nxitëse tregojnë se përdorimi i tyre në bashkëbisedime (forca shprehëse e drejtpërdrejtë, Searle, 1979) kodohet apo lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shprehjen gramatikore (Han, 1998), ndërsa të tjera qasje shpjegojnë se shprehja formale nuk e kodon përdorimin në bashkëbisedime. Ana formale e fjalisë kodon një përmbajtje semantike të veçantë, e cila sjell një gamë të larmishme të përdorimeve në bashkëbisedime (Wilson and Sperber, 1988; Portner, 2003)¹⁸³. Mastop ka bërë një analizë shkencore bindëse për kuptimin e fjalive nxitëse duke theksuar se qëllimi i semantikës së këtyre fjalive nuk është thjesht të na paraqesë një semantikë të tyre. Semantika duhet të shpjegojë disa prej tipareve dhe mundësive intriguese, në mënyrë që të kemi një shkallë më të lartë të të kuptuarit të kuptimeve gjuhësore në përgjithësi. Teoria që paraqet Mastop-i lidhet me përgjigjet ndaj debateve të ndryshme në lidhje me praninë e “logjikës të fjalitë nxitëse”, pra nëse te këto fjali e zbatojmë kriterin e vërtetësisë ose jo¹⁸⁴.

Pikëpamjet tona në lidhje me semantikën e fjalive nxitëse përputhen me ato të Mastop-it.

Në analizën e semantikës së fjalive nxitëse Starr-i thekson se kjo analizë nuk duhet kuptuar në aspektin se çfarë fjalia tregon ose shpreh, por në lidhje me efektin karakteristik që ka mbi qëndrimet e vepruesve (folësi-dëgjues). Pra, kuptimi i fjalive nxitëse duhet të ndryshojë preferencat e ndërsjella të agjentëve për t'i shërbyer qëllimit të bisedës¹⁸⁵.

Han, Rivero dhe Terzi¹⁸⁶ kanë përqaftuar idenë e *operatorit urdhërues*, i cili është i pranishëm te fjalitë nxitëse duke drejtuar sintaksën e fjalive dhe njëkohësisht duke shënuar dhe aktin e ligjërimit të realizuar (akte ligjërimit që kryhen nga një fjali nxitëse: urdhër, komandë etj.). Pra, operatori urdhërues, si mbartës i forcës urdhëruese në fjali, përlligj strukturën e veçantë sintaksore të fjalive nxitëse. Kjo mund të ilustruhet me një fjali në gjuhën italiane, ku nuk mund të japim fjalinë mohore gjegjëse të një fjalie nxitëse, duke shtuar pjesëzën mohuese *non*.

8. *Manga! / Non mangiare!* (Ha! / Mos ha!)

Në vend të saj në fjali përdoret forma e infinitivit dhe me këtë formë foljore mund të shprehim aktin e ligjërimit që folësi dëshiron të realizojë. Kjo dukuri gjuhësore është e pranishme dhe në gjuhën shqipe, ku folja-kallëzues mund të shprehet me një folje në mënyrën dëftore apo lidhore, duke kryer në këtë mënyrë një akt ligjërimit të kërkesës ose urdhrit.

9. *Të lexoni* sa më shumë.

¹⁸³ R. Mastop, *What can you do? Imperative mood and semantic theory*, PhD dissertation, Amsterdam: ILLC, 2005, f. 2.

¹⁸⁴ *Po aty*, f. 6.

¹⁸⁵ W. Starr, *A preference semantics for imperatives*, Dissertation, 2010, Kapitulli IV, f. 1-4.

¹⁸⁶ Ch. Han, *The structure and interpretation of imperatives*, Garland publishings, Inc, 2000, f. 130.

10. *Shkojmë!*

Po kështu ndodh në greqisht, ku fjalia nxitëse mohore shprehet formalisht me një folje në mënyrën dëftore dhe tregon aktin e ligjërimit të synuar prej folësit.

11. *Mi milas! / Mi milate! (Esi-milas- Ti flet.) (Esis – milate – Ju flisni.) (Mos fol / Mos flisni!)*

Të gjitha këto tregojnë se nuk mund të kemi një lidhje të ndërsjellë mes formës foljore gramatikore dhe aktit të ligjërimit përkatës të urdhërores. Te shembulli gjegjës në shqip dallojmë se forca e fjalive (këshillë në këtë rast) nuk mund të shprehet vetëm me një folje në mënyrën urdhërore, por edhe në mënyrën lidhore a dëftore. Han-i, në analizën e interpretimeve të semantikës së fjalive nxitëse që mund të shfaqë një akt komunikimi i karakterizuar nga një forcë shprehëse, përdor konceptin e *Plan Set* (plane të përcaktuara), si një modul i ligjërimit që i përket të adresuarit. Sipas Han-it, në realizimin e aktit të ligjërimit folësi udhëzon të adresuarin për të “përditësuar” synimet e tij të emërtuara si *Plan Set*¹⁸⁷. Për të adresuarin, koncepti i *Plan Set* përmban një sërë pohimesh ku specifikohen synimet e tij, të cilat përfaqësojnë gjendjen e gjërave që ai do të krijojë apo do të sjellë. Pra, funksioni në ligjërimit i një fjalie nxitëse është një udhëzim i folësit që i drejtohet të adresuarit për të shtuar një *pohim* (proposition) në *planin e përcaktuar* (Plan Set). I adresuari në këtë akt ligjërimit është planifikuesi. Folësi në këtë rast beson në aftësinë e tij për të realizuar këtë plan. Ky konceptim i Han-it shpjegon edhe disa veçori të urdhërores të përmenduar më herët si: kryefjala përkon me të adresuarin, koha e realizimit të këtij plani është në të ardhmen, pas çastit të ligjërimit dhe është forca drejtuese shprehëse e saj.

§3.2. Veçoritë semantike të fjalive nxitëse në gjuhën angleze

Duke analizuar këto përcaktime dhe përkufizime kuptojmë veçoritë kryesore semantike që karakterizojnë fjalitë nxitëse: kumtimi i tyre kryen një akt komunikimi që përfshin dy palë: folësi (i cili kërkon, urdhëron, drejton etj.) dhe dëgjuesi (i cili pritet të reagojë, të veprojë dhe të përmbushë detyrat e ngarkuara). Ky akt duhet të përmbajë po ashtu listën e kërkesave (*to-do-list*). Komunikimi i dyanshëm përvijohet nga tiparet e listës së kërkesave, të cilat përbëjnë thelbin kuptimor të kumtimit të thënies. Urdhërorja jo domosdoshmërisht ka parakushte. Ajo shërben për të zgjeruar më shumë konceptin e *to-do-list*, të shpjeguar nga Portner-i, si i kushtëzuar nga konteksti. Pra, konteksti në të cilin gjejnë përdorim këto kërkesa u jep atyre vlerën kuptimore¹⁸⁸.

12. *I would like a cola.*

(Do të dëshiroja / do të doja një kola.)

Kjo fjali e shkëputur nga një ligjërimit i caktuar është një akt direkt i pohimit, informimit, ndërsa në një kontekst tjetër kjo thënie mund të interpretohet si një akt i tërthortë i kërkesës, ku i adresuari duhet në këtë rast të sigurojë një pije për folësin. Pra, thënia kumton një nuancë kuptimore të një kërkesë etj. Fjali të tilla kumtojnë thënie me një larmi kuptimore dhe krijojnë hapësira interpretimi të ndryshme. Interpretimet e ndryshme që mund të marrin thënie të caktuara vënë në dukje rëndësinë e kontekstit të bisedës dhe të pjesëmarrësve në këtë ligjërimit.

¹⁸⁷ Cituar nga *Semantics, An international handbook of natural Language meaning*, Volume 2, Walter de Gruyter, 2011, f. 1793-1794.

¹⁸⁸ R. Mastop, *What can you do? Imperative mood in semantic theory*, 2005, f. 5-6.

Searle-i (1969), si një nga përfaqësuesit e shkollës semantike gjenerativiste, me teorinë e kuptimit të fjalisë thekson se një fjali nxitëse (si fjalia 13) nuk mund të kumtojë të njëjtën thënie në të njëjtin kontekst krahasuar me fjalinë gjegjëse dëftore 14.

13. *Please, help me tomorrow.*
(Ju lutem më ndihmo/ni nesër.)
14. *You will help me tomorrow.*
(Ti do të më ndihmosh nesër¹⁸⁹.)

Pra, edhe pse të dyja fjalitë nga ana semantike tregojnë një situatë të ngjashme kuptimore, nga këndvështrimi i dëgjuesit ose i lexuesit, mund të themi se personi në një akt ligjërimi të tillë do të ndihmojë në një situatë të caktuar. E parë në këndvështrimin e pjesëmarrësve në këtë komunikim kemi një kërkesë ose një lutje për ndihmë nga ana folësit dhe një pohim ose një informim në rastin e fjalisë së dytë.

Fjalia nxitëse ka një marrëdhënie të fortë mes kuptimit të saj dhe forcës ilokutore me të cilën shprehet, një marrëdhënie më e fortë krahasuar me tipat e tjerë të fjalisë. Forma logjike e fjalive nxitëse përfshin dy komponentë: një që përmban forcë shprehëse *direkte* (si një udhëzim për dëgjuesin për të ndryshuar një model të dhënë), si dhe një tjetër që shpreh modalitetin e një interpretimi të *parealizuar*. Prandaj forca *urdhëruese* ose *shprehëse* në fjalitë nxitëse nuk pasqyrohet vetëm në përmbajtjen semantike të saj dhe nga situatat komunikative ku gjen përdorim, por në mënyrë direkte kodohet nga forma logjike.

Modaliteti i fjalive nxitëse-dëshirore shpjegon edhe një semantikë të gjerë të këtyre fjalive. Forca urdhëruese apo drejtuese (*directive force*) që fjalitë nxitëse përmbajnë, bën që ato të gjejnë përdorim në një gamë të gjerë të akteve komunikuese shprehëse. Forca shprehëse lidhet me autoritetin që shfaq folësi dhe me situatën kontekstuale ku zhvillohet një ligjërim me nuancë urdhri. Larmia e nuancave kuptimore tregon një lidhje të ngushtë mes anës thelbësore kuptimore të fjalive nxitëse me anën pragmatike, e cila ka të bëjë me situatën konkrete ku këto përdoren. Përbërësit semantikë të këtyre fjalive mund të kushtëzohen dhe nga kuptimi i *kallëzuesit*, *statusi a pozicioni i vepruesit*, *veta* dhe lloji i *marrëdhënieve* mes pjesëmarrësve në situata të ndryshme komunikimi. Fusha kuptimore e fjalive nxitëse ka një shtrirje të gjerë dhe të larmishme, si më poshtë:

A. *Urdhër, komandë:*

15. *Go to your room*¹⁹⁰.
(Shko në dhomën tënde.)

B. *Kërkesë, lutje:*

16. *Kindly leave the room / Open the door, will you*¹⁹¹? So, tell us¹⁹².
(Mund të largoheni nga dhoma / Hapeni derën. Mund ta hapni derën? Na trego, pra.)

C. *Ndalim / moslejim:*

17. *Don't smoke!*
(Mos pi / pini duhan!)

¹⁸⁹ Cituar nga D. Vanderveken, *Searle on meaning and action, Speech acts*, Mind and Social Reality discussions with Searle, 2002, f. 141-161.

¹⁹⁰ S. Beauman, *Destiny*, f. 795.

¹⁹¹ Përshtatja e *tag-questions* në gjuhën shqipe krijon vështirësi në dhënien e një përkthimi literal, për arsye se nuk ekzistojnë ndërtime të tilla fundore në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe. Strukturat gjegjëse jepen më poshtë.

¹⁹² *Po aty*, f. 796.

D. *Këshillë / rekomandim / paralajmërim:*

18. *Lock the door before you leave.*
(Kyçe derën para se të ikësh.)
19. *Mind the steps!*
(Kujdes nga shkallët!)

E. *Propozime:*

20. *Let's propose him our plan.*
(Le t'i propozojmë atij planin tonë.)

F. *Udhëzim:*

21. *Turn left.*
(Kthehu / kthehuni majtas.)
22. *Carefully remove the lid....* (Remove the lid *carefully*.)
(Hiqni kapakun me kujdes.)

G. *Pranim:*

23. *Well, join us if you want to.*
(Eja me ne nëse dëshiron.)

H. *Refuzim mosbesues:*

24. *Come on! You don't really mean that.*
(Eja, hë, pra! Nuk e ke me gjithë mend.)

I. *Ftesë:*

25. *Take a seat and have a look at our photos.*
(Ulu dhe hidhu një sy fotove.)
26. *Come in.*
(Hyr.)

J. *Lejim:*

27. *Take as many as you like.*
(Merr sa të duash.)

K. *Ofertë:*

28. *Have a glass of wine.*
(Pi një gotë verë.)

L. *Urim:*

29. *Have a nice time.*
(Ia kalofsh mirë.)

M. *Mallkim:*

30. *Go to hell!*
(Vafsh në djall!)

N. *Mosbesim:*

31. *Let me have a look.*
(Le t'i hedh një sy.)

O. Udhëzime dhe direktiva shpjeguese:

32. Read the newspaper article and match the paragraphs with these sections of the story.
(Lexoni këtë artikull gazete dhe përshtatini paragrafët me këto pjesë të tregimit.)
33. Consult the wikipedia for more information.
(Konsultoni wikipedia-n për më shumë informacion.)

Whitney (1924) i përkufizon fjalitë nxitëse që shënojnë një urdhër si një përpjekje e vullnetit të folësit të ushtruar ndaj dikujt tjetër. Kjo, megjithatë (në sanskritishte ashtu si në gjuhët e tjera), nuk bart të njëjtën forcë shprehëse: urdhri shkon drejt një kërkesë, një këshille, një lutjeje, drejt shprehjes së dëshirës së singertë¹⁹³. Aikhenvald-i (2010) në studimin e saj mbi urdhëroren, që lidhet ngushtësisht me thelbin kuptimor të saj, thekson se kuptimi i urdhërores dhe fjalive nxitëse nënkupton ose kumton një thënie urdhëruese. Por, termi urdhër është konceptuar si një term shumëkuptimësh. E parë në aspektin e shtrirjes së gjerë të nuancave kuptimore, urdhrat përfshijnë kuptimet nga kahu fillestar i vlerës kuptimore (urdhër, kërkesë, këshillë) deri te nuancat kuptimore në skajin tjetër (urim, mallkim, dëshirë etj.).

Ky përcaktim i urdhërores me termin urdhër nuk e mbulon gjithë gamën e kuptimeve të fjalive nxitëse në ligjërimi të caktuara. Mënyra urdhërore është kategoria e foljes që e shpreh më së miri një urdhër nëpërmjet kumtimit të drejtpërdrejtë të thënies. *Urdhërorja është një kategori e gjuhës, kurse urdhrat janë një parametër në botën e vërtetë*¹⁹⁴. Kjo shpjegon edhe lidhjen mes urdhrave dhe urdhërores. Gjuhë të ndryshme në botë shfaqin mjete të kufizuara ose të përcaktuara për të kumtuar një thënie nxitëse. Mundësitë për të dhënë një urdhër janë të shumta. Larmia e kuptimeve që mund të shprehin fjalitë nxitëse në kontekste të ndryshme është e madhe, por shembujt e mësipërm përbëjnë përdorimet që hasen rëndom në ligjërimin e folur dhe të shkruar. Le të analizojmë më me hollësi *fushat* e ndryshme kuptimore të fjalive nxitëse:

Urdhrat. Në fjalitë nxitëse ku kumtohet një komandë, folësi jep një urdhër ndaj të adresuarit, i cili duhet ta përmbushë atë. Në këto fjali nxitëse shprehet *domosdoshmëria* e kryerjes a mospërmbushjes së një veprimi ose gjendjeje të dhënë e lidhur me folësin. Mjedisi social në të cilin urdhrat gjejnë më shumë përdorim lidhet me situata ku kemi marrëdhënie hierarkie sociale, një marrëdhënie ku palët zotërojnë një status social të ndryshëm, si ajo mes drejtuesit dhe vartësit. Kuptimi i mënyrës urdhërore të foljes-kallëzues në këto fjali varet nga shkalla e intensitetit të urdhrit të dhënë. Forca e urdhrit lidhet ngushtësisht me autoritetin që zotëron folësi (drejtuesi në këtë rast) dhe një urdhër i fuqishëm e i prerë rrjedhimisht pasqyron një autoritet më të lartë, një drejtues autoritar dhe urdhërues. Autoriteti i drejtuesit, këmbëngulja, shkalla e urdhrit të dhënë dhe kërkesa për ta përmbushur atë, lidhen me shprehjen e marrëdhënieve ndërpersonale të krijuara në aktin e komunikimit mes të dy pjesëmarrësve. Ky akt komunikimi mund të përfshijë edhe marrëdhëniet prind-fëmijë, marrëdhëniet mes vëllait të madh dhe vëllait ose motrës së vogël etj. Forca shprehëse urdhëruese varet nga dallimet sociale dhe marrëdhëniet ndërpersonale të krijuara në situatën e realitetin e dhënë.

Në disa gjuhë dhe në disa variacione gjuhësore, kultura dhe faktorët socialë sjellin një shmangie të mënyrës urdhërore të foljes në fjalitë nxitëse në shumë kontekste ligjërimi. *Yankunytjara*, një variant i një dialekti australian, nuk e pranon një përdorim të mënyrës urdhërore në fjalinë nxitëse me kumtim urdhërues, në një kontekst social ku marrëdhënia mes individëve është një marrëdhënie vlerësimi e respekti. Kjo fjali, në mënyrë kategorike, nuk gjen përdorim në një situatë familjare ku përballen marrëdhëniet ndërpersonale, p.sh. midis

¹⁹³ Cituar nga A. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 198.

¹⁹⁴ *Po aty*, f. 2.

dhëndrit dhe vjehrrit apo vjehrrës së tij. Marrëdhënia e tyre shoqërore është më e largët, më e ftohtë dhe deri diku formale, dhe si rrjedhim nga një marrëdhënie e tillë dhëndri nuk mund të bëjë një kërkesë të caktuar, p.sh. për ushqim.

34. *Give me some milk.*
(Më jep pak qumësht.)

Kërkesa për ushqim nuk mund të shprehet nëpërmjet një fjalie nxitëse urdhëruese direkte. Përkundrazi, kërkesa shprehet me një fjali të tërthortë (ligjëratë e zhdrejtë) dhe nëpërmjet një personi të tretë si ndërmjetës. Pra, fjalia “nxitëse” ka strukturë të tillë si një ligjëratë e zhdrejtë: “*vjehrrri juaj thotë ose kërkon ushqim*”.¹⁹⁵ Kjo forcë urdhëruese e një shkalle të lartë tek urdhrat kufizohet nga *marrëdhëniet* mes folësit dhe të adresuarit. Ato nuk gjejnë përdorim në të gjitha situatat ku çifti bashkëbisedues *folës-dëgjues* mund të gjendet në jetën e përditshme.

Format e urdhërueses janë quajtur si forma gramatikore me funksion kumtues *të drejtpërdrejtë*. Pra, kumtimi i fjalive nxitëse nuk përcjell mirësjellje, etikë dhe respekt në kontekstet që gjejnë përdorim. Kjo nuk do të thotë se nuk mund të përdoren me ngjyrim mirësjelljeje, por në krahasim me mënyrat e tjera të foljeve, kanë një forcë më të theksuar drejtimi, urdhërimi a komandimi. Në fjalinë 35 kumtohet një urdhër që mund të gjejë përdorim në një situatë familjare a pune, në marrëdhëniet prind-fëmijë, në shkollë, në zyrë etj. Në gjuhën angleze gjen shumë përdorim ndajfolja *please* (të lutem) në fund të fjalive nxitëse që kumtojnë kërkesa a pyetje. *Please* nuk ka kufizim në përdorimin e saj, sepse mund të gjendet edhe në fund të një fjalie nxitëse që kumton një kërkesë ose urdhër të prerë. Le të analizojmë fjalinë e mëposhtme:

35. *Go to your office please.*
(Shko në zyrën tënde, të lutem.)

Përsëri fjalia 35 shpreh një urdhër të vrazhdë e të prerë që i drejtohet vartësit, por i mbështjellë me një nuancë mirësjelljeje, etike dhe dashamirësie. Përsëri urdhri pritët të zbatohet, pavarësisht “*rrëzimit*” të tonit në pozicionin fundor. Intonacioni është mjaft i rëndësishëm në një situatë të tillë komunikimi. Edhe në gjuhën shqipe përdoret ndajfolja të lutem për të shtuar nuancën e mirësjelljes gjatë dhënies së një urdhri.

Kërkesat, lutjet. Në ligjërimin e folur, fjalia nxitëse me vlerën kuptimore të kërkesës gjen përdorim mjaft të dendur. Fjalitë nxitëse që i drejtojnë një kërkesë të adresuarit ose i shtojnë një kërkesë listës personale të tij, kanë një ngjashmëri nga ana kuptimore me urdhrat, sepse në të dy rastet i kërkohet një personi tjetër të përmbushë një detyrim a kërkesë të bërë nga folësi. Kërkesat dallojnë nga urdhrat në mënyrën se si urdhrat “*urdhërojnë dhe i kërkojnë dikujt të realizojë diçka*”. Te kërkesat dëgjuesi nuk është detyrimisht i gatshëm për të përmbushur këtë kërkesë dhe në dallim nga urdhrat, në këtë akt komunikimi janë të pranishme edhe disa alternativa të mosrealizimit të saj.

Duke qëndruar një shkallë më poshtë toneve urdhëruese që e karakterizojnë urdhrin, kërkesat shoqërohen rëndom nga: *please*, nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme (*tag-questions*), të cilat kanë një funksion zbutës të forcës komanduese të urdhërueses, nga pjesëza, pasthirrma etj. Te fjalia 36 kemi një kërkesë drejtuar një dëgjuesi specifik për një veprim ku folësi është përfituesi në këtë situatë. Forca urdhëruese ka tone më të zbehta krahasuar me urdhrat dhe, për më tepër, intensiteti i urdhrit do të zbehet më tej deri në fjalitë që kumtojnë urime (fjalia 29).

¹⁹⁵ Cituar nga A. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 202.

Në rastin e urdhrave folësi shfaqet si një aktor *përfitues*. Në këtë akt komunikimi ai e dominon, e drejton dhe e urdhëron të adresuarin, në mënyrë që të realizojë qëllimet e tij. Duhet të theksojmë se marrëdhënia folës-dëgjues (i adresuari) ndikon dhe në interpretimin e fjalive nxitëse, si një kërkesë apo urdhër.

36. *Don't take the book with you!*
(Mos e merr librin me vete!)

Në fjalinë 36 marrëdhënia prind-fëmijë në një situatë të tillë mund të japë dy interpretime të kësaj fjalie nxitëse: nga ana e *prindit* është kumtuar një *urdhër* që pritet të zbatohet nga fëmija. Nga ana e fëmijës mund të konsiderohet si një *kërkesë*, madje edhe një këshillë e zakonshme e prindit. Një fjali nxitëse që nga ana kuptimore shpreh një komandë ndaj një personi të caktuar, në një kontekst tjetër mund të nënkuptojë një thënie me kuptim të kundërt, pra moskryerjen e urdhrin të dhënë. Të analizojmë shembullin e mëposhtëm:

37. *Well, open the window!*
(Në rregull, hape dritaren).

Kjo thënie e kumtuar në një akt ligjërimit mes nënës dhe fëmijës së vogël që këmbëngul të hapë dritaren, nuk nënkupton zbatimin e urdhrin të lëshuar prej saj, por moszbatimin e tij. Intonacioni, toni i zërit dhe ironia janë mjetet që mundësojnë kumtimin që synon folësi në këtë ligjërimit.

Rekomandimet, *këshillat* apo *paralajmërimet* jepen para të adresuarit si thënie që ai duhet t'i marrë parasysh, sepse janë në të mirë të aktivitetit të tij. Roli i *përfituesit* në këto fjali i kalon *dëgjuesit*, i cili duhet të marrë parasysh se folësi i ofron diçka që për të është e rëndësishme apo e domosdoshme. Mirëpo dëgjuesi fiton "lirinë", e cila e lejon atë të zgjedhë nëse do t'i zbatojë këto këshilla e rekomandime të marra në të mirë të tij. Aikhenvald-i¹⁹⁶ mendon se rekomandimet shprehin diçka që është e mirë në përgjithësi dhe jo thjesht diçka e mirë vetëm për dëgjuesin. Sipas saj, udhëzimet janë më afër nga ana kuptimore me këshillat, sepse nuk i kërkojnë dëgjuesit të bëjë diçka, por si ta kryejë atë me mirëkuptim, në mënyrë që ai të arrijë një qëllim të caktuar. Ky grup fjalish nxitëse përdoren në situata familjare, shkollore, pune etj.

38. *Eat more fruit and vegetables.*
(Ha / hani më shumë fruta dhe perime.)

Udhëzimet dhe *direktivat shpjeguese* janë karakteristikë e ligjërimit të shkruar. I gjejmë në tekste shkollore, manuale, udhëzues e shpjegues të artikujve të ndryshëm (si në fletët shoqëruese dhe informuese të barnave), receta gatimi, tabela drejtuese dhe informuese etj. Përdorimi i tyre si një mjet stilistikor shërben për të realizuar një qëllim të caktuar dhe nuk i drejtohet një lexuesi të vetëm, por një numri të madh lexuesish. Nga ana strukturore këto lloje fjalish nxitëse kanë një ndërtim të thjeshtë dhe disa veçori kuptimore dhe strukturore që i dallojnë nga kërkesat. *Së pari*, udhëzimet, në përgjithësi, në të gjitha kontekstet përmbajnë informacione, detaje dhe njohuri për lexuesin, duke i treguar atij se si duhet të kryhet diçka. Ato nuk e detyrojnë lexuesin të kryejë një veprim të caktuar.

Te kërkesat kemi: *folës - përfitues*;
te udhëzimet kemi: *i adresuar - përfitues*.

Së dyti, udhëzimet dallohen nga paravendosja e ndajfoljeve që tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit udhëzues dhe njëkohësisht e theksojnë atë më tepër se vetë veprimin. Në fjalinë 22, pozicioni nistor i ndajfoljes *carefully* (me kujdes) thekson mënyrën si duhet ta

¹⁹⁶ Cituar nga A. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 200.

lëvizim kapakun në këtë rast. E gjendur në pozicionin fundor *carefully* e humb sadopak shprehjen e një kujdesi të madh në zbatimin e udhëzimit të dhënë. Fjalja nuk e humbet forcën kumtuese të një udhëzimi, pavarësisht ndryshimit të rendit të fjalëve. Përmendim këtu edhe veçorinë e fjalive që ndërtohen nga një pjesore (*participle clauses*)¹⁹⁷ dhe heqjen e kundrinorit në udhëzime si: etiketa, lajmërimet, receta etj. Këto tipare mund të quhen dhe si tipare stilistikore të gjuhës angleze, të përdorura për të shprehur këto nuanca kuptimore, të cilat e bëjnë kumtimin të qartë, të plotë dhe të kuptueshëm. Për këtë arsye duhet të shkruhen shkurt dhe qartë. Heqja e kundrinorit është një tipar i stilit jopersonal të të shkruarit.

Ftesat i drejtohen dëshirës së dëgjuesit a lexuesit (pjesëmarrës në këtë akt komunikimi) për t'i përmbushur ose jo, si përfituesi i vetëm në këtë akt komunikimi. Te fjalitë që *kumtojnë leje* ose *lejim* shprehet dëshira e dëgjuesit a e lexuesit për të kryer diçka dhe në këtë rast folësi, në kontekste të caktuara, duhet të zotërojë autoritet mbi të adresuarin, në mënyrë që me anë të thënies së tij të kumtojë leje ose lejim për të kryer diçka.

39. *Take as many as you like.*
(Merrni sa të dëshironi.)

Te fjalja 39 shprehet një dëshirë e folësit, ku dëgjuesi ose bashkëbiseduesi lejohet në të njëjtën kohë të blejë apo të provojë diçka.

Larmia kuptimore e fjalive nxitëse është aq e gjerë, sa që shpeshherë elementet *kontekstuale* luajnë rolin kryesor në dhënien e vlerës kuptimore të një fjalie të dhënë. Kjo tregon se forca shprehëse e urdhërores në fjalitë nxitëse nuk mund të shënojë vetëm veprime që nxisin dhe që drejtojnë një person të veprorë.

40. *Come in!*
(Hyr brenda!)

Në një kontekst të caktuar, fjalja 40, e parë nga struktura dhe intonacioni, shpreh një urdhër ndaj dëgjuesit për ta përmbushur këtë veprim. Në një kontekst tjetër, kjo fjali mund të shprehë dëshirën e dëgjuesit për të marrë pjesë në paraqitjen e një projekti në auditorin e universitetit. Thënia "*Come in!*" që dëgjohej nga brenda auditorit, pasi studenti troket, nuk shpreh një urdhër dhe një kërkesë të drejtuar ndaj studentit, por një thënie lejuese apo ftuese për të hyrë në auditor.

Edhe në grupin e fjalive që shprehin *pranim* a *miratim*, përmbushja dhe realizimi i tyre nga ana e dëgjuesit nuk varen detyrimisht nga folësi.

Fjalitë që shprehin nuanca kuptimore *urimi*, *mallkimi*, *lutjeje* etj. hyjnë në grupin e fjalive nxitëse që qëndrojnë në pikën B të segmentit AB të nuancave kuptimore të fjalisë nxitëse. Në pikën A gjallojnë urdhrat dhe komandat. Këto fjali shprehin dëshirën e folësit për të realizuar diçka që t'i ngjasë të tjerëve, duke përfshirë edhe veten. Përdorimi i tyre i dendur si në ligjërimin e folur, ashtu dhe në atë të shkruar (veçanërisht proza popullore), ka bërë që të shndërrohen në formula a mënyra të gatshme të thëni.

41. *God bless you!*
(Zoti ju bekoftë!)

42. *Enjoy the meal.*
(Ju bëftë mirë!)

A-----B

¹⁹⁷ Në gjuhën frënge dhe në gjuhën italiane, një fjali nxitëse-parandaluese apo që gjendet në një udhëzim, ndërtohet nga një infinitiv: Ne pas *toucher!* Non *toccare!*

Përfundim: Fjalitë nxitëse shprehin një gamë të gjerë të vullnetit të folësit për të ushtruar ndikim te dëgjuesi ose dëgjuesit për kryerjen a moskryerjen e një fakti të caktuar. Pra, folësi kërkon të realizojë qëllimin e tij, i cili ndikon edhe në përcaktimin e ngjyimeve kuptimore të fjalive nxitëse në kontekste të ndryshme. Qëllimi i folësit është vendimtar në përcaktimin e semantikës së thënies, e cila në akte të ndryshme komunikimi merr interpretime të larmishme. Të përcaktuara si format direkte të të shprehurit dhe larg të qenit një mënyrë e tërthortë dhe me mirësjellje e të shprehurit, fjalitë nxitëse në shumë situata shmangen nga përdorimi. Në kontekste të caktuara disa mjete dhe strategji të përdorura e dobësojnë dinamikën dhe intensitetin drejtues a urdhërues që ato mbartin. Le të analizojmë disa nga mjetet e ndryshme të përdorura në gjuhën angleze në ligjërime të ndryshme, në mënyrë që të krijojmë një situatë simetrike sociale kundrejt një situatë komunikimi sociale asimetrike, situata këto të kudogjendura dhe mjaf të larmishme.

§3.2.1. Vlera e kontekstit social në përdorimin e fjalive nxitëse

“Gjella provohet me lugë, njeriu provohet me gjuhë”

Larmia e nuancave kuptimore lidhet ngushtësisht me faktorë kontekstualë dhe me faktorë të tjerë si: intonacioni, fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme, pjesëzat, parantesat, gjuha e trupit, të emërtuara shpesh nga studiuesit si *direktiva jo-urdhëruese*. Aikhenvald-i i emërton këto mjete leksikore ose gramatikore si *strategji të komandave*, duke theksuar funksionin e tyre të rëndësishëm në zbehjen e fuqisë urdhëruese të këtyre komandave, e cila është jo e përshtatshme në shumë situata të caktuara¹⁹⁸. Në thelb, semantika e urdhërues mbart kuptimin e “komandës ose urdhëruesës”, që e gjendur në kontekste të ndryshme shndërrohet në një kërkesë, lutje e deri në shprehjen e një dëshire a urimi. Nga shembujt e përmendur më lart, vërejmë se të dyja gjuhët nuk shfaqin dallime të dukshme në semantikën dhe larminë kuptimore të fjalive nxitëse, në varësi të situatës ku ato përdoren. Ky spektër i larmishëm kuptimesh është një tipar ndërgjuhësor dhe fjalitë nxitëse e shfaqin këtë tipar në shumë gjuhë. E kemi theksuar se faktorë të ndryshëm ndikojnë në interpretimin e kuptimit të urdhërues. Një prej tyre është edhe *marrëdhënia* në situatën komunikative të dy aktorëve bashkëbisedues: *folësi* dhe *dëgjuesi* ose *i adresuari*. Një urdhër drejtuar vartësit do të ketë këtë strukturë:

43. *File all the necessary documents!* (drejtuesi - vartësit)
(Fut në dosje gjithë dokumentet e nevojshme!)
44. *You'd better, could you please, or please, file all the necessary documents.*
(vartësi - drejtuesit)
- a. (Më mirë t'i vendosësh në dosje të gjitha dokumentet e nevojshme.)
(*Mund! A mund t'i vendosësh në dosje të gjitha dokumentet e nevojshme?*)
- b. (*Ju lutem vendosini në dosje dokumentet që duhen.*)

Në rastin e fjalisë së dytë (44), në të cilën vartësi i kumton këtë thënie drejtuesit, kemi një transformim të kuptimit të thënies nga një urdhër i drejtpërdrejtë në një kërkesë më të zbutur, të tërthortë dhe më me mirësjellje. Vërejmë në këto raste, ku mëtohet të shprehet mirësjellje dhe të demonstron vlerësim i marrëdhënies që rrjedhin nga hierarkia respektive, përdorimin e disa pjesëzave të ndryshme (të cilat shprehin dyshim, emocion, qëndrim), fjalive të ndërkalura, intonacionit dhe ndoshta gjuhës së trupit, si mjete shtesë ose strategji të komandave. Përmendim disa prej mjeteve leksikore të cilat ndihmojnë në zbutjen e urdhrit

¹⁹⁸A. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 203.

dhe detyrimin të imponuar që shpreh fjalia nxitëse urdhëruese. *Please* gjendet rëndom në fjalitë nxitëse, e pëdorur dhe te fjalia 35, 44, 45.

45. *Please*, sit down at the front.

[Ju lutem ulu / uluni përballë / në fillim (p.sh. të rreshtit, varet nga konteksti).]

1. Në disa kontekste struktura e fjalive nxitëse mund të përmbajë shpesh dhe fjalën *thank you* (faleminderit), por kuptimi i *thank you* nga ana pragmatike nënkupton shprehjen e falënderimit për një veprim të realizuar, gjë që nuk përputhet me kuptimin e fjalive nxitëse ku i adresuari duhet të kryejë atë që nënkupton kërkesa. Dimë që referenca kohore e urdhërues është e ardhmja dhe jo një veprim i kryer, por një veprim që kërkohet të kryhet nga i adresuari. *Please* dhe *thank you* në këto fjali shprehin qartë funksionin që ato mbartin në fjali. Në kontekste të tjera, ku duhet të theksojmë nivelin e mirësjelljes, mund të shtojmë edhe ndajfoljen *possibly* (ndoshta).

46. Could you *please* write me back?

(Mund të më kthesh përgjigje, të lutem?)

47. Could you *possibly* fax him the data?

(Mund t'ia dërgosh atij me faks të dhënat?)

Pra, përdorimi i *possibly* dhe *please* bart kuptime urdhëruese të zbutura.

Analizojmë fjalitë gjegjëse 43 dhe 44 në gjuhën shqipe:

(Vendosi në dosje të gjitha dokumentet e nevojshme!)

(A mund t'i vendosni të gjitha dokumentet e nevojshme në dosje?)

(Ju lutem, vendosini në dosje dokumentet që duhen.)

Te fjalia gjegjëse 43 intonacioni shërben për të kumtuar një thënie ku folësi urdhëron. Te fjalia gjegjëse në shqip (44a) vërejmë përdorimin e foljes gjysmëndihmëse *mund* dhe pjesëzës *a*, të cilat nuk shënojnë nga ana kuptimore aftësinë e vartësit për të vendosur dokumentet në dosje, por zbehin dhe zvogëlojnë shkallën e komandimit dhe urdhërimit të kësaj thënieje. Fjalia formalisht është kthyer në një fjali pyetëse jo me funksionin e bërjes së një pyetjeje, por të një kërkesë me tone mirësjelljeje. Te fjalia tjetër gjegjëse (44b) kemi përdorimin e ndajfoljes *ju lutem* si një mjet zbutës i efektit urdhërues. Në gjuhën shqipe këto mjete janë të pranishme në fjalitë nxitëse me kumtim urdhërues, ashtu si dhe në gjuhë të tjera, në të cilat format e mirësjelljes janë të shumta dhe të larmishme. Në gjuhën angleze këto forma të shënimit të mirësjelljes janë të bollshme.

2. Gjuha angleze përdor edhe *fjalitë pyetëse* të cilat fillojnë me foljet modale *could* (mund) dhe *would* (a do të) apo *is it possible* (është e mundur), *are you able* (jeni në gjendje të), *will / would you be able* (do të jeni / ishit në gjendje të...), si një mundësi për të shprehur kërkesa të sjellshme. Modaliteti i shënuar nga foljet modale *could* (mund) dhe *would* (do të + folje = e ardhme e së shkuarës) jo vetëm shërbejnë në zbutjen e forcës urdhëruese që mbart fjalia nxitëse në përgjithësi, por në të njëjtën kohë zvogëlojnë distancën shoqërore në marrëdhëniet ndërpersonale mes folësit dhe dëgjuesit në situatën e komunikimit.

48. *Could* you file all the necessary documents?

(Mund t'i vendosësh në dosje dokumentet e duhura?)

49. *Could* you fill in the form before you leave?

(A mund ta plotësosh formularin para se të largohesh?)

50. *Would* you turn to previous pages?

(A do të kthehesh te faqet më përpara? A nuk kthehesh në faqet e kaluara?)

Edhe në fjalitë gjegjëse të gjuhës shqipe vërejmë përdorimin e fjalive pyetëse, foljeve modale dhe pjesëzave. Pjesëza mohore *nuk* haset dendur në ligjërimin bisedor në situata të ndryshme dhe në një pjesë të rasteve ajo karakterizohet nga një semantikë boshe, e cila nuk

shërben për të dhënë kuptimin mohor të kumtimit të thënies, por në këtë rast zvogëlon fuqinë shprehëse urdhëruese. Në gjuhën angleze mohimi nuk do të shprehte të njëjtin kuptim, por do të përftonim ndoshta kuptimin e kundërt nga thënia në gjuhën shqipe. Në të gjitha çiftet e fjalive, semantika e fjalive pyetëse me kuptim nxitës u afrohet më shumë kërkesave dhe urdhrave të zbutur.

Një specifikë e veçantë e gjuhës angleze është përdorimi i *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme* për qëllime të ndryshme stilistikore, ndër të cilat përmendim synimin e folësit për të shprehur mirësjellje, një kërkesë dhe një ofertë miqësore etj. “Ngjitja” e këtyre strukturave në fund të fjalive nxitëse përbën një prej *strategjive* më të përdorura për të shprehur kuptimin e një fjalie nxitëse në një formë më të sjellshme e për të ngushtuar sadopak “hendekun” social mes bashkëbiseduesve.

51. *Call the doctor for me, can you / could you?*

(Telefonoje / telefonojeni doktorin. / A mund ta telefonosh doktorin? / Ma telefonon pak doktorin, mundesh?)

52. *Don't tell anyone, will you?*

(Mos i thuaj njeriu, dakord, në rregull, apo jo...?)

3. Folësi mund të përdorë edhe konstrukte të tjera për të shprehur një fjali nxitëse më indirekte sesa fjalitë pyetëse me folje modale. Folësi kumton një *fjali dëftore* që në mënyrë të tërthortë kodohet te dëgjuesi si një urdhër ose kërkesë, duke e shqiptuar me intonacionin përkatës:

53. *I can't find the car keys, e cila mund të kuptohet si:*

(Help me find the car keys.)

54. *Nuk po i gjej çelësat e makinës, e cila mund të kuptohet si një fjali nxitëse:*

(Ndhimomë të gjej çelësat e makinës.)

Tendencat ndërgjuhësore për të përdorur fjalitë dëftore në vend të fjalive nxitëse në aktet e ligjërimit të drejtpërdrejtë shmangin efektin urdhërues ose detyrues në shumë situata që mbart folja-kallëzues në mënyrën urdhërore.

55. *You are leaving for America next week.*

(Ti do të ikësh/ikën/ do të nisësh për në Amerikë javën tjetër).

Kjo fjali është formalisht dëftore, por në kontekst nuk kryen një akt ligjërimit të pohimit, informimit etj. Ajo realizon një akt ligjërimit të urdhrit, këshillës apo dhe një kërkesë të dëshiruar nga folësi. Jo në çdo rast fjalia dëftore shpreh një urdhër të zbutur. Analizojmë fjalinë:

56. *You will join your friends immediately!*

(Ti do të bashkohesh me shokët menjëherë!)

Në këtë fjali dëftore kumtohet një urdhër i prerë, i lëshuar nga mësuesi, drejtuesi apo prindi në një kontekst të caktuar. Intonacioni dhe toni i zërit janë të rëndësishëm dhe shënues në një thënie të tillë.

4. Një rast tjetër ku vlera urdhëruese e fjalive nxitëse zbehet është përdorimi i një fjalie dëftore me një folje-kallëzues në pësore me veprues të pashprehur. Vlera semantike e një fjalie pësore shërben për t'i shprehur një udhëzim jo vetëm një të adresuari, por një grupi të adresuarish.

57. *Everyone is invited to attend the English classes.*

(Të gjithë janë të lutur të frekuentojnë orët e mësimit të gjuhës angleze.)

Konteksti është një faktor shumë i rëndësishëm në këtë fjali, sepse ai përcakton kumtimin e një thënieje në të cilën nuk kemi një veprues direkt dhe gjithkush mund të jetë i adresuari. Nga ana kuptimore, adresimi i shprehur me një folje në pësore shpreh me mirësjellje një kërkesë, një udhëzim apo një sugjerim në kufijtë e ftesës. *Shprehja* e një kërkesë ose urdhri në mënyrë të *tërthortë* (përkundrejt një urdhëroreje të drejtpërdrejtë) dhe *adresimi* i urdhrit ndaj një grupi të adresuarish, e zbusin efektin urdhërues që mbartin fjalitë nxitëse.

5. Një tjetër mjet gramatikor që përdoret në ligjërime për të shprehur një kërkesë me mirësjellje është edhe folja ndihmëse *do* jo me funksionin kryesor të përdorimit në fjalitë nxitëse (funksioni përforcues i kumtimin të thënies), por kur kërkesa drejtohet me tone mirësjelljeje dhe dëshire për të kërkuar realizimin e diçkaje nga ana e dëgjuesit. *Do* tradicionalisht është përkufizuar si një pjesëz theksuese, e përdorur në kohën e tashme dhe të shkuar të mënyrës dëftore (*do-did*), për të theksuar realitetin e ngjarjeve të shprehura në fjali. Vërejmë fjalinë:

58. *Do have* another bar of chocolate.
(Merr dhe një çokollatë tjetër.)

Përdorimi i *do* në këto fjali shërben për të theksuar kumtimin e fjalisë dhe është një specifikë dalluese e gjuhës angleze. *Do* në pozicionin para foljes-kallëzues shfaqet e zhveshur nga ana semantike dhe nuk ka një pjesëz gjegjëse në gjuhën shqipe. Në gjuhën shqipe, si një gjuhë me rend të lirë, disa nga mjetet që kryejnë funksionin e theksimit të kumtimin në një fjalie të caktuar janë rendi i gjymtyrëve, intonacioni etj. Fjalitë gjegjëse në shqip pranon dhe përdorimin e lidhëzës *dhe*, e cila mendojmë se e forcon dëshirën dhe këmbënguljen e folësit për të ofruar një çokollatë të bashkëbiseduesit. Disa studiues dallojnë dy funksione kryesore të *do* në fjalitë nxitëse: *kujtesë* dhe *theksim* a përforcim. E përdorur në fjalitë nxitëse folja ndihmëse *do* i shton asaj një vlerë kuptimore nxitëse, jokomanduese dhe urdhëruese.

Nivelet e mirësjelljes kodohen apo shënohen në formën gramatikore të fjalisë, te folja-kallëzues si bërthama e fjalisë. Te fjalitë nxitëse është folja që mban peshën kryesore të kumtimin dhe të strukturës, sepse dimë që këto fjali kanë një strukturë sintaksore të thjeshtë të bazuar te folja. Në botë ka shumë gjuhë dhe variacione ku nivelet e mirësjelljes janë të përfshira brenda strukturës gramatikore të fjalisë, si numri, koha apo aspekti. Në gjuhën koreane sistemi i niveleve të ligjërimit është nga më kompleksët dhe kjo gjuhë ka gjashtë nivele të tilla, të cilat shënohen gramatikisht nga mbaresat foljore. Përmendim gjithashtu gjuhët indiane të cilat kanë forma të mirësjelljes dhe respektit të gramatikalizuara. Në gjuhët indoevropiane dhe shumë gjuhë në botë, shumësi i foljeve dhe i përemrave (T- vs V-forms) janë një kategori tjetër gramatikore që shënon respekt dhe mirësjellje në një akt komunikimi¹⁹⁹. Kjo mënyrë e adresimit të një personi në numrin shumës nuk është specifikë dalluese e urdhërues, por përdoret gjerësisht në të gjitha tipat e fjalive dhe në shumë kontekste sociale. Në gjuhën angleze kategoria e shumësit nuk mund të ketë vlerën e mirësjelljes, sepse në këtë gjuhë mungon dallimi mes vetave qoftë te shumësi i përemrave, qoftë te shumësi i foljeve. Format e kohës (T dhe V-forms) gjejnë përdorim në gjuhën shqipe, në gjuhën frënge, atë italiane, spanjolle, greke etj.

Në grupin e strategjive të përdorura në situata të ndryshme komunikative mund të përmendim dhe një sërë mjetesh të tjera, të cilat ndihmojnë në shprehjen e mirësjelljes dhe realizimin e një komunikimi sa më formal. *Takti* është thelbi i semantikës së fjalive nxitëse në kontekste të mirësjelljes, i cili nuk duhet të shtrihet drejt një thënieje në kufijtë maksimalë të

¹⁹⁹ “The more *polite* the form, the less *forceful* the command”, (Prania e madhe e treguesve formalë për të shprehur mirësjellje ia zbeh vlerën kuptimore urdhëruese fjalisë nxitëse.), cituar nga A. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 221.

të qenit sa më e tërthortë, sepse do të arrijmë në një thënie që nuk mund të shprehë kumtimin që synohet nga folësi ose do të keqkuptohet nga dëgjuesi.

59. *Please could* you give me your email address, *will you*?

(*Ju lutem, mund të më jepni adresën tuaj të e-mail-it, a mundesh?*)

Në këtë bashkëbisedim janë përdorur këto mjete gramatikore dhe leksikore për të shënuar elemente të mirësjelljes dhe të respektit: fjalia nxitëse është kthyer në një fjali pyetëse, përdorimi i foljes modale *could* kundrejt *can*, përdorimi i *please* dhe në fund të thënies është shtuar një fjali pyetëse e pagjymtyrëzueshme *will you*. Pra, në fjalinë 59 dallojmë një varg mjetesh dhe strategjish, ku synimi për të arritur një akt ligjërimi në mënyrë të tërthortë realizon një thënie në të cilën kërkesa shkon në kufijtë e një lutjeje.

Analiza e fjalive nxitëse në aspektin pragmatik është një ndërmarrje e vështirë, sepse këto fjali janë ngushtësisht të lidhura me marrëveshjet dhe kodet e mirësjelljes. Kjo marrëdhënie dialektike mes fjalive nxitëse dhe pragmatikës së tyre shpjegon arsyen pse Leech-i (1983) i përcakton parimet e mirësjelljes në vend të rregullave të mirësjelljes.²⁰⁰ Sipas tij, *takti* në ligjërim përmban dy pole: poli negativ - minimizon koston ndaj dëgjuesit dhe poli pozitiv - minimizon përfitimin ndaj dëgjuesit. Forca shprehëse e drejtpërdrejtë e fjalisë nxitëse, si një karakteristikë dalluese e saj, ndikon në përdorimin praktik të tyre në ligjërim në një mënyrë të tërthortë. Në gjuhën angleze forma e tërthortë shfaqet e lidhur ngushtë me mirësjelljen. Kjo lidhje shënon qartë përdorimin e një arsenali mjetesh e strategjish për të shprehur një fjali duke iu përmbajtur kodeve të mirësjelljes dhe të etikës.

60. *Merrni çfarë të dëshironi.* (*i adresuari është një person / ti*)

Një mënyrë tjetër që përdoret për të shmangur tonet direkte që mbart urdhërorja, është edhe përdorimi i vetës së tretë në italisht e spanjisht²⁰¹.

61. *Prende la macchina dal meccanico.* (*lei*)

(Merr makinën nga mekaniku)

përkthimi literal

(Merreni makinën nga mekaniku.)

62. *Toma el coche de mecano.*

(Merrni makinën te mekaniku.)

Përdorimi i kryefjalës në gjuhën franceze del si formulë e mirësjelljes. Dikur, gjuha e vjetër franceze ka pasur të shprehur kryefjalën (shek. XVIII) për të dhënë kumtime që bartin mirësjellje.

63. *Vous soyez bienvenu.*

(Ju jeni të mirëpritur).

Në aspektin socio-linguistik veprojnë shumë faktorë që ndikojnë në kumtimin e drejtë të thënies dhe që kufizojnë në situata të ndryshme komunikative forcën urdhëruese të kërkesës. Këta faktorë mund të jenë: gjinia, seksi, gjeografia, konteksti social historik, arsimimi, mosha, etj. Nga shumë studiues përmendet se ka një dallim në përdorimin e fjalive nxitëse nga të dy gjinitë dhe është arritur në konkluzionin se gjinia femërore ka tendencën të përdorë më shumë forma gjuhësore të mirësjelljes gjatë ligjërimin, krahasuar me meshkujt. Pra, përdorimi i gjuhës nga folësit karakterizohet nga stili kontekstual d.m.th. nga marrëdhënia e folësit me burimet gjuhësore dhe situatës ku folësi e gjen veten në kohë të ndryshme. Shprehësitë e folësit, si karakteristika të veçanta të tij, janë faktorë të rëndësishëm në kumtimin e thënies nxitëse dhe mënyrën se si ata e përdorin gjuhën.

²⁰⁰ Cituar nga F. Meyer, *Introducing English Linguistics*, Cambridge University Press, 2009, f. 11.

²⁰¹ Në disa kontekste, përdorimi i vetës së tretë (*lei*) mund të ketë edhe funksionin komunikues të autoritetit, të një sjelljeje të ashpër: *Continua da mentire* (*lei*).

Shumë studime tregojnë se femrat në krahasim me meshkujt kanë tendencën të përdorin më tepër format gjuhësore që shprehin mirësjellje në ligjërim. Mënyra se si një individ shprehet në ligjërim dhe format gjuhësore që zgjedh, lidhen drejtpërdrejt me të dhe reflektojnë karakteristikat e këtij individ. Analiza e marrëdhënieve ndërpersonale dhe zgjedhja gjuhësore që ata kryejnë, kanë treguar se folëset femra i kushtojnë një vëmendje më të madhe përzgjedhjes gjuhësore për të qenë më afër gjuhës standarde. Kjo ndodh edhe nga pozicioni i tyre në shoqëri. Ky stil ligjërimi pasqyron dhe shkallën e asimetrisë së forcës që karakterizon rolin e burrave dhe të grave brenda kuadrin social ku ata veprojnë. Përdorimet femërore janë më shprehëse, karakterizohen nga thënie me forma dyshuese, përsëritje, duke përfshirë dhe pjesë të gjesteve dhe gjuhës së trupit, mjete që e kthejnë ligjërimin në një ligjërim me mirësjellje e korrekt dhe më pak të qartë. Të qenit i tërthortë shpeshherë nënkupton dhe largimin nga kuptimi bazë i thënies. Ligjërimi mashkullor përmban thënie me një sintaksë më të thjeshtë, strukturë të saktë nga ana gramatikore dhe karakteristika që i përfaqesin gjuhës së shkruar.

Mjete të tjera që shërbejnë për zbehjen kuptimore të forcës së urdhrin që shprehin fjalitë nxitëse, janë edhe përdorimi i fjalive pyetëse dhe dëftore me funksione komunikative të ndryshme.

Përfundim:

1. Si gjuha angleze, ashtu dhe gjuha shqipe nuk tregojnë dallime të ndjeshme në semantikën dhe larminë kuptimore të fjalive nxitëse, të cilat përbëjnë një tipar ndërgjuhësor. Semantika e fjalive nxitëse është mjaft e gjerë në ligjërimet të ndryshme.

2. Mjetet gjuhësore që shërbejnë për të zbutur forcën urdhëruese tipike të fjalive nxitëse janë të larmishme në gjuhën angleze. Disa prej tyre gjejnë përdorim të gjegjëset në gjuhën shqipe, ndërsa disa të tjera nuk kanë gjegjëse në gjuhën shqipe (*tag questions*).

3. Konteksti ligjërimor është një element i rëndësishëm në përkapjen e anës kuptimore dhe gjithashtu në interpretimin e kumtimit të thënies nxitëse.

§3.3. Vlera kuptimore kushtore të fjalitë nxitëse në gjuhën angleze vështruar në përfaqje me gjegjëset në gjuhën shqipe

Fjalitë nxitëse janë përgjithësisht fjali të thjeshta dhe dendurinë më të madhe të përdorimit e kanë në ligjërimin e folur. *Struktura e thjeshtë* është një prej veçorive të fjalive nxitëse, në dallim nga tipat e tjerë të fjalive. Janë më të pakta rastet ku fjalitë nxitëse kryejnë funksionin sintaksor të një fjalie në strukturën e një periudhe të përbërë, si fjali bashkërenditëse apo e varur. Megjithatë, fjalitë nxitëse mund të jenë pjesë e periudhave me bashkërenditje të lidhura me lidhëzat bashkërenditëse shtuese *e*, *dhe* (*and*). Në këto periudha fjalia nxitëse e ka humbur forcën shprehëse urdhëruese drejtuar të adresuarit dhe në raport me fjalinë tjetër me të cilën është në marrëdhënie bashkërenditjeje, mund të marrë rëndom një vlerë kuptimore kushtore (apo lejore në raste më të rralla).

Huddleston-i²⁰² analizon dy shembujt e mëposhtëm:

64. *Invite one without the other, and there will be trouble.*

(Ftoje njërin pa tjetrin dhe do të kesh probleme.)

65. *Help me this once, and I'll never ask you again.*

(Ndihmomë këtë herë dhe nuk do ju kërkoj më ndihmë.)

Sipas tij, në këta shembuj, fjalitë nxitëse janë elementet e para në një strukturë me bashkërenditje që shpreh ngjyrim kuptimor kushtor.

²⁰² R. Huddleston, G. K. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press, 2005, f. 171.

Por, Huddleston-i thekson se kushti nuk është përbërës kuptimor të fjalitë nxitëse dhe shembujt e mësipërm tregojnë akte të tërthorta ligjërimi²⁰³.

Bashkërenditja dhe kufizimet e bashkëlidhjes së fjalive përbërëse

Para se të bëjmë një analizë të plotë të fjalisë nxitëse, e cila krijon raporte kuptimore kushtore me fjalinë tjetër në periudhën me bashkërenditje, po bëjmë një paraqitje të shkurtër mbi vështrimet dhe problematikën që shfaq lidhja me bashkërenditje mes tipave të ndryshëm të fjalive. Çështja lidhet me kufizimet mbi llojin e fjalive si pjesë e lidhjes me bashkërenditje. Në fjalitë e pavarura, veçoritë e tipave të fjalive sipas kumtimit janë më të dallueshme, krahasuar me përdorimin e tyre në periudhat me bashkërenditje, nënrenditje ose asindetike. Një periudhë e përbërë mund të përmbajë fjali dëftore, pyetëse a nxitëse, por edhe pjesët e fjalisë që e përbëjnë atë duhet t'i përkasin të njëjtit tip fjalie.

Vërejmë shembujt:

66. *Put this bottle of milk in the fridge and where did you buy a loaf of bread?*

(Vendose shishen e qumështit dhe ku e bleve bukën?)

67. *Someone is knocking and don't open the door.*

(Dikush po troket dhe mos e hap derën.)

Por ka raste që tipa të ndryshëm fjalish nxitëse lidhen me bashkërenditje.

Në fjalitë 66 dhe 67 ne vërejmë se bashkëlidhja e njësisë kallëzuesore, pra fjalive përbërëse të periudhës me bashkërenditje, nuk është e shprehur qartë nga ana kuptimore, në mënyrë që të përftojë një periudhë me fjali të bashkërenditura me marrëdhënie këpujore. Fjalitë 66 dhe 67, si në gjuhën angleze dhe te gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe, janë të papranueshme nga çdo folës që mund t'i ndeshë në një kontekst të caktuar ligjërimi. Brenda leksikore është domethënëse në shprehjen e përmbajtjes logjike të periudhës, sepse nga pikëpamja formalo-gramatikore këto fjali lidhen me anë të lidhëzave shtuese, por nuk kemi një bashkëlidhje të trajtave dhe kuptimeve kohore të sintagmës foljore në funksionin e kallëzuesit. Si rrjedhojë, në bashkëlidhjen e fjalive në periudhat me bashkërenditje ka disa kufizime që lidhen me llojin e fjalisë që hyn në këtë raport. Te periudha 66 kemi një fjali nxitëse dhe një fjali pyetëse, që na japin një fjali jo të saktë si nga ana kuptimore, ashtu edhe nga ana gramatikore.

Ky kufizim nuk ka vlerë në të gjitha rastet në fjalitë me bashkërenditje, sepse në kontekste të ndryshme nga bashkime të tilla përftohen periudha të rregullta edhe kuptimisht, edhe gramatikisht. Është me rëndësi të theksojmë se *konteksti i aktit të komunikimit* luan rol të rëndësishëm në kategorizimin e fjalive gramatikore ose jogramatikore. “*Kufizimet mbi bashkëlidhjen e fjalive në periudhën me bashkërenditje nuk mund të kundrohen në aspektin sintaksor dhe semantik, por duhet të lidhen me anën e përgjithshme pragmatike, sepse bashkëlidhja me bashkërenditje duhet të ketë një lidhje që e justifikon atë.*”²⁰⁴

Këtë gjë e vërtetojnë edhe shembujt e mëposhtëm, në të cilët ana kontekstuale ndihmon për të vënë në dukje anën kuptimore të periudhës me bashkërenditje të përbërë nga një *fjali nxitëse + një fjali pyetëse*:

68. *Let me read the essay and what are the books you referred to?*

(Le ta lexoj esenë dhe kujt librave iu referove?)

Në gjuhën angleze vëmë re që shpesh nuancat kuptimore të kushtit shprehen jo vetëm te fjalitë e përbëra me marrëdhënie nënrenditëse, por edhe te periudha me bashkërenditje. Madje, në disa përdorime marrëdhëniet kushtore shprehen edhe brenda fjalive të thjeshta.

²⁰³ *Po aty*, f. 938.

²⁰⁴ E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 161.

Mendojmë që kjo dukuri është e lidhur ngushtë me shtrirjen e gjerë të marrëdhënieve kushtore në jetën e përditshme dhe në botën reale. Në jetën e përditshme çdo dukuri apo mjet mund të shndërrohet papritur në një kusht për të zhvilluar një aktivitet apo dukuri të dytë. Kjo dukuri nuk është gjë tjetër veçse pasojë e një kushti të sapopërmendur. Këto përdorime shpjegojnë format e shprehjes së raporteve kushtore në periudha të ndryshme.

Modaliteti i fjalive nxitëse shpjegon semantikën e gjerë kuptimore të fjalive nxitëse. Kushti nuk është kuptimi thelbësor i këtyre fjalive, por marrëdhënia kushtore shfaqet në gjithë periudhën me bashkërenditje. Forca shprehëse e urdhrit të fjalisë nxitëse në periudhën me bashkërenditje pëson një zvogëlim të shkallës së intensitetit të shprehjes dhe e gjithë fjalia e përbërë nuk është gjë tjetër veçse *një pohim i kushtëzuar*. Ato fjali nxitëse që nuk kumtojnë nuancat kuptimore të urdhrit a të kërkesës janë emërtuar nga gjuhëtarë të ndryshëm si fjali nxitëse me vlerë *jokomanduese* ose *pseudo-urdhërore*. *Janë pseudo-imperative ato fjali nxitëse që nuk kryejnë funksionin e një kërkesë, një urdhri a një komande*²⁰⁵. Sipas M. Franke, pavarësisht strukturës së tyre sipërfaqësore, pseudo-urdhëroret qartësisht shprehin kusht. Pseudo-urdhëroret janë kumtime kushti, që në mënyrë intuitive i lidhim me to²⁰⁶.

Vlera të tilla kuptimore që shprehen nga fjalitë nxitëse, përbëjnë funksione kumtuese jokomanduese apo jonxitëse të këtij tipi fjalish ose vlera kuptimore kushtore:

69. *Play with her toys* and she will get angry instantly.
(*Luaj me lodrat e saj* dhe ajo inatoset menjëherë.) (përkthimi literal)
(*Po të luash me lodrat e saj*, ajo inatoset menjëherë.)

Në këtë fjali kemi një kusht të shprehur në pjesën e parë, përmbushja ose realizimi i të cilit kushtëzon përmbajtjen e pjesës së dytë të fjalisë. Interpretimi i nuancave kushtore shprehet qartë në pjesën e dytë, ku realizimi i kushtit të paraqitur në fjalinë nxitëse (*Play with her toys*. - *Luaj me lodrat e saj*.) lidhet me një sugjerim, një udhëzim apo një paralajmërim të dhënë nga folësi. Kuptimi thelbësor i periudhës me bashkërenditje, ku lidhja e ndërsjellë e situatave ka karakter hipotetik, përkon me kuptimin e fjalisë nxitëse-mohore (*ndaluese*) dhe në këtë rast jepet një paralajmërim i tillë:

70. *Don't play with her toys!*
(Mos luaj me lodrat e saj!)

Nëse analizojmë nga ana formale fjalinë e parë përbërëse të periudhës 69 dhe gjegjësen e saj në gjuhën shqipe, mund të themi se kemi të bëjmë me dy fjali nxitëse të lidhura me anë të bashkërenditjes. Por, nëse fjalisë së parë i paravendosim lidhëzën kushtore *if* (*në qoftë se*), atëherë e gjithë semantika e periudhës merr një interpretim kuptimor kushtor. Folësi në këto fjali prezanton një mundësi para të adresuarit dhe realizimi i saj do të sjellë një pasojë të caktuar. Në këto fjali interpretimi kushtor është i pranueshëm, nëse pjesa e parë e fjalisë rrjedh nga një *if-clause* (fjali e varur kushtore). Ekzistojnë mendime të ndryshme se derivimi nga një fjali kushtore (*if-clause*) mund të vijë edhe nga elipsa.

71. *Play a trick on your friends* and they will never believe you anymore.
(Mashtroji miqtë e tu dhe ata nuk do të të besojnë asnjëherë.)

Pra, fjalia 71 mund të zgjerohet në një fjali me nënrenditje kushtore:

72. *If you play a trick on your friends*, they will not believe you anymore.
(Nëse i mashtron miqtë e tu, ata nuk do të të besojnë asnjëherë.)

²⁰⁵ C. Ascoli, *Some pseudo-imperatives and their communicative function in English*, Folia Linguistica, Volume 12, f. 405.

²⁰⁶ M. Franke, *Pseudoimperatives*, Msc. in Logic, f. 3.

Këto fjali nënkuptojnë realizimin e një kushti të paraqitur në pjesën e parë të fjalisë me një folje-kallëzues në mënyrën urdhërore. Ekzistenca e një kushti të tillë në kumtimin e gjithë periudhës i bën ato të ngjashme me fjalitë e nënrenditura kushtore. Këto ngjashmëri mes fjalive të nënrenditura kushtore dhe fjalive nxitëse me nuancë kuptimore kushtore në raporte bashkërenditëse, na drejtojnë në konkluzionin se të dyja llojet duhet të shihen në *strukturën e tyre sipërfaqësore*. Kjo nënkupton se fjalitë nxitëse me kuptim kushtor rrjedhin nga një fjali e mirëfilltë kushtore (*if-clause*), u mungon kryefjala dhe lidhen me pjesën tjetër të fjalisë nga lidhëza bashkërenditëse këpujore *and* (dhe, e). Lidhëza *and* duhet të shihet në këto fjali larg funksionit të saj bashkërenditës dhe jo si në fjalitë bashkërenditëse, në të cilat shpreh radhitje të situatave dhe dukurive të një fare. Pra, prania e lidhëzës tregon karakterin e njëtipshëm të fjalive përbërëse të periudhës me bashkërenditje. *Mbështetëse të marrëdhënieve kushtore janë lidhëzat, bashkëlidhja e formave mënyrore e kohore të foljeve kallëzues të fjalive, si dhe konteksti*²⁰⁷.

Fjalitë nxitëse të mirëfillta dhe fjalitë nxitëse me interpretim kuptimor kushtor dallojnë në aspektin strukturor, semantik dhe pragmatik.

1. Një dallim midis këtyre fjalive lidhet me përdorimin e disa ndajfoljeve, si *ever* (ndonjëherë), *anymore* (më), *again* (përsëri) të fjalitë nxitëse me nuancë kuptimore kushtore si mjete leksikore që shprehin një polaritet kuptimor negativ. Kjo gjë nuk ndodh në fjalitë nxitëse të mirëfillta.

73. *Call your girlfriend *anymore*.
(Telefonoje të dashurën më.)

Por, këto ndajfolje i gjejmë të përdorura saktë në fjalitë nxitëse me kuptim kushtor si nga ana gramatikore, edhe ajo kuptimore, si të fjalitë më poshtë:

74. Call her *again* and she will forgive you for sure.
(Telefonoje *përsëri* dhe ajo me siguri do t'ju falë.)

2. Dallimi tjetër ka të bëjë me foljet që emërtojnë gjendje apo foljet jovepruese në gjuhën angleze, si *feel* (ndiej), *understand* (kuptoj), *know* (di, njoh) etj., të cilat sipas vlerës kuptimore që shprehin, nuk mund të përdoren në sintagmën foljore të fjalive nxitëse të mirëfillta. Fjalitë nxitëse që kumtojnë një urdhër a direktivë, e lidhin rolin e vepruesit me kryefjalën²⁰⁸. Kumtimi i fjalive nxitëse të mirëfillta nënkupton përmbushje të një urdhri a kërkesë dhe kjo lidhet me kryerjen e një veprimi. Pra, kryefjala fiton rolin e vepruesit, ndërsa sintagma foljore, e shprehur me një folje në mënyrën urdhërore, i cakton asaj një rol të tillë. Ky kufizim në përdorimin e foljeve të gjendjes nuk është i vlefshëm në një fjali nxitëse me kuptim kushtor. Në një kontekst të caktuar, ku gjendja apo veprimi i shprehur nga urdhërorja e foljes-kallëzues shihet brenda aftësisë kontrolluese të dëgjuesit, si një kryefjalë e nënkuptuar e fjalisë, foljet e gjendjes mund të shprehin një nuancë urdhri, kërkesë, udhëzimi, këshillë, që përbën thelbin kuptimor të fjalive nxitëse. Përkatësia e disa foljeve në grupin e foljeve që shprehin gjendje varet nga kuptimi i tyre leksikor në kontekstin ligjërimit të karakterizuar nga marrëdhënia kusht-pasojë. Konteksti në këto raste luan rolin kryesor në kumtimin e një fjalie gramatikusht të saktë:

75. *Know* the correct answers and the teacher will be happy.
(Po të dish përgjigjen e saktë, (dhe) mësuesja do të jetë e lumtur.)

76. **Know* the correct answer. (fjali nxitëse e mirëfilltë)
(*Dije përgjigjen.)

²⁰⁷ M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, ShBLU, Tiranë, 2000, f. 99.

²⁰⁸ R. Huddleston, G. K. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English language*, Cambridge University press, 2005, f. 938.

Duhet të theksojmë se në një kontekst si te fjalia 75, dëshira e të adresuarit për të ditur apo për të dhënë *përgjigjen e saktë*, e kthen gjendjen në një situatë të kontrolluar nga ai, pra folja tani shënon veprim. Gjegjësjë në gjuhën shqipe përkon me një fjali të varur kushtore.

3. Përdorimi i përemrit vetvetor *myself* në fjalitë nxitëse me vlerë kuptimore kushtore i dallon këto fjali nga fjalitë nxitëse të *mirëfillta*. Përemri vetvetor *myself* nuk mund të përdoret në fjalitë nxitëse të mëvetësishme. Në fjalitë nxitëse me nuancë kuptimore kushtore, përdorimi i përemrit vetvetor *myself* shpreh një veprim të drejtuar ndaj një personi tjetër, të vetës së tretë, por edhe të vetës së parë.

Të analizojmë shembullin e mëposhtëm:

77a. *Enjoy *myself* at the party.

(Kënaqem (veten) në mbrëmje.)

b. Enjoy *yourself* at the party.

(Kënaqu në mbrëmje.)

Duke kundruar fjalinë gjegjëse në shqip, vërejmë se fjalia shprehet me një folje të diatezës mesore. Nuk mund të themi se gjegjësjë në gjuhën shqipe e fjalisë 77 është fjali nxitëse nga ana kuptimore, ndërsa në rastin kur folja është në vetën e dytë (77b), “Kënaqu në mbrëmje”, fjalia shpreh një kërkesë dhe një dëshirë të folësit. Në gjuhën angleze, nëse në vend të përemrit vetvetor të vetës së parë *myself* përdorim përemrin e vetës së dytë *yourself*, fjalia *Enjoy yourself at the party*, është një fjali e mirëfilltë nxitëse. Ndërsa te fjalitë nxitëse me vlerë kuptimore kushtore, përdorimi i përemrit vetvetor *myself* nuk e prish kuptimin e fjalisë dhe na jep një fjali të saktë nga ana gramatikore.

78. Enjoy *myself* at the party and my friends will arrange another the next day.

[(Po të) *Kënaqem* në mbrëmje dhe miqtë e mi do të organizojnë një tjetër të nesërmen.]

4. Në dallim nga fjalitë nxitëse të pavarura të mirëfillta, në periudhën me bashkërenditje, fjalitë nxitëse me kuptim kushtor karakterizohen nga veçantia e *shënimit* të një veprimi që i referohet një kohe të shkuar, para çastit të ligjërit. Sintagma foljore në fjalitë nxitëse të mirëfillta nuk e ka kategorinë e kohës dhe shpreh një veprim që pritet të realizohet pas çastit të ligjërit, pra i referohet kohës së ardhme. Të analizojmë shembujt e mëposhtëm:

79. *Cancel the date yesterday* and she would have gone mad.

[Anulo takimin (po të anulohet takimin *dje*, ajo do të inatosej)]

Në gjuhën angleze, periudha 79 ndërtohet nga një fjali nxitëse nga ana strukturore (folja-kallëzues shprehet me formën bazë të foljes), në të cilën gjendet një ndajfolje që i referohet së shkuarës dhe nga një fjali me një folje-kallëzues që kuptimisht shënon çaste të së shkuarës. I gjithë kuptimi i fjalisë lidhet me një situatë të ditës së kaluar.

Në gjuhën shqipe, fjalia gjegjëse 79 është fjali e nënrenditur kushtore dhe trajtat foljore shprehen me folje në të pakryerën e lidhore dhe të tashmen e kushtores, duke shprehur një kusht të pamundur.

Përbërja strukturore e fjalive nxitëse në periudhën me bashkërenditje. Rendi i periudhës karakterizohet nga një fjali nxitëse e ndjekur nga një fjali pyetëse, thirrmore ose nxitëse. Pra, fjalia nxitëse paraprin periudhën me bashkërenditje. Te fjalitë me bashkërenditje me marrëdhënie këpujore brendia logjike nënkupton një renditje dukurish të një fare dhe me një strukturë paralele të fjalive, p.sh. kallëzues të shprehur me folje në të njëjtën kohë. Ky paralelizëm nuk ruhet te fjalitë nxitëse të gjendura në marrëdhënie me bashkërenditje nga ana formale, por nga pikëpamja semantike ato kanë vlerë kuptimore kushtore që ngjason me një

fjali me nënrenditje kushtore. Fjalitë e dytë e periudhës mund të jetë një nga tipat e mëposhtëm me një folje-kallëzues në kohën e ardhme: *will + infinitive*, ku kushti dhe pasoja i përkasin kohës së ardhme.

80. *Book the flight* and what a holiday we will have. Fjali nxitëse, fjali thirrmore
(Rezervo fluturimin dhe çfarë pushimesh do të kalojmë.)
81. *Give up smoking* and what will they think? Fjali nxitëse, fjali pyetëse
(Lëre duhanin dhe çfarë do të mendojnë ata?)
82. *Read the book* and keep down notes. Fjali nxitëse, fjali nxitëse
(Lexoni librin dhe mbani shënime.)

Edhe fjalitë nxitëse me ndërtimin *let's (le të)* mund të kumtojnë një kusht, në rastet kur ndiqen nga një përemër i vetës së tretë, por jo i vetës së parë. Në fjalinë 83, forca shprehëse e nxitjes ose e grishjes, si tipar karakterizues i fjalive nxitëse, nuk është e dallueshme, kurse në rastin e përfshirjes së vetës së parë (njëjës ose shumës), grishja ruhet në të njëjtën shkallë (fjalitë 84) si te fjalitë nxitëse të mirëfillta.

83. *Let the students (them, her, him)*(me) develop* free topics and they will not take it seriously.

[Po (Le) të zhvillojnë tema të lira studentët, (dhe) ata nuk do ta marrin seriozisht atë.]

84. *Let's flatter* Sara for her magnificent voice and the other band members will quit immediately.

[Po të mburrim / Le të mburrim Sarën për zërin e saj të mrekullueshëm, (dhe) të gjithë pjesëtarët e bandës do të largohen menjëherë.]

Rendi dhe mjetet e lidhjes. Fjalitë nxitëse me vlerë kuptimore kushtore në periudhën me bashkërenditje lidhen me pjesën tjetër të fjalisë me lidhëzën *and*, e cila, sipas E. Davies, nuk duhet të trajtohet si e ndryshme nga lidhëza e mirëfilltë në fjalitë me bashkërenditje²⁰⁹. Ne mendojmë se ky vështrim është i drejtë, sepse në disa kontekste të tilla fjalitë nxitëse në periudhën me bashkërenditje mund të lidhen edhe asindetikisht e të shprehin vlerë kuptimore kushtore, edhe pa praninë e lidhëzës *and*.

85. *Set me free* and I shall take my revenge on the world.

[(Po të më lësh të lirë) Më lër të lirë dhe do të hakmerrem ndaj gjithë botës.]

86. *Do it again* and I will tell the nurses.

[Bëje prapë dhe (po e bëre prapë), unë do t'u tregoj infermiereve.]

87. *Collect a gang, see what good you can do.*

[(Po) organizo-ve një grup, do të shikosh ç'të mirë do të sjellësh.]

Këtë dukuri e vërejmë edhe në gjuhën shqipe. Bashkëlidhja e fjalive nxitëse në periudhën me bashkërenditje në gjuhën shqipe mund të bëhet me anë të lidhëzave këpujore *e, dhe, edhe*, si lidhëza tipike bashkërenditëse. "*Ato shprehin një bashkim të thjeshtë gjymtyrësh ose fjalish të një fare*"²¹⁰.

88. *Lexoje përsëri materialin* dhe do të kuptosh të vërtetën.

(Po e lexove materialin, do të kuptosh të vërtetën.)

Funksioni semantiko-sintaksor i lidhëzës këpujore *dhe* në këto fjali nuk është i njëjtë si në fjalitë me bashkërenditje, por përdorimi i saj ka forcë shprehëse nxitëse.

²⁰⁹ E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 200-201.

²¹⁰ *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 404.

89. *Send an e-mail and she will not reply to your boring advice.*

(Po t' i dërgosh një e-mail, ajo nuk do t' u përgjigjet këshillave të tua të mërzitshme.)

(Dërgo një e-mail dhe ajo nuk do t' u përgjigjet këshillave të tua të mërzitshme.)

Megjithatë, lidhëza *dhe* nuk është e vetmja lidhëz bashkërenditëse që gjendet në fjalitë nxitëse me interpretim kushtor. Edhe lidhëza *or* (ose) mund të lidhë dy fjali, ku e para është një fjali nxitëse e mirëfilltë me vlerë kushtore.

90. *Tell me the truth or you will regret it forever.*

(Më trego të vërtetën ose do të pendohesh përgjithmonë.)

91. *Take a taxi or you will miss the first presentation.*

(Merr taksì, përndryshe do ta humbasësh prezantimin.)

Nga ana formale kemi një fjali nxitëse të mirëfilltë, ku kryefjala mungon, e ndjekur nga një fjali që kumton pasojën e parashikuar nga mosrealizimi i kushtit të parashtruar në pjesën e parë të fjalisë. Në fjalitë me bashkërenditje të lidhura me lidhëzën *or* ana kuptimore shpreh një arsye apo argument, i cili lidhet me kryerjen ose jo të veprimit të shprehur nga fjalia nxitëse. Fjalia e dytë përmban rrjedhimin që sjell kumtimi i fjalisë së parë dhe duket të jetë jo i dëshirueshëm për dëgjuesin (do të pendohet, do të humbasë prezantimin). Në disa kontekste fjalia e dytë mund të mungojë dhe nga ana kuptimore del si një pasojë jo shumë e dëshiruar nga ana e folësit. Nuk dihet cila është pasoja që do të ketë folësi, në rast të përmbushjes së direktivës së kumtuar në pjesën e parë të periudhës.

92. *Follow your mum`s instruction or else.*

(Ndiq udhëzimet e nënës tënde, përndryshe nuk i dihet.)

Lidhur me përdorimin e lidhëzës *or*, gjuhëtarë të ndryshëm kanë shprehur mendime të ndryshme. E. Davies-i e emërton periudhën me strukturë *fjali nxitëse + or + fjali dëftore si imperative like ultimatums*. Sipas tij, periudha merr ngjyrimë urdhri dhe shpreh një ultimatum ndaj dëgjuesit²¹¹. Në dallim nga fjalitë nxitëse me vlerë kushtore në bashkërenditje me lidhëzën *dhe*, fjalitë nxitëse që bashkërenditen me lidhëzën *or* kanë vetëm kryefjalë në vetën e dytë.

93. **Take her book or she will get angry.*

(Merr librin e saj ose ajo do të inatoset.)

94. *Take her book and she will get angry.*

(Merr librin e saj dhe ajo do të inatoset.)

Klasifikimi i tyre si grup i veçantë lidhet me ngjashmërinë kumtuuese të një fjalie nxitëse të mirëfilltë. Megjithatë, këto fjali nuk duhet të veçohen nga fjalitë e tjera nxitëse me vlerë kushtore, sepse përdorimi i tyre në ligjërim nuk është gjë tjetër veçse një nga strategjitë e larmishme të komunikimit të përdorura nga folësi, në mënyrë që të shprehë kundërshti në një kontekst ligjërimi të caktuar.

Fjalitë nxitëse në strukturën e fjalive të përbëra kanë sjellë kundërshti dhe qasje të ndryshme nga ana e gjuhëtarëve. Kjo ndodh për arsye të gamës së larmishme kuptimore që fjalitë mund të marrin dhe lidhet ngushtësisht me kontekstin në të cilin përdoren, si dhe me aktin e ligjërimin që kryejnë. Fjalitë nxitëse në strukturën e fjalive të përbëra krijojnë probleme në lidhje me anën kuptimore që shprehin. Pyetja që ngrënë studiuesit lidhet me anën semantike që mbartin fjalitë nxitëse në këto përdorime: nëse ato kanë një formë logjike

²¹¹ E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 204.

të njëjtë me formën logjike të fjalive me nënrenditje kushtore apo ngjyrimet kushtore i marrin në përdorimin në nivelin pragmatik, pra në kontekstin ligjërimor²¹².

Në disa përdorime fjalitë nxitëse mund të ndiqen nga tipa të tjerë fjalish me marrëdhënie bashkërenditjeje jo me anë të lidhëzave, por me anë të intonacionit.

95. *Help him with something, you get a holiday invitation.*

(*Ndihmoje për diçka, ti merr një ftesë për pushime.*) (përkthimi literal)

(Po ta ndihmosh për diçka, do të marrësh një ftesë për pushime.)

Përfundim: Fjalitë nxitëse kanë një shtrirje të gjerë semantike dhe larmia e kuptimeve në kontekste të ndryshme lidhet me modalitetin që ato mbartin. Konteksti ku fjalia nxitëse gjen përdorim si pjesë përbërëse e fjalive me bashkërenditje, është i rëndësishëm për interpretimin e vlerës kuptimore që merr gjithë periudha me bashkërenditje. Periudha me bashkërenditje në këtë rast merr vlerë kuptimore kushtore. Struktura e fjalive nxitëse me nuanca kushtore përkon me strukturën e periudhës me bashkërenditje, por ana kuptimore e tyre nuk bashkëlidh marrëdhënie numërimi të situatave. Realizimi i njëjës situatë kushtëzohet nga mbarëvajtja e situatës tjetër. Duhet të theksojmë se te gjegjëset në shqip nuk kemi një periudhë identike me bashkërenditje të lidhur me lidhëzën shtuese *e* ose *edhe*. Fjalitë nxitëse në këto raporte nga ana kuptimore kryejnë funksionin e një fjalie të nënrenditur kushtore të lidhur me fjalinë drejtuese me lidhëzën shtuese *and* (e, dhe, edhe).

§3.4 Tipare të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme që përdoren pas fjalive nxitëse në gjuhën angleze dhe gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe (*tag-questions*)²¹³

Një karakteristikë e veçantë e fjalive dëftore në gjuhën angleze është “ngjitja” në to e disa strukturave të emërtuara si fjali pyetëse të pagjymtyrëzueshme të cilat shtojnë, përforcojnë dhe zgjerojnë kumtimin e thënies në këto fjali. Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme përkufizohen si fjali a ndërtime pyetëse të shkurtra, të cilat dalin në fund të disa thënieve në ligjërim, madje edhe në ligjërimin e shkruar joformal²¹⁴. Funksionet e tyre në fjalitë dëftore janë të ndryshme, në varësi të përmbajtjes semantike të fjalive. Dendurinë më të madhe të përdorimit ato e kanë në fjalitë dëftore, por këto ndërtime gjenden edhe në fjalitë nxitëse. Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme dallohen jo vetëm nga ana semantike, qëllimi dhe funksioni i tyre, por edhe nga struktura dhe forma gramatikore. Këtë funksion e shpreh më mirë struktura e tyre gramatikore, e cila kushtëzohet nga përbërja e foljes-kallëzues, intonacioni i tyre i veçantë, prania e disa fjalëve leksikore etj.

Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme të vendosura pas fjalive dëftore

Kur kallëzuesi në fjalitë dëftore shprehet me një *folje ndihmëse + infinitivin e foljes*, kjo folje ndihmëse do të rimerret në strukturën e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme. Në rastin kur kjo folje ndihmëse mungon, struktura e tyre përfshin foljen ndihmëse *do*. Forma e *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme* kushtëzohet nga përbërja e kallëzuesit të fjalisë kryesore (dëftore). Kur ky kallëzues në fjalinë dëftore është në formën mohore, atëherë kjo fjali do të ndiqet nga një strukturë pohore e fjalisë pyetëse të pagjymtyrëzueshme. Në rastin e kundërt,

²¹² P. Portner, *Imperatives*, Handbook of Semantics, Cambridge University Press, 2013, f.2.

²¹³ Duke iu referuar semantikës, qëllimit kumtues dhe funksionit që kryejnë, këto ndërtime apo struktura pyetëse, të cilat gjenden shpesh në fund të fjalive dëftore dhe nxitëse, i kemi emërtuar me termin fjali pyetëse të pagjymtyrëzueshme. Sipas mendimit tonë, ky term përfshin më mirë funksionet kryesore të *tag-questions*. Funksioni i përforcimit, theksimit dhe zgjerimit të kërkesës, urdhrin a direktivës është i pranishëm në të gjitha aktet e ligjërimin ku artikullohet një thënie e caktuar me modalitetin e nxitjes.

²¹⁴ M. Swan, *Practical English grammar*, Oxford University Press 2005, f. 469.

kur fjalia dëftore është një fjali mohore, atëherë ajo do të ndiqet nga një fjali pyetëse e pagjymtyrëzueshme pohore. Si rrjedhojë, ka një polaritet të kundërt midis dy strukturave të fjalive dëftore dhe të fjalive pyetëse që e ndjek atë. Vërejmë shembujt:

96. The film *was't* very good, *was it?*
 (Filmi nuk ishte shumë i mirë, *ishte ai?*) (përkthimi literal)
 (Filmi nuk ishte shumë i mirë, *apo jo / si thua?*) (kuptimi)
97. You *don't* mean that I hide them, *do you?*
 (*Ti nuk do të thuash që unë i fsheh ato, *do të thuash?*)
 (Mos do të thuash që i fsheh unë?)

Nga shembujt më lart del qartë kuptimi i fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme dhe funksionet që ato kryejnë në fjalitë dëftore. Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme janë përdorur për të shprehur dyshim, për të kërkuar konfirmim, shprehje interesi, opinion, habi etj. Në fjalitë gjegjëse të gjuhës shqipe vërejmë se nuk kemi struktura të tilla në fjalitë dëftore të ndjekura nga një pyetje fundore, si në rastin e fjalive në gjuhën angleze. Te fjalia në gjuhën shqipe (96) vërejmë se strukturat gjegjëse dalin me një pyetje fundore *apo jo* etj., kumtuar me një intonacion ngjithës. Në rastin e fjalisë në gjuhën angleze (97), folësi kërkon të marrë informacion dhe struktura *do you* e përforcon më tej qëllimin e tij. Te fjalia gjegjëse përdoret pjesëza mohuese *mos*. Kjo pjesëz në këtë fjali ndërton një fjali pyetëse me të njëjtin funksion dhe kuptim, ashtu siç përdoren fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme në gjuhën angleze.

Semantika e fjalive në të dyja gjuhët shpreh kërkesën për të marrë konfirmim apo informacion mbi diçka, e cila përforcohet dhe nxitet me anë të *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme don't you* në gjuhën angleze. Në gjuhën shqipe kuptimi gjegjës shprehet me anë të pjesëzës mohuese *mos*. Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme në gjuhën angleze dhe gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe kryejnë të njëjtin funksion. Në gjuhën shqipe këto fjali shpesh ndryshojnë nga pikëpamja strukturore duke marrë një pjesëz e cila mund të shprehë dyshim apo interes mbi atë që shpreh fjalia dëftore.

Në këtë parashtrim të shkurtër mbi fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme mëtojmë të vëmë në dukje karakteristikat dalluese të tyre në gjuhën angleze dhe të gjegjëseve të tyre në gjuhën shqipe. Gjatë qasjes krahasuese të strukturës së fjalive nxitëse jemi përqendruar te veçantitë e tyre në gjuhën angleze, për shkak të mungesës së një strukture identike të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në gjuhën shqipe. Bëmë si fillim analizën e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme pas fjalive dëftore në gjuhën angleze, sepse pas fjalive dëftore ato kanë dendurinë më të madhe të përdorimit. Përcaktimi dhe analiza e dinamikës së tyre në fjalitë dëftore na japin dorë më tej për të dalluar praninë e *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme* pas fjalive nxitëse në gjuhën angleze, në një vështrim krahasues me fjalitë përkatëse në gjuhën shqipe. Vërejmë shembujt:

98. She is strong, *isn't she?* (konfirmim ose informacion)
 (Ajo është e fortë, *apo jo?*)
 Shembulli i mësipërm shpreh konfirmim të një informacioni të ditur.
99. They won the lottery, *didn't they?*
 (Ata fituan llotarinë, *ë, apo jo?*)
 (A nuk e fituan ata llotarinë?!)

Shembulli i mësipërm shpreh një dakordësi që vjen nga ana e folësit.

100. My friend can't be that strict, *can he?* (dyshim apo pasiguri)
 (Shoqja ime *s'mund* të jetë kaq e rreptë?)
 (*Mund* të jetë shoqja ime kaq e rreptë?)

Ky shembull përdoret për të shprehur dyshim ose pasiguri. (Në këtë rast është kthyer në një fjali pyetëse.)

101. It doesn't bring about changes, *does it?*
(Kjo nuk sjell ndryshime, *apo jo, si thua?*)
Shembulli 101 përdoret për të treguar referencë.

Nga shembujt e sipërpërmendur del qartë kuptimi i fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme dhe funksionet që ato kryejnë në fjalitë dëftore. Këto fjali janë përdorur për të shprehur dyshim, për të kërkuar konfirmim, shprehje interesi, opinion, habi etj.

Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme që u bashkëngjiten fjalive nxitëse

Përdorimi i fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme pas fjalive nxitëse, me të njëjtën strukturë si në fjalitë dëftore, është një specifikë e veçantë e gjuhës angleze. Në strukturën e *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme* të cilat ndjekin fjalinë nxitëse në gjuhën angleze, përveç foljes ndihmëse *do, to be* dhe *to have*, gjendet edhe kryefjala e shprehur me një përemër, që përkon me kryefjalën e fjalisë nxitëse. Vërejmë shembujt:

102. Tell me the truth *will you?*
(Më trego të vërtetën, *mundesh, si thua... etj?*)
103. Help your daughter clean up her mess, *will / can / could you?*
(Ndhimjoje vajzën të rregullojë rrëmujën / *mundesh / a do ta ndihmosh vajzën të ...?*)
104. Follow me, *will you?*
(Më ndiq, *mundesh / do më ndjekësh mua / do vish me mua ...?*)

Duke parë këto fjali nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme, dallojmë tiparet e mëposhtme:

- Nga ana formale fjalitë nxitëse kthehen në një fjali *pyetëse*.
- Struktura e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme përmban një folje *ndihmëse* ose *modale* (*will, won't, can, can't, could, would* etj.) dhe kryefjalën e shprehur me përemrin vector *you (ti / ju)*.
- Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme kanë një *intonacion* të veçantë, me ngritje në pjesën dërrmuese të rasteve, duke u kushtëzuar nga semantika që mbart fjalia nxitëse e ndjekur nga këto ndërtime. Në fjalinë 104 intonacioni rritës përcakton semantikën e kësaj fjalie e kumtuar si një urdhër, kërkesë apo ftesë.

Për të bërë një analizë sa më të plotë dhe për të vënë në dukje dallimin mes përdorimit të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme pas fjalive dëftore dhe atyre nxitëse në gjuhën angleze, është e nevojshme t'i trajtojmë këto fjali nga ana formale, semantike, pragmatike dhe nga stili i përdorimit. Një analizë e tillë e fjalive nxitëse na lehtëson në përshtatjen e tyre në gjuhën shqipe dhe në gjetjen e fjalive nxitëse gjegjëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme.

Strukturat e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme që ndjekin fjalitë nxitëse

Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme janë konstruktet të ndërtuara nga një folje modale *will, would, can, could* etj. + përemrin e vetës së dytë **you** në funksionin e kryefjalës, pra *folje modale + kryefjalë*. Kryefjala e vetës së dytë **you (ti)** shfaqet në fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme *will you*, duke plotësuar mungesën e saj në fjalinë nxitëse. Prania e kryefjalës në këto struktura ka efekte të ndryshme në semantikën që mbart fjalia. Ajo thekson ose përforcon veprimin që duhet të kryhet dhe nxit dëgjuesin të veprojë.

105. *Read the letter, will you?*

(Lexoje letrën, hë pra (ti).?)

**Read the letter, will he?*

Nga ana strukturore këto fjali mund të grupohen në dy tipa:

1. Fjali nxitëse të thjeshta, të ndjekura nga *fjali pyetëse të pagjymtyrëzueshme will / would / can you.*
2. Fjali nxitëse me *let's (we - ne) (le të)*, të ndjekura nga *shall we.*

Në të dy rastet folja modale *can* (mund) përdoret më rrallë. *Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme* ndryshojnë forcën shprehëse të fjalive nxitëse. Zgjedhja e foljeve ndihmëse a modale në strukturën me fjali pyetëse të pagjymtyrëzueshme lidhet me situatën ligjërimore ku veprojnë dy aktorët: *folësi - dëgjuesi* ose *i adresuari*. Folësi i kërkon dëgjuesit të kryejë një urdhër, të bëjë një kërkesë etj. Në çdo rast realizimi i veprimit varet nga vullneti i dëgjuesit për ta kryer. Bolinger (1967) thekson: “Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme në fjalitë nxitëse janë veç një thirrje ndaj vullnetit të folësit²¹⁵”. Këtë e dallojmë te fjalia që vijon:

106. *Help me, will you?*

(Më ndihmo / Ndhimomë, si thua, apo jo?)

Kjo përcakton dhe zgjedhjen e foljeve modale në strukturën e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme. Struktura e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme dhe veçoritë e ligjërimin përcaktojnë edhe kumtimin e fjalisë nxitëse, nëse ajo shpreh një urdhër, ofertë (grupi i parë i fjalive) ose një veprim të përbashkët, ku përfshihet dhe folësi (grupi i dytë i fjalive).

§3.4.1. Vlera kuptimore e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme

Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme vendosen pas fjalive nxitëse për të shprehur një *larmi qëllimesh* nga ana e folësit në një situatë të caktuar komunikimi. Duke ditur spektrin e gjerë që mbart semantika, si koncept në përgjithësi, na duhet të veçojmë rastet më tipike të përdorimit të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme pranë fjalive nxitëse në situata të ndryshme ligjërimore. Semantika e tyre është mjaft e gjerë, duke pasur parasysh faktorët kontekstualë që ndikojnë në interpretimin dhe përkapjen e kuptimit të një thënieje të caktuar. Këto thënie (të kumtuara në fjalitë nxitëse) rimerren, përforcohen a zgjerohen në fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme, të cilat, nga ana strukturore, ngjajnë me fjalitë pyetëse. Ato kanë vlerën e një fjalie pyetëse nga ana kuptimore dhe prania e foljeve modale në strukturën e tyre na jep një fjali eliptike.

Vërejmë shembujt:

107. *Stop playing with these toys, will you; can't you?*

(Ndalo së luajturi me lodra, do të? mund të?)

(përkthimi literal)

(Ndalo së luajturi me lodra, hë pra! / Lëre lojën me lodra, nuk dëgjon?)

(Mos luaj më me lodra!)

A. Te fjalia 107 folësi jep një urdhër të shprehur me një fjali nxitëse. Në fjalinë e dytë ky urdhër, i kumtuar nëpërmjet fjalisë nxitëse me foljen-kallëzues në mënyrën urdhërore, rimerret sërish me anë të një pyetjeje fundore për të shprehur ndjenjën e *inatit, irritimit* apo

²¹⁵ Cituar nga D. Kimps, K. Davidse, “*Illocutionary force and conduciveness in imperative constant polarity tag questions: A typology*”, Walter de Gruyter, 2008, f. 708.

padurimit. Fjalja shoqërohet me një ton rritës në pjesën fundore të saj. Në fjalinë 107 kemi dhënë fjalinë nxitëse gjegjëse të shqipes dhe përkthimin literal, tek i cili vërejmë mospërputhjen e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme të gjuhës angleze me fjalitë nxitëse gjegjëse në gjuhën shqipe. Si rrjedhojë, të dyja gjuhët dallojnë në ndërtimin strukturor të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme dhe në fjalitë gjegjëse këto ndërtime mund të jenë një *fjali pyetëse fundore* si: nuk dëgjon, si thua apo eliptike.

Nga krahasimi i shembullit të anglishtes me atë në gjuhën shqipe vërejmë përdorimin e:

1. Pjesëzave *mos, më, hë, pra* etj.

2. Foljes *dëgjoj* në mohore, për të përforcuar ndjenjën e padurimit apo për të nxitur zbatimin e urdhrin të dhënë. (Kjo folje në këto fjali nuk përdoret me kuptimin e aftësisë për të kapur me anë të veshit tinguj, zhurma etj., por, përkundrazi, nxit dhe përforcon kuptimin e thënies.)

3. *Intonacionit*, si një mjet i rëndësishëm në shprehjen e kuptimit që folësi dëshiron të transmetojë.

Gjatë akteve të ndryshme të ligjërit përdorimi i këtyre mjeteve leksikore dhe gramatikore në fjali ndihmon në shprehjen sa më të qartë të kuptimit leksikor, të ndjenjës së inatit, padurimit etj. Një akt i tillë ligjërimi në fjalinë 107 mund të përfshijë si pjesëmarrës nënën dhe fëmijën.

108. *Print the form for me, can you? Do it now, will you?*

(Mund të ma printosh formularin? / A mundesh të ma printosh formularin? / Mund ta printosh formularin? / Bëje tani, si thua? / apo jo? / apo s'e bën? hë pra. / Printoje tani, si thua? / apo jo? / apo s'e bën? hë pra.

B. Në fjalinë 108 folësi bën një kërkesë *neutrale* dhe një kërkesë *të prerë*, duke theksuar në të njëjtën kohë edhe statusin apo autoritetin që ai zotëron ndaj bashkëfolësit. Në këtë rast bashkëfolësi mund të jetë vartësi, i cili pritet të zbatojë një kërkesë të drejtuar ndaj tij. Duke analizuar barasvlerësit përkatës të shembullit 108 në gjuhën shqipe, vëmë re se për të vënë në dukje kërkesën neutrale të folësit në shqip, janë përdorur:

a. Folja gjysmëndihmëse me vlerë modale *mund* (can), e ndjekur nga një folje në mënyrën lidhore. Në gjuhën angleze infinitivi, si një formë e pashtjelluar e foljes, i korrespondon në gjuhën shqipe formës së shtjelluar të foljes në mënyrën lidhore.

b. Pjesëzat modale dhe emocionuese shprehëse si: *hë pra, a* etj.

c. Intonacioni, si një tipar i pandarë i gjuhës së folur²¹⁶ dhe mjaft i rëndësishëm në këtë akt ligjërimi. Folësi duhet të nxjerrë në pah kërkesën e bërë, e cila pritet të kryhet nga dëgjuesi. Një intonacion me tone në rritje nxit vartësin që të kryejë detyrën e ngarkuar nga drejtuesi.

Duke pasur parasysh dhe një prej funksioneve të përdorimit të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme pas fjalive nxitëse në gjuhën angleze, *zbehjen* e nocionit kuptimor urdhërues, vërejmë se fjalja ka një intonacion të veçantë pyetës ngjites. Fjalja nxitëse është shndërruar në një fjali pyetëse, duke kumtuar një kërkesë në formën e një pyetjeje dhe jo një kërkesë ndaj të adresuarit. Pra, në këtë rast struktura e fjalisë dhe vlera kuptimore i qasen një fjalie pyetëse të mirëfilltë²¹⁷.

109. *Take a seat, will you?*

(Uluni, zini vend, *urdhëroni*.)

110. *Lend me the pen would you, could you?*

(*Mund të më huani pak stilolapsin?*)

²¹⁶ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 119.

²¹⁷ Ka një debat të hapur mes gjuhëtarëve në lidhje me emërtimin e tyre si fjali pyetëse apo nxitëse, duke analizuar peshën që ka kumtimi dhe struktura ndërtimore e fjalisë. Në këtë rast konteksti ku zhvillohet akti i komunikimit ndikon në emërtimin e fjalive sipas tipit ku ato bëjnë pjesë.

C. Në fjalinë 109, për një kërkesë, ftesë apo ofertë sa më miqësore, fjalia nxitëse ndiqet nga foljet modale *would / will* ose *could* për të përforcuar mirësjelljen e treguar. Me të njëjtën vlerë, në gjuhën shqipe përdoren një sërë mjetesh leksikore për të përmbushur qëllimin e folësit si: *a mundesh, pak, urdhëroni* etj. Në gjuhën angleze strukturat e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme me *would you / could you*. shprehin shkallën më të lartë të kortezisë dhe mirësjelljes. Fjalitë pyetëse të ligjërimit joformal në gjuhën angleze ndërtohen me foljet modale *can you / can't you*. Në një ligjërim të tillë kemi “doza” të pakta mirësjelljeje krahasuar me rastet ku përdoren *would, will* apo *could*. Te fjalitë nxitëse mohore si 111, strukturë e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme përmban vetëm foljen modale *will*.

111. *Don't write the address, will you?*

(Mos e shkruaj adresën, si thua / dakord / në rregull?)

Në këto fjali nuk përdoren foljet e tjera modale si: *would, can* etj., të cilat gjenden në strukturën e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në fjalitë nxitëse pohore.

Veçori e fjalive gjegjëse në gjuhën shqipe, si në fjalinë 110, është përdorimi i ndajfoljes së sasisë *pak*, e cila në shembullin tonë nuk shpreh shkallën e intensitetit apo të sasisë së një veprimi. E gjejmë të përdorur shpesh në ligjërimin bisedor, veçanërisht në fjalitë nxitëse të cilat kumtojnë një kërkesë me mirësjellje. Me këtë vlerë kuptimore e gjejmë të përdorur edhe në fjali të tjera si:

112. *Më kalo pak motrën në telefon.*

Më sill pak fjalorin.

Do të më japësh pak adresën e institucionit ku punoni?

Në fjalitë nxitëse, por edhe në tipat e tjerë të fjalive, *pak* është një ndajfolje e zhveshur nga kuptimi i saj i sasisë. Ndajfolja *a bit* e gjuhës angleze nuk përkon në të gjitha rastet e përdorimit të saj me ndajfoljen *pak* në gjuhën shqipe. Ndajfolja *pak* ka një përdorim më të gjerë në ligjërimin e folur, sepse prania e saj në një fjali nxitëse ku folësi kumton një urdhër a kërkesë, e bën ligjërimin e tij më miqësor dhe më të sjellshëm. Folësi zbut forcën urdhëruese që mbart një fjali nxitëse dhe ka një pritshmëri më të lartë të realizimit të urdhrit a kërkesës nga ana e të adresuarit. Në gjuhën angleze mund të përdoret *a bit* në një fjali nxitëse si:

113. *Wait a bit.*

(Prit *pak*.)

Në këtë çift fjalish vërejmë një përputhje të plotë të kuptimit leksikor të ndajfoljes *a bit* me ndajfoljen *pak* në gjuhën shqipe. *A bit* në këtë fjali është përdorur si një ndajfolje sasie, e cila shpreh shkallën e kryerjes së një veprimi, kohëzgjatjen e pritjes. Edhe në gjuhën shqipe ka të njëjtin përdorim dhe të njëjtin kuptim leksikor. Por në lloje të tjera fjalish që shprehin nxitje ose nuanca të tjera kuptimore, ndajfolja *pak* nuk mbart kuptimin leksikor si ndajfolje, por shfaqet e zhveshur nga kuptimi i saj dhe del me një funksion të caktuar kumtues, si për të shprehur një kërkesë sa më të sjellshme. Këtë ndajfolje e gjejmë të përdorur dhe në gjuhën frënge.

Në frëngjisht, në fjalinë nxitëse, ndajfolja *un peu* (*pak*) mund të ndjekë foljen-kallëzues të fjalisë nxitëse pa kuptimin e saj thelbësor.

114. *Passe-moi un peu le sel!*

(Ma kalo *pak* kripën.)

115. *Ouvre un peu la fenetre.*

(Hape *pak* dritaren.)

Te këto fjali nxitëse vërejmë përdorimin e ndajfoljeve *un peu, donc* etj. si një karakteristikë e foljes-kallëzues në mënyrën urdhërore për këtë gjuhë²¹⁸.

D. Në fjalitë nxitëse veprimi i shprehur nga folja-kallëzues (me folje në mënyrën urdhërore) në përgjithësi i përket një çasti kohor të së ardhmes. Megjithëse referenti kohor i veprimit lidhet me të ardhmen, në gjuhën angleze hasen raste ku folja-kallëzues në fjalinë nxitëse mund të jetë në një nga kohët e vazhduara. Si rrjedhim, “ngjitja” e këtyre fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në fund të fjalive nxitëse që kanë në strukturën e tyre një infinitiv në aspektin e vazhduar, nxjerr në pah një prej veçorive të urdhërores i përket së ardhmes). Kjo strukturë, e ndërtuar nga *will + infinitive*, është mënyra më e rëndomtë për të folur për një veprim në të ardhmen²¹⁹, duke ngërthyer gjithashtu kuptimin e fjalisë nxitëse me një folje në kohët e vazhduara. Të analizojmë shembullin e poshtëshënuar:

116. *Be getting on, will you?*

(*Të jesh duke vazhduar, apo jo?)

Mungesa e kategorisë së aspektit në gjuhën shqipe, si një kategori e veçantë, na jep një fjali jo të rregullt nga ana gramatikore dhe semantike. Përdorimi i foljes në kohën e tashme të mënyrës urdhërore do të ishte përkthimi dhe përshtatja e duhur në gjuhën shqipe, si dhe pyetja eliptike *apo jo* si te fjalia më lart.

117. *Get on with this, will you?*

(Vazhdo me këtë gjë, apo jo? / hë pra.)

Mc.Gregor (1997)²²⁰ analizën e semantikës së fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme që u bashkëngjiten të gjithë tipat e fjalive kryesore, e bazon në analizën sintagmatike të strukturës së tyre. Kjo strukturë përfshin fjalinë kryesore (*host clause*) + fjalinë pyetëse të pagjymtyrëzueshme, që është e lidhur strukturalisht me fjalinë që shoqëron. Fjalia kryesore mund të jetë dëftore, nxitëse, pyetëse ose thirrmore (veçanërisht te fjalitë dëftore dhe nxitëse). Në varësi të tipit të fjalisë, vlera *shprehëse* e saj ndryshon. Ajo mund të kumtojë, të pohojë etj. një thënie (fjalia dëftore) apo mund të mbartë kuptimin e një urdhri, një kërkesë etj. (fjalia nxitëse). Sipas Mc.Gregor-it, “*fjalitë nxitëse, të ndjekura nga fjali pyetëse të pagjymtyrëzueshme me polaritet konstant, janë ato fjali ku polariteti i fjalisë kryesore dhe i fjalisë pyetëse të pagjymtyrëzueshme është i njëjtë*”.

118. *Drive him to the airport, will you?*

(fjali nxitëse)

(Çoje atë me makinë në aeroport, mundesh?)

Thelbi kuptimor i fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në shembujt e mësipërm mbart kuptime ndërpersonale, të cilat kanë të bëjnë me pozicionin e pjesëmarrësve në ligjërim, në lidhje me përmbajtjen përshkruese të komunikimit të tyre, ashtu si edhe rolin social dhe gjuhësor që ata gëzojnë në këtë shkëmbim²²¹. Sipas analizës së Mc. Gregor-it, fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme jo vetëm që shënojnë përgjigjen që folësi pret të marrë nga dëgjuesi, por në të njëjtën kohë tregojnë mënyrën se si fjalia kryesore (e cila ndiqet nga fjali pyetëse të pagjymtyrëzueshme) lidhet me kuptime të tilla si: supozime, pritshmëri apo me qëndrimin e folësit ndaj dëgjuesit në një situatë ligjërimore.

²¹⁸ A. Goosse, *Le bon usage*, Éditions Duculot, 1993, f. 1263.

²¹⁹ M. Swan, *Practical English grammar*, Oxford University Press, 2005, f. 186.

²²⁰ D. Kimps, K. Davidse, “*Illocutionary force and conduciveness in imperative constant polarity tag questions: A typology*”, Walter de Gruyter, 2008, f. 700-701.

²²¹ Halliday (1994), cituar nga D. Kimps, K. Davidse, “*Illocutionary force and conduciveness in imperative constant polarity tag questions: A typology*”, Walter de Gruyter, 2008, f. 700.

Disa nga tiparet e ligjërimit që luajnë rol në përcaktimin e semantikës së fjalive nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme janë: intonacioni i veçantë, struktura e tyre, pjesëzat e ndryshme, situata ligjërimore, konteksti etj. Tabela e mëposhtme përmban strukturat e mundshme të fjalive nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme dhe shkallën kuptimore të mirësjelljes.

Semantika përdorimit	e	Urdhërore + tags	Shkalla kuptimore e mirësjelljes
Ftesë		Take a seat, won't you	Në mënyrë të sjellshme
Urdhër		Help me, can you?	Shumë miqësore
		Help me, can you?	Miqësore (duke treguar dhe ndjenjë inati)
		Close the window, would you?	E sjellshme
		Fax / get / take it now, will you?	Jo e sjellshme
Urdhër i prerë		Don't forget, will you?	Me nxitëse mohore vetëm <i>will</i> mund të përdoret në strukturën e <i>fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme</i>

Nga tabela shikojmë se për të qenë sa më të sjellshëm dhe miqësorë, duhet të përdorim *will*, *would*, *won't you*, ndërsa *can*, *can't you* përdoren në situata më pak miqësore dhe më pak të sjellshme.

§3.4.2. Fjali nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme që shprehin urdhra, kërkesa, këshilla, oferta, ftesa

Fjalitë nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme që shprehin urdhra dhe kërkesa, kanë këto veçori tipike:

- Folësi është pjesëmarrësi që *sundon* dhe *përfituesi* në këtë akt ligjërimit.
- Fjalja pyetëse e pagjymtyrëzueshme *will you* shënon një përputhje me thënien urdhëruese.
- Fjalja pyetëse e pagjymtyrëzueshme *zbut* sadopak efektin *urdhërues* të fjalisë nxitëse, që shpreh urdhër, kërkesë, lutje, porosi, këshillë etj.
- Fjalja ka një urdhërore të thjeshtë të foljes.
- Kallëzuesi i fjalive nxitëse shpesh shprehet me foljet *get* (marr, gjej), *give* (jap), *take* (marr) etj.
- Fjalja nxitëse shoqërohet dhe me pjesëza të ligjërimit si: *just*, *then*, *so*, *hey*, *say*, të cilat kanë funksion nxitës në fjali. Këto pjesëza e nxisin dëgjuesin të kundërveprojë ndaj veprimit të dëshiruar nga folësi për të përmbushur kërkesën e dhënë. Në këto fraza fjalja pyetëse e pagjymtyrëzueshme përmban gjithmonë kryefjalën *you: will + you*. Në rastet e kërkesave ku fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme kanë efekt më zbutës, gjejmë dhe strukturën me *would*, në të cilën dëgjuesi nuk ka të njëjtin status në marrëdhënie me folësin, në raport me urdhrat. Prandaj përdorimi i *would* shton një ton më zbutës, disi miqësor dhe shpreh diçka të kërkuar dhe jo të urdhëruar prej folësit.

119. Well, *fax the form for me, would you?*

(*Shiko / Pra*, dërgoje me faks formularin. / *Pra*, a nuk e dërgon me faks formularin? A s'e dërgon pak këtë faks për mua?)

Në shembullin e mësipërm vërejmë një veçori të ligjërimit bisedor në gjuhën shqipe, përdorimin e pjesëzës mohuese *nuk* me efekte zbutëse të urdhrit ose kërkesës, kur folësi kërkon të theksojë familjaritet, informalitet dhe dashamirësi. Edhe pse përdor një pjesëz mohuese, folësi, në të kundërt, ka një pritshmëri pozitive në përmbushjen e kërkesës që i bën dëgjuesit.

Në disa raste të këto fjali mund të gjejmë të përdorur edhe *thirrorin*, i cili e veçon dëgjuesin si marrës të urdhrit ose të kërkesës. Funkzioni zbutës i përdorimit të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në urdhra dhe kërkesa dallohet dhe nga intonacioni i fjalisë, i cili luan një rol të rëndësishëm. Urdhri shqiptohet me një intonacion në rënie në pjesën e parë të fjalisë dhe me intonacion ngjithës të fjalja pyetëse e pagjymtyrëzueshme.

120. *Get it ↓ now, will /you? ↑*
(Merre tani, *hë pra.*)

Në raste të tjera ku folësi në një kontekst të caktuar dëshiron të shprehë një ndjenjë inati, mërzitjeje apo irritimi, intonacioni është unik si në fjalinë nxitëse, ashtu edhe në fjalinë pyetëse të pagjymtyrëzueshme që e ndjek atë. Por, duhet të theksojmë se fjalia pyetëse e pagjymtyrëzueshme në këto periudha ndryshon përmbajtjen e fjalisë nxitëse dhe nuancat kuptimore që ajo mbart.

Fjali nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme që shprehin *këshilla, oferta, ftesa*. Në fjalitë nxitëse që shprehin një këshillë për dëgjuesin, folësi nuk është sundues (kontrollues) në këtë akt komunikimi. Përkundrazi, *dëgjuesi* është më *sundues* dhe merret si përfitues në këta tipa fjalish. Në ligjërim, në këtë grupim, numrin më të madh të fjalive e përbëjnë ftesat dhe ofertat.

121. *Have a drink, will you?*
(Pini diçka.)

122. *Take a seat, will you?*
(Zini vend. / Uluni.)

Këto periudha kanë veçoritë e mëposhtme:

- a. Këto fjali kanë një urdhërore të thjeshtë.
- b. Fjalia pyetëse e pagjymtyrëzueshme ka strukturë të tillë: *will / would + you* në tags.
- c. Mund të kenë në strukturën e tyre dhe disa *pjesëza*, zgjedhja e të cilave varet nga konteksti ku fjalia përdoret.

123. *Well / listen come and join us, right?*
(*Shiko / Dëgjo / Eja me ne. / Eja bashkohu me ne, si thua?*)

d. Shpeshherë në strukturën e fjalive nxitëse mund të gjendet edhe një thirror, përdorimi i të cilit thekson qëllimin e situatës ligjërore, tërheq vëmendjen e dëgjuesit (si pjesëmarrësi përfitues) për të pritur këshillën, ftesën etj. Nëse fjali pyetëse të pagjymtyrëzueshme të tilla si: “*right, will you, would, could you*” gjenden në një fjali nxitëse me nuanca kuptimore të një oferte, ftese apo këshille, pritshmëria e folësit është drejt një përgjigjeje pozitive nga ana e të adresuarit. Rastet për një refuzim të ftesës ose të ofertës janë më të pakta në një kontekst të tillë ku folësi, me anë të *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme, intonacionit, pjesëzave modale* dhe *zbutëse*, shpreh këmbënguljen e tij për të kryer një akt komunikimi, në të cilin dëgjuesi është përfitues. Intonacioni në këto fjali është me *tone ngritjeje unike*.

Në një pikë ku folësi dhe dëgjuesi shpërfaqin një baraspeshë të shkallës së kontrollit dhe të përfitimit, del tipi i dytë i fjalive të ndërtuara me *let's + shall we* (*le të + fjalia pyetëse e pagjymtyrëzueshme*). Tipi i dytë strukturor mbart vlera kuptimore që burojnë nga veprimi i

përbashkët mes folësit dhe dëgjuesit dhe gjenden në një shkallë të barabartë apo të përafërt të përfitimit nga përmbushja e këshillës, ftesës apo ofertës së bërë. Semantika e fjalive drejtohet drejt një bashkëveprimi të të dy pjesëmarrësve dhe në strukturën e *fjalisë pyetëse të pagjymtyrëzueshme* gjejmë *shall* (do të) dhe si kryefjalë përemrin vetor të vetës së parë shumë *we*.

124. *Let's go for a walk, shall we? Right? Okay?*

(Le të shkojmë për shëtitje. A shëtisim *pak*? Shkojmë për shëtitje, *si thua?* Shëtisim, *hë pra, a shëtisim?*)

125. *Let's get back tomorrow, shall we?*

(Le të kthehemi nesër. Kthehemi nesër, *si thua?* A kthehemi nesër? Sikur të kthehemi nesër, *si thua?*)

Efekti zbehës i forcës shprehëse urdhëruese jepet me anë të *shall* në strukturën e fjalisë pyetëse të pagjymtyrëzueshme. Intonacioni në këtë tip fjalish është ngjites. Te fjalitë gjegjëse të gjuhës shqipe 124 dhe 125 vërejmë:

a. Folja-kallëzues në fjalinë nxitëse mund të jetë në mënyrën lidhore, e paraprirë nga pjesëza *le*, në kohën e tashme, mënyra dëftore (në këtë rast intonacioni në ngritje e veçon fjalinë si nxitëse).

b. Përdorimin e pjesëzave të përmendura dhe më parë, që përbëjnë një specifike të gjuhës shqipe. Ndajfolja *pak*, pjesëzat *hë pra, a* shprehin këmbëngulje, hezitim drejt një pritshmërie pozitive dhe fjalia ka intonacion në ngritje si në gjuhën angleze, ashtu edhe në gjuhën shqipe. Edhe në gjuhën angleze tek tipi i fjalive me *let's + shall we* vërejmë përdorimin më të madh të pjesëzave të ndryshme si: *ok, right, er, then* etj.

Fjalia pyetëse e pagjymtyrëzueshme haset rrallë pas fjalive nxitëse mohore dhe kjo gjë e kufizon përdorimin e foljeve të tjera modale. Në këtë rast *will* ose *can* gjejnë përdorim në fjalitë mohore.

125. *Don't lock the door, will/ can you?*

(Mos e mbyll derën, në rregull?)

Në paragrafët e mësipërm kemi bërë një analizë të fjalive nxitëse pohore të ndjekura nga një folje modale dhe përemri vetor *you*.

Pas fjalive nxitëse mohore fjalia pyetëse e pagjymtyrëzueshme del me të njëjtën strukturë si në ato pohore. Po të krahasojmë fjalitë dëftore të ndjekura nga fjalia pyetëse e pagjymtyrëzueshme, do të vëmë re se ato përmbajnë një fjali pohore, por të ndjekur nga një fjali pyetëse e pagjymtyrëzueshme në formën mohore dhe e kundërta.

126. *He won the first prize, didn't he?*

(Ai fitoi çmimin e parë, apo jo?)

127. *He didn't win the first prize, did he?*

(Ai nuk e fitoi çmimin e parë, apo jo?)

Përveç strukturave me folje ndihmëse ose modale, me funksionin e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme pas fjalive nxitëse mund të ndeshet dhe një strukturë e ndërtuar nga përemri pyetës *why* (pse) + *don't + you*.

128. *Book the Chinese restaurant for your birthday party, why don't you?*

(Pse nuk rezervon restorantin kinez për festën e ditëlindjes?)

Pra, konstrukti “*why don't you?*” mund të përshtatet në kontekste në gjuhën shqipe me kuptimin: *Pse nuk... po sikur*. E gjejmë një përdorim të tillë edhe në gjuhën shqipe, pra me një fjali pyetëse, për të shprehur një propozim në mënyrë të tërthortë.

ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme, në të shkruar nuk mund të shprehin kumtimin që folësi synon të realizojë jashtë kontekstit ku kryhet ky akt komunikimi, sepse mjetet e ligjërimin (si intonacioni) nuk veprojnë në këtë kontekst. Pra, në të shkruar konteksti është shumë i rëndësishëm, sepse dhe semantika e fjalive nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme është e qartë brenda një konteksti të caktuar.

Mospërdorimi i fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në gjuhën shqipe, me të njëjtën strukturë si në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze, e vështirëson përvetësimin e tyre nga ana e nxënësve që mësojnë anglishten si gjuhë të huaj. Dhënia e një gjegjëseje të plotë në gjuhën shqipe i pengon ata në përshtatjen e plotë të kumtimit që mbartin fjalitë nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme. Përshtatja jo e saktë e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në bashkëlidhje me fjalitë nxitëse që mbartin kumtimin e një kërkesë, oferte a urdhri, do të sjellë një përdorim të gabuar të tyre. Kjo e shndërron kumtimin nga një nuancë kërkesë në një urdhër të prerë, duke realizuar në këtë mënyrë një akt komunikimi ku marrëdhënia ndërpersonale dhe synimi i folësit në këtë bashkëbisedim nuk përkojnë.

Përdorimi i fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme me fjalitë nxitëse nuk është një karakteristikë vetëm e gjuhës angleze. Ato i gjejmë dhe në gjuhë të tjera për arsye të ndryshme stilistikore ose kuptimore. Gjuha frënge ka *n'est-ce pas* në një kontekst formal, gjuha gjermane ka *nicht wahr*, gjuha kineze ka *ma*. Duke u bazuar në shembujt e përmendur, vërejmë se gjuha shqipe nuk mund të përdorë struktura të tilla për të kryer funksione të ndryshme kuptimore. Gjuha shqipe përdor të tjera mjete për të shprehur kumtime të ndryshme të fjalisë. Ashtu si gjuha angleze, gjuha shqipe me anë të intonacionit mund të shënojë edhe nuancat kuptimore që merr fjalia në përdorime të ndryshme. Nga studiues të ndryshëm është theksuar se fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme, si në fjalitë nxitëse dhe në fjalitë dëftore, janë më tepër një karakteristikë e ligjërimin femëror sesa atij mashkullor (Lakoff 1975²²³). Gjithashtu, fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme janë më tepër një karakteristikë e veçantë e ligjërimin bisedor britanik sesa atij amerikan.

Ne mendojmë se një mësuese e gjuhës angleze, gjatë shpjegimit dhe dhënies së gjegjëseve të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në gjuhën shqipe, duhet t'i mëshojë jo vetëm dallimeve stukturore të fjalive nxitëse me këto struktura fundore (në planin kontrastiv anglisht-shqip), por edhe funksionit komunikues që ato kryejnë në ligjërim: mirësjelljes, zbehjes së kumtimit urdhërues etj. Konteksti ku zhvillohet një ligjërim i tillë ndikon në interpretimin e fjalive nxitëse, të cilat janë karakteristikë e ligjërimin bisedor²²⁴.

Përfundim: Përdorimi i *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme* së bashku me fjalitë nxitëse është një karakteristikë e veçantë e gjuhës angleze. Struktura të tilla nuk hasen në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe dhe në përkthimin literal përftohen fjali nxitëse të ndjekura nga disa pjesëza që shprehin dyshim, miratim, dakordësi ose pjesëza mohuese *mos* (jo me kumtimin e mirëfilltë mohues). Funksioni kryesor i përdorimit të tyre lidhet me zbehjen e nocionit urdhërues të urdhërores në përgjithësi dhe kumtimin e një thënieje më me mirësjellje. Faktor i rëndësishëm në përvetësimin, përdorimin dhe përshtatjen e *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme* në gjuhën shqipe është konteksti. Pjesëmarrësit në një ligjërim ku kumtohet një kërkesë, një urdhër, një ofertë etj. dhe marrëdhënia që ata kanë në këtë bashkëbisedim, kushtëzojnë semantikën e fjalive nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme dhe njëherazi ndikojnë në dhënien e gjegjëses së duhur në gjuhën shqipe.

²²³ R. Lakoff, *Language and woman's place*, 1975.

²²⁴ Përshtatja e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe, edhe pse me një strukturë të ndryshme nga gjegjëset në gjuhën angleze, tregon tiparet universale që gjuhët demonstrojnë dhe gjithashtu universalizmin e përdorimit të urdhërores në përgjithësi në pothuajse të gjitha gjuhët.

§3.5. Bashkëpërkime në përbërës semantikë midis fjalive nxitëse me fjalitë dëftore dhe pyetëse në gjuhën angleze

Semantika urdhëruese dhe drejtuese e fjalive nxitëse nuk shprehet formalisht vetëm nga mënyra urdhërore e foljeve. Disa teknika gjuhësore të përdorura për të shprehur kuptime të ndryshme të semantikës së fjalive nxitëse përfshijnë fjalitë pyetëse, dëftore, shprehje gjuhësore eliptike, fjali të pavarura etj. Kjo tregon se tipat e fjalive nuk mund të kufizohen brenda spektrit kuptimor të tyre, por në ligjërime të caktuara mund të shkëmbejnë funksionin kumtues që luajnë. Një shkëmbim i tillë thekson rëndësinë e kontekstit ku zhvillohet ligjërimi dhe njëherazi rëndësinë e anës pragmatike të gjuhës.

Le të krahasojmë këto përdorime me fjalitë e mirëfillta nxitëse.

Fjalitë dëftore. Semantika e fjalive nxitëse është shumë e larmishme dhe mund të gjejë shprehjen e saj jo vetëm te fjalitë nxitëse, por edhe te fjalitë dëftore. Kuptimi urdhërues mund të shprehet edhe me një fjali dëftore që e ka foljen-kallëzues në kohën e ardhme dhe i drejtohet një çasti kohor pas ligjërimin. Në këto përdorime forca shprehëse e fjalive nxitëse shfaqet më e zbutur dhe urdhri merr ngjyrimet kuptimore të këshillës, porosisë ose rekomandimit. Pra, nga ana e semantikës kuptimore përftojmë urdhra, porosi, kërkesa të një shkalle urdhëruese më të ulët, në të cilat dallohen qartë nuancat kuptimore të mirësjelljes. Përdorime të tilla përbëjnë një prej mjeteve gjuhësore për të shprehur kuptime të tërthorta të udhëzimit, urdhrit a porosisë. Nga ana strukturore, nuk dallojnë nga një fjali dëftore e mirëfilltë, por intonacioni, konteksti dhe kumtimi që ato shprehin, i për afrojnë më shumë me fjalitë nxitëse. Në strukturën e fjalive dëftore ka edhe folje modale, modaliteti i të cilave e bën një urdhër ose një kërkesë më të tërthortë. Vërejmë shembujt:

129. “*You should get right to a hospital,*” the doctor had told him. “*You have lost a good deal of blood.*”

(“*Ti duhet të shkosh menjëherë në spital,*” - i kishte thënë doktori. “*Ti ke humbur shumë gjak.*”) (“*Bloodline*”, Sidney Sheldon, f. 407.)

E parë në kontekstin ku zhvillohet ligjërimi, fjalia dëftore shpreh një “urdhër” në formën e një këshille, rekomandimi apo udhëzimi nga ana e doktorit, folësit në këtë rast. Folësi, në vështrimin e tij e gjykon shumë urgjente kryerjen e veprimit, por në bisedën me dëgjuesin (pacientin), ai shpreh edhe mirësjellje, duke i shtuar kumtimin të tij nuancat kuptimore të këshillës.

130. Major Wageman thought for a moment and then said, “*All right. Check it out. I want you to go there yourself. Do you understand?*”

(Major Wageman-i mendoi një çast dhe tha: “*Në rregull. Kontrollloje. Unë të dua ty të shkosh vetë aty.*”) (“*Bloodline*”, Sidney Sheldon, f. 292.)

Në këtë kontekst folësi (majori) i drejtohet dëgjuesit (vartësit) për të kumtuar një urdhër apo një detyrë për ta përmbytur, si fillim me një fjali nxitëse, më tej me një fjali dëftore dhe në fund me fjali pyetëse. Duke kundruar marrëdhënien ndërpersonale dhe situatën ligjërimore, kemi zhvendosjen nga një urdhër i prerë dhe kategorik, në një urdhër me ngjyrimet kuptimore të kërkesës ose udhëzimit. Edhe gje gjegjëset në gjuhën shqipe mund të shprehin kuptimet e fjalive nxitëse të para në kontekstet ku përdoren. Ato shprehin modalitetin e domosdoshmërisë dhe afrohen me fjalitë nxitëse²²⁵.

Fjalitë pyetëse. E ndërtuar strukturalisht si një fjali pyetëse dhe me funksionin kumtues të një pyetjeje, fjalia pyetëse mund të shprehë nga ana semantike edhe një kërkesë, një ofertë apo dhe një ftesë si veçanti dalluese e fjalive nxitëse.

²²⁵ Gramatika e gjuhës shqipe II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 125.

131. *Could you lend me your dictionary?*
(Mund të më huash fjalorin tënd?)

Fjalja 131, e ndërtuar si një pyetje, shpreh një kërkesë të folësit ndaj të adresuarit. Si rrjedhojë, kjo fjali pyetëse realizon një akt ligjërimi të një kërkesë, kuptim i cili kushtëzohet nga marrëdhënia mes dy bashkëbiseduesve. Në rastin kur kjo marrëdhënie nuk është e afërt dhe kur ata nuk gëzojnë të njëjtin status social, atëherë fjalia pyetëse do të kumtojë një kërkesë më të sjellshme. Megjithatë, jo në çdo rast fjalia pyetëse shpreh një kërkesë a një ofertë në mënyrë të sjellshme, sepse kjo gjë varet nga thelbi i kumtimit. Me tone më të larta që shprehin grishje dhe mërzë, një fjali pyetëse mund të shprehë një kërkesë ose një urdhër të prerë. Intonacioni në këtë rast përcakton kumtimin e fjalisë. Fjalitë pyetëse me një forcë ilokutore të fjalive nxitëse, në strukturën e tyre përmbajnë folje modale dhe, si rrjedhim, në këto fjali ato shprehin vlera kuptimore të aftësisë, nevojës, dëshirës a vullnetit të folësit. Shprehja e modalitetit e përafron më shumë anën kuptimore të fjalive pyetëse me atë të fjalive nxitëse.

132. *Could you lend me the dictionary?*
(Mund të më huash fjalorin?)

133. *Would you help me with feeding the child?* (desire- dëshirë)
(Mund të më ndihmonit me ushqyerjen e fëmijës?)

134. *Do you want to help me with the child?*
(Më ndihmon pak me fëmijën?)

Struktura e fjalisë me *do you want* është më pak e sjellshme se *would you* (a do të ...), *could you* (a mundeshit ju të ...).

135. *Why don't you help me with the child?* (reason - arsye)
(Pse s'më ndihmon pak me fëmijën?
(Sikur të më ndihmoje me fëmijën?)
(Do të më ndihmoje me fëmijën?)

136. *Must you help him with everything?*
(A / duhet ta ndihmosh atë për çdo gjë?)

137. *Is it necessary / do you need/ do you have to help him with everything?*
(A ka nevojë / a është e nevojshme / a duhet ta ndihmosh atë për çdo gjë?)

Këto fjali janë përdorime me kuptime kundërshtie a ndalimi për të mos realizuar diçka dhe nuk mund të merren si fjali alternative për të shprehur mirësjellje. Gjejnë më shumë përdorim në ligjërimin bisedor dhe në krahinorizma. Duke u bazuar në forcën shprehëse, tonin në rënie, shënimin në pikësim me anë të pikëçuditjes, *këto fjali* pyetëse nga ana formale *mund të klasifikohen* si fjali nxitëse-pyetëse. Kjo tregon se kumtimin që shpreh një fjali nxitëse mund ta shprehë edhe një fjali e zakonshme formalisht pyetëse:

138. *Will you close the door!*
(Do ta mbyllësh derën? Sikur ta mbyllësh derën?)

E ndërtuar me një strukturë pyetëse, e kumtuar me një intonacion pyetës dhe e shënuar me një pikëçuditje nga ana e pikësimit, folësi jep një urdhër ndaj dëgjuesit. Megjithatë, fjalitë pyetëse-nxitëse janë më pak të drejtpërdrejta krahasuar me një fjali nxitëse të mirëfilltë.

Edhe në gjuhën shqipe nxitja mund të shprehet në formën e një fjalie pyetëse, kur është fjala për të formuluar një propozim a një kërkesë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë²²⁶. Folja-kallëzues është në vetën e parë shumës të së tashmes ose në të ardhmen e mënyrës dëftore a në të tashmen e lidhore. Shpeshherë përdoret edhe fjala modale *sikur* në strukturën e fjalive pyetëse, të cilat nuk shërbejnë për të kumtuar një pyetje, por shprehin një nxitje për veprim për bashkëbiseduesin.

139. *Po sikur të largoheni nga ky qytet?*

(Largohuni nga ky qytet.)

140. *Sikur ta mbyllim këtu takimin?*

(Le ta mbyllim këtu takimin.)

Përfundim: Si përfundim mund të themi se semantika e fjalive nxitëse mund të shprehet edhe me tipa të tjerë të fjalive të analizuara në lidhje me kontekstin dhe situatën ligjërimore në të cilën përdoren. Në kontekste që kërkohet të jepen kuptime të tërthorta, fjalitë dëftore dhe pyetëse gjejnë më shumë përdorim, përkundrajt fjalive nxitëse, në të cilat shprehen në mënyrë të drejtpërdrejtë nuancat kuptimore të urdhrit dhe të kërkesës.

§ 3.6. Përfundime të kreut

❖ Fjalitë nxitëse shprehin një gamë të gjerë të vullnetit të folësit për të ushtruar ndikim te dëgjuesi ose dëgjuesit për kryerjen a moskryerjen e një fakti të caktuar. Pra, folësi kërkon të realizojë qëllimin e tij, i cili ndikon edhe në përcaktimin e ngjyimeve kuptimore të fjalive nxitëse në kontekste të ndryshme. Qëllimi i folësit është vendimtar në përcaktimin e semantikës së thënies, e cila në akte të ndryshme komunikimi merr interpretime të larmishme. Të përcaktuara si format direkte të të shprehurit dhe larg të qenit një mënyrë e tërthortë dhe me mirësjellje e të shprehurit, fjalitë nxitëse në shumë situata shmangen nga përdorimi. Në kontekste të caktuara disa mjete dhe strategji të përdorura e dobësojnë dinamikën dhe intensitetin drejtues a urdhërues që ato mbartin. Le të analizojmë disa nga mjetet e ndryshme të përdorura në gjuhën angleze në ligjërimet e ndryshme, në mënyrë që të krijojmë një situatë simetrike sociale kundrejt një situatë komunikimi sociale asimetrike, situata këto të kudogjendura dhe mjaf të larmishme.

❖ Si gjuha angleze, ashtu dhe gjuha shqipe nuk tregojnë dallime të ndjeshme në semantikën dhe larminë kuptimore të fjalive nxitëse, të cilat përbëjnë një tipar ndërgjuhësor. Semantika e fjalive nxitëse është mjaft e gjerë në ligjërimet e ndryshme.

Mjetet gjuhësore që shërbejnë për të zbutur forcën urdhëruese tipike të fjalive nxitëse janë të larmishme në gjuhën angleze. Disa prej tyre gjejnë përdorim te gjegjëset në gjuhën shqipe, ndërsa disa të tjera nuk kanë gjegjëse në gjuhën shqipe (*tag questions*).

Konteksti ligjërimor është një element i rëndësishëm në përkapjen e anës kuptimore dhe gjithashtu në interpretimin e kumtimit të thënies nxitëse.

❖ Fjalitë nxitëse kanë një shtrirje të gjerë semantike dhe larmia e kuptimeve në kontekste të ndryshme lidhet me modalitetin që ato mbartin. Konteksti ku fjalia nxitëse gjen përdorim si pjesë përbërëse e fjalive me bashkërenditje, është i rëndësishëm për interpretimin e vlerës kuptimore që merr gjithë periudha me bashkërenditje. Periudha me bashkërenditje në këtë rast merr vlerë kuptimore kushtore. Struktura e fjalive nxitëse me nuanca kushtore përkon me strukturën e periudhës me bashkërenditje, por ana kuptimore e tyre nuk bashkëlidh

²²⁶Gramatika e gjuhës shqipe II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 135.

marrëdhënie numërimi të situatave. Realizimi i njërës situatë kushtëzohet nga mbarëvajtja e situatës tjetër. Duhet të theksojmë se te gjegjëset në shqip nuk kemi një periudhë identike me bashkërenditje të lidhur me lidhëzën shtuese *e* ose *edhe*. Fjalitë nxitëse në këto raporte nga ana kuptimore kryejnë funksionin e një fjalisë të nënrenditur kushtore të lidhur me fjalinë drejtuese me lidhëzën shtuese *and* (e, dhe, edhe).

❖ Përdorimi i *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme* së bashku me fjalitë nxitëse është një karakteristikë e veçantë e gjuhës angleze. Struktura të tilla nuk hasen në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe dhe në përkthimin literal përftohen fjali nxitëse të ndjekura nga disa pjesëza që shprehin dyshim, miratim, dakordësi ose pjesëza mohuese *mos* (jo me kuptimin e mirëfilltë mohues). Funksioni kryesor i përdorimit të tyre lidhet me zbehjen e nocionit urdhëruar të urdhërores në përgjithësi dhe kumtimin e një thënieje më me mirësjellje. Faktor i rëndësishëm në përvetësimin, përdorimin dhe përshtatjen e *fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme* në gjuhën shqipe është konteksti. Pjesëmarrësit në një ligjërim ku kumtohet një kërkesë, një urdhër, një ofertë etj. dhe marrëdhënia që ata kanë në këtë bashkëbisedim, kushtëzojnë semantikën e fjalive nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme dhe njëherazi ndikojnë në dhënien e gjegjëses së duhur në gjuhën shqipe.

❖ Semantika e fjalive nxitëse mund të shprehet edhe me tipa të tjerë të fjalive të analizuara në lidhje me kontekstin dhe situatën ligjërimore në të cilën përdoren. Në kontekste që kërkohet të jepen kumtime të tërthorta, fjalitë dëftore dhe pyetëse gjejnë më shumë përdorim, përkundrajt fjalive nxitëse, në të cilat shprehen në mënyrë të drejtpërdrejtë nuancat kuptimore të urdhrit dhe të kërkesës.

KREU IV

VEÇORITË SINTAKSORE DHE SEMANTIKE TË FJALIVE NXITËSE NË GJUHËN ANGLEZE NË PËRQASJE ME GJEGJËSET NË GJUHËN SHQIPE NË LIGJËRIMIN E SHKRUAR DHE NË LIGJËRIMIN E FOLUR

§4.1. Përdorimi i fjalive nxitëse në ligjërim

Fjalitë nxitëse dallohen për një semantikë të gjerë kuptimesh: nga një komandë dhe urdhër i prerë në një kërkesë, këshillë, lutje apo urim. Krahasuar me tipat e tjerë të fjalive, fjalitë nxitëse dallohen për një strukturë sintaksore më të thjeshtë dhe më pak komplekse. Karakteristikë për to është shpeshësia e përdorimit, e cila në ligjërimin bisedor (ligjërimi i folur) është më e madhe krahasuar me fjalitë dëftore dhe pyetëse. Fjalitë nxitëse përbëjnë thelbin e ligjërimin të folur, veçanërisht hasen shpesh në ligjërimin bisedor. *Fjalitë nxitëse përdoren rëndom në bashkëbisedime, sepse folësit shpesh mëtojnë të drejtojnë veprimet e dëgjuesve*²²⁷. Ky përdorim në ligjërimin bisedor përlligjet nga veçantitë dalluese të fjalive nxitëse, kumtimi i të cilave kërkon dy palë pjesëmarrëse, pra nevojitet të marrin pjesë të paktën dy persona (një folës, disa folësia dhe dëgjuesi, disa dëgjues). Si të tilla, fjalitë nxitëse nisin të artikulohen që në hapat e parë të përvetësimit të një gjuhe. Në situatat fillestare të ligjërimin, ku realizohen dhe aktet e komunikimit me foshnjën (*i saponjohur me elementet thelbësore të gjuhës dhe të ligjërimin, nëpërmjet përballjes sistem gjuhësor-ligjërimin*), fjalitë nxitëse zënë një hapësirë të madhe dhe mbizotërojnë ndaj tipave të tjerë të fjalive në situata të tilla komunikimi. Dinamika dhe denduria e përdorimit të këtyre fjalive është e lidhur ngushtë edhe me vetë semantikën dhe llojin e kumtimit që mbartin fjalitë nxitëse.

Në ligjërimin ku mbizotërojnë fjalitë nxitëse ndërthuren ngjyime kuptimore të urdhit, komandës, udhëzimit, këshillës, paralajmërimit e modalitetit, i cili përbën bërthamën e situatave komunikuese, veçanërisht në fazat e para të përvetësimit të gjuhës së parë ose edhe të një gjuhe të huaj. Semantika kryesore e thënieve në ligjërimin bisedor mes çifteve prind-fëmijë, mësues-nxënës shpreh këshilla, urdhra, udhëzime etj., forca shprehëse e të cilave lidhet me natyrën e ligjërimin dhe pjesëmarrësit në këto situata komunikimi. “*Kur dikush jep një urdhër apo udhëzim shumë të qartë, zakonisht përdoret mënyra urdhërore*²²⁸”. Prandaj, fjalitë nxitëse përbëjnë edhe numrin më të madh të fjalive në këto ligjërime.

Rëndësia e ligjërimin në transmetimin e anës kumtuese të një fjalie nxitëse shpjegon qartë analizën e fjalive nxitëse brenda një situatë të caktuar komunikimi. Si rrjedhojë, pragmatika, si *studimi i mënyrës së përdorimit të gjuhës*²²⁹, është mjaft e rëndësishme në bërjen e një studimi shterues të fjalive nxitëse. Fjalitë nxitëse, për të kryer më së miri funksionet e tyre kumtuese, duhet të vlerësohen brenda ligjërimin ku ato realizojnë kumtimin që synojnë. *Te fjalitë nxitëse gjuha përdoret me funksionin urdhërues ose konativ, që nënkupton nxitjen ndaj dëgjuesit për të kryer diçka*²³⁰. Përfitimi i funksionit kumtues të një thënieje lidhet me tre nivelet e argumentimit në gjuhë:

²²⁷ D. Biber, S. Conrad, G. Leech, *Student Grammar of Spoken and Written English*, Longman, 2002, f. 255.

²²⁸ Collins ELT, *English grammar*, Cobuild, 1990, f. 203.

²²⁹ S. C. Levinson, *Pragmatics*, Cambridge University Press, 2003, f. 5.

²³⁰ Një thënie e caktuar nuk ka vetëm një funksion gjuhësor. Janë shumë të rralla thëniet që kryejnë një funksion të vetëm të kumtuara në një situatë ligjërimi.

a. Niveli *sintaksor*, i cili përcakton rregullat sipas të cilave disa këmbime të simboleve çojnë ose jo në vazhdimet e mirinformuara të gjuhës.

b. Niveli *semantik* që paraqet vendosjen e lidhjeve mes shenjave dhe referentëve. Sipas Morris-it, një shenjë duhet të ketë një referent (*designatum*), edhe pse faktikisht jo çdo shenjë i referohet një objekti real²³¹. Pra, lidhja mes shenjave dhe referentëve do të thotë kuptimi i gjithë fjalisë. Kuptimi i fjalisë (ajo çka i referohet) është vlera e së vërtetës²³².

c. Niveli *pragmatik*, në të cilin folësi kumton një fjali si një dukuri vetjake apo si një ngjarje në marrëdhëniet mes disa individëve në një akt komunikimi²³³. Një dukuri e tillë tregon se në kontekstin ku thënia kumtohet, ne mund të dallojmë anë të ndryshme kuptimore. Këto ngjyime kuptimore lidhen jo vetëm me kontekstin e ligjërimit, por edhe me normat, me rregullat dhe me parimet e shoqërisë që i dikton këto parime. Argumentimi në gjuhë kalon në faza të tilla: nga ajo formale dhe semantike, në fazën pragmatike, pra në kontekstin ligjërimit. Ne mëtojmë të bëjmë një analogji me analizën pragmatike të fjalive nxitëse, sepse kjo lidhet me dendurinë që këto fjali shfaqin në ligjërimitin e përditshëm (ligjërimiti i folur në përjasje me ligjërimitin e shkruar).

Një studim i thelluar dhe tërësor i situatës komunikative, duke përfshirë në këtë analizë edhe pjesëmarrësit ose aktorët që veprojnë në këtë situatë ligjërimore (përfshi këtu *folësin* dhe *marrësin e urdhrin e porosisë*), ashtu si dhe rolin apo statusin e tyre në aktin e ligjërimit, duhet të nxjerrë në pah rëndësinë që shfaq *konteksti* ligjërimit, i cili është më tepër kushtëzues sesa forma e thënies. Gjatë komunikimit folësi përdor një sërë *strategjish* për të kumtuar një thënie të caktuar dhe këto strategji e zgjerojnë më tej fushën semantike të kuptimeve që mbartin fjalitë nxitëse. Ne mëtojmë të vëmë në dukje sendërtimin e karakteristikave dhe veçantive të fjalive nxitëse në ato situata dhe ligjërime, në të cilat ndërthehen larmia e përdorimeve dhe e kuptimeve të fjalive nxitëse.

Analiza jonë për fjalitë nxitëse në përdorimitin praktik të tyre do të përqendrohet në ligjërimitin e shkruar (në letërsinë artistike, udhëzime përdorimi, receta gatimi, reklama etj.) dhe në ligjërimitin e folur (në bisedat prind-fëmijë, si dhe në dialogë të shkëputur nga filma të ndryshëm). Gjurmimi i fjalive nxitëse në këto korpuse ligjërimiti do të paraqesë një panoramë të plotë dhe të qartë të veçorive sintaksore dhe semantike të fjalive nxitëse të hasura në burimet e korpuseve të ligjërimit të marra në analizë. Analiza kontrastive jo vetëm do të përjasë e do të krahasojë strukturat sintaksore të gje gjëseve në gjuhën shqipe, por do të vërë në dukje edhe përdorimitin e fjalive nxitëse në gjuhën shqipe në disa kontekste të veçanta ligjërimiti si: proza popullore, ligjërimiti poetik i Nolit etj. Në botën anglishtfolëse ka një përdorim të bollshëm të “*do’s and don’ts*” (*bëje këtë gjë dhe mos e bëj këtë gjë*)²³⁴. Kjo tregon se fjalitë nxitëse janë shumë të përdorura në bisedat e përditshme, duke filluar nga situatat e komunikimit në familje (këshillat dhe udhëzimet mes prindit dhe fëmijës), në shkollë (mësues-nxënës), në punë (punëdhënës-personel) dhe kështu me radhë një zinxhir në vijimësi gjatë gjithë aktivitetit të përditshëm të njeriut.

Lind pyetja: Sa e rëndësishme është përzgjedhja e korpusit për të arritur rezultatet e synuara? A janë të mjaftueshme burimet e korpusit që janë përzgjedhur për të realizuar një analizë të thellë të fjalive nxitëse me anë të metodës empirike? Ne mendojmë se natyra e materialeve të përzgjedhura është kushtëzuese dhe shpeshherë një faktor i rëndësishëm për rezultatet e arritura. Për sa i përket përdorimit të fjalive nxitëse, ne mëtojmë të përdorim metodën empirike të analizës së fjalive në ligjërimitin ku ato dallojnë nga tipat e tjerë dhe gjithashtu në ligjërime në të cilat nuk gjejmë shumë përdorim. Në ligjërimitin e shkruar mbizotërojnë fjalitë dëftore kundrejt fjalive pyetëse dhe nxitëse, kurse në ligjërimitin e folur

²³¹ F. Kovacs, *Linguistic structures and linguistic laws*, B. R. Gruner Amsterdam, 1971, f. 82.

²³² <http://libra.com/ligjërimiti-i-folur-dhe-i-shkruar/>

²³³ *Po aty*.

²³⁴ Y. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 298.

bashkëbisedimi është *interaktiv*, që do të thotë se folësit bëjnë një kërkesë, pyesin njëri-tjetrin më shpesh dhe ky akt komunikimi mund të kryhet me praninë e dy palëve (folës-dëgjues). Si rrjedhim, fjalitë pyetëse dhe nxitëse përbëjnë pjesën më të madhe të bisedave të folësve të një gjuhe, pra ligjërimin bisedor.

§4.2. Veçori sintaksore dhe semantike të fjalive nxitëse në gjuhën angleze në ligjërimin e shkruar

Fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe në shumë gjuhë të familjes indoevropiane karakterizohen nga mungesa e kryefjalës dhe rëndom në kontekstin ligjërimor ku mund të gjenden këto fjali, nuk kanë një kryefjalë të shprehur. Pjesa më e madhe e gjuhëtarëve pranojnë se paradigma e urdhërores në gjuhën angleze përfshin këto elemente përbërëse²³⁵. Kjo paradigmë shfaq ngjashmëri me paradigmen foljore të mënyrës dëftore, por dallon te format foljore të vetave të kombinuara dhe te veta e tretë njëjës me dallimet e gjinisë.

	Veta e dytë	Vetat e kombinuara	Veta e parë	Veta e tretë (ai)	Veta e tretë (ajo)
Njëjës	<i>Read</i> (Lexo)	<i>Let us read (ti dhe unë)</i> (Le) të lexojmë (ne)	<i>Let me read</i> (Le) të lexoj (unë)	<i>Let him read</i> (Le) të lexojë (ai)	<i>Let her read</i> (Le) të lexojë (ajo)
Shumës				<i>Let them read</i> (Le) të lexojnë (ata, ato)	

Tabela 1

Burimet e korpusit të shfrytëzuara në ligjërimin e shkruar janë këto romane: *The Summoning* dhe *The Awakening* nga Kelly Armstrong; *Dead Reckoning* nga Charlaine Harris; *Bloodline* nga Sidney Sheldon. Në katër romanet e analizuar ne kemi gjetur 21.221 fjali dëftore, 2.892 fjali pyetëse dhe 1.382 fjali nxitëse, të cilat përbëjnë një numër të konsiderueshëm në analizën e strukturave, dendurisë dhe akteve të ligjërimin që këto lloje fjalish realizojnë. Dimë se fjalitë dëftore kumtojnë një pohim, përshkruajnë një ngjarje, japin një informacion rreth një fakti a vëzhgimi të caktuar dhe si rrjedhim janë fjalitë me dendurinë më të madhe në ligjërimin e shkruar, veçanërisht në letërsinë artistike. *Fjalitë dëftore janë më të zakonshmet në ligjërim. Kanë përdorim të dendur në përshkrime e tregime*²³⁶. Megjithatë, prania e dialogëve në romane na jep një panoramë të plotë të komunikimit ndërveprues mes folësit dhe dëgjuesit, si dy elementet bazë për të realizuar aktin e komunikimit. Në njëfarë mënyre ato na japin një pamje të qartë të realitetit bisedor në të cilin fjalitë nxitëse janë shumë më të përdorshme. “*Dialogët në tregime (d.m.th. ata që mundësohen në letërsinë artistike) janë përfaqësime të ndërmjetme të bashkëbisedimeve reale*²³⁷”. Pra, dialogët në këto romane janë burime të mjaftueshme për të sendërtuar konkluzionet teorike mbi fjalitë nxitëse.

²³⁵ T. G. Akimova, *Imperative sentences in English*, cituar nga Victor S. Xrakovskij, *Typology of imperative constructions*, Lincom Europa, 2001, f. 355.

²³⁶ *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 122.

²³⁷ R. E. Asher dhe J. M. Y. Simpson, 1994, *The Encyclopedia of language and linguistics*, f. 2689, cituar nga H. Takahashi, *A usage-based analysis of imperative verbs in English* (1), 2007, f. 90.

Shpeshtësia e përdorimit të fjalive sipas qëllimit të kumtimit

Burimi i korpusit	Shpeshtësia e përdorimit		
Romanet	Lloji i fjalisë		
	Dëftore	Pyetëse	Nxitëse
<i>The Awakening</i>	4641	357	356
<i>The Summoning</i>	5020	780	400
<i>Dead Reckoning</i>	6500	812	350
<i>Bloodline</i>	5060	943	276
Filmat			
<i>The Past</i>	594	301	133
<i>Promised Land</i>	995	295	136
<i>American Hustle</i>	1146	355	222
<i>12 years a slave</i>	782	160	253
<i>Beginners</i>	497	131	55
Totali	25235	4134	2181

Tabela 2

§4.2.1. Analiza sintaksore dhe semantike e fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar

Analizën e strukturës së fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar e kemi nisur nga struktura më e thjeshtë (e cila është karakteristikë e sintaksës së fjalive nxitëse) e deri në përdorimin e tyre si pjesë e fjalive të përbëra (një veçori që haset më rrallë në gjuhën angleze, kryesisht në disa kontekste të veçanta të ligjërimin). Pavarësisht modeleve të thjeshta strukturore, fjalitë nxitëse shfaqen si fjali me struktura sintaksore të thjeshta, por të larmishme. Fjalitë nxitëse pa kryefjalë dalin me dendurinë më të madhe të përdorimit në burimet e korpusit të shfrytëzuara. Kjo denduri përdorimi e këtij tipi strukturor është një dëshmi e veçantisë së fjalive nxitëse në shumë gjuhë, si fjali me strukturë të thjeshtë dhe pa kryefjalë të shprehur. Me anë të kësaj strukture tipike, fjalitë nxitëse kumtojnë kërkesa e urdhra që i drejtohen kryefjalës së “fshehur”. Vërejmë më poshtë tipat strukturorë më të përdorur që kemi hasur në fjalitë nxitëse në burimet e korpusit të ligjërimin të shkruar.

1. Tipat strukturorë pa kryefjalë të shprehur

- A. Kryefjalë zero + kallëzues (folje jokalmtare)
- B. Kryefjalë zero + kallëzues (f. kal.) + kundrinor i drejtë
- C. Kryefjalë zero + kallëzues (f. kal.) + kundrinor i drejtë + kundrinor i zhdrejtë
- D. Kryefjalë zero + kallëzues (f. kal.) + kundrinor i drejtë + plotës (rrethanor)
- E. Kryefjalë zero + kallëzues + plotës rrethanor
- F. Kryefjalë zero + kallëzues + plotës kallëzuesor

A. Kryefjalë zero + folje-kallëzues (folje jokalmtare)

1. “Go!”
(Shko/-ni!)
2. “Move!”
(Lëviz/-ni!)

3. “Hurry!”
(Nxito/-ni!)

(*The Awakening*, f. 54, 86, 91)

4. “Come on²³⁸,” she said. “Breakfast’s in five minutes, and they get real snippy if you’re late.”

(“Ejani”, - tha ajo. “Mëngjesi është gati për pesë minuta dhe ata zemërohen nëse vonoheni.”)

5. *I swung my legs over the side of the bed. “Hold up. I’m coming.”*

(I vara këmbët tek ana e krevatit. “Prit pak. Po vij.”)

(*The Summoning*, f. 38, 226)

6. “Hold on,” Alec objected.

(“Prisni,” - kundërshtoi Aleksii.)

7. “Go on. Our problems are becoming too well-known.”

(“Vazhdo. Problemet tona po bëhen shumë të njohura.”)

8. “Get out,” Elisabeth said.

(“Dil / dil jashtë!”, - tha Elisabeta.)

(*Bloodline*, f. 248, 258, 352)

Te fjalitë nxitëse 1, 2 dhe 3 vërejmë vetëm kallëzues të shprehur nga folje jokalimtare të lëvizjes dhe folje që shenjojnë veprime të kontrollueshme nga kryefjala e pashprehur. Kështu, në mënyrë që të realizohet synimi i kumtimit, *folësi* e nxit *dëgjuesin* të veprojë. *Një thënie nxitëse shpreh një përmbajtje kuptimore që lidhet me veprimet e dëgjuesit në të ardhmen, mbart dëshirën e folësit që kuptimi të përmbushet dhe vepron si një shtysë (nxitje) për dëgjuesin për të realizuar këtë përmbajtje kuptimore*²³⁹. Folësi në këto fjali gëzon kontroll në ligjërimin që ato shqiptohen dhe, siç e kemi përmendur edhe në krerët e mëparshëm, përdorimi i foljeve që emërtojnë veprime a lëvizje në fjalitë nxitëse, tregon kufizim të përdorimit të foljeve që emërtojnë gjendjen e kryefjalës si: *want* (dua), *know* (di), *see* (shikoj), *can* (jam në gjendje të), *belong* (përkas) etj²⁴⁰.

Te fjalitë 4, 5, 6, 7 dhe 8 në gjuhën angleze, kallëzuesi shprehet me foljet frazale *come on*, *hold up*, *hold on*, *go on*, *get out*, ndërsa te gjegjëset në gjuhën shqipe kallëzuesi shprehet me folje në mënyrën urdhërore, në vetën e dytë njëjës ose shumës, ose i ndjekur nga një plotës rrethanor (*pak*, *jashtë*). Theksojmë se në gjuhën angleze folja frazale *come on* në fjalinë 4, shfaqet më tepër si një fjalë me vlerë kuptimore nxitëse, sesa me ngjyrimet kuptimore që merr në bashkëlidhje me parafjalën *on*. Veçanërisht në fjalitë nxitëse, *come on* ka një përdorim mjaft të shpeshtë, të cilin do ta gjejmë të përdorur edhe në korpusin e ligjëtimeve të tjera.

Në fjalitë nxitëse 1 - 8 në gjuhën angleze të tipit strukturor A, folja-kallëzues përbën bërthamën e këtyre fjalive strukturalisht të thjeshta. Por, marrëdhënia mes folësit dhe dëgjuesit është e formësuar në kontekstin nga i cili këto fjali nxitëse të thjeshta janë shkëputur. Mënyra e strukturimit nga ana gjuhësore, konteksti, intonacioni dhe shenjat e pikësimit ndërveprojnë në kumtimin e urdhrit, udhëzimit, direktivës dhe kërkesës. Fjalitë gjegjëse në gjuhën shqipe, nga ana strukturore, shprehen me një folje në mënyrën urdhërore,

²³⁸ Foljet mund të ndiqen nga parafjalë, pjesëza apo ndajfolje duke u bashkuar në një njësi të vetme kuptimore, e cila nuk është gjithmonë shuma e kuptimeve të fjalëve përbërëse gjegjëse dhe në gjuhën angleze emërtohen si *folje frazale*.

²³⁹ C. Condovardi, S. Lauer, *Imperatives: Meaning and illocutionary force*, *Empirical Issues in Syntax and Semantics* 9, 2012, f. 38.

²⁴⁰ Në kontekste në të cilat fjalitë nxitëse me folje-kallëzues që emërton gjendje, gjendet në një fjalë të përbërë (me vlerë kushtore), përdorimi i foljeve të gjendjes si kallëzues të fjalive nxitëse është i saktë si nga ana gramatikore, ashtu edhe nga ajo kuptimore.

ku mbaresat vetore shënojnë edhe dallimin mes një dëgjuesi të vetëm apo një grupi dëgjuesish, si te fjalia 1 (*Shko* - veta e dytë njëjës dhe *Shkoni* - veta e dytë shumës.) Në një ligjërim gjegjës në gjuhën angleze, konteksti ligjërimor ose mjete të tjera jogjuhësore bëjnë dallimin mes një apo disa personave, të cilëve ne u drejtohem për të përmbushur një kërkesë të caktuar. Në gjuhën shqipe dëgjuesi (referenti) mund të dallohet edhe jashtë kontekstit të kësaj thënieje, për shkak të mbaresave vetore foljore.

Nga ana semantike, këto fjali kumtojnë urdhra dhe direktiva të qarta për dëgjuesin dhe gjejnë përdorim në kontekste ku çifti folës-dëgjues është në dijeni të marrëdhënieve që ata kanë mes njëri-tjetrit. Te fjalia 1 jepet një urdhër i prerë që pritet të zbatohet, sepse elementet e kontekstit janë të mjaftueshëm për një kumtim të tillë. Personi që duhet të zbatojë urdhrin apo të kryejë një udhëzim, ose gjendet fizikisht brenda situatës ku zhvillohet ligjërimi, ose është një urdhër që do të zbatohet nga dikush tjetër. Këto fjali kanë intonacion në ngritje me tone të larta të autoritetit, për të lëshuar një urdhër kategorik, thirrje apo grishje për veprim. Në vështrimin e anës kuptimore këto fjali marrin ngjyime të shumta në kontekste të ndryshme. Vërejmë se fjalitë e gjurmara të shprehura nga kontekstet përkatëse mund të shprehin këto ngjyime kuptimore:

a. Urdhër (i prerë):

9. *Samuel said: "I can't leave the cart." "Yes, you can," the policeman said. He cast a stern eye over the crowd. "I'll be right here. Hurry!"*

(Samueli tha: "Unë s'mund të largohem nga karroca." "Po, ti mundesh", - tha polici. Ai i hodhi një vështrim të vrazhdë turmës. "Unë këtu do të jem. Nxito!")

10. *"Yes, sir. Is it all right if I attend the funeral? It's this morning." "Yes! Go!" "Thank you, sir. I..." "Just go!"*

("Po, zotëri. A ka problem nëse unë marr pjesë në funeral? Është këtë mëngjes." "Po! Shko! / Të shkosh!" "Faleminderit, zotëri. Unë...." "Ik, pra! / Vetëm ik! / Të ikësh!")

(*Bloodline*, f. 51. 320-321)

b. Kërkesë:

11. *"Yeah, we gotta go," he said, starting to rise. "Not yet. Lie down. Rest."*

(*The Awakening*, f. 12.)

12. *"Please, Go." The words were a deep mumble, like he wasn't opening his mouth.*

("Të lutem, shko. / Të shkosh." Fjalët e tij ishin një murmuritje e mbytur, sikur nuk e hapte fare gojën.)

(*The Summoning*, f. 337)

c. Moslejim, qortim, kërcënim, paralajmërim:

13. *Back off, Bill! Leave!*

(Tërhiq, Bill! Largohu!)

14. *"Oh, stop," I said, disgusted.*

("Oh, ndalo," - thashë unë me neveri.)

(*Dead Reckoning*, f. 69, 234)

d. Këshillë, rekomandim, sugjerim:

15. *"Concentrate," Derek whispered.*

("Përqendrohu," - pëshpëriti Derek.)

(*The Awakening*, f. 174)

16. *"Whatever you did, undo it. Reverse it." "I didn't do." "Just try." I closed my eyes. "Go back. Back to your afterlife. I release you."*

("Çfarëdo që bëre, zhbëje. Paracaktoje atë." "Unë nuk bëra gjë." "Vetëm / thjesht përpiqu." Unë mbylla sytë. "Kthehu! Kthehu në jetën e përtejme! Unë të lë të lirë.")

(*The Summoning*, f. 241)

Nga vështrimi i anës kuptimore mund të japim një larmishmëri të kuptimeve që fjalitë nxitëse pa kryefjalë të shprehur mund të kumtojnë në kontekste të ndryshme në dialogët e shkëputur nga letërsia artistike. Megjithatë, kumtimet thelbësore që hasen rëndom lidhen me një urdhër të prerë, një kërkesë, një paralajmërim apo një qortim. Duhet të theksojmë edhe një dukuri tipike të ndërveprimit dialektik të strukturës (*sintaksa e fjalisë*) dhe anës kuptimore (*semantikës së fjalisë*) të fjalive nxitëse të tipit strukturor A. Në këndvështrimin e anës kuptimore, nga fjalia nxitëse 1 e deri te fjalia 16, urdhri pëson një rënie të intensitetit të forcës urdhëruese shprehëse. Në fjalinë 16 forca urdhëruese është e barasvlershme me një këshillë a propozim të cilët, në kontekstin ligjërimor përkatës, quhen si një e mirë në favor të dëgjuesit. Prandaj, përveç urdhrit (i cili për folësin përgjithësisht është në të mirë të tij), fjalitë nxitëse shprehin edhe rekomandime të mirëfillta.

Si është përfutur ky kalim kuptimor nga ana strukturore?

Së pari, te fjalia 1 vërejmë se urdhri jepet vetëm nëpërmjet një foljeje jokalimtare të lëvizjes, më tej me folje frazale dhe te fjalitë në vijim struktura e fjalisë plotësohet me anë të fjalëve leksikore, pjesëzave, fjalive dëftore, fjalive pyetëse apo edhe me fjalët e autorit. Pra, duke kundruar kontekstin gjegejës, ne mund të themi se nëpërmjet ndihmesës së këtyre mjeteve, fjalitë nxitëse kryejnë funksionin komunikativ përkatës dhe në njëfarë mënyre ngushtojnë edhe hapësirën që ka krijuar dyshja folës-dëgjues në marrëdhënien e tyre. *Së dyti*, të ndërtuara strukturalisht vetëm nga kallëzuesi, këto fjali janë një shprehje e drejtpërdrejtë e kumtimit të urdhrit.

I dallojmë këto dukuri te fjalitë 10, 12 dhe 16, në të cilat fjalët leksikore (*just, yes*), shprehin kuptime më të zbutura të urdhrit a kërkesës. Fjalitë nxitëse 5, 9, 10 paraprihen a ndiqen nga fjali pyetëse dhe dëftore duke e zbehur në një kontekst të tillë forcën shprehëse të urdhrit a kërkesës. Prandaj, nga ana kuptimore kalohet nga një urdhër kategorik dhe i rreptë, në një propozim apo rekomandim. Disa nga këto mjete janë: *just, please, oh* apo fjalitë: *Our problems are becoming too well-known; I'll be right here; Back to your afterlife*. Të gjitha këto mjete leksikore-gjuhësore i shërbejnë realizimit të kumtimit gjegejës dhe në ligjërimin e shkruar janë shumë të rëndësishme, sepse funksioni gjuhësor i mjeteve prozodike nuk dallohet në këtë ligjërim. Pikësimi është një mjet plotësues formal në zberthimin e anës kuptimore të fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar.

Edhe te gjegejset në gjuhën shqipe struktura sintaksore me një folje në urdhërore apo në lidhore shpreh kumtime si urdhra të prerë dhe kërkesa. Konteksti e veçanërisht intonacioni dallojnë fjalitë që shprehin një urdhër që duhet të zbatohet menjëherë nga një kërkesë a një rekomandim.

B. Kryefjalë zero + kallëzues (folje kalimtare) + kundrinor i drejtë

Ky tip strukturor i fjalive nxitëse, mjaft i shpeshtë në dialogët e romaneve, ka një strukturë të thjeshtë, të ndërtuar nga *folja-kallëzues* dhe *kundrinori i drejtë*.

17. "Call me."

("Më telefono. /Telefonomë.")

18. "Lock it."

["Kyçe atë (derën)."]

19. "Save it, take some money. Keep your money, Chloe."

("Kurseje / kurseje atë, merr ca para! Ruaje paranë tënde, Kloe!")

20. "Search her. Do something!"

("Kërkoje atë! Bëj diçka!")

(*The Awakening*, f. 17, 54, 197, 141)

21. Alec said, "Close your eyes, Elisabeth." She said fiercely, "No!" and Rhys's voice suddenly called, "Drop the gun, Alec!"

(Aleksi tha: “*Mbylli sytë, Elisabetë!*” Ajo i tha me egërsi jo dhe papritur u dëgjua zëri i Raisit: “*Lëshoje armën, Aleks!*”)

22. “*Mrs. Williams...*” *Detective Campagna was standing over her, holding out a cup of coffee. “Drink this,” he said. “You’ll feel better.”*

(“Zonja Uilliams...”, - tha detektivi Kampanja që gjendej në këmbë pranë saj duke i zgjatur një filxhan kafe. “*Pije këtë,*” - tha ai. “Ti do të ndihesh më mirë.”)

(*Bloodline*, f. 456, 436)

23. *Now I was horribly embarrassed. “Please, accept my apology.” I said.*

(Atë kohë ndihesha tmerresisht në siklet. “Të lutem, pranoje faljen time,” - thashë unë.

24. “*Look at that,*” *Brenda Hesterman’s voice said from behind me.*

(“Shikoje atë,” - u dëgjua zëri i Brenda Hesterman-it mbrapa meje.)

25. “*Drop the knife,*” *Andy said. He was in deadly earnest.*

(“Lëshoje thikën,” - tha Andi. Ai e kishte me shumë seriozitet.)

(*Dead Reckoning*, f. 45, 40, 120)

Struktura e fjalive nxitëse me një *kallëzues* të ndjekur nga një *kundrinor* i drejtë ose i zhdrejtë haset rëndom në pjesët e dialogëve dhe bisedave të shkëputura nga romanet e gjurmara. Rendi i ngulitur i gjuhës angleze e ngurtëson pozicionin dhe ekzistencën e tij në fjali të vendosur pas *kallëzuesit*. Në këto fjali *kundrinori* jep një kumtim më të plotë të thënies urdhëruese, sepse i shprehur formalisht me një emër apo përemër shënon personin, sendin a objektin ku veprimi do të bjerë. E ilustruam me një shembull:

26a. *Step one: Establish the goal.*

(Hapi i parë: *Përcakto qëllimin.*)

b. *Step two: Introduce the obstacle.*

(Hapi i dytë: *Paraqit pengesën.*)

c. *Step three: Map out the detour.*

(Hapi i tretë: *Planifiko rrugëzgjdhje të tërthortë.*)

(*The Awakening*, f. 8)

Në gjuhën angleze, në të tre shembujt e sipërpërmendur vërejmë se fjalitë nxitëse shfaqen me strukturën e tyre të plotë të ndërtuar nga *kallëzuesi* dhe *kundrinori i drejtë*. Kryefjala nuk shprehet në fjali dhe nga pikëpamja kuptimore *kundrinori* jep një kumtim që në këtë rast përkon me një udhëzim apo me opinionin e folësit drejtuar dëgjuesit, i cili nënkuptohet si personi që duhet të ndjekë hapat e mësipërm. Në këto fjali përdorimi i *kundrinorit* është i nevojshëm, në mënyrë që vlera kuptuese dhe kuptimore të jetë sa më e plotë dhe e qartë. Në kontekstin e shkëputur ligjërimor, shprehja e *kundrinorit* mbart edhe vlerën kuptimore thelbësore të fjalisë dhe është gjymtyra ku duhet të bjerë theksi logjik. Struktura të tilla janë të zakonshme dhe hasen rëndom në fjalitë nxitëse që po analizojmë, por në korpusin e studiuar vihet re një përdorim mjaft i dendur i fjalive nxitëse jo vetëm pa kryefjalë të shprehur, por edhe pa *kundrinor* të shprehur.

Një tipar karakteristik i fjalive nxitëse në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera izoluese është mungesa e *kundrinorit* në strukturën e fjalive nxitëse. Megjithatë, pavarësisht mungesës së *kundrinorit* dhe strukturës së thjeshtë, kumtimi i tyre është i plotë. Dyshja folës-dëgjues janë në dijeni të plotë për kumtimin e fjalisë. *Kundrinori* mund të mos përdoret edhe në fjalitë nxitëse që kumtojnë urdhra dhe direktiva shpjeguese, një tipar stilistikor ky për të shprehur vlera kuptimore të qarta dhe që lidhet me stilin neutral të të shkruarit.

Në gjuhën shqipe, te fjalitë gjegjëse vërejmë se *kundrinori* mund të shprehet në trajtën e plotë me emër ose përemër dhe gjithashtu mund të rimerret me një trajtë të shkurtër të vendosur pas, para ose të ndërfutur në trupin e foljes-kallëzues. Vërejmë fjalitë gjegjëse në gjuhën shqipe 17, 18 dhe 19 (Më telefono / telefonomë; Kyçe; Kurseje). Trajtat e shkurtra *më* dhe *e* në funksionin e *kundrinorit* gjenden para ose pas foljes-kallëzues të fjalisë nxitëse. Në

fjalinë 19 kundrinori shprehet me trajtën e shkurtër të prapavendosur *e* dhe gjithashtu me formën e tij të plotë përemërore *atë*. Dimë se këto trajta përemërore në funksion të kundrinorit shfaqen si *proklitike* dhe *endoklitike*. Ato shoqërojnë foljen-kallëzues të fjalive nxitëse dhe përbëjnë një veçanti të gjuhëve që kanë një eptim të pasur, si te gjuha shqipe.

Në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze kemi një përdorim të klitikëve, të cilët kanë këtë shpërndarje: në fjalitë nxitëse me folje-kallëzues në vetën e dytë njëjës, përemrat vetorë të vetës së parë dhe të dytë në funksionin e kundrinorit mund të paravendosen apo të prapavendosen, ndërsa klitikët e vetës së tretë duhet të vendosen në mënyrë të detyrueshme pas foljes-kallëzues. Në fjalitë nxitëse me folje-kallëzues në vetën e dytë shumës, gjithë përemrat mund të jenë *proklitikë* dhe *endoklitikë*, por jo *enklitikë*²⁴¹. E kemi trajtuar dukurinë e klitikëve në gjuhën shqipe më me hollësi në kreun e parë.

Përfundim: Tipi strukturor i fjalive nxitëse vetëm me një kallëzues të shprehur dhe kryefjalë zero përbën grupin më tipik të fjalive nxitëse. Kuptimi thelbësor i tyre është një urdhër i prerë, një kërkesë, një rekomandim a një propozim. Fjalitë nxitëse të ndërtuara nga një kallëzues dhe kundrinor i drejtë përdoren rëndom në ligjërimin e shkruar dhe kundrinori shenjon personin a sendin të cilit i drejtohet kumtimi i fjalisë. Në gjuhën angleze kundrinori vendoset pas foljes-kallëzues, ndërsa në gjuhën shqipe ai shprehet në formën e plotë ose të shkurtër përemërore, e prapavendosur, e pasvendosur apo edhe e ndërfutur në trupin e foljes në mënyrën urdhërore. Dukuria e klitikëve dëshmon dallimin mes dy gjuhëve në përdorimin apo jo të kundrinorit.

C. Kryefjalë zero + kallëzues (f. kal.) + kundrinor i drejtë + kundrinor i zhdrejtë

Siç e kemi theksuar edhe më lart, te fjalitë nxitëse pa kryefjalë të shprehur, kallëzuesi përbën bërthamën e fjalisë dhe, si i tillë, gjymtyrët e tjera ndërvaren nga lloji dhe kuptimi i foljes-kallëzues. Përderisa në gjuhën angleze fjalitë nxitëse rëndom ndërtohen vetëm nga folja-kallëzues dhe fjalia është kuptimisht dhe gramatikisht e saktë, kjo gjë e bën kallëzuesin gjymtyrë *drejtuese* në këto fjali. Pra, në shumë kontekste folja-kallëzues është kalimtare dhe mund të marrë kundrinor të drejtë dhe të zhdrejtë. *Shpeshherë, mund të dëshirojmë të flasim për një ngjarje e cila përfshin dikë tjetër, përveç kryefjalës dhe kundrinorit në fjali. Pjesëmarrësi i tretë është dikush që përfiton diçka si rezultat i kumtimit të fjalisë. Pra, kemi të bëjmë me kundrinorin e zhdrejtë të fjalisë*²⁴². Shumë folje mund të marrin dy kundrinorë. Kjo ndodh shpesh me foljet që përdoren për të transferuar ose për të komunikuar mendime nga një person tek tjetri apo për të kryer diçka për dikë (*give* - jap, *send* - dërgoj, *bring* - sjell, *tell* - tregoj, *take* - marr etj.²⁴³).

27. “*Just give me a couple of days.*”

(“*Më jep mua disa ditë kohë.*”)

28. “*No, I’ve got it. Just give me a sec so my eyes adjust.*”

(“*Jo, unë e mora atë. Vetëm më jep një sekondë kohë sa të më mësohen sytë.*”)

(*The Summoning*, f. 139, 227)

29. “*Ask me your questions, and I shall play schoolteacher, answering them at no cost.*”

(“*M’i bëj mua pyetjet e tua dhe unë do të bëhem mësuesi e do të të përgjigjem patjetër.*”)

(*The Awakening*, f. 43)

30. “*Get me a handkerchief of your father’s.*”

(“*Më sill një shami të babait tënd.*”)

²⁴¹ Cituar nga G. Turano, *On clitics and negation in Albanian*, Rivista di Grammatica Generativa, vol. 25, f. 107-108.

²⁴² Collins ELT, *English grammar*, Cobuild, 1990, f. 159.

²⁴³ M. Swan, *Practical English usage*, Oxford University Press, 2005, f. 610.

31. “*Leave everything to me.*”
 (“Lërmë / Më lër çdo gjë mua.”)

(*Bloodline*, f. 149, 186)

Për sa i përket pozicionit që të dy kundrinorët zënë në fjali, mund të themi se kryesisht kundrinori i zhdrejtë shenjon personin dhe paraprin kundrinorin e drejtë jo vetëm në fjalitë nxitëse, por edhe në llojet e tjera të fjalive²⁴⁴. Ky pozicion i kundrinorëve vërehet edhe te gjegjëset në gjuhën shqipe, por, në dallim nga gjuha angleze, kundrinori i zhdrejtë mund të shprehet nga një formë e plotë emërore dhe një trajtë e shkurtër (të cilat mund të shoqërojnë njëra-tjetrën) ose mund të shprehet vetëm trajta e shkurtër. Këto forma përemërore në funksionin e kundrinorit të drejtë ose të zhdrejtë shfaqen si klitikë në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe. Mungesa e kategorisë së rasës në gjuhën angleze bën që kundrinori të mos dallohet nga shprehja formale, por me ndihmën e kontekstit dhe të rendit të fjalëve në fjali. Shpeshësia e përdorimit të fjalive nxitëse me kundrinor të drejtë dhe të zhdrejtë nuk është shumë e madhe krahasuar me tipin strukturor A dhe B, sepse përdorimi i tyre është i kufizuar në disa folje të veçanta.

D. Tipi strukturor: *Kryefjalë zero + kallëzues (f. kal.) + kundrinor i drejtë + plotës rrethanor* (vendi, mënyre etj.)

Edhe këtë tip e kemi hasur në strukturën e fjalive nxitëse në dialogët e romaneve. Në burimet e korpusit që kemi shfrytëzuar këto fjali janë shumë të shpeshta. Këtë e vëmë re në të dhënat që ka Tabela 3 e shpeshësisë së përdorimit të tipave strukturorë të fjalive nxitëse.

32. “*Get her out of here.*”
 (“Nxirre atë prej këtej.”)
 33. “*Please, please, get him away from me, get him away.*”
 (“Ju lutem, ju lutem, largoje atë nga unë, largoje/ni.”)

(*The Summoning*, f. 27)

34. “*Take it slow,*” *Alex counseled.* “*One step at a time. It’s a piece of cake.*”
 (“Merre me ngadalë,” - e këshilloi Aleks. “Me një hap. Është shumë e thjeshtë.”)
 35. “*Get everyone in place. Five minutes.*”
 (“Të shkojnë të gjithë në vendin e tyre. Për pesë minuta.”)

(*Bloodline*, f. 453, 421)

E. Tipi strukturor: *Kryefjalë + kallëzues + plotës rrethanor*

36. “*Meet at the Buffalo Street.*”
 (Takohe mi në rrugën “Bufalo”.)
 37. “*Stay close to me!*”
 (“Qëndro afër meje!”)
 38. “*Hey, Pete, come here!*”
 (“Ej, Pit, eja këtu!”)
 39. “*Come inside.*”
 (“Hyr brenda.”)
 40. “*No, no stay here, go to the road and hide.*”
 (“Jo, jo, qëndro këtu, kalo nga rruga dhe fshihu.”)
 41. “*Speak slowly.*”
 (“Fol ngadalë.”)

(*The Awakening*, f. 78, 93, 110, 329)

²⁴⁴ Në një fjali me dy kundrinorë, kundrinori i zhdrejtë në shumicën e rasteve vendoset para kundrinorit të drejtë. Por, në kontekste të tjera, ai mund të vendoset pas kundrinorit të drejtë dhe në këtë pozicion paraprihet nga një parafjalë ose shprehet nga një përemër, ashtu si edhe kundrinori i drejtë.

42. “Go now.”

(“Shko! / Ik tani! Shko që tani!”)

(*The Summoning*, f. 110)

43. “Closer. Come here.”

“Më afër. Eja këtu!”

(*Bloodline*, f. 153)

Në grupin e fjalive të marra në studim, struktura e fjalive nxitëse me një folje-kallëzues të ndjekur nga një rrethanor është mjaft e përdorshme dhe brenda këtij lloji fjalitë me rrethanor vendi janë më të shumta sesa përdorimet me rrethanor mënyre apo ndonjë lloj tjetër rrethanori. Rrethanorët shprehen kryesisht me ndajfoljet gjegjëse, por edhe me sintagma emërore. Ka një karakteristikë të ndajfoljeve që gjejnë përdorim në dialogët e shkëputur nga romanet. Ndajfoljet e vendit, kohës apo mënyrës, që rëndom i shoqërojnë kallëzuesit e fjalive nxitëse, janë: *here* (këtu), *there* (atje), *quickly* (shpejt), *slowly* (ngadalë), *well* (mirë), *now* (tani), *today* (sot), *tomorrow* (nesër), *later* (më vonë) etj., në të cilat do të veçojmë ndajfoljet e kohës *now* (tani), *today* (sot), *tomorrow* (nesër) për vlerën kuptimore që ato kanë në fjali. Dimë se kallëzuesi i fjalive nxitëse nuk e ka kategorinë gramatikore të kohës [-Tense] dhe shpeshherë në fjali kuptimi kohor shenjohet nga ndajfoljet e kohës që tregojnë një çast kohor pas aktit të ligjërimit, pra pas çastit të të folurit. *Me çast të të folurit do të kuptojmë momentin kur folësi kumton diçka me gojë ose me shkrim*²⁴⁵. Edhe pse ndajfolja *now* shpreh kuptimin e një veprimi që ndodh në çastin e ligjërimit, kumtimi i thënies nxitëse do të kryhet në një çast të së ardhmes.

Në shumë gjuhë, kategoria e kohës është kategoria kryesore gramatikore e mënyrës dëftore, ndërsa në mënyrën urdhërore ajo ose shuhet plotësisht, ose shfaqet si një grup i *pseudo-formave* foljore, të cilat përcaktojnë ose shënojnë çështje të ndryshme që lidhen me çastin kohor pas momentit të ligjërimit²⁴⁶. Nga analiza përfaqësuese e fjalisë në gjuhën angleze me gjegjësen në gjuhën shqipe, vërejmë një përputhje kuptimore të fjalive kur përdoren ndajfoljet e kohës me kuptime kohore të kohës së ardhme. Mungesa e tipareve kohore të foljes-kallëzues në fjalitë nxitëse e përfaqëson foljen-kallëzues me tiparet e infinitivit.

Ndajfolja *now* (tani), nga ana kuptimore lidhet me shprehjen e kohës për veprime të momentit të ligjërimit, ndërsa në fjalitë nxitëse nuk i referohet këtij momenti, por kohës pas çastit të ligjërimit. Përdorimi i ndajfoljes *now* përbën një dukuri interesante dhe të veçantë të fjalive nxitëse në gjuhën angleze. Në fjalorin e gjuhës angleze ndajfolja *now* përkufizohet: në këtë moment, pas këtij çasti, por jo më përpara²⁴⁷.

44. *Start writing now.*

(Fillo të shkruash tani.)

Në fjalorin e gjuhës shqipe ndajfolja *tani* i referohet *pak përpara këtij çasti* apo *menjëherë pas këtij çasti*. Në këtë kuptim (menjëherë pas këtij çasti), në gjuhën shqipe përdoret me të tashmen dhe të ardhmen e mënyrës dëftore, por nuk përjashton edhe përdorimin me urdhëroren.

45. *Shkojmë tani.*

Nga analiza e fjalisë 45 mund të themi se në këto përdorime *now* (tani) e ka humbur kuptimin thelbësor të shenjimit të një çasti që lidhet me ligjërimitin përkatës dhe përdoret në kontekste që i referohen një çasti kohor të së ardhmes.

E gjejmë *now* të përdoret edhe në gjuhën frënge: *maintenant*, por jo me shpeshësinë që ka *now* në gjuhën angleze dhe *tani* në gjuhën shqipe. Robert-i e përkufizon termin *maintenant*

²⁴⁵ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 238.

²⁴⁶ V. S. Xrakovskij, *Typology of imperative constructions*, Lincom Europa, 2001, f. 30-31.

²⁴⁷ *Oxford Advanced Learner's Dictionary*, Oxford University Press, 2000, f. 868.

si një situatë eliptike ku mungon pjesa e parë²⁴⁸. Në gjuhën frënge *maintenant* përdoret me kohën e ardhme, por mund të përdoret edhe me urdhëroren.

46. *Maintenant agissons...*

(Le të shkojmë. / Të shkojmë tani. / Tani të shkojmë.)

Megjithatë, në gjuhën frënge nuk e dallojmë këtë përdorim të *maintenant* kaq të shpeshtë në fjalitë nxitëse, krahasuar me ndajfoljen gjegjëse *now* në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze.

F. Tipi strukturor: Kryefjalë zero + folja be (jam) + plotës kallëzuesor

47. “*Be careful.*” - Alec said

(“Të jesh i kujdesshëm./ Kujdes!” – tha Aleks.)

(*Bloodline*, f. 288)

48. “*If there’s anything I can do -I know there probably isn’t, but...*”

“*Just be there.*”

(- Po ka diçka që mund të bëj. - E di që me sa duket nuk ka, por...)

“Vetëm të jesh aty. / Vetëm eja.”

49. “*Goodbye, child. And do be careful, you and your little band of magic makers and monsters.*”

(Mirupafshim, bir. Dhe të jesh i kujdesshëm, ti me gjithë bandën e magjistarëve dhe përbindëshave të vegjël.)

50. “*Be careful and*” *The other words that rose to my lips were “be quick”, but I couldn’t be that callous - even to think it shocked me. So I swallowed and repeated, “Be careful.*”

(“Ki kujdes... / Kujdes dhe...” Fjala e parë që më erdhi në mend ishte “shpejt”, por unë nuk mund të isha kaq i pashpirt - të mendoje dhe që sa më tronditi. Kështu që e gëlltita tronditjen dhe përsërita: “Të kesh kujdes! / Të jesh i kujdesshëm! / Kujdes!”)

(*The Awakening*, f. 229, 66, 345)

2. Tipi strukturor me kryefjalë të shprehur

A. Tipi strukturor: Kryefjalë + folje kallëzues + gjymtyrë të tjera

51. “*You go,*” *I said. Sit with him the rest of the way.*

(“Ti shko”, - i thashë. “Ulu me të pjesën tjetër të rrugës.”)

52. “*You go ahead,*” *I said. “I’ll talk to...”*

(“Ti / Ju shko/ni përpara”, - thashë unë. “Do të bisedoj unë nesër...”)

(*The Awakening*, f. 223, 225)

53. “*You go back there and wait.*”

(“Ti / Ju shko/ni atje dhe pris/ni. Të shkosh atje dhe të presësh!”)

54. “*You. Get back here. I want to talk to you.*”

(“Ti, kthehu këtu! Dua të bisedoj me ty!”)

(*The Summoning*, f. 394)

²⁴⁸Nouveau Petit Robert (2000), *Dictionnaire alphabetique et analogique de la langue française*, Paris: Dictionnaires Le Robert.

Në kontekstet e sipërpërmendura përdorimet e kryefjalës i japin fjalisë një kuptim të barasvlerëshëm me nuanca kundërshtie, kontrasti, kategorizimi, veçimi etj. Këto kuptime përmbushen edhe nëpërmjet elementeve intonacionore që veçojnë vepruesin në fjali dhe vënë theksin mbi dëgjuesin dhe kumtimin e thënies. Folësi në këtë akt ligjërimit ka “pushtet” mbi dëgjuesin dhe shprehja e kryefjalës në fjali nënvizon më shumë vlerën kumtuese të nxitjes, grishjes e paralajmërimit ndaj dëgjuesit. Te gjegjëset në gjuhën shqipe, kryefjala mund të zërë pozicionin nistor apo fundor në fjali dhe përsëri mbetet elementi që shqiptohet më fuqishëm, sepse mbart peshën bazë kumtuese. Në gjuhën shqipe thjesht i vihet theksi personit apo personave duke i veçuar nga të tjerët, sepse shenjimi i tij apo i tyre bëhet nëpërmjet mbaresave vetore përkatëse (*shko-shkoni*) të foljeve në të dyja vetat e mënyrës urdhërore.

Edhe te shembujt që vijojnë vërejmë dukurinë e përdorimit të kryefjalës në fjalitë nxitëse. Në këto përdorime folja-kallëzues paraprihet me folje modale dhe nga ana e vlerës kuptimore kemi të bëjmë me një forcë urdhëruese shprehëse më të ulët dhe të shqiptuar më me takt nga ana e folësit. Fjalitë nxitëse me kryefjalë të shprehur kumtojnë një kërkesë më të matur ndaj dëgjuesit, në krahasim me fjalitë nxitëse të mirëfillta pa kryefjalë të shprehur.

55. “*Drive me out of my sleeping spot for kicks. Roll me for my boots. Now, you come here.*”

(“Më dëboni nga vendi ku fle për të më shkëlmuar. Më rrokullisni për çizmet. Tani, ti eja këtu.”)

56. “*You go back and tell them that,*” *Simon said.*

(“*Ti kthehu / kthehu ti dhe u trego atyre për të!*” - tha Simoni.)

Te fjalia gjegjëse në gjuhën shqipe (56), kryefjala mund ta ndjekë kallëzuesin dhe të ketë theks logjik të njëjtë.

57. “*You should get some sleep!*”

(“*Ti duhet të dremisësh pak²⁴⁹!*”)

(*The Awakening*, f. 181, 151, 298)

58. “*Come on breakfast, in five minutes, you can wear your pyjamas down to breakfast.*”

(“Eja/ni, mëngjesi është gati për pesë minuta. Ju mund t’i mbani veshur pizhamet edhe këtu poshtë.”)

(*The Summoning*, f. 38)

3. Tipi strukturor me foljen let

A. Tipi strukturor: *Folja let + kryefjalë + folja bazë* (në formën e infinitivit pa pjesëzën *to*)

Let - imperatives janë përkufizuar nga studiues të shumtë si fjalitë nxitëse ku mënyra urdhërore e foljes-kallëzues shpreh veprime të përbashkëta mes folësit dhe dëgjuesit. Pra, folja *let* në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze shpreh propozime dhe urdhra të cilët nuk i drejtohen vetëm dëgjuesit ose lexuesit²⁵⁰. Fjalitë nxitëse me *let* janë shumë të përdorura në biseda dhe i gjejmë me një denduri të konsiderueshme edhe në dialogët e romaneve të marrë në analizë. Funkcionet kumtuese në kontekstet ligjërimore mund të jenë të ndryshme si:

²⁴⁹ Ndajfoljen e sasisë *pak* e gjejmë të përdorur shpesh në ligjërimitin bisedor në gjuhën shqipe. E gjejmë të përdorur veçanërisht te gjegjëset e fjalive nxitëse të ndjekura nga *fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme*, në të cilat kumtohet shpeshherë një kërkesë me mirësjellje. Në këtë kontekst ndajfolja *pak* është e zhveshur nga *kuptimi i saj leksikor dhe semantik*.

²⁵⁰ M. Swan, *Practical English Usage*, Oxford University Press, 2005, f. 323.

veprime të përbashkëta folës-dëgjues, si dhe veprime vetëm nga ana e dëgjuesit apo folësit. Shpeshherë mund të shërbejnë si mjete ndihmëse për të vijuar një bisedë dhe për të kërkuar detaje në lidhje me elementet thelbësore të bisedës. Në një fjali nxitëse me *let* kumtohet një veprim që pritet të kryhet nga folësi, i cili e “fton” dëgjuesin të përmbushë një kërkesë, një urdhër apo një lutje. Në bashkëbisedimet e përditshme këto ngjyime kuptimore janë të larmishme dhe kushtëzohen nga konteksti në të cilin bashkëbiseduesit kryejnë aktin e komunikimit.

59. “*Just let me finish.*”

(Më lër vetëm të mbaroj. / Vetëm të mbaroj.)

60. “*Just let me*”, - *I began.*

(“Thjesht më lër”, - fillova unë.)

61. “*Let me go or I.*”

(Më lër të shkoj ose unë...)

62. “*Let her go.*”

(Lëre të shkojë. Le të shkojë ajo.)

63. “*Let me check your eyes.*”

(“Më lër të të kontrolloj sytë.”)

(*The Awakening*, f. 27, 59, 116, 259, 293)

64. *Rhys thought for a moment, then nodded and said, “I like it. Let’s try it.”*

(Raisi mendoi për një çast, pastaj pohoi me kokë dhe tha: “Mua më pëlqen ajo. Le ta provojmë.”)

65. “*Good. Let’s keep it that way. How is it going?*” “*Wonderfully, sir.*”

(“Bukuri. Le / Ta mbajmë në këtë formë. Si po ecën?” “Për mrekulli, zotëri.”)

66. *When he spoke, his voice was hoarse. He said, “Let’s go back to the hotel.”*

(Kur foli, zërin e kishte të ngjirur. Ai tha: “Le / Të kthehemi. / Kthehemi në hotel.”)

(*Bloodline*, f. 286, 340, 401)

Nga analiza e shembujve të mësipërm vërejmë se te fjalitë gjegjëse në gjuhën shqipe kemi një strukturë të ndërtuar nga pjesëza *let* (e cila dhe mund të hiqet), të ndjekur nga një folje-kallëzues në mënyrën lidhore. Në pjesën më të madhe të përdorimeve në gjuhën shqipe fjalitë nxitëse e kanë foljen-kallëzues të shprehur me folje në mënyrën lidhore. Përdorimi i foljes në mënyrën lidhore, shpeshherë edhe e paraprirë nga pjesëza *le*, shpreh kumtime urdhëruese më të zbutura në krahasim me fjalitë nxitëse me foljen-kallëzues në mënyrën urdhërore. Siç e kemi përmendur edhe në kreun e dytë, folja *let* në gjuhën angleze jepet me anë të pjesëzës foljore *le*, si një trajtë e gjymtë e urdhërores së foljes *le* në vetën e dytë të njëjësit. Folja *leave*, e cila është gramatikalizuar në shenjues të urdhërores së vetës së parë, mund të marrë ngjyime lejimi. E vërejmë këtë ngjyrim kuptimor te fjalia më poshtë:

67. “*Leave her alone,*” Beth said.

(“Lër / lëre atë vetëm!” - tha Beti.)

(*The Summoning*, f. 15)

Folja *let* në gjuhën angleze, e përdorur me urdhra që i drejtohen vetës së parë e të tretë, ka ndjekur të njëjtën rrugë gramatikalizimi. Në gjuhën shqipe, *lë* (leave, let) është kthyer në shenjues që shpreh nxitje të drejtuar vetës së parë dhe të tretë²⁵¹.

Fjalitë nxitëse dhe kumtimi i tyre nuk i drejtohen vetëm një personi të vetës së dytë, por në përdorimet me *let* kumtimi përfshin edhe vetën e parë. Konstruktet e fjalive me *let* duhet të analizohen si fjali nxitëse të një fare të veçantë, të cilat plotësojnë kuptimin urdhëror të mirëfilltë me kryefjalë të shprehur. Kryefjala e nënkuptuar *you* në fjalitë nxitëse me *let* nuk mund të shprehet si te fjalitë nxitëse të mirëfillta, në të cilat mund të shprehet ose mund të

²⁵¹ A. Y. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010, f. 348-349.

mungojë në fjali. Por, kryefjala shenjohet së bashku me dëgjuesin (të adresuarin) në përemrat vetorë *me, him, her, us* që ndjekin foljen *let* në fjalitë nxitëse.

Edhe pse *let* funksionon si një shenjues prezantues, nga ana sintaksore ajo kryen funksionin e një foljeje bazë në urdhërore, veçanërisht në anglishten britanike²⁵². Funksionet kumtuese në fjalitë nxitëse me *let* mund të grupohen në:

A. Veprime që duhen kryer me pjesëmarrjen e folës-dëgjues, veprime që kërkojnë përkushtimin e të dyve, pra një ndërmarrje e përbashkët. Në biseda, fjalitë nxitëse me *let's* në mënyrë tipike propozojnë për një veprim të përbashkët²⁵³.

68. "All right. *Let's make it fast and quiet. Get everyone in place. Five minutes.*"

("Në rregull. Le ta kryejmë shpejt dhe me qetësi. Të jenë të gjithë në vendin e tyre.

Për pesë minuta.")

69. *Rhys shrugged. "Tell her to send the man in. Let's find out what's so important."*

(Raisi mblodhi supet. "Thuaj asaj të dërgojë atë personin brenda. Le të / Të zbulojmë çfarë është kaq e rëndësishme.")

(*Bloodline*, f. 421, 403)

B. Veprime që duhet të kryhen nga dëgjuesi (*bashkëbiseduesi*), kur kryefjala është në vetën e tretë:

70. "*Let him in,*" *I said, and Eric went to the back door.*

("Le / Lëre të hyjë ai," - thashë unë dhe Eriku shkoi nga dera e pasme.)

(*Dead reckoning*, f. 253)

71. "*Let her go.*"

["Lëre atë të shkojë (ti duhet ta bësh këtë gjë)."]

C. Veprime që duhet të kryhen nga folësi, kur kryefjala është në vetën e parë:

72. "*Let me go or I..*"

("Le të shkoj unë. / Më lër të shkoj.")

73. "*Just let me finish.*"

(Më lër të mbaroj. Thjesht të mbaroj.)

(*The Awakening*, f. 259, 116, 27)

Në fjalinë 72 folësi kryen veprimin, pra ai shkon (largohet) dhe te fjalia 73, po folësi, kryen kontrollin e syve në këtë kontekst. Është e rëndësishme të theksojmë faktin se larmia e kuptimeve të fjalive nxitëse me *let's* nuk është e kufizuar vetëm në shprehjen e veprimeve urdhëruese që i përfshijnë të dyja palët si te fjalia 74.

74. "*What's wrong?*" *Remy asked ... "Tell you later," I murmured. "Let's go see something else."*

("Ç'ka ndodhur?" - pyeti Remi ... "Ta tregoj më vonë," - mëmërita unë. "Le të shkojmë të shikojmë diçka tjetër.")

Të tjera ngjyime kuptimore përfshijnë:

Këshilla

75. "*Let's just get this over with,*" *he said. "I'm not in a good mood."*

("Le ta harrojmë këtë," - tha ai. - "Nuk jam në humor të mirë.")

(*The Summoning*, f. 278)

²⁵² E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 249-250.

²⁵³ H. Takahashi, *Let's imperatives in conversational English*, Journal of the Graduate School of Letters 4, f. 33.

Udhëzime

76. “*If we’re going to do something bad, let’s go on and do it - not talk it to death!*”
 (“Nëse do të bëjmë diçka të keqe, le të vazhdojmë ta bëjmë, jo të flasim pa pushim!”)
 (*Dead Reckoning*, f. 198)

Propozime

77. “*Let’s get to work*”, I said...
 (“Le të kthehemi në punë”, - thashë unë...)
 78. “*Let me get out first.*”
 (“Le të dal unë i pari. / Po dal unë i pari.”)

(*Dead Reckoning*, f. 3, 193)

Let’s shpeshherë është përshkruar si “*first person inclusive imperative*”²⁵⁴, që tregon se fjalia nxitëse e tipit *let’s + verb* shpreh veprime që përfshijnë edhe vetën e parë *I* (unë), *we* (ne) dhe *dëgjuesin*. Kontekstet në të cilat ky ndërtim shpreh veprime të përbashkëta janë mjaft të shpeshta. Ndërtimin me *let’s + folje* e kemi hasur në pjesën më të madhe të korpusit. Analiza e korpusit të fjalive nxitëse me *let* dhe shpeshësia e tyre vërteton përdorimin e dëndur në ligjërimin e shkruar.

Let’s + folje, në kontekstet që përdoret, shpreh bashkëveprim folës-dëgjues në përmbushjen e qëllimit kumtues dhe shpeshësia e këtyre fjalive paraqitet në Tabelën 3.

Përdorimi mjaft i dëndur i fjalive nxitëse me *let’s* vihet re jo vetëm në ligjërimin e shkruar, por edhe në atë bisedor dhe një nga faktorët kryesorë të një dëndurie të tillë lidhet më tepër me anën semantike dhe funksionin komunikativ që shpreh kjo fjali. Një thënie nxitëse me *let’s* shpreh kumtime jo të drejtpërdrejta, sepse përfshirja e të dy palëve tregon se i kërkohet diçka dëgjuesit në mënyrë të tërthortë dhe me mirësjellje për të bashkëpunuar. Pra, folësi në këto akte ligjërimi nuk shfaq një ndikim të dukshëm detyrues ndaj dëgjuesit. Reagimi dhe pjesëmarrja e dëgjuesit në këtë akt komunikimi është më mbizotërues dhe më i dukshëm.

Duhet të përmendim edhe përdorimin e dy strukturave të tjera me *let*, që dalin hera-herës në fjalitë nxitëse si struktura të ngulitura: *let me see* (pa ta shoh unë) dhe *let me say* (le të themi se / që). Përkthimi literal shënon veprime që ofrohen nga folësi për të ndihmuar, për të marrë pjesë ose për të ndërhyrë në një bisedë. Një strukturë e tillë zë vend në fillim të periudhave të ndryshme në ligjërimin e shkruar a të folur dhe në këtë përdorim duket të ketë humbur kuptimin thelbësor të fjalive nxitëse të tipit *let me*. Le t’i bëjmë objekt analize shembujt në të cilët gjejmë përdorim, në mënyrë që të dallojmë anën semantike dhe funksionin komunikativ që ato kryejnë në këto fjali.

79. “*Let me just say here that normally I have quite a strong stomach, but the rain wasn’t the only thing that was dripping.*”
 (“Le të themi se normalisht unë kam stomak të fortë, por shiu nuk ishte i vetmi që pikonte...”)

(*Dead Reckoning*, f. 246)

80. “*Just let me finish.*”
 (“Le të mbaroj / po mbaroj unë atëherë.”)

(*The Awakening*, f. 27)

81. “*Let me guess.*” *he said.*
 (“Më lër ta marr me mend.\ Ta marr me mend”)

(*The Summoning*, f. 258)

²⁵⁴ R. Huddleston, G. K. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English language*, Cambridge University Press, 2002, f. 936.

Analiza kontrastive e shembujve 79, 80, 81 tregon se nga ana kuptimore këto ndërtime nuk përshkohen nga një forcë shprehëse urdhëruese, tipike për fjalitë nxitëse. Në disa fjali gjegjëse në gjuhën shqipe vërejmë përdorimin e mënyrës dëftore të foljes, veta e parë njëjës a shumës. Si në gjuhën angleze, ashtu edhe në gjuhën shqipe del mjaft qartë zbehja e shkallës së urdhrit dhe nuancës kuptimore të bashkëveprimit mes dy palëve. Dhe si rrjedhim, kuptimi i tyre nuk është i barasvlerëshëm me kuptimet që shprehin fjalitë nxitëse me *let*. Sipas vlerës kuptimore në kontekstet e përdorura, mund të themi se *let me see* dhe *let me say* ose *let's see* më tepër mund të trajtohen si pjesëza shenjuese të ligjërimit (mjete plotësuese). *Këto shprehje i japin më tepër kohë folësit për të menduar*²⁵⁵. Pra, folësit fitojnë kohë për të vijuar bisedën më tej me një mendim, një vendim, një propozim a një konkluzion që mëtojnë të shprehin. E njëjta dukuri ndodh edhe me foljen *look* (shikoj) në përdorimin e saj në një sërë kontekstesh dhe situatash me funksione të ndryshme. Në një kontekst ku i kërkohet dikujt të hedhë një sy, atëherë kemi të bëjmë me një fjali nxitëse të mirëfilltë, si te fjalia 24 e përmendur më parë.

Foljen *look* e gjejmë të përdorur në shumë ligjërime me vlerë kuptimore të ndryshme nga kuptimet e saj dhe me funksione komunikative të larmishme. Në këto kontekste, përdorimi i foljes *look* para fillimit të bisedës, marrjes së fjalës ose theksimit për të paralajmëruar diçka më të rëndësishme dhe më interesante, zbeh forcën urdhëruese shprehëse të fjalive nxitëse dhe, për pasojë, folja *look* kthehet në një pjesëz shenjuese ligjërimore (*discourse filler*). *Thelbi i zhvillimit të këtyre mjeteve të ligjërimit qëndron në përdorimin e foljeve në mënyrën urdhërore, në të cilin na kumtojnë një thënie që ndërpret thënien paraprijëse*²⁵⁶. Përdorimi i foljes *look* në gjuhën angleze (*shiko* - në gjuhën shqipe, *guarda* - në gjuhën italiane) në të tilla struktura tregon se urdhërorja e foljeve-kallëzues në fjalitë nxitëse është një mjet i fuqishëm në bashkëbisedime.

Ka shumë qasje të studiuesve të ndryshëm në lidhje me historinë e shndërrimit të formës foljore *look* në një shenjues ligjërimit. *Look*, si një shenjues i ligjërimit, është trajtuar si *gramatikalizim i kësaj forme foljore* nga Traguott (1997), por qasja e Waltereit-it shpjegon se mospërfshirja e *look* në strukturën sintaksore të fjalive që u paraprin dhe lidhja kuptimore me ligjërimitin që vijon, e hedh poshtë atë. Ky element gjuhësor i ligjërimit nuk shfaqet i detyrueshëm në strukturën sintaksore të fjalisë, por si shenjues i ligjërimit. Kur folësi shqipton fjalinë nxitëse strukturalisht të ndërtuar vetëm nga folja *look*, ai nuk mëton të theksojë elemente të tjera të së njëjtës fjali (do të ishte e pamundur nëse fjalia do të kishte vetëm një gjymtyrë), por ai synon të theksojë elementet që lidhen me pjesën vijuese të ligjërimit²⁵⁷. Për këtë arsye, folja *look* ndeshet shpesh në kontekste të ndryshme duke paraprirë jo vetëm fjalitë nxitëse, por edhe ato dëftore dhe pyetëse. Kjo shpeshësi përdorimi e ka shndërruar foljen *look* në shumë kontekste në një shenjues të ligjërimit.

Nga analiza e përdorimit të fjalive nxitëse me *let* në gjuhën angleze mund të themi se *struktura* sintaksore e tyre ka këto veçori dalluese:

A. Struktura *let's + folje / let + kundrinor* i shprehur me përemër vetor (*us, me, him, her, them*); nuk ka asnjë rast të strukturës *let's + you*.

Në fjalitë nxitëse me *let's, us* (ne) është kundrinori i shfaqur si shkurtim në formën '*s*, i cili mund të interpretohet në fjali që përfshijnë dëgjuesin së bashku me folësin: *let's go for a walk* (le të shkojmë / shkojmë për një shëtitje); pra, sugjeron që *ti* dhe *unë* të shkojmë për shëtitje, jo të shkoj unë me një person të tretë²⁵⁸.

²⁵⁵ M. Swan, *Practical English Usage*, Oxford University Press, 2005, f. 138-145.

²⁵⁶ R. Waltereit, *Imperatives, interruption in conversation and the rise of discourse markers: a study of Italian "guarda"*, *Linguistics*, Walter de Gruyter, 2002, 987-1010.

²⁵⁷ *Po aty*, f. 1007.

²⁵⁸ R. Huddleston, G. K. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press, 2002, f. 934.

B. Shpreh përgjithësisht veprime të përbashkëta që të realizohen nga pjesëmarrësit në aktin e komunikimit folës-dëgjues, pra *let's* në fjalitë nxitëse shpreh sjellje bashkëvepruese:

- Veprimet e dëgjuesit janë më të shpeshta dhe jo të ndikuara prej folësit.

- Aktet e ligjëritimit që realizohen janë jo vetëm veprime të përbashkëta, por edhe udhëzime, këshilla, sugjerime. Prandaj, forca urdhëruese shprehëse në fjalitë nxitëse me *let's* nuk ka të njëjtin intensitet të shprehjes së saj, krahasuar me fjalitë nxitëse që shprehen formalisht nga një folje-kallëzues në mënyrën urdhëruese.

- Këto fjali nxitëse në shumicën e rasteve nuk ndiqen nga fjali të tjera nxitëse ose dëftore, që shërbejnë si një përgjigje, miratim a refuzim i kumtimit të dhënë. Përmbushja apo dakordësia me kumtimin e shprehur merret si e mirëqenë nga të dyja palët, folës-dëgjues.

C. Sipas shpeshtësisë së përdorimit, fjalitë nxitëse me *let's* gjenden rëndom në dialogët e studiuar nga letërsia artistike. Në pjesën më të madhe të konteksteve ku përdoren fjalitë nxitëse, lloji i fjalive me *let* spikat në krahasim me tipat e tjerë strukturorë. Kjo vërehet qartë në tabelën e shpeshtësisë së përdorimit të strukturave tipike sintaksore të fjalive nxitëse. (Tabela 3)

4. Tipi strukturor me *don't* + kryefjalë + folje-kallëzues + kundrinor/rrethator

82. “*Don't ask what I've been doing.*”

(“Mos pyet me çfarë jam marrë këto kohë.”)

(*The Awakening*, f. 156)

83. “*Don't take her away. I need her.*”

(“Mos e largo atë. Unë kam nevojë për të.”)

(*The Summoning*, f. 28)

84. He patted me on the shoulder. “*Don't worry about it.*”

(Ai më fërkoj shpatullën. “Mos u shqetëso për këtë gjë.”)

85. “*Don't cry!*” He waved his hands in front of him as if to ward off my tears.

(“Mos qaj!” Ai tundi dorën para tij, sikur donte të më largonte lotët.)

(*Dead Reckoning*, f. 45)

86. “*I'll make the reservations for you.*” “*Don't bother. They're already made.*”

(“Do t'i bëj unë rezervimet për ty.” “Mos u mërzit. Tashmë janë bërë.”)

87. “*Don't look down,*” he said. “*Close your eyes, and let yourself go. I'll catch you.*”

(“Mos shiko poshtë,” - tha ai. “Mbylli sytë, lëshoje veten. Unë do të të kap.”)

88. “*Don't let it look like an accident.*”

(“Mos e lër të duket si aksident.”)

(*Bloodline*, f. 95, 454, 446)

Shpeshësia e përdorimit e tipave strukturorë të fjalive nxitëse

Burimi i korpusit	Strukturat e fjalive nxitëse						Pje të përbëra								
	Let		Ø + kall.	Ø + kall + kd.	Ø + kd + kzhd.	Ø + kall. + rreth.	Kryef. kall. + rreth.	Ø + be + Plotës kall.	Me bashkë.	Nënrenditëse		Fj. Pvet.	Fj. Dëft.	Don't	Fj. Elipt.
	Me	's								Ftilluese	Kushtore				
<i>The Awakening</i>	5	4	40	47	4	23	2	2	10	7	10	6	10	9	12
<i>The Summoning</i>	6	10	37	59	3	42	7	3	21	8	4	7	10	25	10
<i>Dead Reckoning</i>	13	11	18	23	5	13	3	3	5	5	3	5	13	8	3
<i>Bloodline</i>	6	9	35	27	7	40	9	4	15	7	8	13	15	16	8
<i>Filmat</i>															
<i>The Past</i>	4	5	35	26	5	20	5	3	12	9	4	5	7	9	5
<i>Promised Land</i>	10	16	29	33	7	18	13	7	7	14	3	12	9	10	8
<i>American Hustle</i>	11	14	33	22	6	19	10	8	15	11	6	7	8	6	7
<i>12 years a slave</i>	10	5	27	26	12	14	20	11	16	9	5	9	8	11	9
<i>Beginners</i>	1	7	42	20	10	12	17	9	13	6	9	11	9	7	6

Tabela 3

Korpusi i fjalëve: Roman - 731 000
Korpusi i fjalëve: Filma - 165 500

§4.2.2. Fjali dëftore a pyetëse me funksionin kumtues të fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar

Fjalitë dëftore. Kumtimi i fjalive nxitëse mund të shprehet edhe me një formë foljore jourdhërore, d.m.th. me një fjalë pyetëse ose dëftore. Edhe një fjalë dëftore me foljenkallëzues në kohën e ardhme mund të kumtojë një kërkesë, një urdhër, një këshillë etj. Në përgjithësi, fjalitë dëftore me funksione gjuhësore të nxitjes shprehin në mënyrë më të zbutur një kërkesë, një urdhër a një këshillë. Pra, mund të themi se fjalitë dëftore përbëjnë një prej mjeteve gjuhësore të emërtuara si *strategji të komunikimit* dhe për sa u përket fjalive nxitëse, ato shërbejnë për ta bërë kumtimin gjegjës më pak të drejtpërdrejtë dhe me më tepër nuanca të mirësjelljes. Sipas Leech-it (1983), nivelet e mirësjelljes lidhen me konceptin e taktit. Për Leech-in, takti ka dy pole: atë *negativ*, në të cilin duhet të zvogëlohet kostoja ndaj *dëgjuesit* dhe polin *pozitiv*, në të cilin duhet të rritet përfitimi i *dëgjuesit*²⁵⁹. Në kontekste të tilla fjalitë nxitëse në gjuhën angleze me mjete të ndryshme gjuhësore të tërthorta janë shumë të zakonshme.

Fjalitë dëftore me foljet modale *might*, *should* apo *want to* shprehin edhe kuptime që kalojnë nga ngjyrimet e një urdhri të prerë, në një propozim ose udhëzim me ngjyrimet të zbutura të thirrjes për të kryer diçka. Prania e foljeve modale e ngarkon kumtimin e fjalisë me modalitet të domosdoshmërisë. Në këto raste fjalia dëftore dhe fjalia nxitëse shfaqin bashkëpërkime kuptimore. Si rrjedhojë, është e vështirë të dallosh caqet e secilës fjali dhe të

²⁵⁹ Cituar nga Ch. F. Meyer, *Introducing English Linguistics*, Cambridge University Press, 2009, f. 50.

bësh kategorizimin e tyre në grupin përkatës. Krahasojmë një fjali nxitëse të mirëfilltë me një fjali dëftore me kuptim nxitës.

89. "Get some sleep!"

("Fli gjumë!")

90. "You should get some sleep."

("Ti duhet të flesh gjumë.")

(*The Awakening*, f. 298)

Tek të dyja fjalitë dallohet qartë modaliteti i domosdoshmërisë së kryerjes së veprimit, një fakt, qenia a mosqenia e të cilit diktohet nga faktorë të jashtëm ose nga shtysa të brendshme të folësit²⁶⁰. Fjalitë 89 kumton një urdhër që duhet të zbatohet nga dëgjuesi dhe te fjalitë 90 folësi nxit bashkëbiseduesin për të kryer atë veprim (të flejë gjumë) në formën e një porosie, propozimi a këshille. Ngjyrimi urdhërues është më pak i dallueshëm në fjalinë e dytë. Edhe veçoritë që shfaq intonacioni tek të dyja fjalitë, janë të ndryshme: te *fjalitë e parë*, ku nuk shprehet kryefjala, intonacioni është i veçantë, zbritës dhe urdhërues, ndërsa te *fjalitë e dytë* vija intonacionore ruan një ritëm mesatar dhe toni ulet në fund të fjalisë. Megjithatë, fjalitë e dytë nga ana strukturore mund të kategorizohet si fjali dëftore, por nga ana kumtuese shpreh një domosdoshmëri që nxitet nga folësi dhe që përkon me natyrën e kumtimit të fjalive nxitëse²⁶¹.

Fjalitë dëftore që përdoren për të shprehur kumtime të fjalive nxitëse, mund të marrin interpretime kuptimore të ndryshme në kontekste më të gjera. Interpretimi kuptimor lidhet me përfituesin e kumtimit, nëse përmbushja e urdhrat apo e kërkesës është në favor të dëgjuesit a të çiftit folës-dëgjues (në këtë akt komunikimi), por jo vetëm të folësit.

91. "Before you do that, you'd better take a look at Chloe's arm."

("Para se të bësh këtë, më mirë hidhi një sy krahut të Kloes.")

92. "I don't think that's yours, Chloe," she said as she approached, flashlight in my eyes.)

("Unë nuk mendoj që ajo është jotja, Kloe," - tha ajo dhe u afrua duke më drejtuar dritën e dorës në sy.)

93. "Chloe?" she said, voice low. "Honey, you need to step away from that window."

"I was just..."

("Kloe?" - tha ajo me zë të ulët. "Shpirt, ti duhet të largohesh nga ajo dritare.")

"Unë thjesht po..."

(*The Summoning*, f. 376, 343, 26)

94. "You can read the book in here, while I work in my office."

("Ju mund ta lexoni librin këtu.")

95. "You can skip the screaming part."

("Ti mund ta ndalosh / Ju mund ta ndaloni të bërtiturën.")

(*The Awakening*, f. 47, 227)

96. Sam sounded pleased. "You can tell me what you think about whatever Brenda shows. It'll be good to have a woman's opinion."

(Semi dukej i kënaqur. "Ti mund të më tregosh çfarë mendon për ato që tregon Brenda. Do të ishte mirë të merrim dhe mendimin e një gruaje.")

97. "I want you to move in with me," Eric said. "You can stay in one of the bedrooms if you want."

("Unë dua që ti të shpërngulesh me mua," - tha Eriku. "Ti mund të qëndrosh në një nga dhomat e gjumit, nëse dëshiron.")

(*Dead reckoning*, f. 7, 148)

98. "Then you've got to give her police protection," Rhys demanded.

²⁶⁰ Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 124.

²⁶¹ Ka ende kundërtënie e kundërshti në lidhje me kriteret që duhet të merren parasysh për kategorizimin e fjalive në njërin tip ose në tjetrin.

(“Atëherë ju duhet t’i siguroni asaj mbrojtjen nga policia,” – kërkoi Raisi.)

99. “*I want you to do me a favor, Maria.*”

“*Name it.*”

(“Unë dua të më bësh një nder, Maria.”

“*Thuaje.*”)

100. “*You should get right to a hospital,*” *the doctor had told him.*

“*Ti duhet të shkosh menjëherë në një spital,*” i kishte thënë doktori.

(*Bloodline*, f. 406, 356, 407)

Shpeshësia e përdorimit është paraqitur në Tabelën 3 dhe në të vërejmë se fjalitë dëftore mund të shprehin kuptime që janë tipike të fjalive nxitëse. Duhet të theksojmë faktin se këto kuptime nxitëse marrin vlerë si të tilla në kontekstin ligjërimit në të cilin janë përdorur. Pra, ana kuptimore është e lidhur ngushtësisht me faktorët kontekstualë dhe më elementet prozodike (intonacioni, theksi logjik etj.). Në vështrimin strukturor, edhe në gjuhën shqipe fjalitë dëftore mund të shprehin kuptime të fjalive nxitëse dhe duke iu referuar gjegjëseve të shembujt më lart përdorimi i kryefjalës dhe intonacioni e shndërrojnë ngjyrimin kuptimor në thirrje, nxitje apo urdhër. Përderisa në gjuhën shqipe kryefjala e munguar e fjalive nxitëse shenjohe me anë të mbaresave vetore, të fjalitë dëftore me kuptim nxitës elementet intonacionore janë të rëndësishme në dhënien e kumtimit të synuar.

Fjalitë pyetëse. Edhe *fjalitë pyetëse* kumtojnë në mënyrë të tërthortë një kërkesë, një porosi, një lutje, ndalim a moslejim në formën e një pyetjeje. Kuptimi i fjalive pyetëse kalon nga shprehja e një pyetjeje në shprehjen e kuptimeve të fjalive nxitëse, të kundruara vetëm brenda kontekstit ligjërimit në të cilin ato gjejnë përdorim. Vërejmë shembujt e vjelë:

101. “*Please. Can we stop bickering?*” *I stepped between them.*

(“*Të lutem, a mund ta ndalojmë / lëmë grindjen? Sikur ta lëmë grindjen?*”)

(*The Awakening*, f. 157)

102. (*Please, stop bickering.*)

(*Të lutem, ndaloje grindjen / të lutem, po sikur ta lëmë / do ta lëmë grindjen...*)

- fjalia gjegjëse nxitëse

Te fjalia 101 nxitja shprehet në formën e një pyetjeje për të bërë një propozim a një kërkesë për të ndaluar grindjen. Përmbushja ose jo e kërkesës së bërë i lihet bashkëbiseduesit në dorë. Megjithatë, synimi bazë i folësit është të ndalojë grindjen. Te fjalia 102 folësi urdhëron ndalimin e grindjes në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pret zbatimin e tij të menjëhershëm. Edhe te gjegjëset në shqip dallojmë taktin dhe mënyrën e tërthortë të kërkesës që i bëhet dëgjuesit nëpërmjet pyetjes. Në gjuhën shqipe, nga ana formale, folja-kallëzues shprehet me folje në mënyrën lidhore ose në kohën e ardhme të mënyrës dëftore. Fjala leksikore *sikur*²⁶² haset shpesh në fjalitë nxitëse-pyetëse dhe përdorimi i saj e bën kërkesën më të tërthortë dhe hipotetike.

Këto fjali nxitëse-pyetëse gjenden shumë shpesh edhe në gjuhën shqipe, veçanërisht në ligjërimit bisedor. Ne mendojmë se te fjalia nxitëse me formë pyetëse shprehet edhe gjendja ndjenjësore e folësit, i cili është i interesuar që kjo gjë (grindja, për shembull te fjalia 101) të përfundojë. Për këtë arsye pritët që thirrja për veprim të kryhet. Përdorimi i fjalive nxitëse-pyetëse në ligjërimit e shkruar shërben si një strategji e komunikimit, krahas një sërë strategjish të tjera për ta bërë komunikimin sa më miqësor, të afërt dhe me rezultatet e duhura. Strategjitë e kumtimit të urdhrave mund t’u japin kuptime të tjera fjalive nxitëse, të cilat nuk mund të gjenden te fjalitë nxitëse të mirëfillta²⁶³. Kuptime urdhëruese të zbutura

²⁶² *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 135.

²⁶³ A. Y. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press 2010, f. 40.

shprehen edhe te fjalia 103, në të cilën vërejmë konstruktin *why don't you*, një konstrukt që haset rëndom te fjalitë pyetëse në gjuhën angleze.

103. *Why don't you call Derek to help you now, Chloe?*

(Kloe, pse nuk / po sikur e thërret / ta thërrasësh Derekun të të ndihmojë tani?)

(*The Awakening*, f. 36)

Së pari, fjalitë nxitëse-pyetëse në gjuhën angleze e kanë si veçori dalluese ndërtimin me *why don't you* për të bërë një sugjerim dhe, për pasojë, folësi zakonisht nuk pret një përgjigje nga dëgjuesi në këtë kontekst. Pra, konstrukti "*why don't you?*" mund të përshtatet në kontekste të caktuara në gjuhën shqipe me kuptimin (*pse nuk... po sikur... etj.*).

Së dyti, konstruktin "*why don't you?*" e ndeshim edhe në strukturën e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme dhe në këto përdorime e gjithë periudha shpreh sugjerime të tërthorta, si te shembulli 128 i përmendur në kreun e tretë: *Book the Chinese restaurant for your birthday party, why don't you?* (Pse nuk rezervon restorantin kinez për festën e ditëlindjes?)

104. "*Why don't you go grab a coffee, Rob?*", Dr. Davidoff said.

("Pse nuk shkon të marrësh një kafe, Rob?" - tha dr. Davidofi.

(*The Awakening*, f. 20)

105. "*Can you come down and help me?*

("Mund të vish poshtë të më ndihmosh? / A vjen poshtë të më ndihmosh?")

(*The Summoning*, f. 1)

106. *Come down and help me.*

(Zbrit poshtë dhe më ndihmo / të më ndihmosh.) - fjalia gjegjëse nxitëse

Të dyja fjalitë (104 dhe 105) kumtojnë një kërkesë në formën e një pyetjeje. Modaliteti i shprehur nëpërmjet foljes *can* (mund) shpreh një kërkesë që i referohet një të ardhmeje të afërt: gjasat e kryerjes së veprimit dhe kërkesën e diktuar nga forca e brendshme e folësit. Fjalia nxitëse gjegjëse e mirëfilltë 106 shpreh një kërkesë të prerë për të ndihmuar.

107. *He looked as pale as death. "What are you sneaking around here for?" he demanded. He was holding her arm, hurting it. "I- I'm not sneaking," she said. "Today is my day to clean. The agency..."*

(Ai ishte zbehur si i vdekur. "Cfarë po kërkon vjedhurazi"? - pyeti ai. Ai mbante dorën e saj aq fort, saqë po e lëndonte. "Unë-unë nuk po hyj vjedhurazi", - tha ajo. "Sot është dita që duhet të pastroj. Agjencia...")

(*Bloodline*, f. 409)

Fjalia pyetëse 107 në kontekstin e shkëputur nuk kumton një pyetje drejtuar dikujt, por më tepër shpreh një kërkesë a një urdher të folësit për të ndaluar veprimin e personit tjetër (të mos hyjë vjedhurazi në atë vend). Pra, kumtimi mund të shprehet si një fjali nxitëse e mirëfilltë:

108. *Don't sneak around here!*

(Mos hyr vjedhurazi këtu!)

109. "*Hello, Sookie,*" Brenda called, as if we were old friends. "*This is Donald Callaway, the co-owner of the shop.*" "*Mr. Callaway,*" I said, nodding. "*You two come on in. Can I get you all a drink?*"

("Përsëndetje, Suki", - tha Brenda, sikur të ishim miq të vjetër. "Ky është Donald Kolluei, bashkëpronari i dyqanit." "Z. Kolluei", - thashë unë duke miratuar me kokë. "Ju të dy eja hyni brenda. Mund t'ju sjell një pije \Doni të gjithë nga një pije?")

(*Dead Reckoning*, f. 104)

110. "*Ivo! I'm exhausted!*" Simoneta complained. "*Can't we rest a minute?*"

("Ivo! Jam e rraskapitur!" - u ankua Simoneta. "S'mund të pushojmë pak?")

(*Bloodline*, f. 299)

Fjalitë 109 dhe 110 nuk kumtojnë pyetje për të marrë informacion apo për të vërtetuar diçka, por shprehin përkatësisht një ofertë a një ftesë miqësore për të pirë një pije dhe një lutje apo grishje për të reaguuar në një situatë të tillë. Fjalitë gjegjëse nxitëse do të tingëllonin si ftesa dhe thirrje jo aq të tërthorta dhe miqësore sa kumtimi i fjalive pyetëse nga ana formale.

Te gjegjëset në gjuhën shqipe vërejmë përdorimin e foljeve modale, pjesëzave *a, pse nuk, sikur, po sikur*, të cilat shërbejnë si mjete leksikore a ligjërimore në pasqyrimin e kumtimit nxitës, i shprehur formalisht me një fjali pyetëse. E gjejmë tepër interesant përdorimin e pjesëzave me kuptim mohor *nuk* dhe *pse nuk*, si pjesëza me domethënie kuptimore zbutëse. Si përfundim, duhet të vëmë në dukje te fjalitë pyetëse që kanë kuptime të fjalive nxitëse, rëndësinë e kontekstit në përkapjen e ngjyimeve kuptimore nxitëse, të cilat në përgjithësi shpërfaqen më të zbutura, më me mirësjellje dhe më të tërthorta në këto fjali.

§4.2.3. Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme në strukturën e fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar

Të emërtuara si *tag-questions* në gjuhën angleze, fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme “ngjiten” në fund të strukturës së fjalive nxitëse dhe përbëjnë një veçori dalluese të gjuhës angleze. Pjesa më e madhe e tyre kanë foljen ndihmëse *will* në strukturën e tyre. Fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme u bashkërenditen kryesisht fjalive dëftore, në të cilat kanë edhe dendurinë më të madhe të përdorimit dhe janë karakteristikë e ligjërimin joformal (*informal writing*). Përdorimi i tyre në fjalitë dëftore shërben për të dëshmuar vërtetësinë e kumtimit të fjalisë apo për të kërkuar miratim rreth tij²⁶⁴. Këto fjali kryejnë funksione të ndryshme kumtuese duke përforcuar, dalluar apo zgjeruar thelbin kuptimor të thënies. Funksionet e ndryshme lidhen me semantikën që shpreh fjalitë nxitëse.

Te fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe nuk kemi ndërtime të tilla. Në këtë mënyrë, gjegjëset e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në gjuhën shqipe, janë fjalë a togje fjalësh me nuanca afektive emocionale të folësit ndaj kumtimit të fjalisë. Semantika e tyre është mjaft e gjerë, duke pasur parasysh faktorët kontekstualë që ndikojnë në interpretimin dhe përkapjen e kumtimit të një thënieje të caktuar.

Le të vërejmë shembujt dhe gjegjëset në gjuhën shqipe. Në varësi të funksionit gjuhësor mund t'i ndajmë në:

Fjali nxitëse të ndjekura nga fjali pyetëse të pagjymtyrëzueshme (*tags*) që shprehin:

a. *Inat dhe padurim, të shqiptuara me një intonacion rritës:*

111. Shut up, *right*?

(Mbylle gojën, në rregull / pusho! Mos fol, dakord?)

(*The Awakening*, f. 325)

b. *Një kërkesë apo këshillë sa më asnjandëse ose me tone të mirësjelljes:*

112. Call him, *right*?

(Telefonoje! / Bëji një telefonatë, si thua?)

113. Join the english club, *why don't you*?

(Bashkohu me klubin e anglishtes, pse jo / si thua?)

c. *Një urdhër a kërkesë të prerë që duhet të përmbushet sa më shpejt:*

114. Drop it, *okay*? *She's not interested. She's made that very, very clear.*

(Lëre atë, në rregull / hë pra? Ajo nuk është e interesuar. Ajo e ka bërë këtë gjë shumë të qartë.)

d. *Për të shprehur një ftesë apo ofertë sa më miqësore:*

²⁶⁴ M. Swan, *Practical English usage*, Oxford University Press, 2005, f. 470.

115. Come and meet me, *will you?*
(Eja më tako, pra!)

(*The Summoning*, f. 148)

§4.2.4. Analiza kontrastive e fjalive nxitëse si pjesë të fjalive të përbëra në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe

Në ligjërime të ndryshme ku fjalitë nxitëse gjejnë përdorim dhe në burimet e korpusit që ne po analizojmë, vërejmë se këto fjali shfaqen me një strukturë të thjeshtë, pra si fjali të mëvetësishme. Kjo strukturë përbën edhe dendurinë më të madhe të përdorimit. Huddleston-i pohon se fjalitë nxitëse janë të kufizuara në përdorimin si fjali kryesore²⁶⁵. Tipat e tjerë të fjalive mund të dalin si fjali të mëvetësishme ose edhe si pjesë e fjalive të përbëra. Fjalitë nxitëse e kanë më të kufizuar përdorimin si pjesë e fjalive të përbëra. Megjithatë, ka raste kur fjalitë nxitëse mund jenë edhe pjesë e një fjalie të përbërë, si fjali me bashkërenditje apo në raste më të rralla, në fjalitë me nënrenditje në kontekste të veçanta përdorimi. Le të analizojmë me hollësi shembujt që kemi vjelë në korpusin e romaneve të gjuhës angleze dhe gjejëset e tyre në gjuhën shqipe:

116. “*Please tell me he isn’t doing what I think he is doing.*”
(“Të lutem, më trego që ai nuk po bën atë që unë mendoj se po bën.”)
117. “*Take her, find Dad and he will fix anything.*”
(“Merre atë, gjej babanë dhe ai do të zgjidhë çdo gjë.”)
118. “*Set me free and I shall take my revenge on the world.*”
(“Më lër të lirë dhe unë do të hakmerrem ndaj botës.”)
119. “*Ask me your questions and I shall play schoolteacher, answering them at no cost.*”
(“M’i bëj mua pyetjet e tua dhe unë do të jem mësuesja. Do t’u përgjigjem, sido që të jetë puna.”)
120. “*Climb on the curb and walk along the edge,*” I said.
(“Ngjitu në bordurë dhe ec anës e anës,” - i thashë.)
121. “*Rescue us from the mad scientists, cure us and take us to a land of lollipops and unicorns.*”
[“Na shpëto ne nga shkencëtarët e marrë, na shëro dhe na merr në tokën e ëmbëlsirave (lëpirëseve dhe njëbrirëshave).”]
(*The Awakening* f. 137, 39, 43, 289,105)
122. “*Say the word and the sign goes up.*”
(“Thuaje fjalën dhe shfaqet shenja.” / “Po the fjalën, u shfaq shenja”. / “Thuaj fjalën, u shfaq shenja.”)
(*The Summoning*, f. 2)

(Te gjejësjë në shqip 122 vërejmë përdorimin e kohës së kryer të thjeshtë *u shfaq* me kuptimin e kohës së ardhme.)

Në gjuhën angleze vëmë re që shpesh nuancat kuptimore të kushtit shprehen jo vetëm te fjalitë e përbëra me marrëdhënie nënrenditëse apo bashkërenditëse, por edhe te fjalitë e thjeshta. Shtrirja e gjerë e marrëdhënieve kushtore në jetën e përditshme dhe botën reale përlligj ngjyrimet kuptimore kushtore edhe në periudha të tjera, përveç asaj me nënrenditje kushtore. Këto përdorime shpjegojnë format e shprehjes së raporteve kushtore në periudha të ndryshme.

²⁶⁵ R. Huddleston, G. K. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press, 2002, f. 854.

Fjalitë nxitëse mund të jenë edhe si pjesë kryesore e fjalive të përbëra me nënrenditje. Frekuenca e përdorimit në këto periudha është më e vogël, krahasuar me përdorimin si fjali të pavarura dhe të mëvetësishme.

Nga ana strukturore lidhen me pjesën e varur me anë të *what* (çfarë), *where* (ku), *which* (cili), *who* (kush) ose edhe pa lidhëz, në mënyrë *asindetike* etj.

123. *Let's see what he can do.*

(Le të shikojmë çfarë mund të bëjë ai.)

124. *But first tell me where you want to go.*

(Por fillimisht më trego ku dëshiron të shkosh.)

125. *Tell us where to look.*

(Na trego ku të shikojmë.)

126. *Tell them my husband has killed our children.*

(Tregoj atyre që burri im ka vrarë fëmijët tanë.) (*Bloodline*, f. 409)

127. “*So explain why you’re living with me and what you want from me,*” I said, hoping they’d answer that one.

(“Shpjegoju pse po largohesh dhe çfarë dëshiron nga unë”, - thashë unë me shpresën se ata do të jepnin një përgjigje.) (*Dead reckoning*, f. 97)

Si pjesë të nënrenditura zakonisht dalin dëftoret. Llojet e tjera dalin më shpesh si pjesë të nënrenditura të pyetjes së zhdrejtë në fjalitë ffilluese. Më rrallë dalin si pjesë të nënrenditura fjalitë nxitëse e dëshirore, të ngjashme shpesh nga forma me fjalitë e zhdrejta²⁶⁶. Kjo dukuri vërehet edhe në gjuhën angleze.

128. *E porositi të vijë menjëherë.*

- pjesë e nënrenditur

129. *Thuaju që të përgatiten për koncertin e së dielës.*

- pjesë kryesore

Pjesa e nënrenditur është e organizuar si fjali nxitëse a dëshirore me foljen-kallëzues në mënyrën lidhore dhe e shpreh brendinë si diçka të lidhur me shprehjen e vullnetit. Ky vullnet ose kuptim nxitës a dëshiror bëhet i qartë nga organizimi i pjesës kryesore, nga folja-kallëzues e saj²⁶⁷. Nga shembujt 128 dhe 129 vërejmë se folja-kallëzues e fjalisë kryesore apo e fjalisë nxitëse kryesore është folje që shpreh elemente kuptimore të vullnetit, brendinë kuptimore të një fjalisë nxitëse të mirëfilltë.

Megjithatë, duhet të theksojmë se kumtimi në fjalitë e përbëra me bashkërenditje (me vlerë kuptimore kushtore) dhe me nënrenditje del me më pak intensitet shprehës urdhërues dhe detyrues. “*Kuptimi i forcës së drejtpërdrejtë, ai i urdhrit, është zbehur, ka humbur ose gjendet në një shkallë të ulët në sfond*”²⁶⁸. Shpeshësia e përdorimit të fjalive nxitëse si fjali kryesore apo me nënrenditje është më e ulët se përdorimi i tyre si fjali të pavarura.

Analiza e fjalive nxitëse në rrafshin gramatikor dhe semantik përbën dy shtyllat bazë të kësaj pjese dhe qasja e elementeve gramatikore të ndërthurura me elementet e semantikës kuptimore mundëson realizimin e një studimi të plotë të këtyre fjalive nga këndvështrimi i *përdorimit praktik*. Gjatë hulumtimit dhe përqasjeve të strukturave gjegjëse në gjuhën shqipe kemi dalluar një *veçanti të kallëzuesit* të fjalive nxitëse në lidhje me klasën e foljeve që përdoren në këtë funksion.

Përveç strukturave të larmishme të fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar dhe gamës së gjerë të anës kuptimore të tyre në kontekste të ndryshme ligjërimore, pra të para në rrafshin gramatikor dhe semantik, ne do të bëjmë një analizë të shkurtër, por mjaft interesante, të klasës leksikore të foljeve që ndërtojnë kallëzuesin e një fjalisë nxitëse.

²⁶⁶ Th. Dhima, *Gjuha shqipe (Sintaksa)*, ShBLU, Tiranë, 2005, f. 51.

²⁶⁷ Th. Dhima, *Gjuha shqipe (Sintaksa)*, ShBLU, Tiranë, 2005, f. 159.

²⁶⁸ R. Huddleston, G. K. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press, 2002, f. 937.

§4.2.5. Denduria e përdorimit të foljeve më tipike në funksionin e kallëzuesit të fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar

Siç e kemi përmendur edhe më parë, në pjesën më të shumtë të rasteve folja-kallëzues përbën gjymtyrën e vetme apo kryesore të saj. Mungesa e kryefjalës e bën kallëzuesin gjymtyrën që mbart thelbin kuptimor të thënies. Duhet të theksojmë se ka një kufizim që lidhet me përdorimin e llojit të foljeve si kallëzues në fjalitë nxitëse. Takahashi thekson se fjalitë nxitëse kanë tërhequr vëmendjen e gramatikanëve dhe sintaksologëve, për shkak të strukturave të veçanta që ato kanë në dallim nga fjalitë dëftore dhe pyetëse. Sipas tij, fjalitë nxitëse shfaqin kufizim të përdorimit të foljeve të cilat kanë tipare të “vetëkontrollueshme” dhe “dinamike”²⁶⁹. Foljet e *gjendjes* nuk mund të përdoren në thënie të tilla, sepse foljet në fjalitë nxitëse duhet të shprehin veprime të kontrollueshme nga folësi, i cili synon të realizojë qëllimet e tij nëpërmjet kërkesës, lutjes a këshillës drejtuar dëgjuesit. Në fjalitë e analizuara janë një grup foljesh që përdoren dendur në fjalitë nxitëse në ligjërimin e ndryshme. Disa prej tyre janë: *go* (shkoj), *tell* (tregoj), *give* (jap), *take* (marr), *get* (marr, fitoj), *open* (hap), *listen* (dëgjoj), *look* (shikoj), *let's* (le të...), *let me* (më lër). Të gjitha këto folje hasen rëndom në bashkëbisedimet folës-dëgjues dhe përgjithësisht ndiqen nga një kundrinor i drejtë ose i zhdrejtë, duke e bërë strukturën sintaksore të fjalive nxitëse të thjeshtë. Në tabelën 4 kemi pasqyruar një përmbledhje të raporteve që shfaq klasa e foljeve në fjalitë nxitëse. Raporti i frekuencës së përdorimit të këtij grupi foljesh përforcon edhe një herë qasjen mbi fjalitë nxitëse që kemi paraqitur më herët: nga ana sintaksore ato kanë një strukturë të thjeshtë dhe nga ana semantike prodhojnë një sërë kuptimesh dhe ngjyrimesh kuptimore në kontekste të ndryshme.

Siç del nga tabela, foljet me dendurinë më të madhe të përdorimit janë *let* (le + folje) dhe *let's* (le + veta e parë shumës, *ne*), të ndjekura shpesh nga një përemër në funksionin e kryefjalës së shprehur në rasën kallëzore. Në disa raste, në varësi të kontekstit ku përdoren, ato shoqërohen nga disa nuanca të mirësjelljes dhe të shprehjes së modestisë. Këto janë strategji të mirësjelljes, term i përdorur nga Brown dhe Levinson (1987) dhe strategjia ose takti që i karakterizon këto folje është edhe arsyeja bazë pse gjenden në të gjitha burimet e korpusit. *Let me / let's* është shumë herë e kumtuar me tone të mirësjelljes, lutjes dhe kulturës së komunikimit dhe këtë e vëmë re në bashkëbisedimet e ligjërimin të përditshëm.

130. “*Let's try the next.*”

(“Le të provojmë tjetrën. / Provojmë (ose të provojmë) tjetrën.”)

(*The Awakening*, f. 76)

131. “*Let me get out first,*” *I said as I pulled up beside the man.*

(“Le të dal unë i pari,” - thashë unë, ndërsa u afrova në krah të burrit.)

132. “*Let him in,*” *I said, and Eric went to the back door.*

(“Le / lëre të hyjë ai,” - thashë unë dhe Eriku shkoi nga dera e pasme.)

(*Dead Reckoning*, f. 193, 253)

Te fjalitë nxitëse gjegjëse në gjuhën shqipe vërejmë se folja-kallëzues është në mënyrën lidhore, urdhërore e dëftore. Ndryshe nga gjuha angleze, në gjuhën shqipe përdorimi i *let* përkon me foljen *le* të ndjekur nga folja përkatëse në mënyrën lidhore. Kjo strukturë gjegjëse në gjuhën shqipe nuk mbart të njëjtën semantikë kuptimore dhe të njëjtin funksion gjuhësor që kryen në ligjërim. Nuk mund të themi se fjalia gjegjëse në shqip shënon një kërkesë apo një urdhër me ngjyrimë kuptimore të mirësjelljes, krahasuar me fjalinë e ndërtuar nga folja-kallëzues *shkojmë*, që në këtë rast shprehet nga një folje e mënyrës dëftore. Intonacioni dhe

²⁶⁹ H. Takahashi, *A usage-based analysis of imperative verbs in English* (2), The Annual Report on Cultural Science, 2007, f. 33.

elementet e tij mund të shprehin kumtimet që folësi dëshiron dhe mëton të shprehë. Pra, vetëm folja *shkojmë*, pa u paraprirë nga folja *le* dhe lidhorja e foljes *shkoj* ose e ndërtuar në formën e një pyetjeje, dallon nga një fjali që kumton urdhër.

Të tjera folje që gjenden në rolin e kallëzuesit të fjalive nxitëse përfshijnë: *tell, come, look, go, give, take*. Përgjithësisht janë një grup foljesh që hyjnë herët në fjalorin e folësve, që në fazat e para të përvetësimit të gjuhës dhe gjejnë përdorim të shpeshtë në jetën e përditshme. Dinamika e përdorimit shpjegohet me natyrën e aktiviteteve të përditshme, në të cilat bashkëbiseduesve u duhet të komunikojnë përmes sjelljeve ndërvepruese: *come, tell, go, wait, get, look* etj. Strukturat më të përdorura në fjalitë e vjela jepen në tabelën 4.

A. *Come + parafjalë / ndajfolje / sintagmë emërore* etj. shpreh kuptime deiktike të lëvizjes, që përkojnë edhe me vetë kuptimin e kësaj foljeje. E gjejmë të përdorur dhe me strukturën *come on*, e cila kumton një thirrje ndaj bashkëbiseduesit për ta nxitur dhe për ta inkurajuar të veprojë, të pranojë, të përpiqet, të largohet etj., të kushtëzuar nga konteksti ku kryhet një akt komunikimi. Denduria e përdorimit të foljes *come* (vij) të ndjekur nga parafjala *on* është mjaft e madhe dhe në ligjërime ku na duhet të motivojmë dikë për të vepruar, përdorimi i *come on* është zgjedhja e duhur. Ne mendojmë që kjo folje është shkrirë kaq natyrshëm me strukturën e fjalisë dhe me ngjyrimet kuptimore që mbart në një mori kontekstesh, sa që shpeshherë mund të quhet si shprehje a pjesëz që shpreh qëndrimin emocional të folësit, parë në këndvështrimin e funksionit që kryen në ligjërim. Kjo strukturë ngjan me pashirrat dhe pjesëzat e përdorura shpesh në llojet e fjalive nxitëse të përmendura në krerët e mëparshëm.

Po të analizojmë gjegjësen në gjuhën shqipe, do të vërejmë se nuk kemi një strukturë të ndërtuar nga folja *come* në mënyrën urdhërore të ndjekur nga parafjala *on*. Në këto fjali, *come on* mbart kuptime të pjesëzave dhe pashirmave që shërbejnë si mjete gjuhësore plotësuese në dhënien e kumtimit të synuar nga folësi. *Come on* mund të përkthehet në kontekste të ndryshme si: *hë, pra, jepi* etj. e ndjekur nga folje-kallëzues të tjerë që japin një kuptim të plotë të mesazhit që duhet të përcillet.

133. “*Come on, come on*”, *Rae said. I ignored her. This room was what the ghost had wanted me to see. I was sure of it.*

(“*Jepi / hë / vazhdo/ pra, hydr,*” - tha ai. Nuk i kushtova rëndësi. Dhoma ishte ajo që fantazma donte që unë të shikoja. Isha i sigurt për këtë gjë.) (The *Summoning*, f. 190)

Duhet të theksojmë se për të kundëruar semantikën kuptimore të çdo fjalie nxitëse, gjithmonë duhet të studiohet konteksti në të cilin kryhet një ligjërim i tillë, i cili përmban elemente të tjera gjuhësore në shprehjen e kumtimit të fjalisë. Në kontekste të ndryshme *come on* mund të përkojë me:

134. *Come on, Eric.*

(*Hë, pra, Erik. Hë... hë Erik, vazhdo!*) (The *Dead reckoning*, f. 184)

Come on mund të gjendet edhe në kontekste ligjërore pa praninë e një fjalie nxitëse që paraprin apo që është e pasvendosur. Konteksti përkatës shpjegon qartë veprimin që duhet të kryejë dëgjuesi i nxitur nga folësi, nëpërmjet konstruktit *come on*. Përdorimi i *come on* është kaq i dendur në ligjërim, sa që shpeshherë mund të konsiderohet si pjesëz apo si element gjuhësor që ka një funksion të rëndësishëm në bashkëbisedime. Kjo trajtë shpreh një thirrje dhe përkrahje për dëgjuesin ose mund të krijojë një lidhje kuptimore mes fragmentarizimit të një bisede apo për t'i dhënë kohë bashkëbiseduesit të vendosë, pra, të pranojë ose të refuzojë diçka. Për të ilustruar vlerën kuptimore të *come on* në kontekste të ndryshme u referohemi shembujve të mëposhtëm:

135. *We peered around the corner of the next building, saw that open expanse, heard voices coming, and knew we'd never make it.*

"Now what?" Tori said.

I didn't answer.

"Come on!" she whispered. "What's the plan?"

(Ne picërruam sytë përreth qoshes së ndërtesës në krah, pamë hapësirën e gjerë, dëgjuam zërat që vinin dhe e kuptuam se asnjëherë nuk do t'ia dilnim mbanë.

"Tani, çfarë?" ("Tani, ç' do të bëjmë?")

Nuk i ktheva përgjigje.

"Hë, pra / më thuaj pra / vazhdo!" - më pëshpëriti ajo. "Cili është plani?"

(The Awakening, f. 91)

Përdorimi i *come on* në këtë pjesë bashkëbisedimi, nga njëra anë krijon lidhjen kuptimore mes dy bashkëbiseduesve, shërben si një nxitje a grishje për të ofruar bashkëpunim. Në këtë kontekst *she* (ajo) e fton folësin (I - unë) të bëjë të ditur planin dhe mënyrën si t'ia dalin mbanë. Pra, nga ana semantike *come on* shpreh nxitje për të treguar, bashkëpunuar dhe vepruar për kryerjen e planit. Nga ana e funksioneve gjuhësore që kryen thënia, ne mendojmë se te fjalia 135 ("*Come on!*", "*What's the plan?*") synohet të verifikohet kanali i komunikimit folës - dëgjues dhe të ngjallet e të zbulohet gjendja ndjenjësore e folësit.

Me termat e R. Memushajt kjo thënie kryen në mënyrë të gërshetuar funksionin *fatik* dhe *konativ*²⁷⁰, në mënyrë që të transformohet informacioni dhe marrësi kodon mesazhin që ka koduar dhënësi. Fjalia gjegjëse në gjuhën shqipe përkon me një sërë foljesh e pjesëzash që lidhen ngushtësisht me kontekstin në të cilin zgjedhim foljen gjegjëse: *them, vazhdo, fol* etj. Ndryshe nga gjuha angleze, në gjuhën shqipe vëmë re edhe përdorimin e pjesëzave (*hë, pra* etj.), të cilat shprehin gjendjen emocionale të folësit (në këtë kontekst: i frikësuar, i paduruar, i pashpresë). Edhe shprehja e kundrinorit në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe nëpërmjet trajtave të shkurtra shërben si një thirrje ndaj dëgjuesit që të reagojë. Në gjuhën angleze struktura e ngurtësuar "*Come on!*" nuk e ndien të nevojshme theksimin e kundrinorit, sepse *come on* duket ta ketë humbur disi vlerën kuptimore të foljes *come* në kuptimin e mëvetësishëm "vij" dhe shërben më tepër si pjesëz plotësuese e ligjëritimit.

Te fjalitë dëftore apo pyetëse folja *come* gjendet në struktura sintaksore të tjera dhe dallohet edhe për kuptime të ndryshme, përveç nuancës kuptimore të lëvizjes, që në fjalitë nxitëse duket qartë që është kuptimi më i shpeshtë. Kjo shpjegohet me karakteristikën që ka kryefjala në fjalitë nxitëse: ajo është një kryefjalë e vetës së dytë dhe është kryefjalë vepruese. Kjo gjithashtu lidhet edhe me rolin që merr dyshja bashkëbiseduese, e cila është përfituese e kumtimit të fjalisë. *Come on* e përdorur në fjali në kuptimin e drejtpërdrejtë të realizimit të veprimit, shënon doza përfitimi nga ana e folësit.

136. *Come in*, Chloe. Let me introduce you ...

(Hyr brenda, Kloe. Po ju prezantoj me...)

Fjali nxitëse

(The Summoning, f. 41)

137. *Samuel's first thought was: They've found Aram's body. They've come to get me.*

(Mendimi i parë i Samuelit ishte: Ata kanë gjetur trupin e Aramit. Ata kanë ardhur të më kapin mua.)

Fjali dëftore

(Bloodline, f. 159)

138. *"You always this jumpy?" he said. "Where did you come from?" "Upstairs."*

("Gjithmonë i inatosur ti?" - tha ai. "Nga erdhe?" "Nga kati lart.")

Fjali pyetëse

(The Summoning, f. 113)

²⁷⁰ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 24-27.

Përfundim: Fjalitë nxitëse karakterizohen nga përdorimi i disa foljeve tipike në strukturën e tyre. Veçantia dalluese që përlligj frekuencën e përdorimit lidhet me tiparin e tyre të shprehjes së veprimeve të kontrollueshme. Thelbi kuptimor i fjalive nxitëse shpjegon përzgjedhjen e disa foljeve, kuptimi i të cilave duhet t'i japë folësit kontroll ndaj veprimeve të dëgjuesit. Disa folje si: *come* (come on), *go*, *listen*, *look* etj. gjenden rëndom në fjalitë nxitëse, saqë shpeshherë janë kthyer në struktura të ngurtësuara që përkojnë me funksionin e shenjuesve të ligjërit. *Come on* përbën një prej rasteve më tipike dhe më interesante të përdorimit si një folje frazale apo si shenjuese e ligjërit në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze.

§4.2.6. Tipare sintaksore dhe semantike të fjalive nxitëse te manualët udhëzuesë, recetat e gatimit, reklamat

Fjalitë nxitëse janë përkufizuar shpesh si fjali që kumtojnë urdhra, kërkesa apo udhëzime dhe që shprehin në mënyrë të drejtpërdrejtë një kërkesë të folësit për bashkëbiseduesin e tij. Kjo do të thotë se është forma që mbart më pak mirësjellje nga ana e folësit, pavarësisht mjeteve të ndryshme që shërbejnë për të zbehur në njëfarë mase forcën urdhëruese të thënies nxitëse. Në kontekstet ku fjalitë nxitëse nuk përshkohen nga elemente të forcës, detyrimit apo urdhrit, këto fjali fitojnë ngjyrimet kuptimore të udhëzimit, këshillimit, sugjerimit dhe të bindjes për të reaguar. Këto përdorime janë përkufizuar shpesh si *pseudo-urdhëruese*. Janë *pseudo-urdhëruese* ato fjali nxitëse që nuk kryejnë funksionin e një kërkesë, urdhri a komande.²⁷¹ Fjalitë nxitëse që nuk urdhërojnë janë përkufizuar si: “*pseudo-urdhëruese* (Ascoli, 1978); urdhëruese “*e sipërfaqshme*” (Bolinger, 1967) apo fjali nxitëse “*joreale, imagjinare*” (Jespersen, 1924)²⁷²”.

Një veçori tipike e fjalive nxitëse është edhe përdorimi i tyre në recetat e gatimit, manualët, udhëzimet e përdorimit a reklamat. Në përdorime të tilla fjalitë nxitëse nuk shprehin kuptimet urdhëruese të mirëfillta, por ruajnë disa nga tiparet dalluese: këto fjali këshillojnë, nxisin, propozojnë dhe akti i komunikimit përmban dy palë, folësi (që del më i “fshehur”) dhe dëgjuesi (i papërcaktuar dhe i kategorizuar). Manualët, recetat dhe reklamat i përkasin stilit tekniko-shkencor. Ato janë të sferës teknike, e cila ka marrë një zhvillim të madh kohët e fundit. Reklamimi dhe ambalazhimi i mallrave realizohet përmes shpjegimit që u bëhet blerësve e konsumatorëve mbi aspektin dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

§4.2.6.1. Përdorimi i fjalive nxitëse në reklama

Krijuesit e reklamave përdorin mjete të larmishme gjuhësore për të tërhequr vëmendjen, për të zgjuar dëshirën, për të nxitur veprimin dhe për të dhënë kontributin drejt arritjes së kënaqësisë (nga ana e klientit)²⁷³. Fjalitë nxitëse përbëjnë një prej mjeteve gjuhësore që shërbejnë për të arritur objektivin kryesor për të cilin reklamat janë krijuar. Disa nga tiparet dalluese të teksteve të reklamave janë:

a. Krahas fjalive *dëftore* që shërbejnë për të pajisur lexuesit e reklamave me informacion dhe detaje mbi produktin e dhënë, fjalitë *nxitëse* zënë një vend të rëndësishëm në reklama.

b. Nga pikëpamja *strukturore* janë fjali të thjeshta, të ndërtruara nga folja-kallëzues dhe kundrinori ose rrethanori i vendit (i mënyrës a i kohës).

²⁷¹ C. Ascoli, *Some pseudo-imperatives and their communicative function in English*, Folia Linguistica, Volume 12, f. 405.

²⁷² Cituar nga A. Y. Aikhenvald, *Imperatives and commands*, Oxford University Press 2010, f. 253.

²⁷³ Zh. Linghong, *The linguistic features of English advertising*, CELEA Journal, Vol. 29, Nr. 1, 2006, f. 71.

c. Nga pikëpamja *semantike* fjalitë nxitëse shprehin një mesazh të drejtpërdrejtë drejtuar lexuesit (blerësit potencial), në mënyrë që ai të reagojë. Pra, në këto fjali kumtohet një udhëzim, një këshillë a një sugjerim për të bindur lexuesin. Mënyra urdhërore shërben si një strategji në komunikimin mes të dyja palëve për të krijuar një marrëdhënie të ngushtë mes tyre, në të cilën jepet një direktivë dhe pritet të zbatohet.

d. Duke u nisur nga synimi për të cilin janë krijuar, zgjedhjet gjuhësore në tekstet e reklamave të ndryshme dallohen për disa *tipare stilistikore*, të cilat përmbushin qëllimin e kumtimit (funksioni evokativ i gjuhës - kur gjuha përdoret në këtë funksion, synohet të ngjallë gjendje emocionale dhe qëndrime të caktuara te dëgjuesi²⁷⁴, konsumatori në këtë rast). Disa prej tyre janë: përdorimi i urdhërores; leksiku i veçantë për të ndikuar te konsumatori që të blejë; neologjizmat; aliteracioni; përsëritja; homofonia; struktura sintaksore paralele etj. Për sa i përket shpeshësisë së fjalive nxitëse në tekstet e reklamave të ndryshme, duhet të theksojmë se ato i shërbejnë kumtimit të fjalisë duke theksuar urgjencën dhe vlerën kuptimore urdhëruese për ta blerë një produkt të dhënë.

Ja disa nga rastet e përdorimit të fjalive nxitëse në reklamat e ndryshme që kemi gjurmuar:

139. *Conquer the ice.*
Get the new tires for better grip. - Ford Service
(Pushtojë akullin. Fitoni gomat e reja për një kontroll më të mirë.) (përkthimi literal)
140. *Sit back, drift along and lose yourself in the moment.* - Ford G Series
(Rehatohu, shëtit dhe largohu nga realiteti për një moment.)
141. *If the scenery gets boring, modify it.*
Don't let nature make you feel insignificant. - Chevrolet Captiva
(Nëse pamja bëhet e mërzitshme, zbukuroje. Mos lejo që natyra të të quajë të parëndësishëm.)
142. *Get there faster.* - Renault Clio RS. 201 HP
(Shko atje më shpejt! / Shkojmë më shpejt.)
143. *Please drink responsibly. Overtake faster.* - The Golf R32 with 250 horsepower
(Ju lutem, pini me përgjegjësi! Parakaloni më shpejt.)
144. *Visit beautiful Bali! Enjoy Bali's beautiful beaches! Stay in Asia's finest hotels!*
(Vizitoni Balin e bukur! Shijoni plazhet e bukura të Balit! Rehatohuni në hotelet më të mrekullueshme të Azisë!)
145. *Come and see the art shops, the temples and the exotic dances. Come and try our restaurants.*
(Eja / ejani të vizitosh / vizitoni dyqanet e artit, tempujt dhe vallëzimet ekzotike.
Ejani të provoni restorantet tona!)
146. *Come grab some ice cream with ASR.*
(Eja rrëmbe një akullore tek ASR!)
147. *Let our pros design your space.* - The Forrest Interior Design
(Le të kompozojnë profesionistët hapësirën tuaj. / Profesionistët tanë kompozojnë hapësirën tuaj.)
148. *Join Denny's dinner perks today! Now there's NEW loyalty program that has a lot more to offer you. Earn points for every purchase towards great rewards, plus surprises and offers along the way. Let's get started earning free food!*
1. Ask your server about the NEW Denny's Diner perks Loyalty Program.
2. Enroll in the restaurant today, online at Dennys.com/loyalty.

²⁷⁴ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 26-27.

(Ejani shijoni vaktet falas sot! Tani ka një program të ri që ka shumë për të ofruar. Fitoni pikë për çdo blerje kundrejt shpërblimeve të mëdha, shoqëruar me surpriza dhe oferta të tjera. Le të fillojmë. / Fillojmë me ushqimin falas! 1. Pyesni kamerierin rreth avantazheve të programit “New Denny’s dinner”. 2. Regjistrohuni online në restorant sot. Adresa është: Denny.com/loyalty.)

149. *Let yourself shine.* - Pantene
(Shkëlqe!)
150. *You can’t afford to be slow in an emergency. Act now for the planet.* - WWF
(Ti s’ mund t’ia leJosh vetes të jesh i ngadaltë në një moment urgjence. VePro tani, në të mirë të planetit!)
151. *Keep on dreaming of a better world.* - Ché Magazine
(Vazhdo të ëndërrosh për një botë më të mirë.)
152. *The pursuit of happiness!*
(Në ndjekje të lumturisë.)
153. *One fragrance - one tree.* - Hugo
(Një aromë - një pemë.)
154. *The best or nothing!* - Mercedes- Benz
(Gjithçka ose asgjë!)

Disa nga karakteristikat e sipërpërmendura sendërtohen qartë në shembujt e gjurmuar nga disa reklama të ndryshme. Duke i mëshuar më tepër anës strukturore dhe frekuencës së përdorimit të fjalive nxitëse sesa anës semantike (sepse kuptimi thelbësor i fjalive dhe kumtimi i tyre mëtojnë të informojnë, të bindin dhe të nxitin të reagosh), kemi vërejtur këto veçori strukturore:

1. Përdorim të dendur të *fjalive nxitëse pa kryefjalë të shprehur.* (*Get there faster. / Please drink responsibly.*) Mungesa e kryefjalës nuk përlligjet vetëm si tipar dallues sintaksor i fjalive nxitëse, por nga ana tjetër vepruesi (kryefjala e munguar) mendohet të jetë lexuesi, dëgjuesi, kalimtari etj. Pra, kryefjala është e papërcaktuar si kategori, grupmoshë apo nivel dhe në këtë mënyrë ajo shenjon edhe një grup më të gjerë dhe është më e përgjithësuar. Këto fjali nuk urdhërojnë në mënyrë kategorike për të kryer diçka, por ato ofrojnë mundësi për të zgjedhur a për të blerë. Si të tilla, fjalitë nxitëse me këtë strukturë e funksion gjuhësor mund të kthehen në fjali dëftore si: *You can get there faster.* Në fjalinë dëftore mund të shtojmë edhe folje modale, si për shembull *can* (mund) për të shprehur modalitet.

2. Fjali nxitëse si pjesë e periudhave *me bashkërenditje* të lidhura me lidhëza apo asindetikisht me ngjyrim kuptimor numërimi. (*Come and try our restaurants. Sit back, drift along. Come grab some ice cream with ASR.*)

3. *Struktura sintaksore paralele* të fjalive nxitëse të mëvetësishme. (*Visit beautiful Bali! Stay in Asia’s ...; Ask your server / Enroll in the restaurant today.*) Fjalitë nxitëse ndjekin njëra tjetrën dhe kjo radhitje e tyre në zinxhir e pajis klientin me informacion dhe rreket ta bindë atë për të reaguuar. Fuqia shprehëse urdhëruese tipike për fjalitë nxitëse shpërfaqet më e zbehur dhe e një shkalle shprehësie të tërthortë. Dëgjuesi (njerëzit që pritët të lexojnë dhe të blejnë), me anë të gjuhës së teksteve të reklamave, arrin të komunikojë me “folësin”, i cili e informon, e bind, e josh, i tërheq vëmendjen dhe e bën të blejë. Në këtë mënyrë ruhet një lidhje e tërthortë mes të dy palëve. Nëse analizojmë shembullin 148, do të vërejmë se fjalitë nxitëse ndjekin njëra-tjetrën duke dhënë informacion dhe gjithashtu duke zgjuar edhe interesin e dëgjuesit. Kemi foljet-kallëzues: *join - earn - let’s get started - ask / enroll.* Ky zinxhir foljesh shkon kuptimisht prej joshjes (*join*), përfshirjes së folësit e deri në bindjen e plotë të dëgjuesit të shkojë apo të vizitojë restorantin. Fjalitë nxitëse e kryejnë më së miri

funksionin e tyre të kontrollit mbi veprimet e dëgjuesit. Ato gjithashtu krijojnë një ndjenjë të fortë bindjeje, e cila ndikon mbi blerësin të vendosë të zgjedhë a të blejë produktet²⁷⁵.

4. Fjali nxitëse si fjali drejtuese në periudhën me marrëdhënie kushtore ose me ngjyrimë kuptimore kushtore. (If the scenery gets boring, *modify it*.)

5. Folje të përzgjedhura nga ana leksikore për të shprehur vlerësimin dhe grishjen për të blerë, të tilla si: *come* (eja), *enjoy* (kënaqem), *come and see* (eja të shikosh), *let us* (le,) *come and try* (eja dhe provo), *join* (bashkohem) etj. Pra, këto folje shërbejnë si folje që zëvendësojnë foljen e nënkuptuar “blej”, e cila në përgjithësi nuk përmendet në reklama. Nënteksti i gjithë reklamave nënkupton: *Blini / Proveni / Konsumoni* një produkt të caktuar.

6. Nga ana strukturore dalin si fjali të thjeshta, të shkurtra dhe lehtësisht të kuptueshme. Shpeshherë mund të jenë edhe fjali eliptike²⁷⁶, me anë të të cilave transmetohet mesazhi te dëgjuesi pa praninë e një foljeje në mënyrën urdhërore. Këto struktura krijojnë një marrëdhënie më të ngushtë mes folësit dhe dëgjuesit, të cilët janë në dijeni të produktit në fjalë. Si rrjedhim, ndjenja e një familjariteti e bën dëgjuesin më të interesuar dhe më të dhënë pas qëllimit të folësit. (*The pursuit of happiness! One fragrance-one tree! No smoking!*) Nëse do të zgjerojmë fjalitë e mësipërme, do të përftojmë këto fjali nxitëse të mirëfillta:

155. *Pursue your happiness!*

(Ndiq / gjej lumturinë tënde!)

156. *Buy one fragrance - plant one!*

(Bli një aromë (parfum) - mbill një pemë!)

157. *Buy the best, or don't buy anything!*

(Blini më të mirën, ose mos ble fare!)

Pra, nënteksi është i barasvlershëm me një propozim të mirëfilltë për të kryer diçka të kumtuar nga një fjali nxitëse. Duke i kundruar këto fjali eliptike nga ana strukturore, mund të themi se mungesa e foljes apo e gjymtyrëve të tjera të fjalisë e bën mesazhin më tërheqës, më interesant dhe më ndjellës.

Te fjalitë gjegjëse në gjuhën shqipe vërejmë bashkëpërkime në shprehjen e foljes-kallëzues, e cila mund të jetë në mënyrën urdhërore, lidhore dhe në disa raste edhe në mënyrën dëftore.

a. Pra, folja-kallëzues në vetën e parë shumës të mënyrës dëftore shpreh një “thirrje” në mënyrë të tërthortë dhe me mirësjellje. (*Shkojmë më shpejt. Profesionistët tanë kompozojnë hapësirën tuaj.*)

b. Foljet leksikore që spikasin në gjuhën e reklamave janë: *vij* (eja / ejani); *provoj*; *shijoj*; *telefonoj* etj. Shpeshherë folja është në vetën e dytë njëjës dhe mesazhi që kumtohet bëhet më individual dhe shfaq më shumë familjaritet me dëgjuesin. (Eja dhe *ti!*)

c. Te fjalitë 144 dhe 145 fjalia gjegjëse në shqip mund të shprehet me folje-kallëzues në mënyrën urdhërore të lidhur nga lidhëza *dhe* ose të ndjekur nga një folje në lidhore: *Eja dhe vizito / eja të vizitosh*. Përdorimi i lidhores i jep më shumë modalitet kuptimit dhe e bën atë të dëshirueshëm ose të detyrueshëm.

d. Në gjuhën shqipe kryefjalën e gjejmë të përdorur më shpesh sesa në gjuhën angleze. Përemrin e vetës së dytë *ti* e dëgjojmë rëndom në reklama të ndryshme. (E shohim botën si *ti!*)

²⁷⁵ J. Ren, *An Analysis of Cohesion Achieved by Imperative Clause in English Netvertising*, Theory and Practice in Language Studies, Vol. 1, No. 6, 2011, f. 746.

²⁷⁶ “Këto fjali nuk kanë nevojë as për kontekst, as për situatë; kumtimi realizohet me gjithë ndërtimin në tërësi.” *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 406.

e. Fjali eliptike dhe struktura sintaksore paralele. (Përrjeto botën tënde! *Bota jonë, ti! Interneti më i shpejtë në rrjetin më të shpejtë*, që nënkupton: *Ti je bota jonë! Provooni internetin më të shpejtë!* - AMC)

Përfundim: Në tërësinë e teknikave të ndryshme dhe mjeteve gjuhësore që dallohen në reklama, fjalitë nxitëse, në përgjithësi, dhe foljet në urdhërore, në veçanti, luajnë një rol të rëndësishëm në transmetimin e kumtimit të synuar - të informojnë, të bindin konsumatorin (dëgjuesi) të reagojë. Kjo arrihet me anë të një force shprehëse urdhëruese, e cila tipizon më së miri fjalitë nxitëse. Fjalitë nxitëse që kumton një direktivë, shpreh një përmbajtje të caktuar që lidhet me veprimet e dëgjuesit në të ardhmen, përçon kuptimin se folësi kërkon që përmbajtja e fjalisë të bëhet realitet dhe vepron si një shtytje për dëgjuesin, në mënyrë që të realizojë përmbajtjen²⁷⁷. Pra, fjalitë nxitëse në gjuhën e reklamave zënë një vend të rëndësishëm dhe janë të vetmet fjali që mund të kryejnë funksionin kryesor për të cilin reklamat janë krijuar.

§4.2.6.2. Fjalitë nxitëse në recetat e gatimit dhe në udhëzuesit e përdorimit

Përdorim mjaft të dendur të fjalive nxitëse gjejmë në recetat e gatimit dhe në manualët e udhëzimeve. Duke u nisur nga veçoritë që i karakterizojnë recetat e gatimit dhe manualët e udhëzimeve, ngjashmërinë që ato shfaqin me semantikën dhe forcën shprehëse të fjalive nxitëse, ne i kemi bërë objekt studimi, me synimin që të paraqesim një hulumtim sa më të plotë të larmisë së kuptimeve dhe të konteksteve në të cilat mund të hasen fjalitë nxitëse. Dimë se në një akt komunikimi, në të cilin folësi kumton një urdhër ose kërkesë, realizohet një thënie nxitëse nga folësi dhe ai pret që dëgjuesi të reagojë. Kemi një akt komunikimi të barasvlerëshëm me shqiptimin e një urdhri a një kërkesë, edhe në rastin kur dëgjuesi dëgjon ose lexon një recetë gatimi apo një udhëzim të caktuar.

Së pari, semantika e tyre dallohet për një natyrë urdhëruese, propozuese, këshilluese dhe rekomanduese. Ky është thelbi kuptimor i këtyre përdorimeve. *Së dyti*, për të përcjellë mesazhin që folësi (prodhuesi, shefi i kuzhinës etj., kjo gjë lidhet me natyrën e udhëzuesit) mëton të japë, ai duhet të “*përballet*” me palën tjetër, dëgjuesin (që në këtë rast është një dëgjues a një grup dëgjuesish), pra konsumatorët e një produkti të caktuar.

Dëgjuesi në këto fjali është i panjohur dhe i papërcaktuar, sepse hartuesi i manualit apo i reklamës nuk mund ta përcaktojë qartësisht grupin e klientëve që do ta lexojnë dhe do ta përdorin një produkt të caktuar. Për këtë arsye, forca shprehëse nuk është *urdhëruese* dhe *detyruese*, por më tepër ka veçori të *sugjerimit* dhe të *këshillës*.

Përdorimi i tyre si një mjet stilistikor shërben për të arritur një qëllim të caktuar dhe të tilla fjali nxitëse nuk i drejtohen një dëgjuesi të vetëm, por një numri të madh dëgjuesish (bashkëbiseduesish). Nga ana strukturore ato kanë një ndërtim të thjeshtë dhe disa veçori kuptimore që i dallojnë nga fjalitë nxitëse që shprehin kërkesa.

Nga analiza e recetave dhe manualeve që kemi bërë objekt analize, i kemi mëshuar më tepër anës strukturore dhe zgjedhjeve gjuhësore që janë përdorur, për shkak se nga pikëpamja semantike kuptimi i tyre dallohet qartë. Në këtë rast synimi i folësit është i përcaktuar: t’i rekomandojë e t’i propozojë klientit një produkt, një ide a një projekt duke shpresuar për një reagim nga ana e dëgjuesit. Në këtë korpus forca urdhëruese e fjalive nxitëse është pothuajse e papërfillshme, sepse ajo kushtëzohet nga pozicioni që merr folësi në lidhje me dëgjuesin, që në këtë rast nuk e ka pushtetin apo autoritetin e duhur për të kumtuar një urdhër. Disa nga veçoritë gramatikore të fjalive nxitëse në recetat dhe manualët që kemi veçuar janë:

²⁷⁷C. Condovardi, S. Lauer, “*Imperatives: meaning and illocutionary force*”, *Empirical Issues in Syntax and Semantics* 9, 2012, f. 37.

1. Sintaksa e fjalive nxitëse shenjohe nga përdorimi i foljeve-kallëzues në mënyrën urdhërore. Fjalitë nxitëse në këto tekste janë më të përdorshme, krahasuar me tipat e tjerë të fjalive. Foljet në *urdhërore* përbëjnë tiparin më të dallueshëm në tekstet e manualeve dhe recetave të gatimit dhe kryejnë edhe funksionin komunikues të kryerjes së aktit të ligjërit, sepse lidhin “në distancë” pjesëmarrësit në këtë bashkëbisedim, në të cilin vetëm njëra palë paraqitet fizikisht. Përdorimi i fjalive nxitëse lidhet me atë çka receta duhet të realizojë; ato janë veçoria më tipike e recetave dhe krijojnë një kohezion të brendshëm mes elementeve të ligjërit²⁷⁸. Në gjuhën shqipe, te gjegjëset e recetave gjejnë përdorim jo vetëm foljet në mënyrën *urdhërore*, por shpeshherë edhe në mënyrën *dëftore*, veta e parë shumës.

2. Fjali të tilla nxitëse përdoren *pa ndajfoljet e kohës*, pra vëmë re kufizim të kategorisë së kohës. Te veçoritë morfologjike kemi përmendur faktin se fjalitë nxitëse kategorinë e kohës e kanë të kufizuar dhe i referohen çastit pas ligjërit. Këto tekste organizohen si struktura paralele dhe me folje-kallëzues në mënyrën urdhërore, prandaj përmbajtja kuptimore në tekstet e manualeve nuk i referohet ndonjë çasti kohor të caktuar. Në përgjithësi, në receta vihet re një mungesë e fjalëve që shenjojnë aspektet kohore si: *now* - tani, *when* - kur, *as soon as* - posa etj.²⁷⁹

3. Fjalitë nxitëse në këto tekste dallohen për një *leksik të veçantë*, i cili shënon renditjen e proceseve përkatëse të recetat e gatimit dhe të udhëzuesit, i përbërë nga një grup foljesh, emrash e fjalësh të tjera, për të shprehur kumtimin përkatës. Leksiku i zgjedhur i këtyre teksteve lidhet me natyrën e përmbajtjes dhe përshtatet edhe me strukturën pak a shumë të njëjtë të pjesa më e madhe e recetave. Kjo strukturë paraqitet e ndarë në disa faza që përkohjnë edhe me kryerjen e procesit gjegjës. Jo vetëm të recetat, por edhe tek udhëzimet, strukturimi i fjalive dhe i gjithë tekstit bëhet sipas mënyrës se si duhet të realizohet qëllimi i kumtit: renditen veprimet apo proceset për të arritur në përmbushjen e udhëzimit, recetës, direktivës shpjeguese, eksperimentit etj. Leksiku i veçantë përfshin folje si: *cut* (pres), *hold* (mbaj), *mix* (përziej), *bring* (sjell), *add* (shtoj), *remove* (heq) etj.

4. Fjalitë nxitëse *pa kryefjalë të shprehur* përbëjnë pjesën më të madhe në tekstet e gjurmara të recetave dhe të manualeve, ndërsa në disa raste vëmë re edhe shprehjen e kryefjalës së vetës së dytë *you* (ti / ju). Duhet të theksojmë se ka një ngjashmëri mes forcës ilokutore shprehëse të kërkesave dhe të udhëzimeve, në të cilat nuk urdhërohet, po kërkohet, propozohet dhe jepen direktiva për të kryer diçka. Dallimet mes kërkesave dhe udhëzimeve përfshijnë:

Së pari, udhëzimet në përgjithësi, në të gjitha kontekstet, përmbajnë informacione, detaje dhe njohuri për dëgjuesin, duke i treguar atij se si duhet të kryhet diçka. Ato nuk detyrojnë një veprim të caktuar ndaj dëgjuesit. Te kërkesat kemi:

158. *Open my bedroom window, madam.*

folësi - përfitues

(Hape dritaren e dhomës së gjumit, zonjë.)

Te udhëzimet kemi:

159. *Click the download button to read the article.*

(Shtyp butonin e shkarkimit për të lexuar artikullin.)

dëgjuesi - përfitues

Së dyti, dallohen nga paravendosja e ndajfoljeve që tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit udhëzues dhe njëkohësisht e theksojnë atë më tepër se vetë veprimin, si *occasionally* te fjalia që vijon:

160. *Place the stones in your garden and gently twist them into the soil for security.*

(Vendosini gurët në kopshtin tuaj dhe *me ngadalë* rrotullojini në baltë për t'i mbrojtur.)

²⁷⁸ C. Cotter, “Claiming a piece of the pie: How the language of recipes defines community, 1997, *Recipes for Reading: Community Cookbooks, Stories, Histories*, University of Massachusetts Press, f. 56.

²⁷⁹ *Po aty*, f. 57.

Pavarësisht se nuk shprehet, kryefjala në këto fjali është e dallueshme, sepse dihet kujt i drejtohet udhëzimi. Kështu që përsëri ligjërimi shfaqet konkret dhe mjaft dinamik, si në rastin kur të dyja palët janë fizikisht të pranishme në aktin e komunikimit që kryhet në këtë rast. Në këtë mënyrë ky komunikim kthehet në një bisedë, ku të dyja palët marrin pjesë në përmbushjen e kumtimit. Folësi udhëzon “i fshehur” dhe dëgjuesi “i bindet” atij.

5. Tekstet e këtij korpusi dallohen jo vetëm për fjalitë nxitëse që dalin strukturalisht më tepër si fjali të mëvetësishme, por edhe si fjali të përbëra me bashkërenditje ose me nënrenditje. Fjalitë me nënrenditje dalin si fjali *kushtore*, sepse marrëdhënia mes veprimeve kushtëzohet nga realizimi i njërit veprim. Fjalitë e nënrenditura *kohore* (të cilat mund të dalin edhe asindetike) shënojnë veprime që ndodhin në një renditje të caktuar dhe, si rrjedhim, veprimi i shprehur prej tyre mund të përputhet me veprimin në fjalinë drejtuese, të paraprijë apo ta pasojë atë. Shpeshherë fjalitë janë asindetike duke shenjuar marrëdhënie *këpujore*, duke numëruar veprime që vijnë njëra pas tjetrës dhe me një rend pothuajse të njëjtë të gjymtyrëve.

Vërejmë fjalitë nxitëse të marra nga një manual udhëzimi për instalimin dhe mirëmbajtjen e një mbajtëseje televizori *Sony*:

161. *When installing the glass or top panel, take care not to pinch your fingers in the shelf of panel. To prevent the stand from distorting, observe the following: - Install the stand on a solid and flat surface. - If you install the stand on a soft surface such as a mat, first lay a board under the stand. - Do not install the stand in a place subject to direct sun-light or near a heater. - Do not install the stand in a hot or humid place or outdoors. To keep the stand clean, occasionally wipe the stand with a dry, soft cloth.*

(*Sony SU- Gw3 indoor furnishings user manual*)

(Kur të instaloni pjesën e xhamit ose panelin e sipërm, tregoni kujdes të mos shtrëngoni gishtat te sirtari. Për ta ruajtur mbajtësen nga shtrembërimi, vini re këshillat më poshtë: - Instalojeni mbajtësen në një sipërfaqe të fortë dhe të sheshtë. Nëse e instaloni në një sipërfaqe të butë, si për shembull rrugicë, qilim apo çfarëdolloj sipërfaqe e butë e kësaj natyre, fillimisht vendosni një dërrasë poshtë mbajtëses. - Mos e instaloni mbajtësen në një vend të ekspozuar nga drita e diellit apo afër ngrohësit. - Mos e instaloni në vende të nxehta, me lagështirë apo ambiente jashtë shtëpisë. Për ta mbajtur sa më pastër mbajtësen e televizorit, herë pas here fshijeni me një leckë të butë e të thatë.)

162. *Always ensure there is adequate ventilation when spraying. NEVER smoke near the spray gun, paint or other flammable objects. Always disconnect the unit from the electrical outlet when cleaning the spray gun.*

(*Paint Zoom Manual*)

(Gjithmonë sigurohu të ketë ajrim të mjaftueshëm gjatë spërkatjes. Asnjëherë mos pini duhan afër pistoletës së spërkatjes, bojës ose sendeve ndezëse. Gjithmonë hiqeni pajisjen nga priza, kur pastroni pistoletën e spërkatjes.)

163. *Slip the lid onto the hook.*

(Rrëshqite kapakun deri te çengeli.)

164. *If in eye(s), rinse immediately with plenty of water for 15 minutes and seek medical advice, as needed.*

(Nëse ju bie në sy, shpëlajeni menjëherë me shumë ujë për 15 minuta dhe kërkoni ndihmë mjekësore, nëse është e nevojshme.)

Receta gatimi: Strawberry Cream Brulee

165. Mix fresh cream, vanilla, sugar, eggs yolks, corn flour and bring to boil. Remove from heat, add the Nestlé cream and mix. In small glasses, put the strawberry slices and pour over the mixture slowly using piping bag if available. Put them in the fridge to cool down, and prepare the strawberry sauce by blending the fresh strawberry with the sugar and lemon juice. Add the strawberry sauce on top and serve.

(Përziejeni / përziejme kremin e freskët, vaniljen, sheqerin, të verdhat e vezëve, miellin e misrit dhe ziejini / i ziejmë. Hiqeni / i heqim nga nxehtësia, shtoni / i shtojmë kremin Nestlé dhe përziejeni / i përziejme. Në gota të vogla vendosni / vendosim feta luleshtrydheje dhe derdheni / i derdhim me ngadalë mbi përzierjen duke përdorur dhe një qese pastiçerie (në formë tubi), nëse keni. Vendoseni / e vendosim në frigorifer të ftohet dhe përgatitni / përgatitim kremin e luleshtrydhes duke përzier luleshtrydhe të freskëta me sheqer dhe lëng limoni. Shtoni / shtojmë salcën e luleshtrydhes dhe shërbejeni / e shërbejmë.)

Edhe gjegjëset në gjuhën shqipe dallohen për përdorimin e foljeve-kallëzues në vetën e parë shumë të mënyrës urdhërore dhe në vetën e parë të kohës së tashme në mënyrën dëftore. Kuptimi i fjalive është i njëjtë si: *shërbejeni* apo *e shërbejmë* (165). Veta e parë dhe e dytë shumë janë përdorime vetore që shprehin nuanca të mirësjelljes dhe përkojnë me thelbin kuptimor të tyre: këshilla, propozime dhe udhëzime ndaj blerësit apo ndaj konsumatorit për të blerë a për të provuar diçka, e shprehur në mënyrë të tërthortë dhe me takt. Një tjetër veçanti të gjegjëset në gjuhën shqipe është edhe shprehja e kundrinorit në formën e plotë ose klitike në trupin e foljes-kallëzues (rëshqite 163; shpëlajeni 164). Në shumë raste kundrinori mund të mungojë për arsye stilistikore, duke e vënë theksin mbi veprimin dhe jo mbi personin a objektin që i drejtohem, sepse ai merret si i njohur nga konteksti. Fjalitë gjegjëse në gjuhën shqipe dalin kryesisht pa kryefjalë të shprehur, sepse udhëzimi nuk i drejtohet një personi të veçantë, por një grupi më të madh njerëzish dhe, si rrjedhojë, mungesa e kryefjalës zëvendësohet nga kumtimi i fjalive nxitëse, në të cilat merret e mirëqenë se kujt i drejtohet udhëzimi apo manuali. Te manualët spikatin fjalitë nxitëse mohore, ku dëgjuesi paralajmërohet për disa veprime që mund të ndërmarë dhe te recetat e gatimit foljet-kallëzues përbëjnë një prej tipareve të leksikut, i cili përzgjidhet për të emërtuar sa më mirë dhe për të specifikuar veprimin e synuar për *blerësin* (dëgjuesin).

Si përfundim, recetat e gatimit dhe manualët udhëzuese janë kryesisht tekste që përmbajnë përshkrimin e procedurave dhe udhëzimeve të ndryshme. Fjalitë nxitëse dhe mënyra urdhërore e foljeve përbëjnë tiparin kryesor që ndeshet në pothuajse të gjitha këto tekste jo vetëm në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, por edhe në italisht, frëngjisht, spanjisht etj. Krahas kësaj veçorie, e cila përvijon pothuajse gjithë tekstet që shprehin udhëzime dhe direktiva për lexuesit (bashkëbiseduesi në këtë akt komunikimi), duhet të theksojmë ngurtësimin e strukturës së fjalive të këtyre teksteve. “Ashtu si në tekste të tjera udhëzuese, modelet strukturore të fjalive mbeten të ngulitura dhe të qëndrueshme; ato nuk ndryshojnë në fjalitë që vijojnë më tej. Recetat e gatimit në gjuhën angleze shpalosin njëtrajtshmërinë më të spikatur në modelet strukturore të fjalive, të cilat janë pothuajse vetëm fjali nxitëse²⁸⁰.”

²⁸⁰ J. Todolí, R. Dolón, *Translating cooking recipes in English, Spanish and Catalan*, Studies in Contrastive Linguistics, Proceedings of the 4th International Linguistics Conference, Santiago de Compostela, 2005, f. 1056-1057.

§4.3. Veçori sintaksore dhe semantike të fjalive nxitëse në ligjërimin e folur

§4.3.1. Analiza kontrastive e fjalive nxitëse në dialogët e disa filmave

Fjalitë nxitëse, siç e kemi përmendur edhe më parë, janë karakteristikë e ligjërimin bisedor dhe, të para nga ana sasiore, hasen më së shumti në ligjërimin e folur.

Në dialogët e filmave në përgjithësi mënyra urdhërore e foljeve-kallëzues të fjalive nxitëse kryen funksionin ligjërimor të shprehjes së një mesazhi kumtues të drejtpërdrejtë. Në kryerjen e komunikimit mes bashkëbiseduesve në dialogët e filmave mënyra urdhërore e foljes shërben si një strategji e komunikimit për të shprehur një kumtim të caktuar, pavarësisht statusit social të pjesëmarrësve në këtë akt komunikimi. Në këto biseda të shkëputura nga filmat vërejmë një përdorim të shpeshtë të fjalive nxitëse të thjeshta, të cilat nuk kanë elemente të tjera formale (që shprehin tone të mirësjelljes) dhe, si rrjedhojë, janë thënie që kumtojnë mesazhe të drejtpërdrejta urdhëruese për një dëgjues ose një grup dëgjuesish. Në bisedat e zakonshme, fjalitë nxitëse të mirëfillta, pa elemente të tjera shprehëse për të shënuar mirësjellje, janë pohime urdhëruese të vrazhda²⁸¹. Këto thënie shkëmbehen mes bashkëbiseduesve që kanë marrëdhënie varësie mes tyre: vartës - punëdhënës / drejtues. Megjithatë, në kontekste komunikimi ku mëtohet të theksohet hierarkia, mirësjellja apo marrëdhënia e ngushtë, thëniet nxitëse karakterizohen nga elemente gjuhësore që e shndërrojnë komunikimin nga një direktivë ose urdhër, në një kërkesë a lutje me mirësjellje nga ana e folësit.

Nga pikëpamja e *strukturës*, fjalitë nxitëse në dialogët e filmave të marrë në studim kanë një strukturë të thjeshtë, që në pjesën më të madhe të shembujve shfaqet e tillë: folje-kallëzues pa kryefjalë të shprehur, folje + kundrinor, *let me + folje* ose *let's + folje*. Ka raste të përdorimit të strukturës së një fjalië dëftore për të shprehur kuptime të urdhërores (të ndërtuara nga foljet *listen* dhe *come on*, që shpesh shërbejnë si elemente të ligjërimin dhe përkojnë nga ana funksionale me pasthrrmat që shprehin gjendjen emocionale të folësit ose tërheqin vëmendjen²⁸². Në përgjithësi, fjalitë nxitëse shfaqen në filma si fjali të thjeshta ku mbizotërojnë strukturat me folje-kallëzues + kundrinor ose rrethanor vendi a mënyre. Le të studiojmë shembujt e fjalive nxitëse në dialogët e filmave, duke vënë në dukje *dendurinë* e përdorimit të tipave të strukturave të këtyre fjalive nxitëse, modelet *strukturore* tipike të tyre dhe njëkohësisht dallimin mes *akteve të larmishme të ligjërimin* që këto thënie nxitëse realizojnë.

Në korpusin e filmave të analizuar ne kemi dalluar një *larmishmëri* të modeleve strukturore të fjalive nxitëse, duke filluar nga fjalitë e thjeshta të ndërtuara nga një folje në mënyrën urdhërore (të cilat përbëjnë numrin më të madh të fjalive nxitëse) e deri në fjalitë e përbëra me bashkërenditje apo me nënrenditje me vlerë kushtore (të cilat janë më pak të përdorura, ashtu si edhe në ligjërimet e tjera). Në tekstet e filmave që kemi marrë në studim, ne kemi veçuar këto grupe të tipave strukturorë të fjalive nxitëse:

²⁸¹ I. Y. Chamo, "The language of Hausa films: forging a new discourse", International Journal of Linguistics, 2012, Vol. 4, Nr. 3, f. 141.

²⁸² "Sipas domethënies, pasthrrmat ndahen në dy grupe të mëdha: në pasthrrma *emocionuese* që shprehin ndjenja, dhe në pasthrrma *nxitëse* që shprehin dëshirën a vullnetin e folësit", *Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 431.

1. Tipat strukturorë pa kryefjalë të shprehur

- A. Kryefjalë zero + kallëzues (folje jokalimtare)
- B. Kryefjalë zero + kallëzues (f. kal.) + kundrinor i drejtë
- C. Kryefjalë zero + kallëzues (f. kal.) + kundrinor i drejtë + kundrinor i zhdrejtë
- D. Kryefjalë zero + kallëzues (f. kal.) + kundrinor i drejtë + plotës (rrethanor)
- E. Kryefjalë zero + kallëzues + plotës rrethanor
- F. Kryefjalë zero + kallëzues + plotës kallëzuesor

A. Kryefjalë zero + folje-kallëzues (parafjalë, pjesëz, ndajfolje etj.)

166. *Please, Fonad calm down / shut up! Hurry up, kids.*

(Të lutem Fonad, qetësohu. Qepe / mbylle (gojën), pusho! Nxitoni fëmijë!)

167. *Stop! What are you doing?*

(Ndalo! / Pusho! / Lëre! Çfarë po bën?)

(*The Past*)

168. *Stick! Shut up! Wait! Wake up, Steve, we are fighting. Hold on, hold on!*

(Ngjite! Qepe gojën! Prisni, Stiv, ne po përpiqemi / luftojmë. Prisni, prisni!)

(*Promised land*)

169. *Come here, come on. Go ahead; take your time.*

(Eja këtu, hë pra! Vazhdo! Mos u nxito, merre shtruar!)

(*American Hustle*)

170. *Jump, hear, hear, hush him up! Stand up! Keep on, keep on! Play!*

(Hidhu, dëgjo, dëgjo, mbylli gojën atij / qetësoje atë! Çohu në këmbë! Vazhdo, vazhdo! Luaj!)

171. *Get up! Get up, we dance tonight! We will not waste the evening with her laziness. Get up!*

(Çohu! Çohu, ne do të vallëzojmë sonte! Nuk do ta çojmë dëm këtë mbrëmje, vetëm se ajo është dembele. Çohuni pra!)

(*12 years a slave*)

172. *Wait, wait. Come in, come in. Pop, Pop stop.*

(Prit, prit pak! Hyr / hyni! Pop, ndalo!)

(*Beginners*)

Te shembujt e sipërpërmendur vëmë re një përdorim të dendur të fjalive nxitëse me strukturë të thjeshtë: folje-kallëzues, folje frazale apo folje të përsëritur. Në shumicën e rasteve ligjërimi bëhet mes personave që kanë marrëdhënie të afërt, janë të një statusi të njëjtë dhe komunikimi vjen prej drejtuesit, punëdhënësit, prindit etj. Hera-herës kjo strukturë plotësohet nga fjalët *please, just*, duke e zbehur forcën urdhëruese të fjalive nxitëse në të cilat kallëzuesi mbart theksin logjik dhe përcjell gjithë thelbin kuptimor që folësi mëton të shprehë. Te fjalia 172, te gjegjësjja në *gjuhën shqipe* përdorimin e ndajfoljes së sasisë në funksionin e rrethanorit e kemi hasur në shembuj të tjerë, por te kjo fjali ajo përcjell nuanca të mirësjelljes. Nëse e njëjta fjali do të shqiptohet nga një person, si: **a.** *prit / prisni pak* ose **b.** *prit / prisni*, atëherë personi tjetër (dëgjuesi, i cili në këtë rast është duke trokitur dhe pret të hapet dera) do të ndihet më i mirëpritur në rastin e fjalisë **a**, duke mos marrë parasysh intonacionin me të cilin shqiptohet thënia.

Në kontekste të tilla intonacioni dhe mjetet e tjera prozodike luajnë një rol të rëndësishëm në kategorizimin mes një urdhri të menjëhershëm, që është i prerë dhe kategorik apo një urdhri që duhet të zbatohet në një moment të caktuar. Vija intonacionore ndan edhe ngjyrimet kumtuesore formale nga ato joformale. Gjithashtu, edhe përdorimi i thirrorit e zbeh sadopak sipërinë urdhëruese që mbart një fjali nxitëse e mirëfilltë. Folësi kumton një urdhër që

dëgjuesi do ta zbatojë me çdo kusht. Në kumtimin e fjalisë 168 folja-kallëzues shenjon urdhra të prerë që renditen njëri pas tjetrit duke nënvizuar domosdonë e përmbushjes së kumtimit. Thirrori *Stiv* e zbeh disi urdhrin dhe e ngushton diferencën mes statuseve sociale të dy pjesëmarrësve.

B. Kryefjalë zero + kallëzues (f. kal.) + kundrinor i drejtë

173. *Trust me. Sing something!*
(Më beso. Këndo diçka.)
(Promised land)
174. *Hey, play your part; please, take it to them;*
[Hej, bëj punën tënde / luaj rolin tënd. Të lutem, çoje tek ata këtë (çekun).]
175. *Just, stop it, ok.*
(Thjesht lëre, dakord?)
(American hustle)
176. *Watch the paint! Look at me!*
(Kujdes nga boja! / Ruaju nga boja! Shikomë mua!)
(The past)
177. *Oliver, Stop it. Shake it, you have to shake it.*
[Oliver, lëre atë! / Ndaloje! Tunde atë (llakun), duhet ta tundësh atë.]
(Beginners)

C. Kryefjalë zero + kallëzues (f. kal.) + kundrinor i drejtë + kundrinor i zhdrejtë

178. *Tell her the good news. Give me the chance.*
(Tregoji asaj lajmin e mirë. Më jep mundësinë.)
(Promised land)
179. *Yeah, alright. Give me the flashlight.*
(Po / vërtet. Më jep llambën e dorës.)
(Beginners)
180. *Ok. Give me his number.*
(Në rregull. Më jep numrin e tij.)
(The Past)
181. *Give a guy a chance.*
(Jepi djalit një mundësi.)
(American Hustle)
182. *So tell me the rest of the ice fishing story.*
(Pra, më trego mua pjesën e mbetur të tregimit mbi peshkimin në akull.)
183. *Make me something to eat dear.*
(Më bëj diçka për të ngrënë, i dashur.)
(12 years a slave)

D. Kryefjalë zero + kallëzues (f. kal.) + kundrinor i drejtë + plotës (rrethanor)

184. *Take her to the back*
(Çoje / merre (te dhoma) nga mbrapa.)
(The past)
185. *Shackle my niggers. Get them to my cart.*
(Vëru prangat zezakëve. Hipi në karrocën time.)

186. *Take her out of here.*
(Nxirre atë që këtej.)
187. *Bring him back if you must kill the mule to do so.*
(Ktheje atë këtu, nëse s'të duhet të vrasësh mushkën për këtë gjë.)
188. *Buy the plane ticket tonight.*
(Bleje biletën e avionit sonte.)
- (12 years a slave)
- E. Kryefjalë zero + kallëzues + plotës rrethanor**
189. *Come inside, Ahmad.*
(Hyr / hyr brenda, Ahmad.)
- (The Past)
190. *Get back here! Come here!*
(Kthehu këtu! Eja këtu!)
- (12 years a slave)
191. *Get there and get there quick.*
(Kthehu atje... dhe të kthehesh shpejt madje!)
192. *Stay here.*
(Qëndro këtu.)
- (Beginners)
193. *Irving, come here. Come on. Get into bed.*
(Irving, eja këtu! Eja pra! Futu në krevat!)
- (American Hustle)
- F. Kryefjalë zero + kallëzues + plotës kallëzuesor**
194. *Don't be silly.*
(Mos u sill si budalla.)
- (The past)
195. *Be of cooperative nature, and things don't need be particularly unpleasant.*
(Ji / Tregohu më bashkëpunues dhe gjërat nuk do të jenë të pakëndshme.)
196. *Be silent!*
(Ji / Tregohu // i heshtur! / Rri i qetë!)
197. *God be merciful!*
(Të jesh / Qofsh i mëshirshëm, o zot!)
- (12 years a slave)
198. *Be there to get started first thing tomorrow morning.*
(Të jesh atje për të filluar i pari nesër në mëngjes.)
- (Promised land)
199. *Don't be ridiculous.*
(Mos u bëj qesharak. / Të mos bëhesh qesharak.)
- (Beginners)
200. *Just be happy about it.*
(Thjesht gëzohu / të gëzohesh për këtë gjë.)
- (Promised land)

2. Tipi strukturor me kryefjalë të shprehur

A. Kryefjalë + folje-kallëzues + gjymtyrë të tjera

Në dialogët e filmave të gjurmuar vërejmë një përdorim të fjalive nxitëse me kryefjalë të shprehur. Kryefjala në fjalitë nxitëse shpreh kumtime më të zbutura. Në kontekste të tjera kryefjala e veçon vepruesin nga një grup ku ai bën pjesë ose mund edhe t'i drejtohet dëgjuesit (vepruesit) në mënyrë të drejtpërdrejtë për të nxitur reagimin e tij. I ilustruam këto kuptime që mund të kenë fjalitë nxitëse, me shembuj nga dialogët e filmave:

201. *Olly, you can do better!* *Do better!* - fjalia gjegjëse pa kryefjalë
(Olly, ti mund ta bësh më mirë!) (Bëje më mirë!)

202. *You do something decent once, and that's all people ever want.*
(Ti bëj diçka të hijshme / të përshtatshme një herë dhe vetëm këtë gjë kërkojnë njerëzit nga ty.)
Do something decent! - fjalia gjegjëse pa kryefjalë të shprehur
(Bëj diçka të hijshme një herë!)

(*Beginners*)

203. *Jump. You can make it.*
(Kërce. Ti mund ta bësh këtë.)

204. *Your mother will come, I swear she will, but you must be silent. Please. Be silent!*
(Nëna juaj do të vijë. Të betohem ajo do të vijë, por ti duhet të jesh i qetë. Të lutem. Ji i qetë!)

(*12 years a slave*)

205. *Irving, you better come and get him.*
(Irving, ti më mirë / bën mirë të vish dhe ta marrësh atë.)
(*Come and get him!*)

(Eja dhe merre atë! / Eja ta marrësh atë!)

206. *This is your show, You go get him. You have to go get him.*
(Kjo është shfaqja jote. Ti shko ta marrësh atë. Ti duhet të shkosh dhe ta marrësh atë.)

Go get him. - fjalia gjegjëse pa kryefjalë të shprehur
(Shko ta marrësh atë!)

207. *You let me know when THAT could happen.*
(Më njofto ti kur të ndodhë. / Ti më njofto kur të ndodhë.)

(*American Hustle*)

Fjalitë nxitëse me kryefjalë të shprehur nuk janë shumë të shpeshta, sepse kryefjala në këto fjali është qartësisht e dallueshme dhe folësi është i vetëdijshëm se kujt ia drejton ligjërimin e tij, qoftë veprues, nxitës, urdhërues a qortues. Kjo nuk nënkupton që kryefjala në çdo kontekst mund të mungojë në fjalitë nxitëse. Në shumë kontekste kryefjala, si vepruesi apo personi që kryen direktivën e lëshuar nga folësi, mund të shprehet. Në këto raste ngjyrimi kumtues i fjalisë jepet më i përforcuar; veçohet kryefjala vepruese nga një grup tjetër dëgjuesish, nxitja fiton një shkallë më të lartë të intensitetit të forcës dhe të cilësisë së realizimit të saj. Kryefjalët në shembujt e mësipërm janë të shoqëruara edhe nga thirrjet dhe në këto kontekste folësi e diferencon vepruesin duke e bërë veprimin më urgjent dhe më të domosdoshëm. Gjithashtu, ky tip strukturor ndiqet shpeshherë edhe nga gjegjësjë pa kryefjalë të shprehur, përdorim që e rrit ose e zbut forcën shprehëse të urdhërueses, si te fjalitë 203 dhe 204. Te fjalia 203, folësi e inkurajon dëgjuesin të veprojë (të kërcejë) dhe te fjalia 204, fjalia gjegjëse pa kryefjalë të shprehur *Be silent* i jep zemër dëgjuesit të mos shqetësohet. Në këtë

tip strukturor dallohet edhe përdorimi i foljeve modale apo semi-modale si: *must, can, had better* etj., të cilat i shtojnë ngjyrimet modale kuptimit të fjalisë.

Vërejmë edhe shembuj të tjerë të vjelë nga filmat e marrë në studim:

208. *You stay here. Get yourself some dessert.*

(Ti, qëndro këtu. Merr ndonjë ëmbëlsirë.)

Në këtë fjali, përdorimi i kryefjalës *you* e veçon atë të kryejë këtë veprim dhe kjo fjali është ilustrim i rastit ku kryefjala e shprehur përmbush kuptimin e thënies që përmban kontrast ose kundërshti. Në gjuhën angleze elementet intonacionore luajnë një rol të rëndësishëm, sepse ngritjet e uljet e zërit e dallojnë rolin veprues të kryefjalës në një ligjërim të tillë.

Fjalja gjegjëse në shqip mund të ketë të njëjtën strukturë si zakonisht, pa kryefjalë dhe kuptimi i tyre është i qartë dhe i njëjtë me fjalinë gjegjëse me kryefjalë të shprehur, sepse shenjuesit vetorë e shënojnë atë. Megjithatë, një kryefjalë e shprehur në fjalinë nxitëse nënkupton ngritje të intonacionit të kjo gjymtyrë dhe mbart gjithashtu edhe theksin logjik të fjalisë.

209. *You come back to me. Do not load that gun.*

- Come back to me.

You drop that gun.

- Drop that gun.

[(Ti) Kthehu tek unë! Mos e mbush atë armë! (Ti) Lëshoje atë armë!]

(*American Hustle*)

210. *You better leave those two.*

(Më mirë / është mirë t'i lësh / lëri këto të dyja.)

211. *Pop, you should rest, shake it, You have to shake it.*

(Pop, ti duhet të pushosh, tunde atë. Ti duhet ta tundësh atë.)

212. *Okay, you point - I'll drive.*

(Në rregull, ti trego me gisht. - Unë do të ngas makinën.)

(*Beginners*)

Në fjalitë 209 dhe 212 përdorimi i kryefjalës është i detyrueshëm në strukturën e fjalive, sepse në këtë ligjërim folësi e nxit dëgjuesin të realizojë detyrën e tij dhe kështu folësi përmbush qëllimin e tij. Nuancat kuptimore të kontrastit jepen vetëm nëpërmjet shprehjes formale të kryefjalës (*pra, ti duhet të kthehesh / ti duhet të lëshosh armën / ti duhet të tregosh me gisht / unë do të ngas makinën*). Kjo tregon se pavarësisht veçorisë tipike të fjalive nxitëse, si në gjuhën angleze edhe në gjuhën shqipe, shpeshherë shprehja formale e kryefjalës ndikon në interpretimin kuptimor të fjalisë nxitëse.

3. Tipi strukturor me *let*

Let + me / him / her / them + folje-kallëzues dhe Let's + folje-kallëzues

Ky tip strukturor del rëndom i përdorur në dialogët e filmave dhe në këtë mënyrë përforcon idenë se fjalitë nxitëse janë karakteristike e ligjëritimit bisedor dhe fjalitë nxitëse me *let* spikatin në ligjërimin e folur. Siç e kemi përmendur tek analiza e fjalive me *let* në ligjërimin e shkruar, kuptimi i fjalive shpreh përgjithësisht veprime të përbashkëta të bashkëbiseduesve apo edhe urdhra e kërkesa të drejtuara ndaj dëgjuesit në mënyrë të tërthortë. Jo në çdo rast folësi është pjesë e këtij “bashkëpunimi”, por përfshirja e tij i jep fjalisë ngjyrim kumtuesor më propozues e këshillues, larg të qenit urdhërues e detyrues për të. Vërejmë aktet e komunikimit që kryhen dhe funksionet komunikuese që përmbushin strukturat me *let*:

213. *Let me ask you something.*

(Po / Le t'ju pyes diçka.)

214. *Let some other guy be last*

(Le të jetë dikush i fundit.)

215. *Let me assure you.*
(Më lejoni / Lermëni t'ju siguroj.)

(*Promised land*)

Fjalitë 213, 214, 215 shprehin kuptime që vijnë te dëgjuesi si kërkesa apo lutje, edhe pse te fjalia 213 folësi e ka të detyruar të pyesë dhe dëgjuesi të japë një përgjigje. Në këtë fjali folësi propozon: *I propose to ask a question to you and you have to answer.* (Unë propozoj të bëj një pyetje dhe ti duhet të përgjigjesh.) Konteksti ku kumtohet kjo fjali kushtëzon interpretimin e anës kuptimore dhe roli i tij është i rëndësishëm në përkapjen e kuptimit edhe të tipave të tjerë të fjalive.

Te gjegjëset në gjuhën shqipe dallojmë përdorimin e strukturave me: *po ju / më lejon / le të / lermëni* etj., të cilat nga ana kuptimore shenjojnë më shumë mirësjellje dhe dëshirë nga ana e folësit. Folja kallëzues në mënyrën lidhore ose në mënyrën urdhërore paraprihet nga pjesëza *le*. Vërejmë edhe pjesëzën aspektore *po* (e cila e bën veprimin që kryhet nga të dyja palët më konkret) të ndjekur nga folja-kallëzues në të tashmen e dëftores.

Duhet të theksojmë faktin se ligjërimi me fjali nxitëse të tipit strukturor me *let's* është mënyra e dhënies së një urdhri më me mirësjellje²⁸³.

216. *Let them know.*
(Le ta dinë ata.)

(*The Past*)

217. *Let' get to it; let's face it, let's go inside and straighten all this out.*
(Le të arrijmë te kjo gjë; le të hyjmë brenda dhe ta zgjidhim këtë çështje.)

218. *Let's all take some time.*
(Le të presim dhe pak çaste.)

(*Promised Land*)

219. Both of you, *calm down*. We will have our first lesson after this wonderful dinner. And on that note, *let's start eating.*
(Ju të dy, qetësohuni. Do ta marrim mësimin e parë pas kësaj darke të mrekullueshme. Dhe meqë ra fjala, *le të ulemi të hamë / ulemi për të ngrënë.*)

220. *Let's see what he can do.*
(*Shohim / le të shohim* çfarë mund të bëjë ai.)

221. You are here to work niggers, so *let's commence.*
(Ju skllëvër jeni këtu për të punuar. Kështu filloni!)

(*12 years a slave*)

222. *I am not being hasty. It's just, let's be smart about it. This is not how we do business.*

(Unë nuk po ngutem. Vetëm se, le të jemi / të tregohemi të zgjuar për këtë gjë. Nuk është kjo mënyra si bëjmë biznes.)

223. *I don't know what you are talking about, let's just assume you want to go with that story.*

(Nuk e di për çfarë e ke fjalën, *le të marrim si të vërtetë / supozojmë* se ti dëshiron të vazhdosh me atë histori.)

224. No, *let him speak* for himself.
(Jo, *le të flasë* ai për veten e tij. / *Të flasë* ai për veten e vet.)

(*American Hustle*)

²⁸³ R. Cowan, *The teacher's grammar of English language*, Cambridge University Press, 2008, f. 113.

Te fjalitë nxitëse të sipërpërmendura shprehen veprime të përbashkëta mes folës-dëgjues dhe me ngjyime këshille e propozimi në të mirë të dëgjuesit, por edhe të folësit. Te fjalia 221, vepruesi është vetëm dëgjuesi (niggers), pavarësisht se folësi (Tibeats-padroni) e përfshin edhe veten në dhënien e një urdhri të prerë. Në këtë rast forca shprehëse e urdhërores përkon me atë të fjalive nxitëse të mirëfillta që urdhërojnë a drejtojnë dëgjuesin të bindet. Në kontekste formale struktura me *let* e fjalive nxitëse përdoret e plotë (*let us*), për të shprehur më shumë mirësjellje.

Te gjegjëset në gjuhën shqipe pjesëza *le* i shton më shumë modalitet fjalisë nxitëse. Dallojmë mënyrën *lidhore* (të arrijmë, të fillojmë) dhe gjithashtu vetën e parë *shumës* të mënyrës *dëftore* (shohim, ulemi) të folja-kallëzues, të përdorur më shpesh sesa urdhërorja (filloni).

Shpeshësia e përdorimit të tipit strukturor me *let* në të gjitha burimet e gjurmara të ligjërimin të shkruar e të folur është paraqitur në Tabelën 3.

Përfundim: Krahasuar me të gjithë tipat strukturorë të fjalive nxitëse në ligjërimin e folur dhe atë të shkruar në gjuhën angleze, tipi strukturor me *let* shfaq sipëri në lidhje me dendurinë e përdorimit në korpusin e fjalive nxitëse. Ky tip strukturor përbën llojin e veçantë të fjalive nxitëse në plotësimin e fjalive nxitëse të mirëfillta në disa veçori, si p.sh. shenjimin e disa llojeve të kryefjalëve, të cilat nuk mund të përdoren në fjalitë nxitëse të mirëfillta²⁸⁴.

4. Tipi strukturor me *don't* + kryefjalë + folje-kallëzues + kundrinor / rrethanor etj.

225. *Don't worry about it.*

(Mos u shqetëso. Mos u shqetëso për të.)

226. *Don't bother making your bed.*

(Mos u bezdis / u merr me rregullimin e krevatit.)

227. *Don't start making excuses.*

(Mos fillo me justifikime.)

(*The Past*)

228. *Don't judge me Jessy.*

[Xhesi, mos më gjyko (ose mos më gjyko mua)!]

229. *Don't ever do that again!*

(Mos e bëj kurrë atë gjë! / Kurrë mos e bëj përsëri!)

(*Promised land*)

230. *Don't you touch me!*

[Mos më prek (ti)!]

(*American Hustle*)

Edhe ky tip strukturor del rëndom i përdorur te dialogët e filmave, sepse në aktivitetet e përditshme të gjithë përballemi me gjëra që duhet t'i bëjmë ose jo (pra nënteksti kuptimor i fjalive me *don't*). Denduria e përdorimit lidhet me faktorë, si situata ligjërimore, pjesëmarrësit dhe marrëdhënia që ekziston mes dy palëve bashkëbiseduese. Ligjërimi prind-fëmijë, mësues-nxënës, punëdhënës-vartës etj. shënon rastet më të shpeshta të përdorimit të kësaj strukture.

Duhet të theksojmë se shpeshherë kryefjala e fjalisë nxitëse-mohore mund të shprehet në fjali. Në kontekstet e dhëna ajo shpreh *pezmatim* a *padurim* nga ana e folësit:

231. *Don't you fucking touch me. That bothers me.*

(Ti / Mos më prek fare (ti)! Më bezdis kjo gjë.)

(*American Hustle*)

²⁸⁴ E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 250.

Mund të shprehë edhe ngjyrimet *inkurajimi* dhe *motivimi*:

232. *Don't you worry about Franke Yates, darling. We all know it's not true.*

(Ti / Mos u shqetëso për Franke Yates, e dashur. Të gjithë e dimë që nuk është e vërtetë.)

(*Promised Land*)

Këshillë ose kërcënim:

233. *Don't you fucking touch me! You bother me!*

(Mos më prek mua! / Ti mos e prek atë!)

(*American Hustle*)

Në këto akte komunikimi folësi tregohet më i përfshirë në realizimin e kumtimit dhe ai kërkon të pohojë me anë të fjalive nxitëse me kryefjalë të shprehur autoritetin që ka (sipas tij) ndaj dëgjuesit. Në kontekste të ndryshme, po të krahasojmë *don't + folje* me *don't + you + folje*, struktura me kryefjalë bart ngjyrimet kumtuesore më pak urdhëruese apo ndaluese.

Te gjegjëset në gjuhën shqipe kemi përdorimin e pjesëzës mohuese *mos* dhe tek tipi me kryefjalë të shprehur, kryefjala mund të vendoset në fillim apo në fund të fjalisë nxitëse mohore. Nuk ka dallime të dukshme kuptimore në përdorimin apo jo të kryefjalës te fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe, por intonacioni dhe theksi logjik bëjnë kategorizimin mes një kumtimi nxitës-ndalues të menjëhershëm dhe të detyrueshëm.

§4.3.2 Analiza kontrastive e fjalive nxitëse si pjesë e fjalive të përbëra në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe në ligjërimin e folur

Siç e kemi përmendur edhe te kreu teorik, fjalitë nxitëse shfaqen më së shumti si fjali të thjeshta, pra dendurinë më të madhe të përdorimit e kanë si fjali të pavarura. Megjithatë, në kontekste të ndryshme dhe në situata më të rralla ato mund të jenë pjesë e fjalive të përbëra me bashkërenditje ose me nënrenditje. Në strukturën e fjalive me nënrenditje, fjalitë nxitëse janë fjali kryesore që drejtojnë fjali të varura ftilluese, kushtore, vendore ose kohore. Korpusi i fjalive, si pjesë e fjalive të përbëra, tregon se frekuenca e përdorimit të tyre është më e ulët, krahasuar me përdorimin e tyre si fjali të mëvetësishme. Në vështrimin semantik vërejmë një zbehje të kuptimit urdhërues dhe drejtues të fjalive nxitëse në përgjithësi. Ndjekim shembujt e mëposhtëm:

a. *Me bashkërenditje me vlerë kuptimore shtuese*

234. *Well, good, let's wrap this up and get the hell out of here early.*

(Mirë, pra, le ta mbyllim këtë çështje dhe të largohemi sa më shpejt që këtej.)

235. *Let's go inside and straighten this out.*

(Le të hyjmë dhe ta sqarojmë këtë gjë.)

(*Promised land*)

236. *Close your eyes and go to sleep.*

(Mbyll sytë dhe shko të flesh!)

237. *Lea, leave and close the door.*

(Lea, largohu dhe mbylle derën.)

(*The past*)

b. *Me nënrenditje*

238. *Try to convince her before you make your decision.*

(Përpiqu të bindësh atë, para se të marrësh vendimin.)

kohore

239. *Go change before you catch a cold.*

(Shko / ik të ndërrosh / ndërrohu, para se të marrësh të ftohtë.)

240. *First, tell me where you want to go.*
(Fillimisht, më trego / tregomë mua ku dëshiron të shkosh.) *fjilluese*
(*The past*)
241. *Let's see what he can do.*
(Le të shikojmë / shikojmë çfarë mund të bëjë ai.)
242. *Tell no one who you really are and tell no one that you can read and write.*
(Mos i trego askujt kush je në të vërtetë dhe mos i trego askujt që mund të lexosh dhe të shkruash.)
(*12 years a slave*)
243. *If you want to come over, let me know first.* *kushtore*
(Nëse do të vish për vizitë, fillimisht më njofto mua.)
(*The past*)
244. *Collect a gang; see what good you can do.*
(Mblidh një skuadër; do të shikosh ç' të mira mund të bësh.)
245. *Call, tell him of your previous circumstances and see what it earns you.*
(Thirr / telefonoje! Tregoji atij për kushtet e mëparshme dhe do të shikosh sa do të të vlejë.)
246. *If you want to survive, do and say as little as possible.*
(Po qe se dëshiron të mbijetosh, bëj dhe thuaj sa më pak të mundesh.)
(*12 years a slave*)

Përfundim: Kuptimi i fjalive nxitëse në periudhat me bashkërenditje dhe nënrenditje mund të interpretohet brenda kuptimit të gjithë periudhës dhe në këtë mënyrë fjalitë nxitëse nuk shprehin të njëjtat kuptime si në përdorimin e tyre si fjali të pavarura, pra të mëvetësishme. Përbushja e kumtimit të fjalive nxitëse (kërkesë, lutje, këshillë) në periudha të tilla lidhet me realizimin e një kushti të caktuar: raportin kohësor të fjalisë së varur kohore ndaj përmbajtjes së fjalisë nxitëse, si dhe me kuptimin plotësues të fjalive kundrinore, kryefjalore dhe kallëzuesore. Përdorimet e fjalive nxitëse në strukturën e periudhave me bashkërenditje dhe nënrenditje hasen më rrallë, në përjasje me përdorimet e tjera dhe interpretimi kuptimor i tyre kushtëzohet nga konteksti ku gjendet periudha.

§4.3.3. Fjali dëftore a pyetëse me funksionin kumtues të fjalive nxitëse në ligjërimin e folur

Ka shumë raste, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në gjuhën shqipe, ku mospërputhja e formës së shprehjes së llojeve të fjalive me përmbajtjen e tyre kumtuese krijon vështirësi në kategorizimin e fjalive në grupin e tyre përkatës. “*S’del i përlijtur kategorizimi e trajtimi i tyre sipas formës, kur vihet në bazë një parim si ai i ndarjes sipas qëllimit të kumtimit, siç ndodh mjaft herë në gramatika të ndryshme*²⁸⁵”. Në korpusin e filmave këto fjali janë të shumta dhe elementet gjuhësore që e dallojnë kumtimin që synon të shprehë folësi, lidhen me intonacionin (herë-herë thirrmos), si dhe me melodikën që kushtëzohet nga shkalla e intensitetit të qëndrimit ngashërimor. Si rrjedhojë, mjetet intonacionore janë shënuesit kryesorë, në mënyrë që të kryhet ai akt i ligjërimin që mendohet nga folësi. Le të analizojmë shembujt e mëposhtëm për të parë strukturën, anën e shprehësisë së thënies, si dhe aktet e ligjërimin që realizohen.

247. *You won’t disturb us; you’ll have to come; maybe you could talk to her, try and see*

²⁸⁵ *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 120.

what's wrong with her.

(Ti nuk do të na shqetësosh ne; ti mos na shqetëso, mos na shqetëso! Ti të duhet të vish; ndoshta ti mund të bisedosh me të, përpiku të kuptosh çfarë i ka ngjarë.)

248. *You should go, you're late.*

(Ti duhet të shkosh, ti / je me vonesë.)

(*The Past*)

249. *You should come with me tonight; I want you to look me right in the eye.*

(Ti duhet të vish me ne sonte; unë dua që ti të më shikosh drejt e në sy.)

(*Promised land*)

250. *You have to take me away; you better come get him.*

[Ti duhet të më largosh mua; më mirë eja ti ta marrësh atë / bën mirë të vish ta marrësh (**atë**).]

[(Më largo mua! *Eja ta marrësh* atë! (fjalë gjegjëse nxitëse)]

251. I give you five and you give me fifty right back, right?

(Unë të jap pesë dhe ti më kthen pesëdhjetë, dakord / si thua / në rregull?)

(*American Hustle*)

252. I will not go without my children. *You will not take* them from me.

(Unë nuk iki pa fëmijët e mi. Ti nuk do t'i marrësh ata nga unë.)

(*12 years a slave*)

Në fjalinë 250 kumtohet një kërkesë dhe një sugjerim që i bëhet dëgjuesit nëpërmjet strukturës së një fjalie dëftore të mirëfilltë. Kuptimi nxitës, këshillues dhe rekomandues është më mbizotërues ndaj anës formalo-gramatikore të shprehjes me kryefjalë + foljen modale: *you have to* dhe *you better (had better)*. Te gjegjësjë në gjuhën shqipe rolin kryesor në shprehjen e kuptimit sugjerues a këshillues e luan intonacioni dhe konteksti. Theksi bie mbi kryefjalën **ti**, që e veçon nga pjesëmarrësit e tjerë në këtë bashkëbisedim (dëgjuesit) dhe në këtë mënyrë dallohet një mbivendosje e anës semantike ndaj anës formale të shprehjes. Ne mendojmë se kategorizimi i këtyre lloj fjalive (nxitëse a dëftore) gjithmonë ndërvarret nga konteksti i bashkëbisedimit dhe përderisa ato nuk përligjen nga ana teorike, rolin kryesor e luan autoriteti dhe synimi i folësit në një akt ligjërimit të tillë. Te fjalë 250 folësi gëzon autoritetin e plotë që të japë një këshillë, një sugjerim, një rekomandim ose një urdhër, pse jo.

Te kjo fjali dhe në shumë raste të tjera në dialogët e filmave kemi vërejtur përdorimin e foljeve-kallëzues homogjenë pa lidhëzën bashkërenditëse shtuese *dhe*. *You better come get him. (You come and get him.)* Dy foljet duhet të lidhen me lidhëzën *and* (dhe) dhe fjalia të jetë e saktë si nga ana gramatikore, ashtu edhe nga ajo kuptimore. Në gjuhën shqipe fjalia nxitëse gjegjëse (*Eja ti ta marrësh më mirë*) nuk e ka lidhëzën *dhe* në strukturën e foljes-kallëzues. Fjalë është gramatikusht e saktë dhe shpreh kuptimin e duhur. Folja-kallëzues shprehet me folje në urdhërore + folje në lidhore ose dy folje në urdhërore *eja + merre*. Në gjuhën shqipe, dy folje në mënyrën urdhërore mund të kryejnë funksionin e kallëzuesve homogjenë pa lidhëz bashkërenditëse të shprehur, ndërsa në gjuhën angleze një përdorim i tillë nuk është gramatikusht i saktë. E gjejmë të përdorur në ligjërimitin e folur dhe në dialogët e filmave që po analizojmë.

253. *Go get him.*

(Shko merre atë!)

(*American Hustle*)

254. *Go change* before you catch a cold.

(Shko ndërrohu, se ftohesh.)

255. *Come sit down.*

(Eja ulu.)

256. And you, Fonad, *come get* your things in the bedroom.

(Ti, Fonad, *eja të marrësh / eja merr* gjërat e tua në dhomën e gjumit.)

(*The Past*)

Shembujt e sipërpërmendur tregojnë përdorimin e dy foljeve në formën e infinitivit, pra në mënyrën urdhërore, të lidhura me njëra-tjetrën kuptimisht me kumtimin e thënies dhe jo me një lidhëz për të përmbushur funksionin sintaksor të kallëzuesit.

Në aspektin e akteve të ligjërimit që realizojnë, ne do t'i grupojmë në akte ligjërimit që shprehin:

a. Urdhra dhe domosdonë e realizimit të një veprimi:

257. (*Take it! Come inside Ahmad, get in the car!*)

(Merre këtë! Hyr brenda Ahmed, hip në makinë!)

(*The Past*)

b. Propozim apo nxitje për veprim:

258. (*Let's just go, let's get right to it, come on in, Come on in!*)

(Le të shkojmë / shkojmë, le të kalojmë te çështja, eja pra, hyr brenda!)

c. Kërkesë:

259. *Give me the chance, let me ask you something.*

(Ma jep mua mundësinë, më lër t'ju pyes diçka.)

d. Lejim apo pëlqim:

260. *Let some other guy be last, come and sit here, ok, give me his number.*

(Lëre / të jetë / një djalë tjetër i fundit, eja të ulësh këtu. Në rregull, ma jep mua numrin e tij.)

(*Promised land*)

e. Kërcënim apo paralajmërim:

261. *Can't you watch where you walk, don't you touch me.*

(Nuk shikon ku ecën! Mos më prek mua!)

Nuk mund të themi se aktet e ligjërimit të përmendura më sipër përbëjnë të vetmet akte që shprehin thëniet nxitëse, sepse në kontekste të veçanta e njëjta fjali shpreh një gamë të gjerë ngjyrimesh kuptimore. Ndërveprimi i faktorëve gjuhësorë me ata socialë na japin një shprehësi mjaft të pasur dhe kuptime më të imëta të fjalive nxitëse në ligjërimitin e filmave.

262. *You shouldn't touch him. He doesn't like that.*

(Ti nuk duhet ta prekësh atë.)

Fjalja 262 në gjuhën shqipe nënkupton *Mos e prek atë*. E parë në kontekstin ku përdoret kjo fjali dhe e shqiptuar me një intonacion zbritës, ajo shpreh një mospranim të diçkaje të shqiptuar në mënyrë të tërthortë. Në mënyrë të drejtpërdrejtë thënia do të ndërtohej nga *don't you touch him*, e cila shënon një marrëdhënie shoqërore të afërt dhe mjaft të fortë. Në një kontekst tjetër ky kumtim do të shprehë një *qortim* ose një *kërcënim* të hapur.

Fjali pyetëse me ngjyrimë kuptimore nxitëse. Siç e kemi përmendur, nxitja dhe kuptimi drejtues mund të shprehën edhe nëpërmjet një fjalie pyetëse. Në korpusin e filmave mund të veçojmë fjali të shumta pyetëse, por kuptimisht nxitëse:

263. Fouad! *Can't you watch where you walk?*

(Fouad! Pse nuk shikon ku ecën / kalon?)

264. *Can I ask you not to give it to him?*

(Mund t'ju kërkoj të mos ia japësh atij?)

265. *Will you tell the kids to come here, before they go to sleep?*

(Do t'u thuash fëmijëve të vijnë këtu, para se të flenë?)

(*The past*)

266. *If you could excuse me for one second?*

(Sikur të më falnit për një sekondë. / Mund të më falni një sekondë? - Më falni një sekondë.)

267. *Why you leaving me out of this?*
(Pse po më largoni nga kjo gjë? - Mos më largoni mua nga kjo gjë.)
268. *Why can't you just be happy for me?*
(Pse nuk gëzoheni për mua? - Gëzohuni për mua.)
(*American Hustle*)
269. *Can you read me something?*
(Mund të më lexosh diçka? - Më lexo diçka.)
270. *And now that you are here, uh, would you please put those up there?*
(Tani që jeni këtu, a mund t'i vendosni këto aty lart? - Vendosini këto aty lart.)
(*Beginners*)
271. *Papa, I would very much like to learn how to play the violin. Could you teach me?*
(Baba, do të dëshiroja shumë të mësoja t'i bija violinës. Mund të më mësosh t'i bie?
- Më mëso t'i bie violinës.)
272. *Will you read it again? Not just now, darling.*
(Do ta lexosh përsëri?)
273. *Will you ever let them go in your heart?*
(A do t'i kesh ndonjëherë ata për zemër?)
(*12 years a slave*)

Me anë të tyre mund të bëjmë një propozim a një kërkesë në mënyrë të tërthortë, si dhe të bëjmë një paralajmërim në lidhje me anën kuptimore të kontekstit në fjalitë e tjera që vijnë.

§4.3.4. Përdorimi i disa foljeve tipike në fjalitë nxitëse në filmat e shfrytëzuar

Një veçori tjetër dalluese e ligjërimit bisedor dhe që e gjejmë të sendërtuar te ligjërimit i filmave, ka të bëjë me përdorimin e dendur të fjalive nxitëse që nga ana strukturore kanë vetëm foljen-kallëzues: *listen* (dëgjoj), *look* (shikoj) ose *come* (vij) e përdorur përgjithësisht si folje frazale e tipit *come on* (vazhdo, hej pra... në varësi të fjalisë që vijon në kontekst; e kemi përmendur edhe më sipër). Përdorimet e foljeve *listen*, *look* dhe *come on* janë tipike edhe në ligjërimit e shkruar në letërsinë artistike që kemi përmendur më sipër. Jo në të gjitha rastet kuptimi i tyre përkon me kuptimin e mirëfilltë që shprehin foljet “dëgjoj”, “shikoj” dhe “vij”. Duhet të theksojmë se vlera kuptimore e këtyre foljeve ka pësuar një zgjerim të fushës semantike-kumtuese dhe shpeshherë ato kryejnë funksion të ngjashëm me funksionin që kryen një lidhëz, pjesëz a pasthirmë në fjali. Pozicioni i tyre në fillim të thënies krijon një lidhje koherente dhe kuptimore me fjalitë e saposhqiptuara apo me ligjërimit që do të vijojë më pas. Nga ana e pikësimit ato veçohen me presje ose mund të vendoset pikë dhe shqiptohen me një intonacion zbritës.

274. *Listen, something came up last time.*
(Dëgjo / Shiko, herën e kaluar diçka më ndodhi...)
275. *Listen. Why didn't you ask me to come last year?*
(Pra, hej, ore, dëgjo, shiko. Pse nuk më kërkove të vija vitin e kaluar?)
(*The Past*)
276. *Listen. I'm sorry Michael isn't here yet.*
(Dëgjo. / Shiko. Majkëlli ende s'ka ardhur këtu.)
277. *Listen. None of this is your fault.*
(Dëgjo. / E di? / Ti s'ke asnjë faj.)
(*Promised Land*)
278. *Listen. I'm sorry.*
(Shiko / që ta dish. Më vjen keq / kërktoj ndjesë.)

279. *Why you gotta say that? I mean, that's why I can't invite you. It's too complicated.*

Listen, come on.

(Pse e thua atë? Dua të them, ja pse s'mund të të ftoj. Është shumë e ngatërruar.

Më dëgjon / kupton, hë pra.)

(American Hustle)

Mesazhi që folësi kërkon të përcjellë, duhet të jetë i qartë për dëgjuesit dhe ky grup foljesh përkon me funksionin gjuhësor të pjesëzave të veçanta a pasthirmave për të shprehur më qartë kumtimin e thënies. “Për të identifikuar elementet në thënie të caktuara kërkohet që folësi dhe dëgjuesi të ndajnë atë që Clark-u (1996) e emërton si realitet i përbashkët (common ground)²⁸⁶”. Fjalitë që ndjekin këto përdorime të foljeve *listen*, *look* dhe *come* janë fjali dëftore, më së shumti, nxitëse ose pyetëse. Kuptimi i fjalive dëftore, pyetëse a nxitëse përforcohet dhe qartësohet paraprakisht nga këto folje (shpeshherë të veçuara me pikë nga pjesa tjetër e fjalive) që i paraprijnë.

280. *Hey, look, you're a good person I know that but in all honesty...*

(Ej / hej, shiko, unë e di që ti je njeri i mirë, por me gjithë ndershmërinë time...)

(American Hustle)

281. *Look, we can spend the night imagining things. But it's all a speculation.*

(Pra, shiko, ne mund ta kalojmë natën duke imagjinuar. Por çdo gjë është vetëm një spekulim.)

(The Past)

282. *Look, I just talked to Richards. Just let me leave.*

(Shiko / dëgjo, që ta dish; unë sapo kam biseduar me Riçardin. Më lër të largohem.)

283. *Look, you don't have to decide now. Think about it.*

(Shiko, ti nuk duhet të vendosësh tani. Mendoje mirë.)

(Promised Land)

Edhe folja *look* gjendet shpesh në ligjërimin bisedor dhe përdoret për t'i tërhequr vëmendjen dëgjuesit për të parë diçka, kur themi: *Look at that photo!* (*Shikoje atë foto*). Por në shembujt më lart ajo mund të paraprijë si fjalitë nxitëse, edhe ato dëftore dhe e humb disi forcën urdhëruese shprehëse të fjalive nxitëse të mirëfillta dhe fiton karakteristika të mjeteve të tjera gjuhësore në funksion të realizimit të kuptimit në ligjërim. Disa kategori fjalësh humbin një pjesë të tipareve të veta gjatë përdorimit të tyre në ligjërim.

Te shembujt më sipër (274 - 283) vërejmë se gjegjëset e foljeve *listen* dhe *look* në gjuhën shqipe përkojnë me pjesëza që tërheqin vëmendjen e dëgjuesit ose përforcojnë kuptimin që do të shprehë thënia (ose edhe me foljet *dëgjoj*, *shikoj* jo në kuptimin e tyre të mirëfilltë, por si fjalë ndihmëse të ligjërimin). Në disa shembuj këto fjali përkojnë me fjalitë e ndërmjetme ose të ndërkallura, si te gjegjësjja 278 në gjuhën shqipe²⁸⁷. Nëpërmjet përdorimit të tyre dëgjuesi informohet, paralajmërohet, qartësohet apo edhe i tërhiqet vëmendja për diçka që është thënë apo që do të thuhet më pas. “*Fjalja nxitëse mund të shërbejë ndonjëherë për të tërhequr vëmendjen mbi atë që thuhet më pas; ndër të tjera përdoret në apostrofimet, si një mjet letrar shprehës ose në thëniet ironike: Dëgjoni! A nuk bëjmë ne të shtatë një kooperativë më vete?*²⁸⁸” Edhe në gjuhën shqipe fjalitë: *Dëgjo / dëgjoni* apo *shiko / shikoni* gjejnë përdorim të shpeshtë në ligjërimin e përditshëm dhe ato paraprijnë fjali të tipave të ndryshëm duke shërbyer shpeshherë si mjete për realizimin e kumtimin të thënieve të caktuara. Megjithatë, përdorimi i foljeve *listen* dhe *look* në gjuhën angleze ka një denduri më të madhe

²⁸⁶ Cituar nga *Introducing English Semantics*, Ch. W. Kreidler, Routledge, 1998, f. 23.

²⁸⁷ Fjalja nxitëse mund të dalë edhe si fjali e ndërmjetme a e ndërkallur: “E admirimi që kam, të më besoni, rritet edhe më shumë, kur shoh në ç'rrethana të vështira ka vepruar”, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 135.

²⁸⁸ *Po aty*, f. 134.

sesa në ligjërimin në gjuhën shqipe, në të cilin gjejmë të përdorura pjesëza e pasthirrma të ndryshme të cilat plotësojnë kuptimin e fjalive të mëparshme apo atyre që vijojnë.

Burimi i korpusit									
Korpusi i fjalëve: Roman 731 000					Korpusi i fjalëve: Filma - 165 500				
Foljet më të përdorshme	The Awakening	The Summoning	Dead Reckoning	Bloodline	The Past	Promised land	12 years a slave	Beginners	American Hustle
Let	23	21	28	25	15	26	18	19	23
Take	10	12	9	9	4	2	13	13	10
Come	26	20	19	14	4	8	4	9	10
Get	24	26	13	13	16	11	21	12	25
Look	10	29	13	7	3	10	13	16	35
Go	20	28	9	8	17	12	27	16	21
Tell	19	21	11	9	4	6	12	9	17
Give	16	14	8	9	7	7	9	11	13
Listen	9	12	9	10	4	13	12	8	17
Turn	9	9	7	8	3	4	11	10	8
Ask	11	8	6	9	5	3	12	8	9
Talk	12	14	9	8	2	9	11	14	14
See	16	10	9	9	4	5	4	6	7

Frekuenca e përdorimit të disa foljeve

Tabela 4

§4.3.5. Përdorimi i disa fjalëve leksikore, pjesëzave e thirrësve në fjalitë nxitëse në dialogët e hulumtuar të filmave

Një tjetër veçori dalluese në ligjërimin e filmave është edhe përdorimi i shpeshtë i fjalëve leksikore të veçanta, thirrësve, pjesëzave dhe pasthirrmave. *Thirrëret* i kemi hasur edhe në korpusin e analizuar nga letërsia artistike, në të cilën takohen më dendur dhe janë shpeshherë të shoqëruar nga pjesëza të tjera që shprehin gjendjen ndjenjësore të folësit, në mënyrë që ajo të ndikojë te dëgjuesi në përvetësimin e mesazhit të duhur. *Janë karakteristikë e fjalive nxitëse* ose edhe *pyetëse*, sepse ligjërimi i këtij tipi fjalish i drejtohet një ose disa personave të tjerë, si një veçori dalluese e kuptimit të tyre. Thirrëri në strukturën e fjalive nxitëse apo edhe të fjalive të tjera veçohet me presje dhe nga ana kuptimore ai lidhet me kuptimin tërësor të fjalisë. Pjesëzat që mund të dalin me thirrërin, përforcojnë, dallojnë apo edhe qartësojnë ngjyrimet e ndryshme emocionale. Këto pjesëza vënë në dukje thirrërin (personit a personave që u drejtohet ligjërimi) dhe e përforcojnë forcën shprehëse thirrëse të thënies. Në shembujt e mëposhtëm i gjejmë të ilustruara këto karakteristika të thirrërit dhe pjesëzave që e shoqërojnë atë në fjalitë nxitëse.

284. *Irving, come here, come on. Hey, play your part.*

(Irving, eja këtu, eja pra. Hej, / Ej, merr dhe ti pjesë.)
Hey, hey, hey, go easy on her! *Hey*, quit while you are ahead Carl!
 (Hej, hej, hej, tregohu i butë me atë! Ej, ndalo kur je përpara, Karl!)
Brenda, do the clerical wiring work and don't ask questions; ohhhh, heyyy,
come onnn!
 (Brenda, bëj instalimet dhe mos pyet; oh, ej, ec pra!)

(*American Hustle*)

285. *Stop it, Marie! Please, Fouad, calm down.*
 (Lëre atë, Maria! Të lutem, Fuad, qetësohu!)
Hurry up, kids! Come inside, Ahmad!
 (Nxitoni, fëmijë! Hyr brenda, Ahmad!)

(*The Past*)

286. *Wake up, Steve, we're fighting.*
 (Zgjoju, Stiv, ne po përleshemi!)

(*Promised land*)

287. *Don't cry, mama! Lord, God, help me.*
 (Mos qaj, mama! O zot, më ndihmo!)
Do not set yourself up against Patsey, my dear.
 (Mos u ndesh me Petsin, i dashuri im.)

(*12 years a slave*)

Analiza kontrastive e përdorimit të pjesëzave të fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe tregon një ngjashmëri në shpeshësinë, tipin, kuptimin dhe funksionin e tyre në kontekste të tilla.

Përfundim: Nga këndvështrimi numerik, shpeshësia e përdorimit të fjalive nxitëse në ligjërimin bisedor mund të shpjegohet me faktin se kuptimi i fjalive nxitëse mbart edhe qëllimin e folësit, i cili kërkon të ushtrojë ndikimin e tij ndaj bashkëbiseduesit në aktivitete të ndryshme të jetës së përditshme. Dyshja folës - bashkëbisedues përbën elementin e përhershëm të ligjërimin bisedor edhe në realizimin e aktit të komunikimit. Në këtë akt, përveç qëllimit të folësit, në shprehjet në të cilat mbizotërojnë thëniet nxitëse, vihet re edhe ndjenja afektive të folësit. Me anë të qëndrimit të tij ndaj realitetit që fjalia emërton, folësi shpreh më qartë qëllimin e tij në formën që ai dëshiron: si një lutje, kërkesë, lajm, lajmërim etj. Në të shumtën e rasteve dalin si fjali thirrmore dhe kuptimi apo pikësimi kushtëzohen nga elementet prozodike, intonacioni, melodika, konteksti ligjërimor etj.

Shpeshësia e përdorimit të disa mjeteve leksikore

Mjete leksikore	Burimi i korpusit								
	Korpusi i fjalëve: Roman 731 000				Korpusi i fjalëve: Filma - 165 500				
	Romanet				Filmat				
	<i>The Awakening</i>	<i>The Summoning</i>	<i>Dead Reckoning</i>	<i>Bloodline</i>	<i>The Past</i>	<i>Promised land</i>	<i>12 years a slave</i>	<i>Beginners</i>	<i>American Hustle</i>
Come on	17	18	22	25	2	7	2	5	17
Listen	9	8	10	8	2	11	3	2	10
Look	7	8	13	9	4	7	2	6	16
Please	13	9	10	13	8	5	9	3	19
Just	14	17	9	11	3	12	3	8	17
Now	5	7	7	5	3	9	12	2	8

Tabela 5

§4.4. Fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe në ligjërimin e prozës popullore

Kemi menduar t'i analizojmë fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe në një nënçështje të veçantë, për arsye se e gjejmë mjaft interesante përdorimin e tyre në prozën popullore si në aspektin semantik dhe akteve të ligjërimin që realizojnë, ashtu edhe në shprehjen formale-gramatikore të tyre. *Kur flasim për prozën popullore, kemi parasysh ato krijime folklorike, gjuha e të cilave është më e lirë se ajo e poezisë, është shumë afër gjuhës së folur*²⁸⁹. Proza popullore ka një sintaksë specifike të fjalive, mbart një ngarkesë emocionale të veçantë dhe dallohet për përdorimin e pasthirmave, pjesëzave, thirrësve, fjalive dëshirore, nxitëse etj. E kemi veçuar prozën popullore, sepse fjalitë nxitëse në këtë prozë janë të shpeshta, shfaqin karakteristika të veçanta dhe dalin më shumë si fjali thirrës. Nga pikëpamja sintaksore gjuha e Musine Kokalarit dallohet për një frazë të shkurtër, të qartë, të rrjedhshme, pa ngarkesa e ndërlikime, të mbushur me idioma, me fjali eliptike, një gjuhë e thjeshtë dhe e kuptueshme e bisedave të përditshme, që ngjan si e regjistruar nga subjekte konkrete. Autorja është njohëse dhe bartëse e shkëlqyer e kësaj idiome, prandaj dhe ka ditur ta përdorë atë bukur në vepër²⁹⁰.

Nga këndvështrimi semantik, fjalitë nxitëse në prozën e M. Kokalarit mund të shprehin:

a. **Urdhër:** - *Ri moj e mallkuar, ri mos u luaj...* (f. 80) / *Hë merjani një herë. Merjani një herë.* (f. 102); - *Mos e ngani me dorë, u tha kjo, - se s'bën muartë vesh?* (f. 111)

- *Lëreni tani, sado, u-tha Ustrefi, - mos këndon. Hidhini këmbët shpejt. Kur të vimë afër shtëpisë së nuses atëherë zëjeni.* (f. 122)

²⁸⁹ J. Panajoti, *Proza popullore*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1985, f. 4.

²⁹⁰ Cituar nga M. Zekaj, *Gjuha e Musine Kokalarit në veprat e saj origjinale*, Disertacion, Tiranë, 2011, f. 52-56.

b. Qortim, paralajmërim, kërcënim: -*Mbaroni këtë dhe mos u dëgjoj prapë. Ecni tani dhe me të katra.* (f. 129); -*Lipsmu, i tha kjo - ikë për kokën t'ënde.* (f. 243); -*Të mos më shkeli më në shtëpi. Të mos më vijë se e kam për ta zbuar.* (f. 291); -*Mbaje golën moj nikoqire!* (f. 26)

c. Pëlqim, mospranim apo lejim:

- *Uh, ri more i përmbisur, i thoshte teto Ruhua, - lermë të kegen Bido.* (f. 101)
 - *Le t'i ruajë, le t'i ruajë e t'i marrë nga prapa atje ku të vejë.* (f. 290)
 - *Mos u - tunt, i foli, - mos i mba ato si ashtu. Të mos qaç sot moj e mallkuar se të prishet stolia.*
 (f. 160); - *Në avli, në avli, thoshte ajo, - ta shohin të gjithë. Ta gëzojmë.*" (f. 164)

d. Ftesë, propozim, kërkesë, lutje a thirrje ndaj dëgjuesit: - *Hajde, merja një herë, të gëzojmë Nexhipin. Hajde moj motër. Zeje një këngë Abidin dhe ktheje mirë për zonjën e shtëpisë.* (f. 101)

- *Këndoni dhe një këngë, u- tha Ustrefi - dhe pushoni pastaj.*" (f.168)
 - *Eja o behar ku je, Të dergjemi n'ato qe.* (f. 208)
 - *Ik, biro, i tha. Ikë foli dhëndërit të vijë këtu. Thuaj që të do nëna, se ka një fjalë. Kështu de.*
 (f. 215)
 - *Tani edhe një këngë për mua, foli halla, duke hirë derën e odasë. -S' dua fjalë se shokët ati i gjen dhe s't'ikin. Hajde de, merjani, dhe e zuri Nexhipin nga dora.* (f. 34)
 - *Uh, moj korbë, e lermë të të puth.* (f. 22)

(Musine Kokalari, ...sa u- tunt jeta...)

Nga shembujt e vjelë, vëmë re këto karakteristika në lidhje me shprehjen formale gramatikore dhe strukturën e fjalive nxitëse:

a. Trajta e urdhërores del e përdorur më dendur, krahasuar me trajtat e lidhore.

b. Pasthirrat, thirrjet dhe pjesëzat shoqërojnë shpesh kallëzuesit në mënyrën urdhërore (*pa, ore, nuse* etj.). Funkzioni i këtyre pjesëzave dhe pasthirrmave shërben për të transmetuar edhe gjendjen ndjenjësore të folësit, përpos kuptimit nxitës, kërkesë ose paralajmërues, një tipar karakterizues i fjalive nxitëse në përgjithësi.

c. Përsëritja e foljeve në urdhërore apo në lidhore, si dhe shpeshherë ndonjë gjymtyrë tjetër në fjali e përforcon kumtimin e synuar dhe e bën aktin e ligjërimit (kërkesë, qortim, urdhër etj.) më këmbëngulës për folësin dhe më detyruar për dëgjuesin (*Ulu, ulu. Të vemi t'i kërkojmë. Të vemi t'i marrim. Lemëni. Lemëni të qaj.*)

d. Fjalitë nxitëse dalin më tepër si fjali nxitëse-thirrmore duke marrë parasysht intonacionin thirrmore të tyre, ndjeshmërinë dhe qëndrimin afektiv të folësit. (*Moj Merushe evgjitka, të thom të mbaç golën, dëgjove dhe gjer ati si vajte shumë e tepërove. Ti shih vehten t'ënde, moj gjuhustër... qelbashe, morrashe.*)

e. Në prozën popullore dhe në ligjërimin bisedor fjalitë nxitëse dalin jo vetëm si fjali të mëvetësishme, por edhe si fjali të varura. *Fjalitë nxitëse mund të dalin edhe si fjali nxitëse të zhdrejta, në formën e fjalive të nënrenditura fülluese, të varura prej foljesh që shprehin të thënë, urdhër, kërkesë, propozim, lutje etj. Thuaji të mos vonohet*²⁹¹.

Vërejmë shembujt: *E porositi një milë herë "të marça të keqen Qato, t'u bëfça kurban, ki një çikë mënden".*

Si përfundim, fjalitë nxitëse (edhe dëshiroret përdoren dendur në prozën popullore) në prozën popullore e gjallërojnë ligjërimin, sendërtojnë gjallërimin e të shprehurit, pasurimin e ngjytimeve kuptimore, përforcimin e tekstit, madje edhe plotësimin i anëve të përbashkëta

²⁹¹ Th. Dhima, Gjuha shqipe (Sintaksa), ShBLU, Tiranë, 2005, f. 60.

semantike. Si pasojë e kësaj vendosjeje, shpaloset një nga format e shkallëzimit stilistik, duke mëshuar tek ana më e rëndësishme e vargut.

§4.5. Fjalitë nxitëse në ligjërimin poetik të Nolit

Përveç korpusit të fjalive nxitëse në prozën popullore në gjuhën shqipe, kemi zgjedhur si një burim korpusi mjaft të pasur, veprën I të Nolit si një nga veprat më tipike të përdorimit të fjalive nxitëse në gjuhën shqipe. Forca urdhëruese shprehëse e fjalive nxitëse sendërtohet natyrshëm në vargjet e Nolit dhe intensiteti i kësaj force lidhet ngushtësisht me synimet e folësit për të përmbushur urdhrin a direktivën e dhënë. Për çdo lloj force urdhëruese shprehëse (*ilokutore*) ka një shkallë karakteristike të forcës së synimit shprehës (*ilokutor*). Urdhri është më i fuqishëm se kërkesa, por forca më e madhe rrjedh nga intensiteti i dëshirës së shprehur. Forca e madhe e urdhrin rrjedh nga fakti se *folësi* përdor pozicionin e autoritetit, d.m.th. pushtetit që ai gëzon ndaj *dëgjuesit* (i adresuari)²⁹². Fjalitë nxitëse gjejnë përdorim edhe në ligjërimin politik sepse ky ligjërim nënkupton një palë tjetër që të dëgjon apo beson dhe pritet të reagojë pas thënieve nxitëse dhe kërkuese nga ana e folësit.

Diskursi politik është gjuhë e përdorur në situatë konkrete për të mbërritur qëllime, është strukturë e njëkohësisht proces. Dy janë karakteristikat thelbësore të diskursit politik: qëllimi alokutiv (të bësh të besojë) dhe qëllimi perlokutiv (të bësh të bëjë). Në diskursin politik, akti i të bindurit (të bësh të besojë) gjithmonë finalizohet me aktin e të bërit. Ligjërimi i Nolit mbetet vetëm në njërin nga karakteristikat e diskursit politik - tek të bërit të besosh. Diskursi politik ka valenca pragmatike që manifestohen në përmasën e tyre performative përmes funksionit konativ të shprehur gramatikisht me foljet në urdhërore apo me përemrat e vetës së dytë. Zgjedhjet gjuhësore, ndonëse duket e kundërta, lidhen më shumë me modalitetet dhe jo me përmbajtjen²⁹³.

Të gjitha vargjet e Nolit karakterizohen nga përdorimi i fjalive nxitëse me funksione komunikuese shumë të larmishme si: thirrje, grishje, kërcënim, paralajmërim apo edhe tërheqje të vëmendjes. Ne mendojmë se ligjërimi poetik i Nolit si ligjërim politik nuk realizon vetëm qëllimin alokutiv, por edhe perlokutiv (të bësh të bëjë, veprim), të cilat e tipizojnë atë përkatësisht në rolin e poetit dhe të politikanit. *Të besosh* te Noli lidhet me fetarinë dhe liturgjinë (predikim-besim) dhe *të veprosh* lidhet me politikanin (predikim-besim-veprim). Asnjë politikan nuk futet në politikë vetëm t'i bëjë të tjerët ta besojnë, por qëllimi final i tyre është të nxisin veprim, sidomos politikanët revolucionarë, mes të cilëve radhitet edhe Noli ynë. Te vargjet: *Ngruhuni dhe bjeruni; Derthni plumba, o Shqiptarë, Mbushni gjyle që t'i shtypni*, Noli shfaq hapur shtysën që bashkëbiseduesit (shqiptarët) në mënyrë urgjente të ndërrojnë veprimin e duhur.

Në paraqitjen e plotë të sintezës historike të kombit të tij Noli *ndërthur* përdorimin e *fjalive nxitëse, përsëritjen* e fjalëve dhe shprehjeve leksikore, me *qëllimin kumtues* që ai mëton të përcjellë te bashkëbiseduesi ose bashkëbiseduesit. Qëllimi i tij është të krijojë në sytë e bashkëbiseduesit një atmosferë të vërtetë të realitetit, i cili shpërfaqet i trishtë, i shkatërruar dhe i përvuajtur. Dinamika e melodikës së vargut me përsëritjen e tingujve, pasthirmave, thirrësve dhe rimave të njëjta janë shprehëse të fuqishme të një mesazhi thirrës për veprim, sulmues, lajmërues dhe urdhërues ndaj popullit të vet. Këta elementë e përqasin shprehjen leksiko-gramatikore të vargjeve (*fjalive nxitëse*) me kontekstin politik të kohës. Ligjërimi poetik urdhërues në gojën e një udhëheqësi politik, por nëpërmjet vargjeve

²⁹² J. R. Searle, D. Vanderveken, *Speech acts and illocutionary logic*, Logic, Thought and Action, Cambridge University Press, 1985.

²⁹³ Dh. Shehri, *Diskursi poetik si diskurs politik*, Studime Albanologjike (*Homopeticus-homopolitikus*), Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, UT, Tiranë, 2012/2, f. 61-66.

të poetit e vendos një rënë palë (*folësi* në këtë rast), mbi bashkëbiseduesin duke shprehur autoritetin e tij veprues dhe ndikues te pala tjetër (*njerëzit*).

Mund të dallojmë nga ana semantike këto grupe të fjalive nxitëse në veprën e Nolit:

- a. Fjali nxitëse që shprehin grishje, urdhër, domosdonë e realizimit të diçkaje, thirrje për veprim: *Armë dhe fishekë mbliithni/Qesen dhe shpirtin hithni/Jepni, Nënë të shpëtoni, Komb e vatra të nderoni.* (F. S. Noli, *Vepra I, Jepni për nënën*, f. 43-44)

Ngrehuni dhe bjeruni/ Korrini dhe shtypini! (Anës lumenjve, f. 72)

- b. Fjali nxitëse që shprehin paralajmërim, qortim, kërcënim:

“O shqiptarë, Nënë mos ia bëni varrë!”, Mbahu, Nëno, *mos kij frikë! Se ke djemtë n’Amerikë.* (Jepni për nënën, f. 42)

Ndreq kurrizin më parë, pastaj ndriço trurin/Merr-e prapë kamçikun, Shën Pjetri u-përgjegj/Përkëdhel-u kurrizin dhe do t’ të besojnë/Vraj-i, shtyp-i, dhe shtrydh-i, dhe do t’ adhurojnë! (Krishti me kamçikun, f. 50)

- c. Fjali nxitëse që shprehin ndalim të kryerjes së veprimit a mosrealizim të tij (*fjali nxitëse-ndaluese*): *Kirenar, sec’ the një fjalë/ Mos e vrisni këtë djalë!”/ Daleni, the, mor amanoratorin mos e nganil...* (Kirenari, f. 59)

- d. Fjali nxitëse që shprehin tërheqje të vëmendjes dhe nxitjen për të vepruar:

Në je trim këtu tregojë/ Shko shpëtoje: Thot’ ajo: - Je, mos gënje!”

(Shën Pjetri në mangall, f. 52)

Në aspektin e semantikës së fjalive dhe akteve të ligjërimit që shprehin grupet e mësipërme të fjalive nxitëse përbëjnë tipat më të spikatura dhe dominuese në ligjërimit politik të Nolit. Fjalitë nxitëse shprehin një gamë të gjerë të ngjyimeve kuptimore në kontekste të ndryshme për realizimin a mos realizimin e një fakti nëpërmjet një urdhri, kërkese a thirrje, si në rastin e Nolit, prandaj grupet e mësipërme përbëjnë llojet tipizuese dhe shprehin kuptimet thelbësore të semantikës së fjalive nxitëse. Semantika e tyre është në funksion të realizimit të qëllimit të kumtimit që shprehin vargjet; thirrje të fuqishme për veprim dhe një dëshirë e folësit për të pasqyruar dhe kuptuar më mirë të vërtetën. Kjo thirrje realizohet nga ana gjuhësore me një larmi mjtesh gramatikore, përmendim këtu: “Embrayage - ku autori i jep vlerë maksimale fjalëve të veta dhe priret ta drejtojë marrësin të njësohet me të. Shenjat gramatikore, përdorimi i diekseve personale, hapësinore e kohore, pra prania e çifteve *unë / ti, ne / ju; këto / ato, tani* etj. Këto janë shenja të një diskursi politik polemik²⁹⁴.”

Duke u nisur nga veçoritë strukturore në vargjet e Nolit, fjalitë nxitëse kanë këto tipare karakterizuese:

1. Në strukturën e fjalive nxitëse gjenden shpesh *thirrori*, i shoqëruar me *pasthirrma nxitëse, fjalë a morfema* që shenjojnë vlera sociale, si mirësjellja, në mënyrë që të shprehin dëshirën a vullnetin e folësit dhe për t’iu drejtuar dëgjuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë²⁹⁵. Thirrorët janë karakteristikë e gjuhës së folur dhe për pasojë i gjejmë më shpesh në dialogë e bashkëbisedime. Në fjalitë nxitëse thirrorët gjejnë përdorim sepse ligjërimit i fjalive nxitëse në kontekste të ndryshme i drejtohet detyrimisht një personi tjetër, dhe te vargjet e Nolit del

²⁹⁴ Dh. Shehri, *Diskursi poetik si diskurs politik*, Studime Albanologjike (*Homopeticus-homopolitikus*), Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, UT, Tiranë, 2012/2, f. 63.

²⁹⁵ Në grupin e pasthirrmave nxitëse hyjnë edhe disa pasthirrma që nga pikëpamja e formimit mund të jenë të parme ose jo, të cilat marrin mbaresën *-ni* të foljes në mënyrën urdhërore për të shprehur vullnetin e folësit: *hajde-hajdeni; hë-hëni, mirëmbërma- mirëmbërmani* etj. Pasthirrmat *hajde-hajdeni* gjejnë shumë përdorim në gjuhën e folur. (*Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia*), Tiranë, 2002, f. 430-431.

mjaft dendur, shpeshherë i shoqëruar edhe nga kryefjala. Le të analizojmë shembuj të përdorimit të thirrорëve në Veprën I:

Te Ura, te ura / Vraponi, o burra, (Thomsoni dhe kuçedra, f.39)

Shokë, sot kam panair / Shokë, bëmeni sehir; (Sulltani dhe kabineti, f.124)

Derthni plumba, o shqiptar, Këta qena, o shok i mbytni,

Mbushni gjyle që t'i shtypni, Mbahu, nëno, mos kij frikë, Se ke djemtë në Amerikë.

(Jepni për nënën, f. 43-44)

Daleni, the, mor ama-ni / Oratorin mos e ngani, (Kirenari, f. 59)

2. Përdorimi i dendur i *foljeve - kallëzues* në vetën e dytë të mënyrës *urdhërore* dhe një *përsëritje* e tyre në fjalitë nxitëse gjallëron ligjërimin thirrës dhe polemik dhe njëherazi përforcon kuptimin thelbësor të thënies ku gjejnë përdorim. Edhe disa gjymtyrë të tjera karakterizohen nga përsëritja në fjalitë nxitëse, dhe në këtë mënyrë Noli (folësi) në këtë akt komunikimi, zotëron “kontroll” mbi dëgjuesin, sepse përsëritjet e herëpashershme i japin më shumë rëndësi fjalëve të tij, përforcojnë thelbin e thënieve nxitëse dhe për pasojë qëllimit të kumtimit. Vërejmë shembujt:

Dale, moj, se kam një fjalë, Dale, moj, se s’jam më djalë,

(Plak, topall, dhe ashik, f.100)

Shokë, sot kam panair / Shokë, bëmeni sehir / Sillni kupat e gostisë / Sillni shishet e rakisë!

(Sulltani dhe kabineti, f.124)

Qëndro, qëndro, moj mbrëmë plot me vrer / Vazhdo, vazhdo, or diell ngazëllimi,

(Dashuria e funtme, f. 99)

3. Lidhëzat bashkërenditëse shtuese *e, dhe* dalin mjaft të përdorura në këto vargje. Ato lidhin dy folje-kallëzues në mënyrën *urdhërore* dhe njëherazi i shërbejnë funksionit kumtues në fjalitë nxitëse duke i rreshtuar veprimet që duhet të përmbushë dëgjuesi a dëgjuesit (Shqiptarët).

I ilustrujmë me shembuj: *Lith litar, dhe mpreh sëpatë / var e ther, po pa shamatë, Bëj simit ‘e bëj kulaç / bëj lakror e bëj syltiaç,* (Sulltani dhe kabineti, f. 127)

Ngrehuni dhe bjeruni / Korini dhe shtypini, (Anës lumenjve, f.72)

4. Fjalitë nxitëse, siç e kemi përmendur edhe më sipër, shfaqen përgjithësisht si fjali të *mëvetësishme*, por në disa kontekste mund të dalin edhe në strukturën e *fjalive të përbëra*. Kjo dukuri haset në të dyja gjuhët. Në gjuhën angleze fjalitë nxitëse mund të jenë pjesë e fjalive të përbëra dhe shpeshherë fitojnë ngjyrimë kushtore. Kemi vënë re se te fjalitë nxitëse që kemi analizuar në vargjet e Nolit, disa fjali nxitëse si pjesë e fjalive të përbëra mund të shprehin nuanca kuptimore kushtore. U referohemi fjalive:

Përkëdhel-u kurrizin dhe do t’ të besojnë,

Vraj-i, shtyp-i, dhe shtrydh-i, dhe do t’adhurojnë. (Krishti me kamakun, f. 50).

Nëse vendosim në fillim të fjalisë lokucionin lidhëzor *po qe se: Po qe se u përkëdhel kurrizin*, ata do të të besojnë; vërejmë dy veprime të shprehura te pjesët përbërëse të fjalisë së përbërë, të cilat janë të ndërvarura midis tyre, pra shprehen marrdhënie kushtore si te:

Në je trim, këtu tregoje / Shko shpëtoje; (Shën Pjetri në mangall, f. 52) Vërejmë edhe një dukuri tjetër gramatikore te fjalia *Shko shpëtoje*; përdorimin e dy foljeve në mënyrën urdhërore që nuk lidhen me lidhëz. Këtu kemi një fjali të saktë nga ana gramatikore, gjë që siç e kemi përmendur edhe më sipër, në gjuhën angleze nuk del e përligjur gramatikisht.

5. Fjalitë nxitëse mund të dalin me një strukturë të thjeshtë pa kryefjalë të shprehur, pra vetëm me foljen-kallëzues, që në disa vargje del më e zgjeruar edhe me kundrinor ose rrethanor. Fjalitë nxitëse pa kryefjalë janë përdorur dendur dhe kanë rëndom të shprehur një *thirror*, i cili përdoret në ligjërimin oratorik, në kushtime e fjalime dhe ndonjëherë mund të shënojë persona që nuk janë të pranishëm. Në vargjet e Nolit vëmë re edhe përdorimin e fjalive eliptike (verbless sentences)²⁹⁶, kumtimi i të cilave realizohet me kumtimin e gjithë thënies. *Fjalitë eliptike janë fjali të një tipi të veçantë, specifike ndërtimore e të cilave është mungesa e kallëzuesit*. I ilustrojmë veçoritë ndërtimore të fjalive me shembuj:

Këta qena, <u>o shok</u> i mbytni; Mbushni gjyle që t'i shtypni,	(Jepni për nënën, f. 43)
Bëj gajret, mor Kirenar / drejt përperjetë në kalvar;	(Kirenari, f. 60)
Cporru prapë mu në djall; Në skëterrë dhe në zall!	(Korbi, f. 87)

6. Një veçori dalluese në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe është dhe *rimarrja e kundrinorit*, pra shprehja e tij si me formën e plotë emërore ose përemërore dhe me një trajtë të shkurtër. Paravendosja, prapavendosja apo ndërputja e kundrinorit të shprehur formalisht me anë të trajtave të shkurtra në trupin e foljes-kallëzues në fjalitë nxitëse është tipike për gjuhën shqipe (kjo dukuri haset edhe në frëngjisht, italisht), por nuk shfaqet në gjuhën angleze sepse është karakteristikë e gjuhëve eptimore.

P.sh. Vala ujë *shtirmëni* / dhe nga furra *nxirmëni* / Eni zemrën *ngrohmani* / Eni, mendjen *rokmani*;
(Sulltani dhe kabinetit, f. 127)

Lidheni, tha, me litar / Tani shkrua-më një shkrim, (Skënderbeu, f. 76)

Duke kundruar anën e jashtme të gjuhës dhe zgjedhjet gjuhësore të përdorura në vargjet e Nolit, vëmë re ai (folësi) ka prirjen të modelojë ligjërimin e tij si poet nëpërmjet fjalive nxitëse dhe nëpërmjet forcës së tyre urdhëruese dhe thirrëse merr rolin e udhëheqësit politik që mëton të pasqyrojë gjendjen a ndjenjat e tij dhe në të njëjtën kohë të informojë *dëgjuesit* (shqiptarët) për t'i bindur të reagojnë ndaj një situatë të tillë. Prandaj kumtimi i ligjërimin të tij është i barasvlefshëm me kumtimin e një situatë ligjërimore ku marrin pjesë folës-dëgjues në të cilin folësi kërkon, drejton, urdhëron dhe qorton pse jo, kushtime të realizuara nga ana gjuhësore nëpërmjet semantikës së fjalive nxitëse. E gjetëm mjaft interesante dhe tipike përdorimin e fjalive nxitëse në ligjërimin e Nolit, gjë që na ndihmon të pasqyrojmë në mënyrë sa më shteruese larminë e ngjyrimëve kuptimore që mund të shprehin fjalitë nxitëse në kontekste të ndryshme përdorimi.

Si përfundim mund të themi se, numri i madh i fjalive nxitëse në ligjërimin poetik të Nolit dëshmon jo vetëm shpeshtësinë e përdorimit të këtij lloji të fjalive në ligjërimin e kontekste të ndryshme, por edhe gamën e larmishme të kuptimeve që këto fjali mund të shprehin. Fjalitë nxitëse spikatin në ligjërimin e folur ku edhe zgjerojnë shtrirjen e fushës kuptimore dhe në këto kontekste shfaqen me modele strukturore të larmishme. Struktura e fjalisë pa kryefjalë të

²⁹⁶ Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 406.

shprehur është më e shpeshta dhe më e përdorshme, ndërsa modelet e tjera strukturore gjejnë përdorim në kontekste të ndryshme të situatave ligjërimore.

Përfundim: Tabelat e mësipërme pasqyrojnë shpeshësinë e përdorimit të fjalive nxitëse, modeleve strukturore që ato shfaqin e akteve të ndryshme të ligjërit që mund të realizojnë në ligjërit të ndryshme. Raportet e frekuencës së përdorimit dhe larmia e strukturave që shfaqin, përforcojnë idenë se fjalitë nxitëse përbëjnë tipin e fjalive mbizotëruese në ligjëritin bisedor, janë mjaft interesante nga ana strukturore dhe kanë një larmishmëri në tërësinë e mjeteve gjuhësore (fjalët modale, fjalët leksikore, rendi, intonacioni etj.). Këto mjete gjuhësore rritin shkallën e shprehësisë kuptimore të fjalive nxitëse.

§4.6. Përfundime të kreut

❖ Tipi strukturor i fjalive nxitëse vetëm me një kallëzues të shprehur dhe kryefjalë zero përbën grupin më tipik të fjalive nxitëse. Kuptimi thelbësor i tyre është një urdhër i prerë, një kërkesë, një rekomandim a një propozim. Fjalitë nxitëse të ndërtuara nga një kallëzues dhe kundrinor i drejtë përdoren rëndom në ligjëritin e shkruar dhe kundrinori shenjon personin a sendin të cilit i drejtohet kumtimi i fjalisë. Në gjuhën angleze kundrinori vendoset pas foljes-kallëzues, ndërsa në gjuhën shqipe ai shprehet në formën e plotë ose të shkurtër përemërore, e prapavendosur, e pasvendosur apo edhe e ndërfutur në trupin e foljes në mënyrën urdhërore. Dukuria e klitikëve dëshmon dallimin mes dy gjuhëve në përdorimin apo jo të kundrinorit.

❖ Duhet të vëmë në dukje te fjalitë pyetëse që kanë kuptime të fjalive nxitëse, rëndësinë e kontekstit në përkapjen e ngjyimeve kuptimore nxitëse, të cilat në përgjithësi shpërfaqen më të zbutura, më me mirësjellje dhe më të tërthorta në këto fjali.

❖ Fjalitë nxitëse karakterizohen nga përdorimi i disa foljeve tipike në strukturën e tyre. Veçantia dalluese që përlligj frekuencën e përdorimit lidhet me tiparin e tyre të shprehjes së veprimeve të kontrollueshme. Thelbi kuptimor i fjalive nxitëse shpjegon përzgjedhjen e disa foljeve, kuptimi i të cilave duhet t'i japë folësit kontroll ndaj veprimeve të dëgjuesit. Disa folje si: *come* (come on), *go*, *listen*, *look* etj. gjenden rëndom në fjalitë nxitëse, saqë shpeshherë janë kthyer në struktura të ngurtësuar që përkojnë me funksionin e shenjuesve të ligjëritit. *Come on* përbën një prej rasteve më tipike dhe më interesante të përdorimit si një folje frazale apo si shenjuese e ligjëritit në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze.

❖ Në tërësinë e teknikave të ndryshme dhe mjeteve gjuhësore që dallohen në reklama, fjalitë nxitëse, në përgjithësi, dhe foljet në urdhërore, në veçanti, luajnë një rol të rëndësishëm në transmetimin e kumtimit të synuar - të informojnë, të bindin konsumatorin (dëgjuesi) të reagojë. Kjo arrihet me anë të një force shprehëse urdhëruese, e cila tipizon më së miri fjalitë nxitëse. Fjalitë nxitëse që kumton një direktivë, shpreh një përmbajtje të caktuar që lidhet me veprimet e dëgjuesit në të ardhmen, përçon kuptimin se folësi kërkon që përmbajtja e fjalisë të bëhet realitet dhe vepron si një shtytje për dëgjuesin, në mënyrë që të realizojë përmbajtjen²⁹⁷. Pra, fjalitë nxitëse në gjuhën e reklamave zënë një vend të rëndësishëm dhe janë të vetmet fjali që mund të kryejnë funksionin kryesor për të cilin reklamata janë krijuar.

❖ Recetat e gatimit dhe manualët udhëzuesë janë kryesisht tekste që përmbajnë përshkrimin e procedurave dhe udhëzimeve të ndryshme. Fjalitë nxitëse dhe mënyra urdhërore e foljeve përbëjnë tiparin kryesor që ndeshet në pothuajse të gjitha këto tekste jo vetëm në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, por edhe në italisht, frëngjisht, spanjisht etj. Krahas kësaj veçorie, e cila përvijon pothuajse gjithë tekstet që shprehin udhëzime dhe

²⁹⁷C. Condovardi, S. Lauer, "Imperatives: meaning and illocutionary force", *Empirical Issues in Syntax and Semantics* 9, 2012, f. 37.

direktiva për lexuesit (bashkëbiseduesi në këtë akt komunikimi), duhet të theksojmë ngurtësimin e strukturës së fjalive të këtyre teksteve. “Ashtu si në tekste të tjera udhëzuese, modelet strukturore të fjalive mbeten të ngulitura dhe të qëndrueshme; ato nuk ndryshojnë në fjalitë që vijojnë më tej. Recetat e gatimit në gjuhën angleze shpalosin njëtrajtshmërinë më të spikatur në modelet strukturore të fjalive, të cilat janë pothuajse vetëm fjali nxitëse²⁹⁸.”

❖ Krahasuar me të gjithë tipat strukturorë të fjalive nxitëse në ligjërimin e folur dhe atë të shkruar në gjuhën angleze, tipi strukturor me *let* shfaq sipëri në lidhje me dendurinë e përdorimit në korpusin e fjalive nxitëse. Ky tip strukturor përbën llojin e veçantë të fjalive nxitëse në plotësimin e fjalive nxitëse të mirëfillta në disa veçori, si p.sh. shenjimin e disa llojeve të kryefjalëve, të cilat nuk mund të përdoren në fjalitë nxitëse të mirëfillta²⁹⁹.

❖ Kuptimi i fjalive nxitëse në periudhat me bashkërenditje dhe nënrenditje mund të interpretohet brenda kuptimit të gjithë periudhës dhe në këtë mënyrë fjalitë nxitëse nuk shprehin të njëjtat kuptime si në përdorimin e tyre si fjali të pavarura, pra të mëvetësishme. Përmbushja e kumtimit të fjalive nxitëse (kërkesë, lutje, këshillë) në periudha të tilla lidhet me realizimin e një kushti të caktuar: raportin kohësor të fjalisë së varur kohore ndaj përmbajtjes së fjalisë nxitëse, si dhe me kuptimin plotësues të fjalive kundrinore, kryefjalore dhe kallëzuesore. Përdorimet e fjalive nxitëse në strukturën e periudhave me bashkërenditje dhe nënrenditje hasen më rrallë, në përjasje me përdorimet e tjera dhe interpretimi kuptimor i tyre kushtëzohet nga konteksti ku gjendet periudha.

❖ Nga këndvështrimi numerik, shpeshësia e përdorimit të fjalive nxitëse në ligjërimin bisedor mund të shpjegohet me faktin se kuptimi i fjalive nxitëse mbart edhe qëllimin e folësit, i cili kërkon të ushtrojë ndikimin e tij ndaj bashkëbiseduesit në aktivitete të ndryshme të jetës së përditshme. Dyshja folës - bashkëbisedues përbën elementin e përhershëm të ligjërimin bisedor edhe në realizimin e aktit të komunikimit. Në këtë akt, përveç qëllimit të folësit, në shprehjet në të cilat mbizotërojnë thëniet nxitëse, vihet re edhe ndjenja afektive e folësit. Me anë të qëndrimit të tij ndaj realitetit që fjalia emërton, folësi shpreh më qartë qëllimin e tij në formën që ai dëshiron: si një lutje, kërkesë, lajm, lajmërim etj. Në të shumtën e rasteve dalin si fjali thirrmore dhe kuptimi apo pikësimi kushtëzohen nga elementet prozodike, intonacioni, melodika, konteksti ligjërimor etj.

❖ Fjalitë nxitëse (edhe dëshiroret përdoren dendur në prozën popullore) në prozën popullore e gjallërojnë ligjërimin, sendërtojnë gjallërimin e të shprehurit, pasurimin e ngjytimeve kuptimore, përforcimin e tekstit, madje edhe plotësimin i anëve të përbashkëta semantike. Si pasojë e kësaj vendosjeje, shpaloset një nga format e shkallëzimit stilistik, duke mëshuar tek ana më e rëndësishme e vargut.

❖ Numri i madh i fjalive nxitëse në ligjërimin poetik të Nolit dëshmon jo vetëm shpeshësinë e përdorimit të këtij lloji të fjalive në ligjërimin e kontekste të ndryshme, por edhe gamën e larmishme të kuptimeve që këto fjali mund të shprehin. Fjalitë nxitëse spikatin në ligjërimin e folur ku edhe zgjerojnë shtrirjen e fushës kuptimore dhe në këto kontekste shfaqen me modele strukturore të larmishme. Struktura e fjalisë pa kryefjalë të shprehur është më e shpeshta dhe më e përdorshme, ndërsa modelet e tjera strukturore gjejnë përdorim në kontekste të ndryshme të situatave ligjërimore.

²⁹⁸ J. Todolí, R. Dolón, *Translating cooking recipes in English, Spanish and Catalan*, Studies in Contrastive Linguistics, Proceedings of the 4th International Linguistics Conference, Santiago de Compostela, 2005, f. 1056-1057.

²⁹⁹ E. Davies, *The English imperative*, Croom Helm, 1986, f. 250.

PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME

Në këtë punim jemi përpjekur të nxjerrim në pah ngjashmëritë, përdallimet dhe vetjakësitë që i karakterizojnë fjalitë nxitëse në të dyja gjuhët. Në tërësinë e hulumtimit tonë jemi përqëndruar në arritjet e rrymave të ndryshme gjuhësore, vështrimeve dhe përfundimeve të studiuesve që kanë spikatur si në gjuhësinë tradicionale, ashtu edhe në atë gjenerativiste. Teoritë mbi fjalitë nxitëse janë analizuar në aspektin e përqsasjes, krahasimit dhe me synimin e qartë për të mbajtur një qëndrim ndaj atyre që rezultojnë bindëse dhe shkencore.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është vënia në dukje e veçorive formale-gramatikore, pra e veçorive sintaksore, morfologjike, semantike, vlerën ligjërimore të fjalive nxitëse në gjuhën angleze në përqsasje me gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe. Për të qenë një punim sa më i plotë e gjithëpërfshirës, këto fjali i kemi kundruar në rrafshin diakronik dhe në atë sinkronik.

Punimin e kemi konceptuar të ndarë në tre pjesë. Pas një shestimi të plotë të materialit dhe për të realizuar një analizë sa më shteruese e kemi ndarë në kapituj e sythe gjegjëse.

Fillimisht, për të realizuar pjesën e parë të punimit, me një vjelje të drejtpërdrejtë, kemi nxjerrë lëndë gjuhësore nga punime e autorë të tjerë pararendës a bashkohës, për gjithë ato çështje që i kemi konsideruar si të rëndësishme për studim. Pjesa e parë është ndarë në dy kapituj. Në kreun e parë kemi bërë një paraqitje të plotë të shtrirë në kohë dhe të mbështetur në arritjet e shumë studimeve gjuhësore. Fjalitë është njësi më e vogël kumtuese, me anën e së cilës mendimi formësohet dhe shprehet gjuhësisht. Kundrimi jo vetëm i anës kuptimore të fjalisë, në të cilën funksioni kumtues shërben për të përcjellë mesazhe të caktuara gjuhësore, por edhe asaj strukturore, na japin një tablo të larmishme të tipave të fjalive që gjejnë përdorim në ligjërime të ndryshme.

Në ligjërimin e përditshëm folësit e çdo gjuhe pohojnë, informojnë, pyesin, urdhërojnë, japin udhëzime apo urojnë e mallkojnë. Fjalitë ku shprehen këto kumtime klasifikohen në grupin e fjalive nxitëse. Fjalitë nxitëse janë pjesë e një ligjërimi ku veprojnë dy aktorë: folësi dhe dëgjuesi (i adresuari, marrësi a përfituesi i kumtimit përkatës). Nga pikëpamja strukturore në gjuhën angleze dallojmë katër tipa të fjalive: dëftore, pyetëse, nxitëse dhe thirrmore. Ky klasifikim përbën klasifikimin tradicional të fjalive, i cili jepet në disa gramatika të gjuhës angleze. Në kontekste të ndryshme, si në përshkrime apo ligjërime që përshkohen nga ndjenja, emocione, përjetime ku semantika e tyre nxjerr në pah gjendjen ndiesore të folësit, fjalitë mund të ketë të shprehur vetëm një gjymtyrë të fjalisë, e cila nuk është as kryefjala ose kallëzuesi, por gjymtyrë të tjera të dyta. Megjithatë, fjalitë me një strukturë të tillë nuk janë të shumta në gjuhën angleze dhe nuk hasen shpesh në ligjërime të ndryshme, sepse rendi i ngulitur i gjymtyrëve e kushtëzon përdorimin e tyre në fjali.

Sipas qëllimit të kumtimit në gjuhën angleze fjalitë ndahen në këto grupe kryesore: dëftore, pyetëse, nxitëse dhe thirrmore. Ky klasifikim shfaq ngjashmëri në shumë gramatika dhe në rryma gjuhësore që nga gjuhëtarët tradicionalistë dhe deri tek studiuesit e kohëve të sotme. Në gramatikën e gjuhës angleze fjalitë ndahen në:

1. fjali dëftore
2. fjali pyetëse
3. fjali nxitëse
4. fjali thirrmore.

Gjatë kundrimit të rrjedhës së studimeve gjuhësore mbi fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe klasifikimit të tyre, duke u bazuar në kriterin kumtues të thënies, vëmë re se në studimet e shumta mbi tipat e fjalive dhe fjalitë nxitëse në veçanti, gjuhëtarët kanë shprehur qasje të ndryshme apo shpeshherë kundërshti në lidhje me disa çështje gjuhësore. Nga përqsaja e studimeve mbi klasifikimin dhe kundërshtitë gjegjëse ne kemi arritur në përfundimin se problematika që ka ndarë apo bashkuar analizën përshkruese dhe klasifikuese të tipit të fjalive nxitëse, lidhet me: pranimin ose jo të fjalive nxitëse-dëshirore si grupi i tretë në klasifikimin e fjalive, kategorizimin e fjalive thirrmore si grup i mëvetësishtëm, trajtimin e

fjalive dëshirore si një prej tipave të fjalive apo konstrukteve brenda grupit të fjalive nxitëse, të emërtuara shpesh si pseudo-nxitëse.

Në kreu e parë kemi paraqitur një vështrim përshkrues e krahasues të tipologjisë së studimeve mbi fjalitë nxitëse në të dyja gjuhët. Nga përqsja e studimeve mbi fjalitë nxitëse kemi arritur në këto përfundime:

1. Te klasifikimet e bëra në shumë gramatika të gjuhës angleze të rrymave të ndryshme gjuhësore, vëmë re qasjet mbi kategorizimin e fjalive thirrmore, si grupin e katërt të tipave të fjalive.

2. Në gjuhën shqipe fjalitë thirrmore nuk klasifikohen si grup më vete, por janë përfshirë në secilin lloj të fjalive. Kjo ndodh sepse secili tip i fjalive mund të dalë me të njëjtën përbërje strukturore e të dallohen vetëm nga intonacioni i tyre.

3. Përbërja e veçantë strukturore e fjalive thirrmore në gjuhën angleze përlligj klasifikimin e tyre (sipas qëllimit të kumtimit) si grup më vete.

4. Ne ndajmë mendimin me klasifikimet e bëra në Gramatikën e gjuhës shqipe II dhe shumë studiues shqiptarë, të cilët i ndajnë fjalitë në tre grupe në varësi të funksionit të tyre kumtues.

5. Veçantia strukturore e fjalive thirrmore në gjuhën angleze përlligj kategorizimin e tyre si grupin e katërt të fjalive në shumicën e studimeve gjuhësore.

6. Fjalitë thirrmore në gjuhën shqipe duhet të kundrohesh në kontekstin përkatës. Arsyeja që i kemi bërë objekt studimi lidhet me veçantinë e fjalive nxitëse në gjuhën shqipe, që në të shumtën e rasteve dalin si thirrmore.

Argumentet tona i kemi mbështetur në analizën e qasjeve dhe vështrimeve të ndryshme mbi kategorizimin e tipave të fjalive, në rryma të ndryshme dhe nga shumë studiues. Në dritën e këtij këndvështrimi ne kemi arritur në përfundimin se këto dukuri gjuhësore kanë disa veçori dalluese, të cilat kanë drejtuar studimet dhe klasifikimet e fjalive nxitëse:

1. Kriteret bazë klasifikuese të tyre.

2. Kalimin nga tiparet e shprehjes funksionale dhe formale të marra bazë për klasifikimin e fjalive nxitëse, në trajtimin e situatës ligjërimore dhe pjesëmarrësve në këtë situatë komunikimi (prirja e teorive gjuhësore të dekadave të fundit). Në studimet e mëparshme kumtimi i fjalisë nxitëse ishte i lidhur ngushtë me shprehjen formale të kallëzuesit në mënyrën urdhërore.

3. Dallimet në zgjedhjen e terminologjisë emërtuese të fjalive nxitëse, nga fjali urdhërore në nxitëse, apo nxitëse-dëshirore në studimet e mëvonshme. Mungesa e një marrëveshjeje të përgjithshme mes gjuhëtarëve ka sjellë një dallim në terminologjinë e përdorur për nocione të ndryshme gjuhësore.

4. Zhvendosja e objektit të studimeve gjuhësore mbi fjalitë nxitëse nga struktura dhe ndërtimi gramatikor i tyre drejt një analize më të thellë e komplekse të tyre.

Nga analiza e studimeve mbi fjalitë nxitëse kemi vërejtur se studiuesit ndajnë një mendim të përbashkët në lidhje me thelbin e kumtimit që mbartin fjalitë nxitëse (kërkesë, urdhër, porosi, këshillë). Por, ka një hendek që i ndan gjuhëtarët në këtë konceptim, sepse ata nuk përcaktojnë kufirin deri ku duhet të shtrihen fjalitë nxitëse në lidhje me semantikën e gjerë që ato shprehin. Sa i përket kufirit mes kumtimit të fjalive nxitëse apo dëshirore ne kemi arritur në këto përfundime: 1. Kategorizimi i fjalive sipas qëllimit të kumtimit duhet të varet edhe nga tiparet e semantikës që ato mbartin në fjali.

2. Gjurmimi i materialeve faktike dhe analiza e fjalive nxitëse në kontekstet ligjërimore dëshmojnë se fjalitë nxitëse duhet të kundrohesh në kontekstin ligjërimor ku ato përdoren.

3. Analiza formale gramatikore nuk mund të realizojë një studim tërësor dhe të detajuar të fjalive nxitëse. Si rrjedhojë, kriteret klasifikuese ende mbeten të papërcaktuara qartë për kategorizimin e tyre dhe përkatësia në secilin tip duhet të marrë parasysh këtë kriter.

Duke mëtuar të përjasim klasifikimet e fjalive në gjuhën angleze me ato në gjuhën shqipe, jemi përqendruar në paraqitjen e vështrimeve mbi klasifikimin e fjalive të studiuësve më në zë të gjuhësisë shqiptare. Nga kjo përjasje ne kemi arritur në këto përfundime:

1. Klasifikimi i fjalive sipas funksionit kumtues në gjuhën shqipe nuk përkon tërësisht me klasifikimin gjegjës në gjuhën angleze.

2. Mendojmë se klasifikimi i fjalive sipas qëllimit të kumtimit të dhënë nga Gramatika e Akademisë, është kategorizimi më i përshtatshëm i tyre dhe ne ndajmë të njëjtin mendim me këtë klasifikim.

Duke mëtuar të realizojmë një studim shterues të fjalive nxitëse jemi përqendruar në krahasimin e vështrimeve dhe përkufizimeve të shumta që shprehin anë të ndryshme të brendisë së fjalive nxitëse. Analiza e tyre përforcon më tej konceptimet e gjuhëtarëve se fjalitë nxitëse kanë një strukturë sintaksore të veçantë, që i dallon nga fjalitë e tjera. Disa nga këto karakteristika të përgjithshme janë: mungesa e kryefjalës; mungesa e kategorisë së kohës; përdorimi i foljes ndihmëse do në një fjali nxitëse pohore dhe mohore

Gramatika tradicionale nuk mund të japë një përshkrim tërësor të veçorive të fjalive nxitëse dhe si rrjedhim, ato u kthyen në objekt studimi nga gjuhëtarët e gjenerativizmit. Gramatika tradicionale ka hasur vështirësi në paraqitjen skematike të tyre, sepse këto tipa fjalish konsideroheshin si fjali që nuk kanë tipare të veçanta për t'u analizuar, për shkak të strukturës së thjeshtë të ndërtimit të tyre. Fjalitë nxitëse u studiuën dhe analizuan mënyrë shteruese në fazat e para të zhvillimit të rrymës gjenerativiste. Teoria gjenerative u ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe fjalive nxitëse për shkak të larmisë së madhe të modalitetit që ato shprehin. Në spektrin e teorive gjenerative transformuese përsiatjet e studiuësve gjenerativistë u drejtuan drejt paraqitjes së rregullave transformuese që e shndërruan fjalinë nxitëse nga një strukturë e thellë në atë sipërfaqësore, duke theksuar faktin se fjalia nxitëse "fshihte" disa dukuri sintaksore që drejtoheshin nga këta rregulla. Nga analiza e vështrimeve gjenerativiste ne arritëm në këto përfundime: - Fjalitë nxitëse kanë një strukturë sipërfaqësore të thjeshtë, formohen nga të njëjtat rregulla komplekse transformuese si fjalitë dëftore e pyetëse.

-Struktura të thellë të fjalive nxitëse është e ndërtuar nga përbërësit *you* dhe *will*. Në studimet e mëtejshme Chomsky dhe të tjerë gjenerativistë shpjeguan se ishin rregullat e transformimit që e vendosnin *will* në strukturën e fjalive dëftore dhe fjalive pyetëse të pagjymtyrëzyeshme të fjalitë nxitëse.

- Analizat tradicionale të brendisë kuptimore të fjalive të bazuar në kriterin e vërtetësisë së kumtimit të tyre dëshmuar se nuk i përfshinte të gjitha tipat e fjalive dhe nuk mund të ishte një analizë përshkruese. Kjo mungesë e analizës së gjithë llojeve të fjalive, të cilat jo gjithmonë mund të shprehin diçka të vërtetë ose jo, u pasua nga teoria e akteve të ligjërimin (Austin), sipas së cilës fjalitë nxitëse karakterizohen nga vlera ilokutive ose forca shprehëse e thënies.

- Përjasja dhe shpjegimi i strukturës së fjalive nxitëse me anë të fjalive performative dëshmon ngjashmërinë që shfaqin tipat e tjerë të fjalive (dëftore a pyetëse) në përmbushjen e një funksioni tjetër ligjërimor, krahas funksionit gjuhësor që i karakterizon këto fjali.

- Analiza gjenerative transformacionore dëshmoi se ajo ishte mjaft e dobishme dhe frytdhënëse për një përshkrim më të plotë të fjalive nxitëse.

- Mënyra e shprehjes së kryefjalës dhe natyra e saj në fjalinë nxitëse përbëjnë një çështje mjaft të mprehtë teorike ende të shtruar për zgjidhje në gjuhësinë gjenerative. Ne pajtohemi me teorinë e zbatimit të parametrin *pro-drop* (të kryefjalës zero në gjuhën shqipe) dhe atij *non-pro-drop* (të kryefjalës së shprehur në gjuhën angleze), jo vetëm në fjalitë nxitëse, por edhe në ato dëftore. Konteksti është thelbësor në interpretimin e kryefjalës në këto fjali.

- Pozicioni i kundrinorit dhe lëvizja e tij në fjali vërtetojnë se sintagma foljore ka të njëjtit tipare të brendshme të shfaqura, si në fjalitë dëftore, ashtu edhe në ato nxitëse. Por,

kundrinori i fjalive nxitëse mund të shfaqet i fshehur, apo mund të mungojë, ndryshe nga pozicioni i tyre te fjalitë dëftore.

Më tej kundrimin e fjalive nxitëse në hullinë e vështrimeve gjenerativiste e kemi përfunduar me trajtimin e klitikëve, pra rimarrja e kundrinorit te fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe, si veçori tipike e kësaj gjuhe. Për arsye se klitikët kanë një sjellje sintaksore mjaft të veçantë në strukturën e fjalive nxitëse, ne jemi përqendruar te tipizimi i tyre, pozicioni dhe kategorizimi i tyre në gjuhën shqipe. Disa nga përfundimet që kemi arritur nga përjasja dhe analiza kontrastive e këtyre strukturave në të dyja gjuhëve janë:

- Llojet e ndryshme të klitikëve dhe pozicionet e tyre në gjuhën shqipe janë një tjetër tregues i mjeteve të shumta gjuhësore që përdor gjuha shqipe për të shprehur të njëjtin funksion sintaksor krahasuar me gjuhën angleze.

- Llojet e ndryshme të klitikëve në gjuhën shqipe mbeten brenda eptimit. Dallimet në shpërndarjen e tyre për të tri vetat janë rrjedhojë e lëvizjes së foljes nga SF në SK.

- Klitikët në gjuhën shqipe janë shumë problematikë për të huajt që mësojnë gjuhën shqipe.

Në përfundim të analizës së fjalive nxitëse në spektrin e teorive gjenerativiste ne arritëm në këto përfundime:

1. Kundrimi i fjalive nxitëse në vështrimin gjenerativist tregon se ato mund të analizohen dhe paraqiten nga ana skematike ashtu si edhe tipat e tjerë të fjalive në gjuhë.

2. Veçoritë sintaksore të fjalive nxitëse shpërfaqen po aq komplekse dhe interesante për t'u kundruar e përqsuar me gjegjëset në gjuhën shqipe.

3. Hipotezat e përkrahura nga shumë linguistë e radhitin anglishten si një gjuhë që shfaq një sjellje sintaksore të fjalive nxitëse jo të veçantë nga tipat e tjerë të fjalive dhe në këtë mënyrë mund të përfshihet brenda analizës të strukturës së frazës, duke u mbështetur në shumësinë e koncepteve bazë të analizës transformacionore të gjenerativizmit.

Në kreun e dytë, duke e përqendruar kundrimin tonë në trajtimin e rrafshit morfologjik, jemi përpjekur të vëmë në dukje disa nga veçoritë më tipike morfologjike të klasës së foljeve. I kemi veçuar paradigmat foljore dhe karakteristikat e tyre pasi folja përbën gjymtyrën kryesore të brendisë së një fjalie. Brenda reale e fjalisë gjen shprehjen e saj në kategorinë gramatikore të kallzuesisë, e cila është uniteti i pandashëm i kategorisë së modalitetit sintaksor, të kohës sintaksore dhe vetës sintaksore. Fjalitë nxitëse në gjuhë të ndryshme dallohen formalisht nga tipat e tjerë të fjalive, sepse kanë një morfologji të ndryshme të foljes-kallzues.

Njëherazi këto kategori (e mënyrës; aspektit; diatezës; kohës) përbëjnë edhe veçantitë dalluese të foljes-kallzues të fjalive nxitëse në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe. Struktura e thjeshtë e fjalive nxitëse e ndërtuar përgjithësisht nga një folje-kallzues (edhe nga gjymtyrë të tjera: kundrinor, rrethanor etj.), përlligj analizën e detajuar të foljes-kallzues si në shprehjen formale, ashtu edhe në funksionin sintaksor dhe komunikativ që ajo luan te fjalitë nxitëse. Qasja e fjalive nxitëse dhe dëshirore në gjuhën angleze dhe shqipe lidhet ngushtë me veçoritë që karakterizojnë dy gjuhët, eptimore dhe analitike.

Kategoria gramatikore e mënyrës është mjeti kryesor për të shprehur modalitetin. Në gjuhën angleze karakteristikë për foljen-kallzues te fjalitë nxitëse është mënyra urdhërore e foljeve. Mënyra urdhërore kategoritë gramatikore i shfaq më të kufizuara në krahasim me mënyrat e tjera, për shkak të modalitetit që ka. Si në gjuhën shqipe dhe në atë angleze mënyra urdhërore ka vetëm dy veta II (njëjës dhe shumës) të kohës së tashme. Urdhërorja është një prej mënyrave të trashëguara nga një fazë e lashtë indoevropiane.

Paradigma e foljes-kallzues të fjalive nxitëse në gjuhën angleze përfshin forma të foljes në vetën e dytë, njëjës e shumës, si dhe trajta të kombinuara të vetës së parë, të tretë, njëjës dhe shumës. Trajtat foljore të vetës së parë, të dytë e të tretë njëjës a shumës, janë emërtuar

në gjuhën angleze si forma të kombinuara. Përdorimi i mënyrës lidhore për foljen-kallëzues të fjalive nxitëse, është një karakteristikë për gjuhën shqipe.

Fjalitë nxitëse në gjuhën angleze shfaqin karakteristika të të dy diatezave, por në diatezën pësore përdorimet janë më të rralla, veçanërisht pësore me formë foljore në të kryerën (*perfect passive*), si dhe forma e pësores me foljen *to be* (*be passives*) të përdorura si (*negative passives*). Modaliteti i mënyrës urdhërore e kufizon kategorinë e kohës. Folja-kallëzues e fjalive nxitëse ka të kufizuar kategorinë e kohës, e cila në këto fjali i përket së ardhmes dhe jo veprimeve të së shkuarës.

Nga krahasimi i kategorive gramatikore (të diatezës, kohës, mënyrës) në fjalitë nxitëse në të dyja gjuhët kemi arritur në përfundimet e mëposhtme:

1. Kategoritë gramatikore të fjalitë nxitëse dhe dëshirore janë më të kufizuara krahasuar me fjalitë dëftore dhe pyetëse.

2. Këto kategori gramatikore të fjalitë nxitëse dallojnë nga gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe, sepse kategoritë gramatikore në këtë gjuhë shprehen me anë të fleksionit.

3. Kategoritë gramatikore që gjejnë shprehje në fjalitë nxitëse dhe dëshirore në gjuhën shqipe dallohen më shkoqur dhe nuk janë të kufizuara si të gjegjëset e tyre në gjuhën angleze.

4. Gjuha shqipe përdor tri mënyra të foljeve në fjalitë nxitëse: urdhërore, lidhore dhe dëftore, kurse në gjuhën angleze përdoret vetëm forma e infinitivit, i cili merr vlerat e urdhërores.

5. Kategoria e kohës është e kufizuar si në gjuhën angleze, ashtu edhe në gjuhën shqipe, pasi ajo lidhet me shprehjen e modalitetit në fjalitë nxitëse.

6. Format e diatezës pësore përdoren rrallë në të dyja gjuhët.

7. Gjuhës shqipe i mungojnë format gramatikore të aspektit të vazhduar.

8. Pavarësisht profilit të ndryshëm të dy gjuhëve, që tipologjikisht janë të ndryshme (anglishtja si gjuhë izoluese dhe shqipja si gjuhë flektive), vërejmë ngjashmëri në shumë dukuri morfologjike, përfshi kategorinë e kufizuar të kohës së foljes, vetës, aspektit, diatezës, modalitetin e mënyrës urdhërore dhe dallimet mes të dyja gjuhëve janë të natyrshme.

Në këtë kre kemi bërë objekte studimi edhe fjalitë nxitëse- mohore, sepse ato kanë disa veçanti dalluese strukturore dhe kuptimore. Studiues të ndryshëm e gjejnë si të papërshtatshëm mohimin të fjalitë nxitëse, sepse ai bie në kundërshtim me thelbin kuptimor të tyre, i cili nënkupton kryerjen a realizimin e një urdhëri ose kërkesë dhe jo mosrealizimin e tij.

Më tej në analizën tonë jemi përqendruar në trajtimin e disa veçorive sintaksore në hullinë e qasjes kontrastive në të dyja gjuhët. Veçoritë sintaksore që kemi trajtuar janë: kryefjala; përdorimi i thirrorit dhe kryefjalës; foljen ndihmëse *do* për efekt të theksimit (tipare të strukturës së fjalisë), etj. Qasjet e ndryshme të studiuesve i kanë klasifikuar të gjitha fjalitë nxitëse në gjuhën angleze në dy grupe duke marrë parasysh strukturën sintaksore dhe formën e shprehjes gramatikore të foljes kallëzues: fjali që përmbajnë një shenjues gramatikor specifik dhe në fjali që nuk kanë shenjues gramatikorë të veçantë.

Elementi i pashprehur (kryefjala zero) në fjalitë nxitëse gjendet në pozicionin e kryefjalës, i referohet të adresuarit ose marrësit të urdhërit dhe interpretohet si një agent ose veprues.

Nga analiza e veçorive të kryefjalës së fjalive nxitëse në të dyja gjuhët kemi arritur në këto përfundime: - Mungesa e kryefjalës është një karakteristikë e strukturës së fjalive në të dyja gjuhët. - Gjuha angleze si një gjuhë me rend të ngulitur, shfaq një marrdhënie të fortë mes tre karakteristikave të kryefjalës. - Në gjuhën shqipe mungesa e kryefjalës plotësohet me mbaresat flektive, të cilat shënojnë vetën e dytë njëjës ose shumës. - Funkcioni kryesor i kryefjalës është të shënojë personin a një grup personash që u drejtohem. - Kryefjala e fjalive nxitëse përfaqësohet nga një përemër i vetës së dytë njëjës dhe shumës, që në shumicën e rasteve nuk shprehet.

- Mungesa e kryefjalës tregon se informacioni që folësi synon të japë me anë të një fjalisë nxitëse është i plotë. - Kur kryefjala shprehet në fjali, funksioni i saj shkon përtej shënimit të të adresuarit apo të adresuarve.

Një veçori tipike e fjalive nxitëse në shumë gjuhë është se kumtimi i tyre i drejtohet vetës së dytë njëjës a shumës. Megjithatë, kumtimet e fjalive nxitëse mund t'i drejtohen edhe vetës së parë njëjës, shumës ose vetës së tretë. Kjo lidhet me një nëntipi të veçantë të paradigmes së urdhërores të ndërtuar me foljen let. Nga përjasja e fjalive nxitëse me let në të dyja gjuhët dhe fjalive nxitëse të mirëfillta kemi arritur në këto përfundime: - Mundësia e përdorimit të disa sintagmave emërore në strukturën e fjalive nxitëse me let në funksionin e kryefjalës, është veçoria që e dallon nga fjalitë nxitëse të mirëfillta. - Fjalitë nxitëse me let janë më të shpeshta krahasuar me fjalitë nxitëse të mirëfillta. - Në gjuhën shqipe, gjegjëset me let shprehen me një folje-kallëzues në mënyrën lidhore të paraprirë nga pjesëza le (e cila edhe mund të hiqet) .

Nga pikëpamja e strukturës sintaksore të fjalitë nxitëse dallojmë edhe praninë e thirrorit, Shpeshherë thirrori dhe kryefjala e fjalisë nxitëse mund të gjenden në të njëjtën fjali, gjë që vështirëson dallimin e funksionit që kryen sintagma emërore si kryefjalë apo thirrhor. Natyra e kumtimit të fjalive nxitëse përlligj edhe përdorimin e dendur të thirrorit në to. Thirrhorët janë karakteristikë e gjuhës së folur, funksioni i të cilëve përkon me tiparet karakterizuese të fjalive nxitëse. Disa nga dallimet mes thirrorit dhe kryefjalës së fjalive nxitëse lidhen me pauzën intonacionore, vendin që zënë në fjali, adresimi i kumtimit të fjalisë dhe kufizime në larminë e sintagmave emërore në këto funksione.

Nga analiza kontrastive e veçoritë sintaksore të fjalive nxitëse në gjuhën angleze dhe shqipe kemi arritur në këto përfundime:

1. Të dy gjuhët shfaqin bashkëpërkime në disa veçori si: ana e thjeshtë formale e këtyre fjalive, mungesa e kryefjalës në pjesën më të madhe të rasteve, denduria e përdorimit në ligjërimin e përditshëm, përdorimi i thirrorit etj.

2. Bashkëpërkimet që kemi dalluar gjatë kundërimit të fjalive nxitëse nënvizojnë idenë e universalitetit të fjalive nxitëse.

3. Dallimet në të dyja gjuhët vërehen në shprehjen morfologjike të foljes-kallëzues, përdorimin e foljes ndihmëse si mjet përforcues i kumtimit të fjalisë, rendi i përmbysur i fjalisë në fjalitë nxitëse-mohore, mungesa e fleksionit kohor, etj.

4. Qoftë në gjuhën angleze, qoftë në gjuhën shqipe dhe në shumë gjuhë indoevropiane, fjalia nxitëse shpreh vullnetin e folësit në formë dëshire ose kërkesë për realizimin a mosrealizimin e një veprimi ose të një gjendjeje.

Në kreun e tretë kemi trajtuar veçoritë tipike semantike të fjalive nxitëse. Sipas konceptimit nga shumë studiues dhe shkolla gjuhësore, të gjithë tipat e fjalive të klasifikuara sipas kumtimit që përçojnë në ligjërim, janë semantikisht të specifikuar në mënyrë që të shprehin një forcë ilokutore të caktuar. Por jo domosdoshmërisht në çdo kontekst gjuhësor një fjali do të gjejë përdorim vetëm për të shprehur një forcë ilokutore të caktuar, pra duke iu përmbajtur përshkrimit semantik të saj.

Në këtë kre kemi vënë në dukje kuptimet bazë të fjalive nxitëse, aktet e ligjërimin që ato kryejnë në kontekste të ndryshme ligjërimore dhe marrdhënien e përbërësve kuptimorë të tyre me modalitetin që ato shprehin. Qasjet e studiuesve mbi fjalitë nxitëse përgjithësisht përkrijnë në kumtimin bazë që shprehin fjalitë nxitëse: kuptim drejtues dhe urdhërues. Kjo nënkupton që veçantia tipike e urdhërores qëndron te përdorimi i saj në një funksion drejtues dhe urdhërues, ku një person i dytë (i adresuari) “urdhërohet” (nga folësi) të ndërmarrë një veprim të caktuar.

Disa nga qasjet e studiuesve më të spikatur të semantikës formale që ne kemi analizuar, janë konceptet e listës së kërkesave, informacioni i përbashkët (Portner), marrdhënia e fjalive nxitëse me modalitetin (Isac), komponenti modal dhe performativ i fjalive nxitëse

(Kaufmann), operatori urdhërues (Han), prania e logjikës së fjalive nxitëse (Mastop, pikëpamjet tona përputhen me qasjet e tij mbi semantikën e fjalive nxitëse).

Duke i bazuar argumentat tona në përcaktimet dhe përkufizimet e studimeve dhe rrymave gjuhësore më në zë arrijmë në përfundimin se veçoritë kryesore semantike të fjalive nxitëse janë: - Akti i komunikimit përfshin dy palë: folësi (i cili kërkon, urdhëron, drejton etj.) dhe dëgjuesi (i cili pritët të reagojë, veprojë dhe përmbushë detyrat e ngarkuara).

- Ky akt duhet të përmbajë po ashtu listën e kërkesave (to-do-list).

- Ky komunikim i dyanshëm përvijohet nga tiparet e listës së kërkesave, të cilat përbëjnë thelbin kuptimor të kumtimit të thënies.

Modaliteti i fjalive nxitëse shpjegon dhe semantikën e gjerë kuptimore të fjalive nxitëse e cila mund të shprehë: Urdhër; komandë; kërkesë, lutje; ndalim; këshillë, rekomandim, paralajmërim; propozim; udhëzim; pranim; refuzim; mosbesues; ftesë; lejim; ofertë; mallkim; udhëzime a direktiva shpjeguese etj.

Nga analiza e larmisë kuptimore dhe akteve të ligjërimit që realizojnë ne kemi arritur në këto përfundime:

1. Fjalitë nxitëse shprehin një gamë të gjerë të vullnetit të folësit për të ushtruar ndikim te dëgjuesi ose dëgjuesit për kryerjen a moskryerjen e një fakti të caktuar.

2. Qëllimi i folësit është vendimtar në përcaktimin e semantikës së thënies, e cila në akte të ndryshme komunikimi merr interpretime të larmishme.

3. Të përcaktuara si format direkte të të shprehurit dhe larg të qënit një mënyrë e tërthortë dhe me mirësjellje e të shprehurit, fjalitë nxitëse në shumë situata shmangen nga përdorimi.

Në vijim, gjatë kundërimit të semantikës së fjalive nxitëse kemi vënë re rëndësinë e elementëve kontekstualë, të cilët luajnë rolin kryesor në dhënien e vlerës kuptimore të tyre. Kjo tregon se forca shprehëse e urdhërues në fjalitë nxitëse nuk mund të shënojë vetëm veprime që nxitin dhe drejtojnë një person të veprojë, por ngrimit kuptimore janë të ndryshme në kontekste të ndryshme. Larmia e nuancave kuptimore lidhet ngushtësisht me faktorët kontekstualë dhe faktorë të tjerë si: intonacioni, fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme, pjesëzat, parantezat, gjuha e trupit, të emërtuara nga studiues të ndryshëm si direktiva jo-urdhëruese si strategji të komandave.

Ne pajtohemi me mendimin e shumë studiuesve se fjalitë nxitëse shprehin në mënyrë të drejtpërdrejtë kumtimin e tyre dhe në komunikimin e përditshëm vihen re një sërë mjetesh që shërbejnë si shenjues të mirësjelljes. Disa nga mjetet që përdoren dhe që i kemi analizuar në mënyrë të hollësishme janë: fjalët leksikore (please, thank you,); fjalitë pyetëse me modalet could, would, are you able, will/ would you be able, fjali dëftore që kumtojnë urdhër ose kërkesë në mënyrë të tërthortë, folja ndihmëse do etj.

Në analizën e semantikës së fjalive nxitëse kemi arritur në përfundimet e mëposhtme:

4. Si gjuha angleze dhe ajo shqipe nuk tregojnë dallime të ndjeshme në semantikën dhe larminë kuptimore të fjalive nxitëse, të cilat përbëjnë një tipar ndërgjuhësor. Semantika e fjalive nxitëse është mjaft e gjerë në ligjërimi të ndryshme.

5. Mjetet gjuhësore që shërbejnë për të zbutur forcën urdhëruese tipike të fjalive nxitëse janë të larmishme në gjuhën angleze. Disa prej tyre gjejnë përdorim te gjegjëset në gjuhën shqipe, ndërsa disa të tjera nuk kanë gjegjëse në gjuhën shqipe (tag questions).

6. Konteksti ligjërimor është një element i rëndësishëm në përkapjen e anës kuptimore dhe gjithashtu në interpretimin e kumtimit të thënies nxitëse.

E kemi shtrirë analizën e semantikës kuptimore të fjalive nxitëse jo vetëm në përdorimin e tyre si fjali të thjeshta, por edhe në strukturën e një periudhe të përbërë, si fjali bashkërenditëse apo e varur. Pra, fjalitë nxitëse mund të jenë pjesë e periudhave me bashkërenditje të lidhura me lidhëzat bashkërenditëse shtuese (and) e, dhe,. Në këto periudha fjalia nxitëse e ka humbur forcën shprehëse urdhëruese drejtuar të adresuarit dhe në raport me

fjalinë tjetër me të cilën është në marrdhënie bashkërenditjeje, mund të marrë rëndom një vlerë kuptimore kushtore (apo lejore në raste më të rralla).

Kemi vënë re disa dallime mes fjalive nxitëse të mirëfillta dhe fjalive nxitëse me vlerë kuptimore kushtore. Këto dallime lidhen me përdorimin në fjalitë nxitëse me vlerë kuptimore kushtore të disa ndajfoljeve, foljeve që emërtojnë gjendje, përemrit vetvetor myself dhe veçantia e shënimit të një veprimi që i referohet një kohe të shkuar, para çastit të ligjërit.

Disa nga përfundimet e arritura nga analiza dhe përjasja e tyre me gjegjëset në gjuhën shqipe janë:

- Fjalitë nxitëse kanë një shtrirje të gjerë semantike dhe larmia e kuptimeve në kontekste të ndryshme lidhet me modalitetin që ato mbartin. - Konteksti ku fjalia nxitëse gjen përdorim si pjesë përbërëse e fjalive me bashkërenditje, është i rëndësishëm për interpretimin e vlerës kuptimore që merr gjithë periudha. - Struktura e fjalive nxitëse me nuanca kushtore përkon me strukturën e periudhës me bashkërenditje, por ana kuptimore e tyre nuk bashkëlidh marrdhënie numërimi të situatave. Realizimi i njërës situatë kushtëzohet nga mbarëvajtja e situatës tjetër.

- Te gjegjëset në gjuhën shqipe nuk kemi një periudhë identike me bashkërenditje të lidhur me lidhëzën shtuese e, edhe. Fjalitë nxitëse në këto raporte nga ana kuptimore kryejnë funksionin e një fjalie të nënrenditur kushtore të lidhur me fjalinë drejtuese me lidhëzën shtuese and (e, dhe, edhe).

Në fund të kreut të tretë kemi analizuar fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme, të cilat përbëjnë një veçori tipike të fjalive nxitëse në gjuhën angleze. Ato përkufizohen si fjali a ndërtime pyetëse të shkurtra, të cilat dalin në fund të disa thënieve në ligjërim, madje edhe në ligjërimin e shkruar joformal. Dendurinë më të madhe të përdorimit ato e kanë në fjalitë dëftore, por këto ndërtime gjenden edhe në fjalitë nxitëse. Duke ditur spektrin e gjerë që mbart semantika, si koncept në përgjithësi, ne kemi veçuar rastet më tipike të përdorimit të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në fund të fjalive nxitëse në situata të ndryshme ligjërimore. Këto thënie (të kumtuara në fjalitë nxitëse) rimerren, përforcohen a zgjerohen në fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme, të cilat, nga ana strukturore, ngjajnë me fjalitë pyetëse.

Nga analiza e fjalive nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme që shprehin urdhra dhe kërkesa, këshilla, oferta apo ftesa ne kemi dalluar këto veçori tipike: Këto fjali kanë një urdhërore të thjeshtë; shoqërohen dhe me disa pjesëza të ligjërit; kallëzuesi i shprehet me foljet get, give, take, etj; ato zbutin sadopak efektin urdhërues të fjalive nxitëse.

Gjatë trajtimit të veçorive të fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme jemi përpjekur të japim edhe gjegjëset në gjuhën shqipe. Nga kjo analizë kontrastive kemi arritur në këto përfundime:

1. Mospërdorimi i fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në gjuhën shqipe, me të njëjtën strukturë si në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze, e vështirëson përvetësimin e tyre nga ana e nxënësve që mësojnë anglishten si gjuhë të huaj.

2. Gjuha shqipe nuk mund të përdorë struktura të tilla për të kryer funksione të ndryshme kuptimore.

3. Si një karakteristikë e veçantë e gjuhës angleze fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme te gjegjëset në gjuhën shqipe dhe në përkthimin literal përftohen fjali nxitëse të ndjekura nga disa pjesëza që shprehin dyshim, miratim, dakortësi ose pjesëza mohuese mos.

4. Faktor i rëndësishëm në përvetësimin, përdorimin dhe përshtatjen e fjalive pyetëse të pagjymtyrëzueshme në gjuhën shqipe, është konteksti.

5. Pjesëmarrësit në një ligjërim ku kumtohet një kërkesë, urdhër, ofertë etj dhe marrdhënia që ata kanë në këtë bashkëbisedim, kushtëzojnë semantikën e fjalive nxitëse të ndjekura nga fjalitë pyetëse të pagjymtyrëzueshme dhe njëherazi ndikojnë në dhënien e gjegjëses së duhur në gjuhën shqipe.

Në kreun e katërt puna jonë është përqendruar në analizën e materialit faktik, praninë dhe shpeshësinë e fjalive nxitëse në ligjërime të ndryshme. Të kundruara në burime të larmishme korpusi ne kemi bërë shtimin e materialit të ndarë burime të ligjërimit të shkruar dhe të folur.

Rëndësia e ligjërimit në transmetimin e anës kumtuese të një fjalie nxitëse shpjegon qartë analizën e fjalive nxitëse brenda një situatë të caktuar komunikimi. Fjalitë nxitëse, për të kryer më së miri funksionet e tyre kumtuese, duhet të vlerësohen brenda ligjërimit ku ato kumtohen. Si rrjedhojë, ne arritëm në përfundimin se studimi i thelluar dhe tërësor i situatës komunikative, duhet të nxjerrë në pah rëndësinë që shfaq konteksti ligjërimit, i cili është më tepër kushtëzues sesa forma e thënies. Në këtë kontekst ne mëtuam të vëmë në dukje sendërtimin e karakteristikave dhe veçantive të fjalive nxitëse në ato situata dhe ligjërime, në të cilat ngërthehet një larmi përdorimesh dhe kuptimesh.

Analiza jonë e fjalive nxitëse në përdorimin praktik të tyre u përqendrohet në ligjërimin e shkruar, në (letërsinë artistike, udhëzime përdorimi, receta gatimi, reklama etj.) dhe ligjërimin e folur në (bisedat e dialogë të shkëputur nga filma të ndryshëm). Gjurmimi i fjalive nxitëse në këto korpusë ligjërimit na dha një panoramë të plotë dhe të qartë të veçorive sintaksore dhe semantike të fjalive nxitëse. Me anë të analizës kontrastive jo vetëm kemi përjasur e krahasuar strukturat sintaksore me gjegjëset në gjuhën shqipe, por kemi veçuar edhe disa përdorime tipike të fjalive nxitëse në gjuhën shqipe (proza popullore, ligjërimit poetik i Nolit).

Ne mendojmë se natyra e materialeve të përzgjedhura është kushtëzuese dhe shpeshherë një faktor i rëndësishëm për rezultatet e arritura. Në ligjërimin e shkruar mbizotërojnë fjalitë dëftore kundrejt fjalive pyetëse dhe nxitëse, kurse në ligjërimin e folur bashkëbisedimi është interaktiv që do të thotë se folësit bëjnë një kërkesë, pyesin njëri - tjetrin më shpesh dhe ky akt komunikimi mund të kryhet me praninë e dy palëve (folës-dëgjues).

Analizën e strukturës së fjalive nxitëse në ligjërimin e shkruar dhe të folur e kemi nisur nga struktura më e thjeshtë, e cila është karakteristikë e sintaksës së fjalive nxitëse e deri në përdorimin e tyre si pjesë e fjalive të përbëra (një veçori që haset më rrallë në gjuhën angleze, kryesisht në disa kontekste të veçanta të ligjërimit). Pavarësisht modeleve të thjeshta strukturore, fjalitë nxitëse shfaqen si fjali me struktura sintaksore të thjeshta, por të larmishme. Fjalitë nxitëse pa kryefjalë dalin me dendurinë më të madhe të përdorimit në burimet e korpusit të shfrytëzuara. Kjo denduri përdorimi e këtij tipi strukturor janë një dëshmi e veçantisë së fjalive nxitëse në shumë gjuhë, si fjali me strukturë të thjeshtë dhe pa kryefjalë të shprehur. Disa nga tipat strukturorë tipikë që ne kemi hasur në fjalitë nxitëse në burimet e korpusit të shfrytëzuara janë:

1. Tipat strukturorë pa kryefjalë të shprehur: Kryefjalë zero+ Kallëzues / Kr.zero + kall. + kund. i drejtë / Kr. zero + Kall. + kund.i drejtë + kund. i zhd. / Kr. zero + Kall. + kund. i drejtë + plotës / Kr. zero + Kall. + plotës rrethanor / Kr. zero + Kall. + plotës kallëzuesor
2. Tipi strukturor me kryefjalë të shprehur
3. Tipi strukturor me foljen *let*
4. Tipi strukturor me *Don't*

Nga analiza e këtyre tipave strukturorë në korpuset e vjela të ligjërimit të shkruar kemi arritur në këto përfundime:

1. Tipi strukturor i fjalive nxitëse vetëm me një kallëzues të shprehur dhe kryefjalë zero, përbën grupin më tipik të fjalive nxitëse dhe kuptimi thelbësor i tyre është një urdhër i prerë, kërkesë, rekomandim a propozim.

2. Fjalitë nxitëse të ndërtaura nga një kallëzues dhe kundrinor i drejtë përdoren rëndom në ligjërimin e shkruar dhe kundrinori shenjon personin a sendin të cilit i drejtohet kumtimi i fjalisë.

3. Dukuria e klitikëve dëshmon dallimin mes dy gjuhëve në përdorimin apo jo të kundrinorit.

4. Përdorimi i kryefjalës i jep fjalisë nxitëse një kuptim të barasvlershëm me nuanca kundërshtie, kontrasti, kategorizimi, veçimi etj.

5. Te gjegjëset në gjuhën shqipe, kryefjala mund të zërë pozicionin nistor apo fundor në fjali dhe përsëri mbetet elementi që shqiptohet më fuqishëm, sepse mbart peshën bazë kumtuese.

6. Përdorimi i foljes në mënyrën lidhore, shpeshherë edhe e paraprirë nga pjesëza le, shpreh kumtime urdhëruese më të zbutura në krahasim me fjalitë nxitëse me foljen-kallëzues në mënyrën urdhërore.

7. Fjalitë nxitëse karakterizohen nga përdorimi i disa foljeve tipike në strukturën e tyre. Veçantia dalluese që përlligj frekuencën e përdorimit lidhet me tiparin e tyre të shprehjes së veprimeve të kontrollueshme.

8. Come on përbën një prej rasteve më tipike dhe më interesante të përdorimit si një folje frazale apo si shenjues i ligjëritimit, në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze.

Më tej hulumimin tonë e përqendruam në përdorimin e fjalive nxitëse në recetat e gatimit, manualët, udhëzimet e përdorimit a reklamën etj. Në përdorime të tilla fjalitë nxitëse nuk shprehin kumtime urdhëruese të mirëfillta, por në këto tekste ato kumtojnë këshilla, propozime dhe ky akt komunikimi përmban dy palë folësi (që del më i “fshehur”) dhe dëgjuesi (i papërcaktuar).

Disa nga tiparet dalluese të teksteve të reklamave janë: fjalitë nxitëse zënë një vend të rëndësishëm në reklama krahas fjalive dëftore; nga pikëpamja strukturore janë fjali të thjeshta; nga pikëpamja semantike shprehin një mesazh të drejtpërdrejtë drejtuar lexuesit (blerësit potencial), në mënyrë që ai të reagojë; tipare stilistikore, të cilat përmbushin qëllimin e kumtimit (funksioni evokativ i gjuhës- kur gjuha përdoret në këtë funksion synohet të ngjallë gjendje emocionale dhe qëndrime të caktuara te dëgjuesi, konsumatori në këtë rast). I kemi mbështetur argumentat dhe përfundimet mbi përdorimin e fjalive nxitëse në reklama në analizën e detajuar të teksteve të tyre.

Përdorim mjaft të dendur të fjalive nxitëse gjejmë në recetat e gatimit dhe në manualët e udhëzimeve. Duke u nisur nga veçoritë që i karakterizojnë recetat e gatimit dhe manualët e udhëzimeve, ngjashmërinë që ato shfaqin me semantikën dhe forcën shprehëse të fjalive nxitëse, ne i kemi bërë objekt studimi, me synimin që të paraqesim një hulumtim sa më të plotë të larmisë së kuptimeve dhe të konteksteve në të cilat mund të hasen fjalitë nxitëse. Semantika e tyre dallohet për një natyrë urdhëruese, propozuese, këshilluese dhe rekomanduese. Ky është thelbi kuptimor i këtyre përdorimeve.

Disa nga veçoritë gramatikore të fjalive nxitëse në recetat dhe manualët që kemi veçuar janë:

1. Sintaksa e fjalive nxitëse shenjohe nga përdorimi i foljeve-kallëzues në mënyrën urdhërore. Në gjuhën shqipe, te gjegjëset e recetave gjejnë përdorim jo vetëm foljet në mënyrën urdhërore, por shpeshherë edhe në mënyrën dëftore, veta e parë shumës.

2. Fjali të tilla nxitëse përdoren pa ndajfoljet e kohës, pra vëmë re kufizim të kategorisë së kohës.

3. Fjalitë nxitëse në këto tekste dallohen për një leksik të veçantë, i cili shënon renditjen e proceseve përkatëse të recetave e gatimit dhe të udhëzuesit, i përbërë nga një grup foljesh, emrash e fjalësh të tjera, për të shprehur kumtimin përkatës.

4. Fjalitë nxitëse pa kryefjalë të shprehur përbëjnë pjesën më të madhe në tekstet e gjurmara të recetave dhe të manualeve, ndërsa në disa raste vëmë re edhe shprehjen e kryefjalës së vetës së dytë you (ti / ju).

5. Tekstet e këtij korpusi dallohen jo vetëm për fjalitë nxitëse që dalin strukturalisht më tepër si fjali të mëvetësishme, por edhe si fjali të përbëra me bashkërenditje ose me

nënrenditje. Fjalitë me nënrenditje dalin si fjali kushtore, kohore a këpujore (të cilat dalin shpeshherë si asindetike duke numëruar veprime që vijnë njëra pas tjetrës).

Pra, recetat e gatimit dhe manualët udhëzuesë janë kryesisht tekste që përmbajnë përshkrimin e procedurave dhe udhëzimeve të ndryshme. Ashtu si në tekste të tjera udhëzuese, modelet strukturore të fjalive mbeten të ngulitura dhe të qëndrueshme; ato nuk ndryshojnë në fjalitë që vijojnë më tej. Recetat e gatimit në gjuhën angleze shpalosin njëtrajtshmërinë më të spikatur në modelet strukturore të fjalive, të cilat janë pothuajse vetëm fjali nxitëse.

Pjesa e fundit në këtë kapitull trajton veçoritë e fjalive nxitëse në ligjërimin e folur dhe kemi bërë objekt hulumtimi dialogët e disa filmave. Nga analiza e shembujve të vjelë nga ky burim korpusi kemi arritur në këto përfundime:

1. Mënyra urdhërore e foljeve-kallëzues të fjalive nxitëse kryen funksionin ligjërimor të shprehjes së një mesazhi kumtues të drejtpërdrejtë.

2. Përdorim të shpeshtë të fjalive nxitëse të thjeshta, të cilat nuk kanë elemente të tjera formale (që shprehin tone të mirësjelljes) dhe, si rrjedhojë, janë thënie që kumtojnë mesazhe urdhëruese për një dëgjues ose një grup dëgjuesish.

3. Larmishmëri të modeleve strukturore të fjalive nxitëse. Ne kemi veçuar tipat strukturorë të fjalive nxitëse si të korpusi i ligjërimin të shkruar.

4. Krahasuar me të gjithë tipat strukturorë të fjalive nxitëse në ligjërimin e folur dhe atë të shkruar në gjuhën angleze, tipi strukturor me let shfaq sipëri në lidhje me dendurinë e përdorimit në korpusin e fjalive nxitëse.

5. Përdorimin e dendur të fjalive nxitëse që nga ana strukturore kanë vetëm foljen-kallëzues: listen (dëgjoj), look (shikoj) ose come (vij) e përdorur përgjithësisht si folje frazale e tipit come on etj.

6. Përdorimi i shpeshtë i fjalëve leksikore të veçanta, thirrurëve, pjesëzave dhe pasthirmave.

7. Nga këndvështrimi numerik, shpeshtësia e përdorimit të fjalive nxitëse në ligjërimin bisedor mund të shpjegohet me faktin se kuptimi i fjalive nxitëse mbart edhe qëllimin e folësit (si një lutje, kërkesë, lajm, lajmërim etj.). Dyshja folës - bashkëbisedues përbën elementin e përhershëm të ligjërimin bisedor edhe në realizimin e aktit të komunikimit.

8. Në të shumtën e rasteve dalin si fjali thirrmore dhe kuptimi apo pikësimi kushtëzohen nga elementet prozodike, intonacioni, melodika, konteksti ligjërimor etj.

Gjatë punës sonë hulumtuese kemi mëtuar të japim gjegjëset në gjuhën shqipe dhe në rastet kur nuk ka struktura gjegjëse jemi përpjekur të bëjmë një përshtatje kuptimore të tyre. E kemi gjetur mjaft interesante përdorimin e fjalive nxitëse në prozën popullore si në aspektin semantik dhe akteve të ligjërimin që realizojnë, ashtu edhe në shprehjen formale-gramatikore të tyre. Fjalitë nxitëse në këtë prozë janë të shpeshta, shfaqin karakteristika të veçanta dhe dalin më shumë si fjali thirrmore. Nga pikëpamja sintaksore gjuha e Musine Kokalarit dallohet për një frazë të shkurtër, të qartë, të rrjedhshme, pa ngarkesa e ndërlikime.

Disa nga përfundimet që kemi arritur nga analiza e fjalive nxitëse janë:

1. Trajta e urdhërores del e përdorur më dendur, krahasuar me trajtat e lidhore.

2. Pasthirmat, thirrurët dhe pjesëzat shoqërojnë shpesh kallëzuesin në mënyrën urdhërore dhe transmetojnë edhe gjendjen ndjenjësore të folësit, përpos kuptimit nxitës, kërkuar ose paralajmërues që ato kanë.

3. Përsëritja e foljeve në urdhërore apo në lidhore, si dhe shpeshherë ndonjë gjymtyrë tjetër në fjali e përforcon kumtimin e synuar dhe e bën aktin e ligjërimin më këmbëngulës për folësin dhe më detyruar për dëgjuesin.

4. Fjalitë nxitëse dalin më tepër si fjali nxitëse-thirrmore duke marrë parasysh intonacionin thirrmosor të tyre, ndjeshmërinë dhe qëndrimin afektiv të folësit.

5. Fjalitë nxitëse (edhe dëshiroret përdoren dendur në prozën popullore) në prozën popullore e gjallërojnë ligjërimin, sendërtojnë gjallërimin e të shprehurit, pasurimin e ngjyimeve kuptimore, përforcimin e tekstit, madje edhe plotësimin e anëve të përbashkëta semantike.

Vepra I e Nolit është një nga veprat më tipike të përdorimit të fjalive nxitëse në gjuhën shqipe. Forca urdhëruese shprehëse e fjalive nxitëse sendërtohet natyrshëm në vargjet e Nolit dhe intensiteti i kësaj force lidhet ngushtësisht me synimet e folësit për të përmbushur urdhrin a direktivën e dhënë. Forca e madhe e urdhrin rrjedh nga fakti se folësi përdor pozicionin e autoritetit, d.m.th. pushtetit që ai gëzon ndaj dëgjuesit. Fjalitë nxitëse gjejnë përdorim në ligjërimin politik, sepse ky ligjërim nënkupton një palë tjetër që të dëgjon apo beson dhe pritet të reagojë pas thënieve nxitëse dhe kërkuese nga ana e folësit. Disa nga veçoritë që kemi dalluar në ligjërimin e Nolit janë:

1. Noli ndërthur përdorimin e fjalive nxitëse, përsëritjen e fjalëve dhe shprehjeve leksikore, me qëllimin kumtues që ai mëton të përcjellë te bashkëbiseduesi ose bashkëbiseduesit.

2. Fjalitë nxitëse dalin më së shumti si nxitëse-ndaluese dhe shprehin grishje, urdhrë, thirrje për veprim, ndalim të kryerjes së veprimit a mosrealizim të tij.

3. Thirrja del shpesh në fjalitë nxitëse i shoqëruar me pasthirrma nxitëse, fjalë a morfema që shenjojnë vlera sociale, si mirësjellja, në mënyrë që të shprehin dëshirën a vullnetin e folësit dhe për t'iu drejtuar dëgjuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

4. Përdorimi i dendur i foljeve - kallëzues në vetën e dytë të mënyrës urdhërore dhe përsëritja e tyre e gjallëron ligjërimin thirrës dhe polemik.

5. Lidhëzat bashkërenditëse shtuese e, dhe lidhin dy folje-kallëzues në mënyrën urdhërore dhe njëherazi i shërbejnë funksionit kumtues në fjalitë nxitëse duke i rreshtuar veprimet që duhet të përmbushë dëgjuesi a dëgjuesit.

6. Në vargjet e Nolit vëmë re edhe përdorimin e fjalive eliptike, kumtimi i të cilave realizohet me kumtimin e gjithë thënies.

Fjalitë nxitëse spikatin në ligjërimin e folur ku edhe zgjerojnë shtrirjen e fushës kuptimore dhe në këto kontekste shfaqen me modele strukturore të larmishme. Struktura e fjalisë pa kryefjalë të shprehur është më e shpeshta dhe më e përdorshme, ndërsa modelet e tjera strukturore gjejnë përdorim në kontekste të ndryshme të situatave ligjërimore.

Në përfundim të këtij punimi nuk mendojmë se i kemi trajtuar të gjitha çështjet që e plotësojnë një studim tërësor dhe shterues. Fjalitë nxitëse shprehin një gamë të gjerë kuptimesh dhe prania e tyre në kontekste e situata të larmishme ligjërimore dëshmon për veçantitë dalluese të tyre, të cilat nuk mund të shestohen vetëm me një punim të tillë. Megjithatë, mendojmë se përpjekja jonë për të realizuar një studim shterues do të jetë një kontribut modest në lëmin e studimeve gjuhësore krahasuese mbi fjalitë nxitëse. Çështje si fjalitë eliptike (me forcë shprehëse urdhëruese), fjalitë nxitëse-ndaluese, përdorimet tipike të fjalive nxitëse në gjuhën shqipe në ligjërimin e ndryshme, do të jenë objekt studimi në kërkimet tona të mëtejshme në këtë fushë.

BIBLIOGRAFIA

Fjalorë

- Bambiniotis, C., *Fjalor i gjuhës së re greke*, Athinë : Qendra e leksikologjisë, 1998
Fjalor i Shqipes së Sotme Shqipe, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002.
Goosse, A., *Le bon usage*, Éditions Duculot, 1993.
Mathews, P. H., *The Concise Oxford Dictionary of Linguistics*, Oxford University Press, 2007.
Nouveau Petit Robert, *Dictionnaire alphabétique et analogique de la langue française*, Paris: Dictionnaires Le Robert, 2000.
Online Etymology Dictionary.
Oxford Advanced Learner's Dictionary, Oxford University Press, 2004.

Bibliografi e përgjithshme

- Altenberg, E. P., Vago, R. M., *English grammar, understanding the basics*, Cambridge University Press, 2010.
Biber, D., Conrad, S., Leech, G., *Student Grammar of Spoken and Written English*, Longman, 2002 .
Cipo, K., *Gramatika shqipe*, 1949.
Cipo, K., *Sintaksa*, Tiranë, 1952.
Collins ELT, *English grammar*, Cobuild, 1990.
Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002.
Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002.
Huddleston, R., Pullum, G. K., *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press, 2002.
Nelson, G., *English, an essential grammar*, Routledge, 2001.
Prifti, S., *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 1971.
Quirk, R., Greenbaum, S., *A student's grammar of the English language*, London: Longman, 1990.
Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G., Svartvik, J., *A comprehensive Grammar of the English Language*, Longman, 1985.
Swan, M., *Practical English usage*, Oxford University Press, 2005.
Sheperi, I. D., *Gramatika dhe Sindaska e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001.
Willis, D., *Student's grammar*, Collins Cobuild, 2002.

Bibliografi e veçantë

- Aikhenvald, A. Y., *Imperatives and commands*, Oxford University Press, 2010.
- Akmaijan, A., Demers, R. A., Farmer, A. K., Harnish, R. M., *Linguistics, an introduction to language and communication*, MIT, 2001.
- Aloni, M., *Utility and implicatures of imperatives*, Proceedings of DIALOR'05, 2005.
- Ascoli, C., *Some pseudo-imperatives and their communicative function in English*, Folia Linguistica, Volume 12, 2009.
- Austin, J. L., *How to do things with words*, William James Lectures, Oxford University Press, 1962.
- Azar, B. S., *Understanding and using English grammar*, 1988.
- Beukema, F., Dikken, M., *Clitic phenomena in European languages*, John Benjamin Publishing Co., Vol. 30, 2000.
- Bezhani, H., *A short historical grammar of English language*, SHBLU, Tiranë, 2002.
- Bošković, Z., *When are negatives banned?* University of Connecticut, Proceedings of SinFonIJA3, 2011.
- Brinton, L. J., *The structure of modern English, a linguistic introduction*, John Benjamins publishings, 2000.
- Brinton, L. J., *The structure of modern English, A linguistic introduction*, John Benjamins, 2000.
- Chamo, I. Y., "The language of Hausa films: forging a new discourse", International Journal of Linguistics, 2012, Vol. 4, Nr. 3.
- Chomsky, N., *Aspects of the Theory of Syntax*, Cambridge, Massachussets, 1972.
- Chomsky, N., *Lectures on government and binding*, Dordrecht: Foris, 1981.
- Chomsky, N., *Some concepts and consequences of the theory of government and binding*, Cambridge MA: MIT Press, 1982.
- Chomsky, N., *Some empirical issues in the theory of transformational grammar*, Goals of linguistic theory, 1972.
- Chomsky, N., *Syntactic structures*, second edition, Mouton de Gruyter, 2002.
- Collins, P., *The handbook of English Linguistics*, Blackwell Publishing Ltd 2006.
- Conditionalized imperatives*, Proceedings of SALT XV, 2006.
- Condovardi, C., Lauer, S., *Imperatives: Meaning and illocutionary force*, Empirical Issues in Syntax and Semantics 9, 2012.
- Cotter, C., *Claiming a piece of the pie: How the language of recepies defines community, Recipes for Reading: Community Cookbooks, Stories, Histories*, University of Massachusetts Press, 1997.
- Cowan, R., *The teacher's grammar of English language*, Cambridge University Press 2008
- Çeliku, M., *Sintaksë e gjuhës shqipe, përbërësit sintaksorë*, Tiranë: ILAR, 2012.
- Çeliku, M., *Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde*, Tiranë: ILAR, 2007.
- Davies, E., *The English imperative*, Croom Helm, 1986.
- Demiraj, Sh., *Gjuhësi ballkanike*, Logos, Shkup, 1994.
- Demiraj, Sh., *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 1976.
- Demiraj, Sh., *Rreth kategorisë gramatikore të kohës dhe mënyrës në gjuhën shqipe*, SF. 3, 1977.
- Dibra, K., Varfi, N., *Gjuhësi teksti*, Albatros, 2007.
- Dhima, Th., *Gjuha shqipe*, Sintaksa, Tiranë, 2005.
- Dhima, Th., *Histori e Gjuhësisë*, INFBOTUES, Tiranë, 2014.
- Dhima, Th., *Mbi klasifikimin e foljeve sipas valencës*, Seminari XXI Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2002.

- Eckardt, R., *Imperatives as future plans*, Proceedings of Sinn & Bedeulung 13, Saarland University press, 2011.
- Flagg, E. J., *Interface issues in the English imperatives*, Dissertation, Massachusetts Institute of Technology, 2002.
- Fortuin, E., Boogart, R., *Imperative as conditional: From constructional to compositional semantics*, Cognitive Linguistics, vol. 20, 2009.
- Franke, M., *Pseudo-imperatives*, Institute for Logic and Computation, 2005.
- Graffi, G., *Ç'është gramatika gjenerative*, Toena, 2008.
- Graffi, G., *Sintaksa*, Dituria, 2008.
- Haegeman, L., *Introduction to government and binding theory*, Cambridge University Press, 1991.
- Han, Ch., *The structure and interpretation of imperatives*, Garland publishings, Inc, 2000.
- Haspelmath M., & Muller-Bardey, T., *Valence change*, Morphology, a handbook on inflection and word formation, Vol. 2, Berlin: de Gruyter, 2001.
<http://dualibra.com/ligjërimi-i-folur-dhe-i-shkruar/>
- Isac, D., *Imperatives are modal*, Bucharest Working Papers in Linguistics, Volume 14, Nr. 2.
- Islamaj, Sh., *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2004.
- Jensen, B., *Syntax and semantics of imperative subjects*, Proceedings of 19-th Scandinavian Conference of Linguistics, Vol. 31.1, 2003.
- Jespersen, O., *A modern English Grammar on historical principles*, London.
- Jespersen, O., *Essentials of English Grammar*, Routledge, London 1933.
- Jespersen, O., *Language, its nature, developement and origin*, London: George, 1992.
- Jespersen, O., *The philosophy of grammar*, London, 1934.
- Kallulli, D., *Direct object clitic doubling in Albanian and Greek*, Oxford Studies in Comparative Syntax, 2001.
- Kaufmann, M., *Interpreting imperatives*, Springer, 2012.
- Kimps, D., Davidse, K., *Illocutionary force and conduciveness in imperative constant polarity tag questions: A typology*, Walter de Gruyter, 2008.
- Koopman, H., *Topics on imperatives*, UCLA, 2001.
- Kovacs, F., *Linguistic structures and linguistic laws*, B. R. Gruner Amsterdam, 1971, fq. 82.
- Kreidler, Ch. W., *Introduction to English Semantics*, Routledge 2002.
- Lakoff, R., *Language and woman's place*, Cambridge University Press, 1975.
- Levinson, D., *Polarity Sensitivity in Inflectional Morphology*, Standford University, 2006.
- Levinson, S. C., *Pragmatics*, Cambridge University Press, 2003.
- Lewis, D., *General Semantics*, Reidel Publishing Company, 1970.
- Linghong, Zh., *The linguistic features of English advertising*, CELEA Journal, Vol. 29, Nr.1, 2006.
- Lyons, J., *Semantics*, Vol. 2, Cambridge University Press, 1977.
- Lloshi, XH., *Stilistika dhe Pragmatika*, Toena 1999.
- Mansaku, S., *Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare*, SF, Nr. 3, Tiranë, 1969.
- Mastop, R., *What can you do? Imperative mood and semantic theory*, PhD dissertation, Amsterdam: ILLC, 2005.
- Mathews, P. H., *Morphology*, second edition, Cambridge University Press, 2006.
- Mauck, S., Portner, P., Zanuttini, R., *Imperative subjects: A cross-linguistic perspective*, Georgetown University, 2004.
- Mauck, S., Zanuttini, R., *The subjects of English imperatives*, 2004.
- Medeiros, D. J., *Formal approaches to the syntax and semantics of imperatives*", Dissertation, University of Michigan, 2013.
- Memushaj, R., *Gjuhësia gjenerative*, shblu, Tiranë, 2003.

- Memushaj, R., *Hyrje në gjuhësi*, Dituria 2002.
- Meyer, Ch. F., *Introducing English Linguistics*, Cambridge University Press, 2009.
- Meyer, F., *Introducing English Linguistics*, Cambridge University Press, 2009.
- Mita, J. *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, 2005.
- Panajoti, J. *Proza popullore*, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë, 1985.
- Portner, P., *Imperatives and Modals*, Natural Language Semantics, 15 (4).
- Portner, P., *Imperatives*, *Handbook of Semantics*, Cambridge University Press, 2013.
- Portner, P., *The semantics of imperative within a theory of clause*, Proceedings of Semantics and Linguistic Theory, XIV, CLC publications, 2004.
- Portner, P., *Vocatives, Topics and Imperatives*, IMS Workshop on information structure, 2004.
- Potsdam, E., *Analyzing word order in the English imperative*, In Wim van der Wurff (ed.), *Imperative Clauses in Generative Grammar*. Amsterdam: John Benjamins, 2007.
- Potsdam, E., *Phrase Structure of the English Imperative*, *The Proceedings of the Sixth Annual Meeting of the Formal Linguistics Society of Midamerica*. Bloomington: Indiana University Linguistics Club Publications.
- Potsdam, E., *Syntactic issues in the English imperatives*, New York: Garland, 1998.
- Radford, A., *Transformational Grammar*, Cambridge University Press, 1992.
- Ren, J., *An Analysis of Cohesion Achieved by Imperative Clause in English Netvertising*, Theory and Practice in Language Studies, Vol. 1, No. 6, 2011.
- Rupp, L., *The syntax of imperatives in English and Germanic*, Palgrave Macmillan, 2003.
- Rrokaj, Sh., *Filozofi e gjuhës, prej antikitetit në kohën e sotme*, Arbëria 2010.
- Searle, J. R., Vanderveken, D., *Speech acts and illocutionary logic*, Logic, Thought and Action, Cambridge University Press, 1985.
- Semantics, An international handbook of natural Language meaning*, Volume 2, Walter de Gruyter, 2011.
- Simon, S., *Sentence types in Appellative Advertisements*, Scientific Bulletin of the "Politehnica" University of Timisoara, Transactions on modern languages, vol. 9, nr.1-2, 2010.
- Singh, I., *The history of English*, Hodder Education, 2005.
- Starr, W. B., *A preference semantics for imperatives*, Dissertation, 2010.
- Stefanllari, R., Hintz, B., *541 Albanian verbs*, Albatros, 2006.
- Sharra, Th., *A comprehensive English Grammar*, Tiranë 1981.
- Shehri, Dh., *Diskursi poetik si diskurs politik*, Studime Albanologjike (*Homopeticus-homopolitikus*), Fakulteti i Historisë dhe filologjisë, UT, Tiranë, 2012\2.
- Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009.
- Takahashi, H., *A cognitive linguistic analysis of English imperative: with special reference to Japanese imperatives*, John Benjamins, 2012.
- Takahashi, H., *A usage-based analysis of imperative verbs in English (1)*, The Annual Report on Cultural Science 121, 2007.
- Takahashi, H., *A usage-based analysis of imperative verbs in English (2)*, The Annual Report on Cultural Science 122, 2007.
- Takahashi, H., *Let's imperatives in conversational English*, Journal of the Graduate School of letters 4.
- Takahashi, H., *Let's-imperatives in Conversational English*, Journal of the Graduate School of Letters 4, 2009.
- Topalli, K., *Rreth trajtës foljore të mënyrës dëshirore në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike, Nr. 3-4, 1998.
- Topalli, T., *Gjuhësi teksti*, Shkodër, 2011. Dhima, Th., *Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe*, Infbotues, Tiranë, 2013.

- Totoni, M., *Fraza me nënrenditje*, Shblu Tiranë, 2000.
- Totoni, M., *Sintaksa e gjuhës shqipe, Fraza e përbërë*, Arbëria, 2012.
- Turano, G., *On clitics and negation in Albanian*, Rivista di grammatica generativa, vol. 25.
- Van der Wurff, W., *Imperative clauses in generative grammar*, Benjamins publishings, 2007.
- Vanderveken, D., *Searle on meaning and action*, Speech Acts, Mind and Social Reality discussions with Searle, Dordrecht, 2002.
- Waltereit, R., *Imperatives, interruption in conversation and the rise of discourse markers: a study of Italian “guarda”*, Linguistics, Walter de Gruyter, 2002
- Wilson, D., Sperber, D., *Mood and the analysis of non-declarative sentences*, Cambridge University Press, 2012.
- Williams, Ch., *The use of progressive tenses in imperative*, Nottingham Linguistic Circular 16, 2001.
- Xrakovskij, V. S., *Typology of imperative constructions*, Lincom Europa, 2001.
- Zanuttini, R., *Addressing the Addressee in Imperatives*, Georgetown University, 2005.
- Zanuttini, R., & Portner, P., *Exclamative Clauses: At the Syntax–Semantics Interface*, Language, Vol. 79, Nr. 1, 2003.
- Zanuttini, R., *Encoding the addressee in the syntax: evidence from English imperative subjects*, Natural Language and Linguistic Theory 26, 2008.
- Zeijlstra, H., *The ban on true negative imperatives*, Empirical Issues in Syntax and Semantics 6, 2006.
- Zekaj, M., *Gjuha e Musine Kokalarit në veprat e saj origjinale*, Disertacion, Tiranë 2011.
- Zwicky, A., *On the subject of bare imperatives in English*, Duncan-Rose & Vennemann, Festschrift for Robert P. Stockwell, 1988.
- Zhang, Sh., *Sentence types: A look at imperative constructions*, Proceedings of the Western Conference on linguistics: WECOL 89, Vol 2.

Burime të vjela:

Letërsi artistike:

- Kuteli, M., *Tregime të zgjedhura*, Naim Frashëri, 1972.
- Kongoli, F., *Porta e Shën Pjetrit*, Toena, 2005.
- Beauman, S., *Destiny*, Bantam books, 1988.
- Armstrong, K., *The summoning*, HarperCollins Publisher, 2008.
- Armstrong, K., *The awakening*, HarperCollins Publisher, 2009.
- Harris, Ch., *Dead reckoning*, Ace books, 2011.
- Lewis, C. S., *The lion, the witch and the wardrobe*, Lions, 1988.
- Koreshi, V., *Tregime të zgjedhura*, Naim Frashëri, 1972.
- Kokalari, M., *...sa u tunt' jeta*, Tiranë, 1944.
- Noli, F. S., *Vepra I*, Botimet Dudaj, 2003.
- Sheldon, S., *Bloodline*, Morrow, 1977.
- Crompton, R., *William the tramp*, Macmillan books.
- Filma:**
- Ridley, J., *12 years a slave*, 2013.
- Singer, E. W., Russell D. O., *American hustle*, 2013.
- Millis, M., *Beginners*, 2010.
- Farhadi, A., *The past*, 2013.
- Krasinski, J., Damon, M., *Promised land*, 2012.